NDI	Instituti Kombëtar Demokratik	UNHCR	Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
OJQ	Organizatat Joqeveritare	UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
OJF	Organizatat Jofitimprurëse	USAID	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut		
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë		
OSFA	Fondacioni i Shoqërisë së Hapur Shqipëri		

TVSH Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
KQV Komisionet e Qendrave të Votimit

ORGANI LEGJISLATIV

PËRMBLEDHJE



Shqipëria është një republikë parlamentare. Kuvendi ka 140 deputetë të zgjedhur në bazë të sistemit zgjedhor proporcional në nivel rajoni me prag kombëtar prej një përqind dhe lista gjysmë të hapura, ku qytetarët kanë një votë preferenciale. Legjislatura e dhjetë nisi në shtator të vitit 2021.⁵⁸

Vihet re mungesa e pavarësisë së pushtetit legjislativ nga pushteti ekzekutiv për shkak të efekteve të sistemit zgjedhor, mungesës së demokracisë brendapartiake, qeverisjes njëpartiake dhe veprimeve të dobëta të opozitës për shkak të mosmarrëveshjeve dhe konflikteve të brendshme. Mbikëqyrja e Kuvendit ndaj organit ekzekutiv drejtpërdrejt ose me anë të mbështetjes së zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Lartë të Auditimit (KLSH) dhe Avokatit të Popullit për qeverinë është e dobët.

Kohët e fundit, Kuvendi ka shtuar transparencën dhe llogaridhënien e tij duke u angazhuar në mënyrë më aktive në konsultimin publik dhe me shoqërinë civile, por ky angazhim vazhdon të mbetet kryesisht formal për vendimmarrjen e Kuvendit. Megjithatë vazhdojnë të ekzistojnë mekanizma për sigurimin e integritetit të deputetëve, Kuvendi nuk e monitoron zbatimin e tyre. Dispozitat e etikës dhe integritetit zbatohen në mënyrë të dobët dhe sjellja e pahijshme e deputetëve në shumicën e rasteve nuk ndëshkohet. Kuvendi ka burime financiare të planifikuara dhe të përshtatshme, por stafi i tij politik dhe administrativ ekzistues në mbështetje të deputetëve është i pamjaftueshëm për veprimtarinë e gjerë të Kuvendit.

Kuvendi u ka dhënë prioritet reformave kundër korrupsionit nëpërmjet ratifikimit të konventave ndërkombëtare dhe miratimit të një kuadri të gjerë legjislativ, si dhe u ka dhënë prioritet reformave të tjera lidhur me mirë qeverisjen në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian (BE). Megjithatë, kuadri i organit legjislativ është akoma i fragmentuar. Përmban hendeqe lidhur me partitë politike dhe financat e fushatës dhe reformat janë kryesisht të paefektshme ose nuk kanë dhënë akoma rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit në vend.

KAPACITETET

TREGUESI 1.1.1 BURIMET (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë dispozita që i sigurojnë organit legjislativ burime të përshtatshme financiare, njerëzore dhe infrastrukturore për të përmbushur me efektivitet detyrat e tij?

Rezultati 100

Ekzistojnë dispozita të mjaftueshme në Kushtetutë, Ligjin për Statusin e Deputetëve dhe Rregulloren e Kuvendit për të siguruar që organi legjislativ të marrë burime të përshtatshme për të përmbushur me efektivitet detyrat e tij.

Në bazë të Kushtetutës, organizimi dhe funksionimi i Kuvendit bazohet në rregulloren e tij e cila miratohet me shumicë absolute të deputetëve.⁵⁹ gstaffit si pjesë e buxhetit të shtetit i cili miratohet

me ligj. Byroja e Kuvendit është organi vendimmarrës nga ana administrative dhe financiare.⁶⁰ Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit, duke bashkëpunuar me Sekretarin e Përgjithshëm, ndjek dhe mbikëqyr të gjitha procedurat e hartimit të buxhetit vjetor dhe afatmesëm deri në miratimin e tij nga Byroja, si dhe mbikëqyr zbatimin e buxhetit gjatë vitit.⁶¹ Projektbuxheti i miratuar nga Byroja i dorëzohet Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, i cili mban përgjegjësi për diskutimin e projektligjit mbi buxhetin e shtetit dhe më pas i dërgohet Kuvendit për miratim përfundimtar.⁶² Megjithatë qeveria mund të bëjë shkurtime buxhetore afatmesme me akte normative të marra nga Këshilli i Ministrave, këto akte duhet të miratohen nga Kuvend brenda 45 ditëve.⁶³

Ligji për statusin e deputetit parashikon përfitime financiare shtesë për deputetët, si mbulimi i qirasë së tyre nëse nuk janë rezidentë në kryeqytet, shpenzimet për shërbime telefonike dhe trajtime të specializuara shëndetësore jashtë vendit nëse nuk ofrohen brenda vendit.⁶⁴ Gjithashtu, ligji parashikon që komisionet parlamentare, grupet parlamentare dhe deputetët, duke përfshirë stafin e tyre të emërimit, pajisen me zyra brenda ambienteve të Kuvendit si dhe zyra në çdo qark, një për deputetët e mazhorancës dhe një për deputetët e opozitës.⁶⁵

Veprimtaria administrative e Kuvendit drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm,⁶⁶ i cili mban përgjegjësi për veprimet e tij para Kryetarit të Kuvendit dhe Byrosë së Kuvendit.⁶⁷ Kuvendi është i pavarur për sa i përket rekrutimit dhe vetëadministrimit të marrëdhënieve të punës së stafit të tij.⁶⁸ Së fundmi është miratuar strategjia e re e burimeve njerëzore dhe rregullorja e brendshme për punën e Kuvendit.⁶⁹

TREGUESI 1.1.2 BURIMET (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli organi legjislativ ka burime të mjaftueshme për të përmbushur detyrat e tij?



Organi legjislativ ka burime të mjaftueshme financiare. Megjithatë, numri i deputetëve që mbështesin veprimtarinë parlamentare është i ulët dhe ka vende të lira të konsiderueshme në burimet njerëzore administrative dhe politike, të cilat mund të ndikojnë në performancën e deputetëve dhe të Kuvendit.

Ndonëse Kuvendi ka rënë dakord çdo vit për rishikimet e buxhetit që devijojnë nga buxheti i planifikuar, për shembull për shkak të numrit më të ulët të deputetëve nga viti 2019 në 2021 pasi deputetët e partive opozitare shfuqizuan mandatet e tyre ose për shkak të situatës emergjente gjatë COVID-19 në 2020, buxheti i tij i përgjithshëm ka qenë i mjaftueshëm për të përmbushur në mënyrë efektive detyrat e tij.⁷⁰

Është instaluar infrastruktura digjitale dhe burimet e tjera teknike si sistemi elektronik i votimit dhe sistemi me audio dhe video për të mbështetur aktivitetet në komisionet parlamentare dhe seancat plenare, si dhe për të siguruar akses më të mirë të këtyre aktiviteteve për publikun.⁷² Instituti Parlamentar është krijuar në vitin 2020 me tetë punonjës për t'u ofruar deputetëve informacione kërkimore ose të tjera në kuadër të roleve të tyre përfaqësuese, legjislative dhe vëzhguese.⁷³ Njëzet e katër zyra që do jenë në dispozicion të deputetëve, një për deputetët e mazhorancës dhe një për deputetët e opozitës në secilin prej 12 qarqeve të Shqipërisë, të cilat janë krijuar për të lehtësuar komunikimin e deputetëve me votuesit e tyre.⁷⁴ Ndërkohë, në ambientet e Kuvendit ofrohen zyra

Buxheti/viti	2019	2020	2021	2022
Buxheti i planifikuar për Kuvendin në lekë dhe euro ⁷¹	1,324,000,000 lekë 10,852,459 euro	1,341,000,000 lekë 10,982,800 euro	1,153,160,000 lekë 9,375,284 euro	1,431,566,000 lekë 12,288,120 euro
Buxheti i rishikuar për Kuvendin	1,231,000,000 lekë 10,090,163 euro	1,174,100,000 lekë 9,703,306 euro	1,050,293,440 lekë 8,538,970 euro	-

individuale vetëm për funksione të caktuara si kryetari dhe kryetarët e grupeve parlamentare dhe komisioneve parlamentare, ndërsa deputetët në përgjithësi i ndajnë zyrat.⁷⁵

Sipas një studimi të Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) në vitin 2020 në një këndvështrim krahasues, Kuvendi i Shqipërisë kishte numrin më të ulët të stafit administrativ, si dhe stafit jopartiak dhe partiak për deputet.⁷⁶ Megjithatë, kohët e fundit ka pasur një rritje të numri të stafit politik të përkushtuar për të mbështetur veprimtarinë parlamentare. Për shembull, aktualisht ka tetë këshilltarë për dy grupet më të mëdha parlamentare krahasuar me katër më parë, dhe ka një këshilltar të dedikuar për grupet më të vogla parlamentare. Të gjitha grupet parlamentare kanë një sekretar për veprimtaritë e tyre.⁷⁷ Megjithatë, sipas një këshilltari të grupit parlamentar të Partisë Socialiste, që përbëjnë shumicën parlamentare, stafi politik nuk është i mjaftueshëm për veprimtarinë e gjerë të komisioneve parlamentare dhe të Kuvendit. Komisionet parlamentare mbështeten vetëm nga dy këshilltarë dhe numri i stafit politik të përkushtuar për të mbështetur grupet parlamentare është akoma i ulët krahasuar me vendet e tjera të rajonit.⁷⁸ Nuk ka asistent personal për të mbështetur veprimtarinë e deputetëve përveç stafit politik për grupin parlamentar.⁷⁹

Duke qenë se Kuvendi e konsideron numrin e shtuar të stafit administrativ të miratuar si të mjaftueshëm, ka mjaft vende të lira të stafit në stafin administrativ ose politik, të cilat mund të ndikojnë në performancën e punës së Kuvendit.⁸⁰ Kuvendi nuk ofron të dhëna të qarta për stafin e përgjithshëm të planifikuar dhe aktual administrativ apo politik në raportet e tij. Megjithatë, raportohet se në vitin 2019, 43 anëtarë të stafit administrativ dhe politik të Kuvendit kishin lënë punën e tyre.⁸¹ Në vitin 2020, krahasuar me 407 anëtarë të planifikuar në total, ku përfshihen deputetët dhe stafi i Kuvendit, numri i përgjithshëm aktual ishte 339, dhe në vitin 2021, krahasuar me 409 anëtarë të stafit të planifikuar, gjithsej numri i anëtarëve të stafit aktual ishte 356.⁸² Numri i përafërt i vendeve vakante për

stafin politik dhe administrativ të Kuvendit ishte më shumë se 60 në 2020 dhe mbi 50 në 2021.⁸³

TREGUESI 1.1.3 PAVARËSIA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli organi legjislativ është i pavarur dhe i lirë nga nënshtrimi ndaj aktorëve të jashtëm me ligj?

100

Rezultati

Kuadri legjislativ siguron në mënyrë gjithëpërfshirëse pavarësinë e organit legjislativ.

Presidenti i Republikës mbledh Kuvendin e sapozgjedhur, ose nëse nuk e ushtron këtë kompetencë, Kuvendi mblidhet vetë.⁸⁴ Në mënyrë të ngjashme, Kuvendi mund të mblidhet sërish jashtë seancave normale nëse kërkohet nga një e pesta e të gjithë deputetëve.⁸⁵ Kuvendi zgjedh dhe shkarkon kryetarin e tij dhe kontrollon emërimet në komisionet e tij të përhershme dhe të posaçme⁸⁶ dhe përcakton agjendën e tij.⁸⁷

Ligjvënësit nuk janë ligjërishit përgjegjës për votat dhe fjalimet e tyre të shprehura në Kuvend, me përjashtim të shpifjeve. Ata gëzojnë imunitet, të cilin mund ta heqë vetëm Kuvendi, përveç nëse zbulohen se janë duke kryer një krim.⁸⁸ Kuvendi mund të shkarkohet para përfundimit të mandatit të tij katërvjeçar nëse nuk arrin të zgjedhë Presidentin e Republikës ose Kryeministrin, ose nëse një mocion besimi i paraqitur nga Këshilli i Ministrave miratohet nga më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.⁸⁹

Autoriteti i organit ekzekutivi kundrejt atij legjislativ u zbatua në vitin 2008 përmes dispozitës kushtetuese të një mocioni konstruktiv të mosbesimit,⁹⁰ pasi Kuvendi duhet të zgjedhë një kryeministër të ri me një shumicë absolute përpara se të shpërbëjë qeverinë aktuale.⁹¹ Gjithashtu, çdo nismë ligjore joqeveritare që rrit shpenzimet buxhetore ose redukton të ardhurat e shtetit nuk mund të miratohet nga Kuvendi pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve.⁹² Megjithatë, organi legjislativ

autorizon qeverinë dhe miraton dhe shqyrton buxhetin e shtetit dhe veprimtarinë e përgjithshme ekzekutive.⁹³

TREGUESI 1.1.4 PAVARËSIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli organi ekzekutiv nuk është subjekt i vartësisë ndaj aktorëve të jashtëm?



Organi ekzekutiv shpesh ndërhyr në aktivitetet e organit legjislativ me pasoja në sjelljen e këtij të fundit.

Megjithëse Shqipëria prezantoi një sistem zgjedhor proporcional në nivel qarku në vitin 2009, ajo ka krijuar një shumicë njëpartiake në Kuvend që nga viti 2017,⁹⁴ e cila ka fuqizuar stabilitetin e organit ekzekutiv përballë atij legjislativ më shumë se në një sistem zgjedhor me shumicë të thjeshtë.

Kryeministri, përveç se është kryetari i partisë në pushtet, ai vendos edhe për renditjen e listave të kandidatëve për deputetë, të cilat si rrjedhojë janë më shumë të lidhura me liderin e partisë politike sesa me një zonë elektorale dhe qytetarët e saj. Në Shqipëri, dominimi i kryetarit të partisë politike zbatohet edhe nëpërmjet demokracisë brendapartiake në nivel të ulët për përzgjedhjen e kandidatëve për deputetë, liderëve të fortë politikë dhe mungesës së mbështetjes për partitë partiake.⁹⁵ Megjithatë, listat e kandidatëve për deputetë u hapën pjesërisht në vitin 2021 përmes prezantimit të një vote preferenciale. 17 kandidatë kanë kaluar koeficientin zgjedhor dhe tre prej tyre janë zgjedhur me ripozicionim për shkak të mbështetjes zgjedhore.⁹⁶ Megjithatë, edhe ata ishin pjesë e listave të përcaktuara nga kryesia e partisë.

Veprimtaria institucionale e Kuvendit u pengua edhe nga partitë opozitare, të cilat shfuqizuan mandatet e tyre nga shkurti 2019 deri në fund të legjislaturës në 2021 dhe u zëvendësuan nga kandidatë të partive të vogla ose kandidatë që ishin deputetë të pavarur. Kjo nënkuptonte se veprimtaria e partisë kryesore opozitare ishte jashtëparlamentare. Partitë kryesore opozitare iu rikthyen aktiviteteve parlamentare në

legjislaturën e re që filloi në shtator 2021 dhe drejtojnë tre nga tetë komisionet e përhershme të Kuvendit dhe dy nga shtatë sekretariatet e Byrosë së Kuvendit. Një deputet i opozitës është edhe një nga dy nënkryetarët e Kuvendit.⁹⁷ Megjithatë, organi i ri legjislativ e konsideroi partinë kryesore opozitare të fragmentuar për shkak të konflikteve të brendshme për kreun e partisë, duke penguar aktivitetin e përbashkët politik në organin legjislativ.

Organi ekzekutiv gëzon iniciativën kryesore legjislativ dhe nga janari 2021 deri në korrik 2022 ka propozuar rreth 86% të projektligjeve. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur raste të projektligjeve të paraqitur nga qeveria që Kuvendi nuk i ka votuar.⁹⁸ Megjithatë, Kuvendi angazhohet kryesisht në ndryshimin e propozimeve të qeverisë dhe në vitin 2021 ka miratuar gjithsej 940 amendamente për projektligje.⁹⁹ Mungesa e pavarësisë së Kuvendit nga organi ekzekutiv është e dukshme edhe në mbikëqyrjen e dobët të veprimtarisë qeveritare drejtpërdrejt ose duke mbështetur rekomandimet e organeve të pavarura për organin ekzekutiv (*shih 1.3.1*).

QEVERISJA

TREGUESI 1.2.1 TRANSPARENCA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë dispozita që sigurojnë që publiku të mund të marrë informacion përkatës dhe në kohë mbi aktivitetet dhe proceset vendimmarrëse të organit legjislativ?



Ekzistojnë disa dispozita gjithëpërfshirëse në Kushtetutë, Rregulloren e Kuvendit dhe në Ligjin për të Drejtën e Informimit¹⁰⁰ të cilat sigurojnë që publiku të mund të marrë informacion për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit, për vendimet që ai merr dhe se si janë marrë këto vendime. Nuk ka afate për publikimin e procesverbaleve me shkrim të seancave plenare dhe mbledhjeve të komisioneve pas miratimit të tyre. Megjithatë, seancat e tyre transmetohen në televizionin publik.

Sekretariati për Transparencë dhe Teknologjinë e Informacionit të Kuvendit është përgjegjës për sigurimin dhe mbikëqyrjen e transparencës së institucionit për publikun.¹⁰¹ Në përgjithësi, mbledhjet e Kuvendit duhet të jenë të hapura, me përjashtim të rasteve kur shumica e deputetëve një e pesta e tyre kanë votuar kundër, pas propozimit të Presidentit të Republikës, Kryeministrit, ose një të pestës së deputetëve.¹⁰²

Veprimtaria e hapur e Kuvendit realizohet nëpërmjet transmetimit të veprimtarisë së tij në mediat e shkruara dhe vizive pa pagesë dhe nëpërmjet publikimit të dokumentacionit parlamentar. Sipas Rregullores së Kuvendit, miratimi i programit politik dhe i përbërjes së Këshillit të Ministrave, seancat e pyetjeve, seanca javore pyetje-përgjigje, interpelanca, interpelanca urgjente, mocionet, mocionet e besimit dhe mosbesimit, si dhe raportet e komisioneve hetimore transmetohen të plota në televizionin publik.¹⁰³ Në seancat plenare të Kuvendit marrin pjesë edhe përfaqësues të akredituar të mediave të shkruara dhe elektronike.¹⁰⁴ Për më tepër, dokumentacioni parlamentar duhet të publikohet në format të shkruar dhe në faqen zyrtare të Kuvendit. Dokumentacioni parlamentar përfshin agjendat e seancave legislative dhe seancave dëgjimore të komisioneve, tekstet e projektligjeve të paraqitura ose amendamentet e propozuara së bashku me dokumentacionin shoqëruar të tyre, procesverbalet e votimit dhe procesverbalet e seancave plenare ose mbledhjeve të komisioneve parlamentare.¹⁰⁵ Procesverbali publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit pas miratimit përfundimtar të tyre në seancën plenare ose mbledhjen e komisionit pasardhës.¹⁰⁶ Ndonëse mbledhjet e komisioneve dhe seancat plenare transmetohen në televizionin publik, nuk ka afat për publikimin e procesverbaleve me shkrim pas miratimit përfundimtar të tyre.

Ekzistojnë dispozita që u mundësojnë publikut të kenë akses dhe të marrin pjesë në seancat legislative, si dhe t'i dërgojnë kërkesat Kuvendit.¹⁰⁷

Byroja e Kuvendit miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Kuvendit në mars dhe raportin vjetor të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen

e Kuvendit dhe të dy raportet duhet të publikohen në faqen e internetit të Kuvendit.¹⁰⁸ Gjithashtu, Byroja autorizon publikimin e shpenzimeve financiare të bëra nga Kuvendi në faqen zyrtare një herë në dy muaj.¹⁰⁹ Deklaratat e deputetëve për interesat dhe pasuritë private mund të publikohen vetëm në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, që nënkupton se të dhënat personale duhet të rishikohen (*shih 10.2.1*).¹¹⁰

Deklaratat me shkrim të deputetëve për konfliktin e interesit duhet të publikohen në çdo rast në faqen zyrtare të Kuvendit.¹¹¹ Për më tepër, Kuvendi duhet të zbatojë ligjin për të drejtën e informimit për të publikuar programin e tij të transparencës ose duke i dhënë publikut informacion sipas kërkesës brenda dhjetë ditëve pune.¹¹²

TREGUESI 1.2.2 TRANSPARENCA (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli publiku mund të marrë informacion përkatës dhe në kohë mbi aktivitetet dhe proceset vendimmarrëse të organit legjislativ?



Publiku mund të marrë informacionin përkatës për pjesën më të madhe të elementeve lidhur me organizimin dhe funksionimin e organit legjislativ për vendimet që kanë të bëjnë me të dhe mënyrën e marrjes së këtyre vendimeve. Megjithatë, ka vonesa në publikimin e procesverbaleve të mbledhjes pas miratimit të tyre dhe faqja e internetit e Kuvendit është duke u krijuar.

Një grup parlamentar pune për standardet e transparencës ekziston që nga viti 2021, ndërsa Kuvendi është drejt fundit të miratimit të standardeve dhe treguesve të qartë të transparencës bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare për një parlament të hapur dhe promovimin e një dialogu konstruktiv me shoqërinë civile.¹¹³

Megjithatë, Kuvendi ka lehtësuar pjesëmarrjen e publikut në seancat e tij. Kuvendi ka lëshuar 546 leje

për anëtarët e publikut që të marrin pjesë në seancat e Kuvendit në 2021.¹¹⁴ Brenda Institutit Parlamentar është krijuar shërbimi i edukimit qytetar për të inkurajuar qytetarët që të përshihen në mënyrë aktive në punët e Kuvendit.¹¹⁵

Kanali i dedikuar për televizionet kombëtare transmeton në mënyrë të drejtpërdrejtë seancat plenare të Kuvendit. Seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve parlamentare me interesa publike, si dhe informacione të mëtejshme për veprimtarinë e Kuvendit, transmetohen edhe në profilet e Kuvendit nëpër rrjete sociale.¹¹⁶

Nëpërmjet legjislaturës së re në vitin 2021, Kuvendi gjithashtu ka përmirësuar transparencën e tij për publikun, që përfshin publikimin e raportit vjetor të Kuvendit dhe raportin vjetor të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen e Kuvendit, procesverbalet e komisioneve parlamentare dhe të seancave plenare, rezultatet e votimeve, të dhënat statistikore për deputetët ose për veprimtarinë e Kuvendit, buxhetin e Kuvendit dhe raportet e tij për monitorimin si dhe shpenzimet për çdo deputet dhe rastet kur deputetët nuk marrin pjesë në votim për shkak të konfliktit të mundshëm të tyre të interesit në faqen zyrtare të Kuvendit.¹¹⁷

Transparenca e përmirësuar në Kuvend tregohet edhe në raportet e monitorimit të organizatave të shoqërisë civile. Mirëpo, vazhdon të ketë vonesa në zbatim për publikimin e procesverbaleve me shkrim të mbledhjeve të komisioneve parlamentare apo seancave plenare pas miratimit të tyre dhe faqja zyrtare e Kuvendit është në ndërtim e sipër prej disa muajsh, gjë që në fakt krijon vështirësi në qasjen e informacionit të publikuar.¹¹⁸

TREGUESI 1.2.3 LLOGARIDHËNIA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë dispozita që sigurojnë se organi ligjvënës duhet të raportojë dhe të mbajë përgjegjësi për veprimet e tij?



Ekzistojnë dispozita për vlerësimin kushtetues të veprimtarive të organit legjislativ. Megjithatë, dispozitat për konsultim publik nuk e lehtësojnë mundësinë e publikut për të përcjellë komente dhe konsultimi me grupet e interesuara gjykohet nga komisionet parlamentare.

Megjithatë ligji për konsultimin publik përcakton detyrimin që projektaktet duhet të konsultohen me publikun,¹¹⁹ në zbatim ky proces vështirësohet nga dispozitat e Kuvendit. Manuali i ri i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen e Kuvendit, megjithatë i njeh publikut të drejtën për të përcjellë komente dhe rekomandime për projektaktet, për më tepër duke siguruar se ata duhet të marrin formën e ndryshimeve sipas teknikës së organit legjislativ.¹²⁰ Për më tepër, seanca dëgjimore publike e ekspertëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile, përfaqësuesve të grupeve të interesit dhe grupeve të tjera të interesuara gjatë procesit legjislativ në komisionet parlamentare gjykohet nga komisioni parlamentar përkatës, me përjashtim të rasteve kur një e treta e anëtarëve të tij kërkon shprehimisht seancat dëgjimore me anë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar.¹²¹

Gjykata Kushtetuese shqyrton përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe konfliktet e kompetencave ndërmjet degëve të pushtetit dhe jep gjykimin përfundimtar për ankesat e individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë e tyre themelore të garantuara nga Kushtetuta.¹²²

Për më tepër, Gjykata Kushtetuese jep vendimin përfundimtar ndaj vendimit të Kuvendit për shkarkimin e Presidentit të Republikës ose për konstatimin e paaftësisë së tij ligjore për të kryer detyrën, si dhe për të vendosur nëse një deputet ka

përfituar fonde publike ose ka bërë veprimtari fitimprurëse në kundërshtim me ligjin.¹²³ Deputetët nuk mbajnë përgjegjësi ligjore për mendimet e shprehura dhe votat e tyre në Kuvend, me përjashtim të rasteve të shpifjes.¹²⁴

TREGUESI 1.2.4 LLOGARIDHËNIA (ZBATIMI)

Në çfarë niveli organi legjislativ dhe anëtarët e tij raportojnë dhe mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre?



Megjithëse anëtarët e organit legjislativ duhet të raportojnë dhe të mbajnë përgjegjësi për veprime të caktuara të tyre, konsultimi publik me shoqërinë civile vazhdon të mbetet formal, vendimmarrja e Kuvendit dhe informimi publik për peticionet e marra nga qytetarët është e paefektshme dhe besimi i shoqërisë ndaj Kuvendit është i ulët.

Kuvendi publikon vazhdimisht raporte dhe dokumente për veprimtarinë e tij legjislative, por ky informacion nuk publikohet në kohën e duhur (*shih 1.2.2*). Duke filluar që nga viti 2017, disa deputetë janë dënuar nga gjykata për shpifje dhe u është kërkuar dëmshpërbim për kolegun apo qytetarët e fyer.¹²⁵ Megjithatë, dispozitat e tjera për përgjegjësinë e deputetëve zbatohen vetëm pjesërisht. Në 2017, Kuvendi ndaloi arrestimin e një deputeti të shumicës duke përdorur rregulloren e imunitetit dhe vetëm duke i dhënë autorizimin e prokurorisë për të kontrolluar banesën e tij.¹²⁶ Ish-deputeti u arrestua dhe u dënua pasi dha dorëheqjen vullnetarisht nga mandati parlamentar.¹²⁷ Në rastin më të fundit, Kuvendi nuk mundi të vendosë imunitetin për një tjetër deputet, sërish nga shumica, pasi ai kishte dhënë dorëheqjen vullnetarisht nga mandati dhe pasi prokuroria kërkoj arrestimin e tij.¹²⁸

Bazuar në një studim të vitit 2020, ekzistonte një hendek ndërmjet perceptimit të Kuvendit dhe atij të organizatave të shoqërisë civile që Kuvendi ta bëjë më të lehtë pjesëmarrjen në organizatat e shoqërisë

civile dhe grupeve të interesit në procesin legjislativ.¹²⁹ Kuvendi filloi të angazhohet në konsultime publike për çështjet përkatëse në vitin 2021 nëpërmjet zbatimit të një platforme të konsultimit publik dhe duke qenë më proaktiv në përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në veprimtarinë e organit legjislativ.¹³⁰ Megjithatë, bazuar në raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022, konsultimi me grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile vazhdon akoma të mbetet një procedurë formale.¹³¹

Në mënyrë të ngjashme, e dobët është edhe vendimmarrja e Kuvendit dhe informimi i publikut për peticionet e marra nga qytetarët. Sipas një studimi të vitit 2022 nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, kishte mungesë të të dhënave të duhura parlamentare për ndjekjen e tij për 24 nga 42 peticionet e dorëzuara nga viti 2016 deri në vitin 2020, dhe vetëm një nga këto peticione u konsiderua i suksesshëm për të ndikuar në vendimmarrjen e Kuvendit.¹³² Besimi i publikut në Kuvend gjithashtu mbetet i ulët. Disa sondazhe e vlerësojnë besimin e qytetarëve në Kuvend ndërmjet 7 dhe 41 përqind.¹³³

TREGUESI 1.2.5 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë mekanizma që garantojnë integritetin e anëtarëve të organit legjislativ?



Megjithëse ekzistojnë dispozita që garantojnë integritetin e anëtarëve të organit legjislativ, Kodi i Sjelljes për deputetët ka mangësi në sanksione lidhur me shkeljet e etikës, ndërsa dispozitat e Rregullores së Kuvendit i klasifikojnë shkeljet e rregullave për dhënien e dhuratave dhe aktivitetet lobuese si të parëndësishme.

Kushtetuta parashikon që deputetë nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht asnjë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të

Ministrave, dhe i ndalon deputetët të përfitojnë nga veprimtari që rrjedhin nga prona publike.¹³⁴ Ligji përcakton edhe disa mekanizma për sigurimin e integritetit të deputetëve. Deklarimi i pasurisë dhe i interesave private rregullohen sipas ligjit për deklarimin e pasurisë dhe ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave, i cili përfshin deklarimin dhe regjistrimin e konflikteve të mundshme të interesave rast pas rasti dhe ndalon deputetët të marrin pjesë në vendimmarrje për disa raste (shihni 10.3.1).¹³⁵ Deputetët gjithashtu duhet të respektojnë dispozitat e ligjit për dekriminalizimin, i cili ndalon të dënuarit për disa krime të kandidojnë në zgjedhje ose të mbajnë mandatin e tyre.¹³⁶

Rregullat e etikës për deputetët, ashtu si edhe për të zgjedhurit e tjerë, nuk përfshihen në objektin e ligjit për etikën në administratën publike shqiptare.¹³⁷ Megjithatë, dispozita të ngjashme rregullohen përmes Kodit të Sjelljes për deputetët, i cili parashikon rregullat e sjelljes etike, rregullat për konfliktin e interesit, pranimin e dhuratave dhe mikpritjen, si dhe zbulimin e kontakteve me lobistët.¹³⁸ Pas përfundimit të mandatit, deputetët kanë të drejtë të kthehen në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një punë të ngjashme nëse ka qenë në një institucion publik brenda një viti nga përfundimi i mandatit të tyre.¹³⁹ Megjithatë, dispozitat në Kodin e Sjelljes rregullojnë kufizimet pas punësimit si detyrimi për t'u përmbajtur nga zbulimi i informacionit të klasifikuar të marrë gjatë mandatit dhe një periudhë pritjeje njëvjeçare gjatë së cilës nuk mund të nënshkruajnë marrëdhënie kontraktuale, konsulente ose biznesi me Kuvendin ose përfaqësojnë një palë të tretë në konflikt me Kuvendin.¹⁴⁰ Byroja e Kuvendit ka miratuar një manual të dedikuar për lehtësimin e të kuptuarit të Kodit të Sjelljes për deputetët.¹⁴¹ Një vlerësim i plotë i standardeve etike dhe ndikimi i tyre në veprimtarinë e deputetëve siç parashikohet nga Kodi i Sjelljes bëhet gjashtë muaj përpara përfundimit të një organi legjislativ.¹⁴² Raporti i vlerësimit duhet të paraqitet në seancën plenare të Kuvendit dhe të publikohet.¹⁴³

Mirëpo, Kodi i Sjelljes nuk parashikon masa disiplinore për shkeljet ndaj etikës. Masat disiplinore

dhe procedura disiplinore për shkeljet etike parashikohen në Rregulloren e Kuvendit ku Kodi i Sjelljes konsiderohet si pjesë integrale dhe përfshihet si shtojcë.¹⁴⁴ Ndarja e rregullave etike nga pasojat e shkeljes së tyre në dy dokumente është një hendek që mund të pengojë mirëkuptimin dhe zbatimin e rregullave për etikën dhe integritetin nga deputetët.

Me përjashtim të veprave penale dhe shpifjeve,¹⁴⁵ deputetët përballen me dënime të lehta për shkelje të etikës dhe integritetit. Në bazë të Rregullores së Kuvendit, masat disiplinore kategorizohen si shkelje të lehta ose të rënda dhe këto të fundit mund të apelojnë.¹⁴⁶ Për shkeljet e lehta masat disiplinore fillojnë që nga paralajmërimi verbal, tek vërejtja me shkrim dhe deri te heqja e të drejtës për të folur në seancën plenare ose të komisionit parlamentar.¹⁴⁷ Masat disiplinore për shkelje të rënda fillojnë që me përjashtimin nga mbledhjet plenare apo komisionet deri tek përjashtimi nga pjesëmarrja deri në dhjetë ditë në veprimtarinë parlamentare, shoqëruar me pezullimin e pagës së deputetit për ato ditë.¹⁴⁸ Megjithëse, këto masa disiplinore parashikojnë përgjithësisht përsëritjen ose seriozitetin e sjelljeve të pahijshme të deputetëve në veprimtarinë parlamentare si përdorimi i gjuhës fyese, pengimi i deputetëve të tjerë që të marrin të drejtën e fjalës, shkelja e rendit në seancën plenare ose në mbledhjen e komisionit, vota për një deputet tjetër ose refuzimi për të lënë seancën ose mbledhjen nëse është subjekt i masës disiplinore.¹⁴⁹ Shkeljet e rregullave të etikës dhe integritetit nëpërmjet dhuratave apo lobimit kategorizohen si të parëndësishme dhe dënohen me anë të një paralajmërimi verbal.¹⁵⁰

TREGUESI 1.2.6 MEKANIZMAT E INTEGRITIT (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli sigurohet integriteti i ligjvënësve?



Edhe pse ka disa masa që synojnë të garantojnë integritetin e ligjvënësve, Kuvendi nuk e monitoron vënien në zbatim të Kodit të Sjelljes së deputetëve, rregullat e integritetit nuk zbatohen siç duhet, ndërsa sjellja e joprofesionale e deputetëve nuk ndëshkohet.

Kodi i Sjelljes për deputetët që është miratuar në vitin 2018 parashikon që Kuvendi duhet të vlerësojë standardet etike dhe të publikojë një raport që përfshin ndikimin e tyre në veprimtarinë e deputetëve,¹⁵¹ gjashtë muaj para përfundimit të legjislaturës, mirëpo Kuvendi nuk ka publikuar ende një raport të tillë monitorimi.¹⁵² Mungesa e monitorimit të Kodit të Sjelljes nga Kuvendi parandalon një pasqyrë të përgjithshme të vënies në zbatim të Kodit në fjalë dhe mbledhjen e të dhënave të qarta statistikore për shkeljet etike të deputetëve gjatë mandatit të tyre apo punësimit pas mandatit.

Diskursi politik parlamentar vazhdon të karakterizohet shpesh me gjuhë fyese dhe joetike dhe sjellje joprofesionale në veprimtarinë parlamentare.¹⁵³ Sipas një raporti monitorimi të një organizate të shoqërisë civile, në vitin 2022, sanksionet disiplinore nga Sekretariati për Procedurat, Votimi dhe Etika e Kuvendit për shkelje të tilla shpesh janë reduktuar nga Byroja e Kuvendit dhe janë zbatuar kryesisht për deputetët e partive opozitare duke anashkaluar shkeljet etike të deputetëve të shumicës apo anëtarëve të qeverisë.¹⁵⁴ Për shembull, nga nëntori i vitit 2022 deri në shkurt 2023, ka pasur shtatë vendime nga Sekretariati për Procedurat, Votimin dhe Etikën e Kuvendit, duke prekur katër deputetë të shumicës dhe dy të opozitës. Të gjitha vendimet kanë lidhje me shkelje të rënda për sjellje të pahijshme.¹⁵⁵ 24 deputetë të opozitës u sanksionuan duke i përjashtuar nga pjesëmarrja në komisione apo

seanca plenare duke filluar nga tre deri në dhjetë ditë, ndërsa hodh poshtë kërkesa për sanksionimin e kryeministrit për shkelje të ngjashme.¹⁵⁶

Në lidhje me deklarin e pasurisë, janë ngritur shqetësime të rëndësishme për aftësinë e Inspektoratit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit për të kryer auditime të plota dhe të sakta ose hetime administrative lidhur me interesat private dhe deklaratat e pasurisë (shih 10.3.3). Duke filluar që nga viti 2017, janë publikuar 14 konflikte interesi të deklaruara për çdo çështje nga deputetët në faqen e Kuvendit.¹⁵⁷ Megjithëse, një organizatë e shoqërisë civile ka ngritur shqetësime lidhur me disa raste të mundshme të konfliktit të interesit që nuk janë regjistruar dhe nuk është marrë një përgjigje zyrtare nëse ka pasur konflikte.¹⁵⁸ Ekzistojnë katër raste të deklarimit të dhuratave dhe mikpritjes për deputetë nga qeveri apo organizata ndërkombëtare në vitin 2019, por asnjë rast nuk është regjistruar deri në shtator të vitit 2023 për legjislaturën e re që ka nisur në 2021.¹⁵⁹ Regjistri i deklarimeve të deputetëve për takimet me lobistët është bosh.

Është përmirësuar zbatimi i ligjit për dekriminalizimin. Në vitin 2018, në legjislaturën e mëparshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi t'u heqë mandatin dy deputetëve që nuk kishin deklaruar se ishin dënuar për vepra penale jashtë vendit. Megjithatë, të dy deputetët janë angazhuar edhe në legjislaturën e mëparshme 2013-2017, ndërsa ligji i dekriminalizimit u miratua në vitin 2015, gjë që tregon procedurat e gjata dhe të vështira për zbatimin e këtij ligji.¹⁶⁰

Së fundmi, Gjykata Kushtetuese anuloi si antikushtetuese dy vendime të Kuvendit për të ndaluar paraqitjen e mocionit të opozitës për përputhshmërinë e mandatit për një ministër.¹⁶¹ Ka pasur edhe raste të kallëzimeve penale për deputetë lidhur me detyrat e tyre të mëparshme si anëtar i qeverisë që kanë sjellë dënimin e tyre pas dorëheqjes së tyre nga mandati (shih 1.2.4).

TREGUESI 1.2.7 PËRFAQËSIMI GJINOR

Sa të përfaqësuara janë gratë në organin legjislativ?



Dispozitat ligjore ekzistojnë dhe zbatohen, por vetëm 36 % e anëtarëve të organit legjislativ janë gra dhe përfaqësimi i tyre në komisionet parlamentare vazhdon të jetë jo i balancuar.

Dispozitat ligjore promovojnë barazinë gjinore dhe parashikojnë që të paktën 30 % e vendeve në Kuvend duhet të rezervohen për gratë.¹⁶² Në organin legjislativ aktuale, 36 % e deputetëve janë gra.¹⁶³ Raportet e monitorimit theksojnë gjithashtu një pjesëmarrje aktive dhe performancë të mirë të grave në parlament. Nga janari 2021 deri në korrik 2022, 40 % e debatit të përgjithshëm të Kuvendit në komisionet parlamentare dhe seancat plenare u zhvillua nga gratë.¹⁶⁴ Kryetarja e Kuvendit është grua dhe pjesëmarrja e grave dhe burrave në udhëheqjen legjislative si Byroja e Kuvendit ose si drejtues të komisioneve parlamentare është e balancuar.¹⁶⁵ Megjithatë, pjesëmarrja gjinore në komisionet parlamentare mbetet e pabalancuar dhe ka njëanshmëri gjinore. Numri i grave është më i lartë në Komisionin Parlamentar për Punë, Mirëqenie dhe Shëndetësi me 62 % të anëtarëve të komisionit dhe në Komisionin Parlamentar për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik me 58 %, ndërsa janë në numër më të ulët në Komisionin Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregti dhe Mjedis, ku vetëm 10 % janë gra, ndërsa në Komisionin Parlamentar për Sigurinë Kombëtare zënë 15 % të vendeve.¹⁶⁶

ROLI

TREGUESI 1.3.1 MBIKËQYRJA E SISTEMIT EKZEKUTIV

Deri në çfarë niveli kuvendi ofron mbikëqyrje efektive të organit ekzekutiv?



Kuvendi ka fuqinë për të ushtruar mbikëqyrje mbi ekzekutivin, por efektiviteti ka qenë i kufizuar. Vërehet një mungesë pavarësie e legjislativit nga ekzekutivi për shkak të efekteve të sistemit zgjedhor, mungesës së demokracisë brendapartiake dhe një qeverisje njëpartiake si dhe një opozitë të dobët.

Anëtarët e Këshillit të Ministrave janë të detyruar të marrin pjesë në seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve nëse kërkohet nga Kuvendi.¹⁶⁷ Mjetet kryesore të mbikëqyrjes legjislative të sistemit ekzekutiv realizohen nëpërmjet pyetjeve me shkrim për marrjen e informacionit, interpelancave për të marrë shpjegime për motivet, synimet dhe qëndrimin e Këshillit të Ministrave ose që lidhen me aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së tij, si dhe me shkresat e paraqitura nga drejtuesi i një grupi parlamentar ose të paktën shtatë deputetë me qëllim të zhvillimit të një debati në Kuvend për një çështje të caktuar dhe në përfundim të tij mund të propozojnë miratimin e një rezolute ose deklarate.¹⁶⁸ Kuvendi mund të ngrëjë edhe një komision hetimor me kërkesë të një të katërtës së anëtarëve të tij.¹⁶⁹

Megjithatë, këto instrumente janë zbatuar vetëm me raste. Nga janari 2021 deri në korrik 2022, janë adresuar dhjetë pyetje dhe gjashtë interpelanca për Këshillin e Ministrave¹⁷⁰ dhe dy komisione hetimore.¹⁷¹ Është vërejtur një përmirësim i funksionimit dhe ndikimit të komisioneve hetimore në debatin publik, por pa asnjë rezultat për shkak të votimit të mazhorancës në mbështetje të qeverisë.¹⁷² Për shembull, një praktikë e mirë është Komisioni për Mbetjet Urbane me një qasje konstruktive nga qeveria dhe transmetim të diskutimeve në media. Megjithatë, Komisioni

përfundoi me hartimin e dy raporteve të veçanta, një nga opozita dhe një nga mazhoranca, me rezultate qartësisht të ndryshme. Raporti i mazhorancës mori mbështetje në komisionin hetimor dhe nga seanca plenare për shkak të votimit të mazhorancës.¹⁷³

Kuvendi ka kompetencën të ndikojë në buxhetin kombëtar, duke përfshirë shkurtime afatmesme të buxhetit me akte normative, të cilat kërkojnë miratimin e Kuvendit brenda 45 ditëve, në të kundërt ato anulohen.¹⁷⁴ Në vitin 2021, komisionet parlamentare organizuan 79 seanca dëgjimore me institucionet publike dhe grupet e interesit për projektbuxhetin dhe paketën fiskale, si dhe miratuan 65 ndryshime.¹⁷⁵ Në total, Kuvendi miratoi 940 ndryshime në projektligje në vitin 2021.¹⁷⁶ Megjithatë, shqyrtimi parlamentar i buxhetit vjetor mbetet i kufizuar.¹⁷⁷ Ka shqetësime për sa i përket tolerancës së Kuvendit në rastet kur mungon dokumentacioni i kërkuar i përcjellë nga Këshilli i Ministrave në kuadër të nismave legjislative si dhe rastet e ligjeve të posaçme apo të propozuara nga qeveria me procedura të përshpejtuara.¹⁷⁸ Sipas Mbështetjes për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim (SIGMA), shqyrtimi parlamentar mbi zbatimin e ligjit dhe politikat ekzekutive është i kufizuar.¹⁷⁹ Roli i Kuvendit në mbështetjen e zbatimit të rekomandimeve nga institucionet e pavarura drejtuar qeverisë është gjithashtu i kufizuar (*shih Kolonën 8 Avokati i Popullit dhe Kolonën 9 Institucioni i Lartë i Auditimit*).¹⁸⁰ Në vitin 2021, Presidenti i Republikës ktheu në Kuvend për rishqyrtim 22 ligje nga 136 të miratuara, ndërsa Kuvendi i rrëzoi të gjitha dekretet.¹⁸¹

Partitë kryesore opozitare zbehen rolin e Kuvendit për mbikëqyrjen efektive të organit ekzekutiv gjatë legjislaturës së mëparshme, të cilat anuluan mandatet e tyre parlamentare në shkurt 2019. Vendet vakante u plotësuan pjesërisht nga kandidatë të partive të vogla ose nga disa kandidatë nga listat kryesore të opozitës, të cilët kanë vepruar si deputetë të pavarur pasi u përjashtuan zyrtarisht nga anëtarësia e tyre partiake. Ka pasur dy opozita, një në parlament dhe një jashtë tij. Megjithatë, bashkëbiseduesi kryesor i mazhorancës për

reformën zgjedhore në 2020 nuk ishte opozita parlamentare, por ajo jashtëparlamentare, gjë që dëshmon rolin e kufizuar të veprimit opozitar brenda Kuvendit për kohën në fjalë.¹⁸² Në legjislaturën e re që nisi në shtator 2021, ndërsa partia kryesore opozitare u rikthye në Kuvend, veprimtaria e saj ka qenë i kufizuar për shkak të shpërndarjeve dhe konflikteve të brendshme. Sipas indeksit të Projektit Botëror të Drejtësisë, nuk ka rritje të mbikëqyrjes së qeverisë nga Kuvendi në legjislaturën e re.¹⁸³

TREGUESI 1.3.2 REFORMA LIGJORE

Deri në çfarë niveli e konsideron organi legjislativ antikorrupsionin dhe qeverisjen si shqetësim në vend?



Kuvendi ka miratuar reformat ligjore gjithëpërfshirëse dhe konkrete për të luftuar korrupsionin dhe për të promovuar integritetin, mirëpo kuadri legjislativ në fuqi është ende i fragmentuar dhe reformat rezultojnë kryesisht joefektive.

Shqipëria ka miratuar dhe është pjesë e të gjitha konventave ndërkombëtare kundër korrupsionit.¹⁸⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është ndryshuar dy herë që nga viti 2016 në kuadër të reformës në drejtësi, ndërsa Kuvendi ka miratuar kuadrin legjislativ për zbatimin e saj. Janë gjeneruar disa rezultate në luftimin e korrupsionit të zyrtarëve më të lartë ekzekutivë ose të zgjedhur, të cilët përmirësoi vlerësimin e korrupsionit të Shqipërisë nga Freedom House nga 2.75 to 3.00 në 2023 (*për më shumë detaje shih Shtyllën 3 Gjyqësori dhe Shtyllën 4 Prokuroria Publike*).¹⁸⁵ Ka një kuadër të gjerë legjislativ për parandalimin e korrupsionit, duke përfshirë ligjet për sjelljen etike, deklarimin e pasurisë, parandalimin e konfliktit të interesit, mbrojtjen e sinjalizuesve, informimin dhe konsultimin publik, integritetin e personave të zgjedhur në funksionet publike, etj.¹⁸⁶ Në vitin 2021, SIGMA e vlerësoi hartimin e përgjithshëm ligjor si cilësor dhe vlerësoi se kuadri ligjor është kryesisht i

qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, por që është ende i fragmentuar dhe pa një njësi raportuese të centralizuar për zbatimin e tij.¹⁸⁷ Sipas raportit të Komisionit Evropian të vitit 2022 për Shqipërinë, kuadri legjislativ në Shqipëri ka boshllëqe, pasi përputhet vetëm pjesërisht me Konventën e OECD-së për Luftimin e Ryshfetit të Zyrtarëve Publikë të Huaj në transaksionet e biznesit ndërkombëtar.¹⁸⁸ Në mënyrë të ngjashme, reformat ligjore për partitë politike dhe financat e fushatës të rekomanduara nga Zyra e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe Komisioni Evropian nuk janë miratuar ende.¹⁸⁹ Ligji i ri për parandalimin e konfliktit të interesit i mbështetur nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) është ende në pritje për t'u miratuar që prej vitit 2021 dhe do të prezantonte një procedurë dhe mekanizma të qartë për zbatimin e parandalimit të konfliktit të interesit (shih 10.3.1). Shqyrtimi pasues i Kuvendit mbi zbatimin e ligjit është gjithashtu i kufizuar. Mbikëqyrja e pamjaftueshme e Kuvendit lidhur me zbatimin praktik të ligjeve dhe zbatimin e tyre praktik mund t'i hapë rrugë praktikave korruptive. Sipas SIGMA-s, nuk është e zakonshme që Kuvendi të ndërmarrë një hap për rishikimin e politikave kryesore ose zbatimin e ligjeve kyçe.¹⁹⁰ Rekomandimet për ekzekutivin nga organet e pavarura nuk marrin mbështetje të mjaftueshme nga Kuvendi për t'u vënë në zbatim (*shih Shtyllën 8 Avokati i Popullit dhe Shtylla 9 KLSH*).

Ndërsa Ministri i Drejtësisë miratoi një metodologji në vitin 2022 e cila përfshin vlerësimin e fushave të mundshme për korrupsion në iniciativat ligjore të iniciuara nga qeveria,¹⁹¹ vetë Kuvendit i mungon një metodologji për këtë vlerësim, e cila mund të ndikojë në aftësinë e Kuvendit për të kontrolluar iniciativat e qeverisë dhe mund të jetë më problematike për nismat ligjore nga deputetët apo qytetarët.¹⁹²

Kuadri i gjerë rregullator dhe reformat kryesore të miratuara nga Kuvendi nuk dhanë rezultatet e pritshme dhe sipas Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara (SHBA), korrupsioni është i pranishëm në të gjitha degët e qeverisë dhe në nivel lokal.¹⁹³ Perceptimi i qytetarëve për korrupsionin në vend gjithashtu mbetet në nivel të lartë.¹⁹⁴

NDËRVEPRIMET

Kuvendi ndërvepron në kuadër të ndarjes dhe balancimit të pushteteve të sistemit ekzekutiv dhe gjyqësor. Megjithatë, këto kompetenca janë të pabalancuara dhe ka një dominim të organit ekzekutiv në lidhje me organin legjislativ në praktikë që është më i madh se ai i parashikuar në ligj. Kuvendi në kuadrin e Kushtetutës dhe funksioneve të tij ndërvepron me Presidentin e Republikës dhe institucionet e pavarura të parashikuara në Kushtetutë ose në ligj. Institucionet e pavarura raportojnë në Kuvend, por rekomandimet e tyre për organin ekzekutiv nuk marrin mbështetje të mjaftueshme nga Kuvendi (*shih 8.2.4 dhe 9.3.3*).

Kuvendi është proaktiv në diplomacinë parlamentare. Delegacionet kanë marrë pjesë në takimet e Parlamentit Evropian dhe është e përfaqësuar në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, Këshillin e Evropës, OSBE-në dhe disa nisma rajonale. Gjithashtu ka rritur bashkëpunimin dypalësh me asambletë e tjera në rajon apo në vendet anëtare të BE-së në kuadër të procesit të anëtarësimit evropian të Republikës së Shqipërisë.

REKOMANDIMET E ORGANIT

- + Kuvendi duhet të zhvillojë një metodologji për vlerësimin e fushave të mundshme për korrupsion në projektligje sipas standardeve ndërkombëtare dhe në konsultim me ekspertë dhe organizata të shoqërisë civile dhe ta zbatojë në praktikë për propozimet ligjore nga Këshilli i Ministrave, deputetët dhe qytetarët.
- + Kuvendi duhet të zbatojë në praktikë një kontroll legjislativ *ex-post* në kuadër të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit duke mbikëqyrur zbatimin praktik të legjislacionit dhe politikave kryesore.
- + Kuvendi duhet të mbështesë zbatimin e rekomandimeve të pavarura institucionale për organin ekzekutiv duke shfrytëzuar në mënyrë efektive mekanizmat për kontrollin e organit ekzekutiv, siç janë seancat dëgjimore parlamentare, pyetjet dhe interpelancat për zbatimin e këtyre rekomandimeve.
- + Kuvendi duhet të vlerësojë standardet e integritetit të parashikuara nga Kodi i Sjelljes për deputetët dhe të monitorojë efektet e tij praktike në veprimtarinë e deputetëve gjashtë muaj përpara përfundimit të legjislaturës. Duhet të rishikojë Kodin e Sjelljes sipas raportit të vlerësimit dhe monitorimit.
- + Kuvendi duhet të sanksionojë shkeljet e integritetit dhe sjelljet e pahijshme etike nga deputetët, pavarësisht përkatësisë së tyre politike.
- + Kuvendi duhet të angazhohet në mënyrë aktive në konsultimet publike si pjesë e vendimmarrjes së tij legjislativ dhe të vlerësojë dhe të marrë parasysh të dhëna nga ekspertët, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët.
- + Kuvendi duhet të regjistrojë, menaxhojë dhe të bëjë transparent vendimin dhe ndjekjen e tij për petitionet e dorëzuara në Kuvend nga qytetarët.
- + Kuvendi duhet të punësojë staf në kapacitet e duhura për sa i përket formimit politik dhe administrativ për të mbështetur dhe mundësuar veprimtarinë e gjerë të komisioneve parlamentare dhe të Kuvendit me standarde të larta. Gjithashtu duhet të punësojë staf në kapacitet e duhura për sa i përket formimit politik për të mbështetur grupet parlamentare dhe deputetët individualë në mënyrë që të sigurojë një pavarësi më të madhe nga partitë e tyre politike përkatëse në vendimmarrjen e tyre.

BIBLIOGRAFI

- ⁵⁷ Rezultati i përgjithshëm i organit, sipas metodologjisë, nuk merr në konsideratë treguesin 1.2.7 Përfaqësimi gjinor.
- ⁵⁸ Partia Socialiste ka 74 deputetë, Partia Demokratike me 59 deputetë, Lëvizja Socialiste për Integrim (Partia e Lirisë) me katër deputetë dhe Partia Socialdemokrate me tre deputetë.
- ⁵⁹ Neni 75 (2), Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, <http://staging.parlament.al/Files/sKuvendi/kushtetuta.pdf>, [aksesuar më 10 tetor 2022].
- ⁶⁰ Sipas nenit 8 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, Byroja e Kuvendit drejtohet nga Kryetari i Kuvendit dhe përbërja e saj duhet të pasqyrojë, sa më shumë që të jetë e mundur, përbërjen politike të Kuvendit, <https://web-api.parlament.al/Files/RregullorjaeKuvenditeperditesuar.pdf>, [aksesuar më 10 tetor 2022].
- ⁶¹ Neni 10/1, Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar.
- ⁶² *Ibidem*, Nenet 79-85.
- ⁶³ Neni 101, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar.
- ⁶⁴ Nenet 14, 19 dhe 20 (2), Ligji Nr.8550, datë 18.11.1999 "Për Statusin e Deputetit", i ndryshuar, <http://staging.parlament.al/Files/Informacione/ligji-per-statusin-e-deputetit.pdf>, [aksesuar më 21 qershor 2023]
- ⁶⁵ Neni 18, Ligji nr.8550, datë 18.11.1999 Për statusin e deputetit, i ndryshuar.
- ⁶⁶ Neni 75, Kushtetuta, i ndryshuar; Neni 121, Rregullorja e Kuvendit, e ndryshuar.
- ⁶⁷ Neni 3 (2) i *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe funksionimit të Shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë*, i ndryshuar, http://staging.parlament.al/Files/sAdministrata/Rregullore_e_brendshme.pdf, [aksesuar më 10 tetor 2022].
- ⁶⁸ Nenet 8-11, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, *Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë*, e ndryshuar, http://staging.parlament.al/Files/sAdministrata/Rregullore_e_brendshme.pdf, [aksesuar më 10 tetor 2022].; Ligji 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-sherbimin-civil>, [aksesuar më 10 tetor 2022]
- ⁶⁹ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, *Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë; Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Raporti Vjetor i Veprimtarisë së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë 2021*, <http://www.parlament.al/boxhetiFooter>, [aksesuar më 10.10.2022]
- ⁷⁰ Shihni Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2020), *Raporti Vjetor 2019*; Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2021), *Raporti Vjetor 2020*; Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2022), *Raport Vjetor 2021*, <http://www.parlament.al/struktura/f5e7176c-d17e-4427-a627-c3e47e202e31/#doku>: Buxheti i planifikuar për vitin 2022 është aksesuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, <https://financa.gov.al/per-buxhetin-e-vitit-2022/>
- ⁷¹ Shumat në euro llogariten sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për çdo vit, https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/
- ⁷² Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, *Raport vjetor 2021*, f. 40.
Deklaratat e pasurisë dhe të interesit privat, të konsideruara si dokumente zyrtare, supozohet se publikohen në faqen zyrtare të ILDKPKI-së me të dhënat personale të ndjeshme të redaktuara dhe përdorimi ose shpërndarja e paautorizuar e këtyre të dhënave rregullohet rreptësisht për të garantuar përputhjen ligjore.²³³ Megjithatë, deri më tani ato nuk janë publikuar, por janë vënë në dispozicion në bazë të kërkesës për informacion.²³⁴ Sistemi i ri elektronik parashikon publikimin e deklaratave të pasurisë dhe interesave private, por është ende një punë në vazhdim deri në plotësimin e kërkesave të sigurisë kibernetike.

TREGUESI 2.2.3 LLOGARIDHËNIA (LIGJI)

Deri në çfarë mase ekzistojnë dispozita për të siguruar që anëtarët e organit ekzekutiv duhet të raportojnë dhe të përgjigjen për veprimet e tyre?



Ndërkohë që ekzistojnë një sërë ligjesh për të siguruar që anëtarët e organit ekzekutiv duhet të raportojnë dhe të përgjigjen për veprimet e tyre, ato nuk mbulojnë potencialin e qeverisë për të përdorur aktet normative si një mjet për të ndryshuar ligjet pa shqyrtim të menjëhershëm parlamentar.

Organi ekzekutiv i nënshtrohet mbikëqyrjes parlamentare dhe mbikëqyrjes së institucioneve të pavarura si Avokati i Popullit,²³⁵ Institucioni i Lartë i Kontrollit,²³⁶ Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,²³⁷ Komisioneri për Mbrojtjen e Informacionit dhe të Dhënave,²³⁸ Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konflikti i Interesit,²³⁹ dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.²⁴⁰ Vendimmarrja ekzekutive mund të ankimohet në gjykatë në bazë të natyrës së shkeljes së pretenduar.

Me përjashtim të projektligjeve për politikën fiskale, marrëdhëniet ndërkombëtare, emergjencat civile dhe sigurinë kombëtare, organi ekzekutiv duhet të sigurojë një vlerësim të ndikimit rregullator (VNR) me projektligjin e shpallur për miratim. Për më tepër, VNR-ja përfshihet kur ligji i propozuar kërkon të hartojë *acquis* të BE-së.²⁴¹ Përfaqësuesit e institucionit qeveritar që mbajnë përgjegjësi për propozimin detyrohen të marrin pjesë në interpretimet e projektligjit (në parim, nen për nen dhe në tërësi) në komisionet përkatëse ku diskutohen projektligjet.²⁴² Ata mund të merren në pyetje nga anëtarët e komisionit, të cilët mund të bëjnë ndryshime ligjore.²⁴³ Për më tepër, ndryshimet mund të bëhen në seancën plenare, gjatë së cilës projektligji është subjekt i tre interpretimeve të njëjta si në komision. Deputetët e Kuvendit mund të thërrasin mendimin e ekspertit pasi që Rregullorja e Punës parasheh konsultimin e ekspertëve të jashtëm gjatë procesit legjislativ.²⁴⁴

Megjithatë, qeveria mund të shmangë llogaridhënien legislative, përkatësisht, përmes akteve normative, të cilat në thelb janë ndryshime qeveritare të ligjeve që hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit për 45 ditë. Megjithatë, qeveria mund t'ia dorëzojë Kuvendit aktin normativ për miratim të përhershëm.²⁴⁵

Institucionet e pavarura mbikëqyrëse ushtrojnë kompetencat e tyre mbikëqyrëse sipas mandateve të tyre përkatëse. Mandatet e institucioneve të pavarura mbikëqyrëse, përfshirë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), në përgjithësi janë të qarta (për më tepër shih 5.1.2). Një ndryshim që vlen të përmendet është se KMSHC-ja, ndryshe nga institucionet e tjera të pavarura mbikëqyrëse, nuk ka mandat për të propozuar ndryshime në ligjin ku mbikëqyr zbatimin e tij, përkatësisht Ligjin për Nëpunësin Civil.

TREGUESI 2.2.4 LLOGARIDHËNIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë pike është efektive mbikëqyrja e veprimtarive të organit ekzekutiv?



Megjithëse anëtarëve të organit ekzekutiv në Shqipëri u kërkohet të raportojnë në Kuvend për zbatimin e politikave, efektiviteti i këtyre dispozitave kufizohet për shkak të polarizimit politik dhe përdorimit të papërshtatshëm të mjeteve të mbikëqyrjes nga Kuvendi, si dhe për çështje themelore të zbatimit dhe ndikimit minimal të institucioneve të pavarura mbikëqyrëse si ILDKPKI-ja dhe KLSH-ja.

Megjithëse, Kuvendi mundëson mjete të mjaftueshme për të ushtruar mbikëqyrje efektive, ai në pjesën më të madhe të rasteve nuk arrin ta realizojë këtë në mënyrë efektive. Duke filluar që nga shtatori 2021 deri në korrik 2022, janë bërë gjashtë interpelanca dhe dy hetime parlamentare.²⁴⁶ Në vjeshtën e 2023, Kuvendi dëshmoi shtim të tensioneve dhe përplasjeve pasi gjashtë komisione hetimore parlamentare nuk u pranuan nga shumica

në parlament.²⁴⁷ Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2023 për Shqipërinë nxjerr në pah si një problematikë me rëndësi të madhe mbikëqyrjen e kufizuar parlamentare të qeverisë si funksionet kryesore të parlamentit për të mbajtur organin ekzekutivin përgjegjës përmes një kontrolli efektiv dhe duke shërbyer si një forum për debatin politik konstruktiv, si dhe përgjegjësinë e tij për të zgjedhur kryetarët e institucioneve themelore të pavarura në kohën e duhur, pengohen nga polarizimi politik dhe përçarjet e thella brenda opozitës.²⁴⁸

Në rrethana të ngjashme, puna e institucioneve të pavarura mbikëqyrëse nuk ka ndonjë ndikim të madh në përmirësimin e qeverisjes, performancës dhe integritetit të organit ekzekutiv. ILDKPKI-ja nuk ka dhënë hollësi për zbatimin e legjislacionit mbi konfliktin e interesit, duke sugjeruar në këtë mënyrë problematika rrënjësore në zbatimin e ligjit. Për sa i përket deklaratimit dhe auditimit të pasurisë dhe deklaratave të tjera financiare, raportet e tij sugjerojnë një zbatim në një nivel bazik administrativ dhe jo në një nivel të rëndësishëm.²⁴⁹

Të dhënat e siguruara nga KLSH-ja në raportet vjetore tregojnë se institucionet publike zbatojnë më pak se gjysmën e rekomandimeve të bëra në raportet e auditimit dhe se numri i çështjeve penale që hidhen në gjyq është tepër i ulët. Në vitin 2021, KLSH-ja kishte ngritur 14 padi penale: 12 raste janë pushuar nga gjykata në fazën paraprake, ndërsa dy prej tyre që ishin kundër dy komunave janë kthyer në prokurori për hetime të mëtejshme.²⁵⁰ Për më tepër, KLSH-ja ngriti katër padi në përputhje me Kodin Penal në 2022 kundër 16 zyrtarëve publikë pas rezultateve të auditimit.²⁵¹ KLSH-ja raporton në Kuvend për zbatimin e buxhetit të shtetit, jep opinione për raportet e shpenzimeve financiare të organit ekzekutiv dhe institucioneve publike, si dhe dorëzon informacionin për rezultatet e auditimit dhe raportet përfundimtare të auditimit siç nevojitet ose kërkohet. Përveç kësaj, një raport vjetor për veprimtaritë e tij i paraqitet Kuvendit çdo vit.²⁵²

Sanksionet (gjobat) administrative të Komisionerit për Mbrojtjen e Informacionit dhe të Dhënave (IMD) janë të papërshtatshme. Në vitin 2021, Komisioneri i IMD-së vendosi katër gjoba, ndërsa një vit më parë

kishte vendosur tre të tilla në lidhje me udhëzimin e tij për transparencën institucionale.²⁵³ Në 2022, IMD-ja bëri 35 inspektime në institucionet e qeverisjes qendrore dhe si rrjedhojë këto autoritete publike publikuan Programet e Transparencës në faqet e tyre zyrtare të internetit.²⁵⁴ IMD-ja pranon se autoriteteve publike ende u mungon proaktiviteti për të publikuar informacionin përkatës me interes publik. Në lidhje me zbatimin e mandatit të tij për mbrojtjen e të dhënave personale, Komisioneri vendosi 16 gjopa për institucionet publike dhe 14 gjopa për subjektet private në vitin 2021 dhe 37 gjopa (në institucionet publike ashtu edhe në subjektet private) në vitin 2020.²⁵⁵ IMD-ja lëshoi 42 rekomandime dhe 34 sanksione administrative lidhur me mandatin e tij për mbrojtjen e të dhënave personale në vitin 2022.²⁵⁶

Në tre vitet e fundit, mbështetja në rritje e qeverisë për aktet normative në vend të procesit të rregullt legjislativ ka ngritur në mënyrë të vazhdueshme shqetësime për mungesën e transparencës dhe dobësitë në aftësitë planifikuese.²⁵⁷

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mund të lëshojë urdhra të detyrueshëm për institucionet publike që nuk zbatojnë siç duhet dispozitat ligjore dhe gjopa nëse institucionet publike nuk i zbatojnë ato.²⁵⁸ Sidoqoftë, sipas raportit vjetor të Komisionerit për vitin 2021,²⁵⁹ nuk ka pasur problematika lidhur me zbatimin e masave të dhëna ndaj institucioneve publike. Masat ose janë zbatuar plotësisht ose janë në proces për t'u vënë në zbatim.²⁶⁰

TREGUESI 2.2.5 INTEGRITETI (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë mekanizma që garantojnë integritetin e anëtarëve të organit ekzekutiv?



Megjithëse Kodi i Etikës Ministrore në Shqipëri rregullon sjelljen e ministrave dhe konfliktet e interesit, i mungon qartësia në adresimin e skenarëve të rotacioneve të shpeshhta ("revolving-door") dhe kalimit të ministrave në rolet e ndërmarrjeve private apo publike. Për më tepër, kufizohet nga mekanizmat e paqartë të zbatimit dhe dispozitat e paqarta për lirinë e fjalës, duke ndikuar në transparencën dhe llogaridhënien e përgjithshme.

Shqipëria duhet të rrisë koherencën e kuadrit ligjor dhe institucional për të parandaluar korrupsionin dhe integritetin e zyrtarëve publikë, i cili është gjithëpërfshirës, por mjaft i ndërlikuar, sidomos që lidhen me zyrtarët e nivelit të lartë. Kuadri legjislativ për konfliktin e interesit duhet të jetë në përputhje me standardet evropiane dhe acquis të BE-së.²⁶¹

Kodi i Etikës Ministrore²⁶² përfshin dispozita të huazuara nga Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit²⁶³ dhe, në një farë mase, nga Ligji për Rregullat e Etikës në Administratën Publike.²⁶⁴ Kodi i Etikës Ministrore në Shqipëri u rishikua më 29 shtator 2021 në mënyrë të konsiderueshme.²⁶⁵ Komisioni i Etikës është themeluar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 90 më 20 maj 2022, me autoritetin për të interpretuar Kodin, për të dhënë opinione këshillimore dhe për të përcaktuar shkeljet nga anëtarët e qeverisë.

Kodi i Etikës vendos standardet e sjelljes së ministrave dhe zëvendësministrave dhe përfshin dispozita për konfliktin e interesit, marrjen e dhuratave, punësimin në postet e ministrisë, përdorimin e burimeve qeveritare, marrëdhëniet me bizneset dhe konfidencialitetin e informacionit. Ministrat dhe zëvendësministrat duhet të tërhiqen nga një seancë e Këshillit të Ministrave në të cilën merret një vendim për të cilin ai ose ajo rezulton se ka një interes personal.²⁶⁶ Dispozitat për dhuratat janë të ngjashme me ato të Ligjit për Etikën në

Administratën Publike. Ministrat dhe zëvendësministrat duhet të përmbahen që të mos pranojnë favore apo dhurata për shkak të pozicionit të tyre; ata mund të pranojnë dhurata vetëm nëse kanë një vlerë simbolike, e cila nuk është e specifikuar.²⁶⁷

Për më tepër, Kodi përfshin dispozita më të gjera sesa vetëm paraqitja e deklaratave të interesit privat, të cilat janë në kompetencën e ILDKPKI-së për sa i përket ligjit për konfliktin e interesit. Për më tepër, disa dispozita në Kod, si për shembull ndërgjegjësimi sistematik për çështjet që lidhen me integritetin, i janë caktuar Ministrit të Shtetit për Standardet, një detyrë që nuk ekziston që nga shtatori 2023.

Kodi i Etikës gjithashtu nuk përfshin dispozita për situatat e rotacioneve të shpeshta. Neni 37 ndalon një ish-ministër të emërohet në poste drejtuese ose të kontrollojë ndërmarrjet private ose publike për një vit, nëse në dy vitet e fundit para përfundimit të mandatit ministror ka qenë i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e ndërmarrjeve të tilla. Megjithatë, kjo dispozitë nuk e përcakton në mënyrë specifike kuptimin e "kontrollit" ose "të jesh i përfshirë drejtpërdrejt në veprimtari". Përveç kësaj, këto kufizime mund të mos merren parasysh nga Komisioni i Etikës, por nuk përshkruan rrethanat.

Kodi i Etikës ka dispozita për rregullat etike të udhëtimit, angazhimit në aktivitete publike dhe performancës në publik (Neni 12) dhe udhëhiqet nga parimi "të jesh shembull për stafin dhe të sillësh në një mënyrë që inkurajon zbatimin e standardet më të larta të sjelljes edhe për të rinjtë që kontribuojnë në administratën publike."²⁶⁸ Për më tepër, vendos disa kufizime për lirinë e fjalës sipas parimeve të konfidencialitetit dhe kolegjalitetit: intervistat dhe fjalimet duhet të koordinohen me Agjencinë e Medias dhe të Informacionit; artikujt mund të botohen me kusht që të mos shkelin parimet e "besueshmërisë" dhe "solidaritetit"; Ministrat nuk mund të shkruajnë biografi gjatë kohës që mbajnë postin.²⁶⁹

Për sa i përket lobimit, Neni 26 i Kodit të Ministrave tani kërkon që anëtarët e qeverisë të zhvillojnë

takime me përfaqësues të biznesit ose grupeve të interesit në prani të dy zyrtarëve të lartë të ministrisë, me procesverbal të regjistruar dhe mbajtur në një regjistër nga Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë. Ndërsa anëtarët e qeverisë mund të konsultohen në mënyrë konfidenciale me Komisionin e Etikës në lidhje me ndërveprimet e palëve të treta, Kodit i mungojnë rregulla të detajuara për menaxhimin dhe zbulimin e kontakteve me lobistët dhe të tjerët përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit si email-t dhe telefonatat. Regjistri i këtyre takimeve nuk është i disponueshëm publikisht në internet dhe nuk përditësohet rregullisht.²⁷⁰

Komisioni i Etikës ka autoritetin që të interpretojë Kodin, të japë opinione këshillimore dhe të përcaktojë shkeljet nga anëtarët e qeverisë. Në rast shkeljesh, i rekomandon Kryeministrit masa disiplinore. Megjithatë, Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) ka ngritur shqetësime serioze për praninë e një anëtari të qeverisë në përbërjen e tij, diskutimet dhe procesin e votimit, gjë që do të pengonte funksionimin efektiv të tij, në veçanti pavarësinë dhe paanshmërinë nga organi ekzekutiv.²⁷¹ Roli i Komisionit të Etikës në Shqipëri kufizohet kryesisht në rekomandimin e masave disiplinore ndaj Kryeministrit për ministrat që shkelin Kodin Ministror të Etikës.

Rregulloret që drejtojnë Këshillin e Ministrave dhe këshilltarët politikë në Shqipëri u mungojnë kufizimet e qarta për punësimin pas qeverisë ose marrëdhëniet e biznesit në sektorë që lidhen me detyrat e tyre zyrtare të mëparshme. GRECO vëren më tej se efektiviteti i kufizimeve të pas-punësimit në lidhje me anëtarët e qeverisë varet nga përbërja dhe funksionimi i Komisionit të Etikës, i cili varet nga organi ekzekutiv.²⁷² Rregullat për kufizimet e pas-punësimit që zbatohen si për anëtarët e Këshillit të Ministrave ashtu edhe për këshilltarët politikë duhet të vendosen duke përfshirë një mekanizëm efektiv zbatues lidhur me personat me funksione të larta ekzekutive.²⁷³

Një gamë e gjerë zyrtarësh të degës ekzekutive duhet t'i bëjnë të ditur pasuritë e tyre ILDKPKI-së. Ato përfshijnë ndër të tjera Kryeministrin, ministra

dhe zëvendësministra, nëpunës civilë të nivelit të mesëm dhe të lartë, zyrtarë të lartë në ushtri, Shërbimin Informativ Shtetëror dhe Policinë e Shtetit Shqiptar, drejtorë të përgjithshëm, zëvendësdrejtorë të përgjithshëm, drejtorë drejtorish në qendër dhe qarqe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave; drejtues të të gjitha niveleve të strukturave për kthimin dhe kompensimin e pronave, privatizimin dhe regjistrimin e pronave; zyrtarët e zgjedhur dhe emëruar nga parlamenti, Presidenti i Republikës, Kryeministri, ministra ose persona të barabartë me ta; dhe drejtues të institucioneve publike të varur nga institucionet qendrore në nivel rajonal.²⁷⁴ ILDKPKI-ja mban përgjegjësi për administrimin e deklaratave të pasurisë dhe zbatimin e masave administrative, si gjoba, si dhe referimin e rasteve pranë organeve ligjzbatuese për hetime të mëtejshme në rastet e parregullsive dhe situatave të keqmenaxhimit serioz financiar.²⁷⁵

TREGUESI 2.2.6 INTEGRITETI (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli sigurohet në praktikë integriteti i anëtarëve të ekzekutivit?



Veprimet për të garantuar integritetin ose janë të kufizuara në përmbushjen e detyrimeve administrative themelore dhe formale ose mungojnë plotësisht.

Që nga viti 2021, ministrinë e linjës kanë krijuar plane integriteti të plotësuara me plane veprimi. Megjithatë, jo të gjithë koordinatoret e integritetit janë emëruar për të monitoruar planin e integritetit në ministrinë përkatëse të linjës dhe nuk janë identifikuar masa specifike për të adresuar rreziqet e lidhura me integritetin me të cilat mund të përballen ministrat dhe këshilltarët politikë.²⁷⁶ Për më tepër, pranë zyrës së Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë është krijuar Drejtoria e Përgjithshme Kundër Korrupsionit, e cila ka rolin kryesor të koordinimit të

luftës kundër korrupsionit.²⁷⁷ Për të garantuar efikasitet, kjo Drejtori do të bashkëpunojë edhe me institucione të tjera të specializuara, si Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK), Prokuroria e Përgjithshme, ILDKPKI, Agjencia e Prokurimit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe KLSH-ja. Megjithatë, rezultatet e këtij kuadri të institucioneve dhe mekanizmave në drejtim të sigurimit të integritetit të anëtarëve të organit ekzekutiv në praktikë ende nuk janë vlerësuar.

Nga ASPA janë organizuar vetëm trajnime sporadike për Kodin e Etikës të rishikuar të Ministrisë. Nuk ka asnjë raport të disponueshëm publikisht që detajon zbatimin e Kodit ose veprimet e ndërmarra nga Komisioni i Etikës.

Një raport i fundit dhe një bazë të dhënash shoqëruese për korrupsionin e nivelit të lartë jep dëshmi për fenomenin e kapjes së shtetit në Shqipëri lidhur me ndikimin e padrejtë të interesave private në formësimin e politikave publike në kurriz të publikut.²⁷⁸ Ligji për Investitorët Strategjikë në Shqipëri duket se është ndikuar shumë nga interesat private, veçanërisht në sektorin e ndërtimit. Me qëllim të nxitjes së investimeve të huaja direkte, ligji favorizoi bizneset vendase, siç dëshmohej nga shumica e përfitimeve që rrjedhin nga projektet vendase.²⁷⁹ Kritikët, duke përfshirë ekspertë ekonomikë dhe anëtarë të opozitës, argumentojnë se zbatimi i ligjit ka devijuar nga qëllimet e interesit publik, duke u fokusuar në vend të kësaj në investimet që gjenerojnë të ardhura të larta si pasuritë e paluajtshme, të cilat nuk përputhen me nevojat më të gjera ekonomike të prodhimit, industrisë apo bujqësisë.²⁸⁰ Mungesa e transparencës në procesin e lejeve sugjeron më tej se ligji mund të kujdeset për disa të përzgjedhur, duke minuar qëllimin e tij fillestar dhe potencialin për rritje të barabartë ekonomike.

ILDKPKI-ja ka vendosur një sistem *online* për pasuritë dhe që nga viti 2022, rreth 4000 persona të interesuar kanë futur deklaratat e tyre në sistemin online, por publikimi i pasurisë nuk do të ndodhë derisa të plotësohen kërkesat e sigurisë kibernetike.²⁸¹ Në vitin 2022 është lidhur një

marrëveshje bashkëpunimi mes SPAK-ut dhe ILDKPKI-së, e cila ka sjellë rritjen e asistencës dhe rritjen e shkëmbimit të informacionit mes dy institucioneve.²⁸²

Numri i rasteve të denoncuara në njësitë përkatëse dhe/ose tek ILDKPKI mbetet i ulët.²⁸³ Në vitin 2022, ILDKPKI-ja shqyrtoi 13 çështje sinjalizimi dhe dy kërkesa për mbrojtje kundër hakmarrjes.²⁸⁴ 12 çështje sinjalizimi vijnë nga sektori publik dhe një nga sektori privat.²⁸⁵ Burimet ose sinjalizuesit që raportojnë për korrupsion ose japin informacion në media gjithashtu mund të jenë nën presion dhe shpesh të përmbahen nga raportimi për shkak të frikës se mund të zbulohet identiteti i tyre. Ngurrimi për të raportuar korrupsionin si dhe mosbesimi i përgjithshëm në hetimin efektiv të tij është i dukshëm edhe tek zyrtarët publikë dhe reflektohet në numrin shumë të ulët të rasteve të sinjalizuesve ndër vite.²⁸⁶

TREGUESI 2.2.7 PËRFAQËSIMI GJINOR

Deri në çfarë niveli janë të përfaqësuara gratë në pozicione të ndryshme të organeve ekzekutive (Kabineti dhe emërimet e tjera presidenciale ose pozicione të tjera të ngjashme)?



Ka dispozita ligjore të cilat garantojnë përfaqësim të drejtë gjinor dhe qeveria ka tejkaluar standardet minimale ligjore.

Këto dispozita ligjore në fuqi garantojnë përfaqësimin e drejtë të grave në organet ekzekutive. Neni 15 i Ligjit për Barazinë Gjinore në Shoqëri detyron organet ekzekutive, legjislative, gjyqësore dhe institucionet e tjera publike të garantojnë përfaqësimin e të dyja gjinive me të paktën 30 për qind në organet drejtuese.²⁸⁷ Këshilli i Ministrave përfshin Kryeministrin dhe 16 ministra; dhjetë nga 16 ministrat janë gra.²⁸⁸

Politika e barazisë gjinore është pjesë e mandatit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ministri drejton Këshillin Kombëtar për Barazinë

Gjinore, një organ këshillimor, i cili ka për qëllim të garantojë përfaqësim të barabartë gjinor në fusha të ndryshme, duke përfshirë jetën sociale, ekonomike, politike dhe kulturore; mund t'i propozojë Këshillit të Ministrave politika për përfshirjen gjinore; si dhe miraton raportin e barazisë gjinore të përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këshilli Kombëtar ka dhjetë përfaqësues të qeverisë dhe tre përfaqësues të shoqërisë civile.²⁸⁹

ROLI

TREGUESI 2.3.1 MENAXHIMI I SEKTORIT PUBLIK (LIGJI DHE ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli është i përkushtuar dhe i angazhuar organi ekzekutiv për zhvillimin e një sektori publik të mirëqeverisur?



Rregullat dhe rregulloret e paqarta për përkrahje, trajnim dhe vlerësim priren të çojnë në pasiguri dhe varësi në vullnetin e mirë të eprorëve për ecurinë në karrierë, duke nxitur kështu një klimë që nuk është as profesionale dhe as e favorshme për një sektor publik të mirëqeverisur.

Legjislacioni i shërbimit civil përfshin dispozita që rregullojnë vlerësimin e performancës, nevojat për trajnim, promovimin dhe shpërblimin e nëpunësve civilë. Neni 62 i Ligjit për Shërbimin Civil përcakton rregullat bazë për vlerësimin e performancës, të cilat detajohen më tej në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26 shkurt 2014. Nëpunësit civilë duhet të vlerësohen çdo gjashtë muaj. Ato vlerësohen në bazë të përmbushjes së objektivave në përputhje me pozicionet dhe profesionalizmin e tyre – d.m.th aftësitë drejtuese, puna në ekip dhe përshtatja ndaj ndryshimit.²⁹⁰ Krahas vlerësimit të rregullt të performancës çdo gjashtë muaj, nëpunësit civilë vlerësohen edhe për marrjen e njohurive shtesë në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1037, datë 16 dhjetor 2015. Vendimi i Këshillit të Ministrave

kërkon që nëpunësit civilë të testohen çdo katër vjet për njohuritë e tyre dhe të ndjekin trajnime shtesë nëse vlerësohen me 70 pikë nga 100.²⁹¹ Nëpunësit civilë me rezultat mbi 70 nuk kanë nevojë të ndjekin trajnime shtesë. Ky vlerësim nuk ka për qëllim vetëm të vlerësojë njohuritë e nëpunësve civilë, por edhe të përcaktojë nëse ata janë të përshtatshëm për pozicionet që kanë.

Sistemi i shpërblimit është mjaft i ndërlikuar. Ai përfshin pagën bazë të çdo kategorie nëpunësi civil, një rritje vjetore prej dy për qind dhe kompensim shtesë në përputhje me kualifikimin akademik dhe përkatësinë institucionale.²⁹²

Sipas raportit të monitorimit të SIGMA-s për Shqipërinë 2021, vlerësimi i performancës, përkrahja dhe trajnimi nuk janë të ndërlidhura dhe për rrjedhojë nuk përbëjnë një sistem gjithëpërfshirës të menaxhimit të performancës, ndërkohë që ASPA ende nuk ka përgatitur programin e saj të trajnimit për Trupën e Stafit të Lartë Drejtues (TMC).²⁹³

SIGMA ka vënë në dukje gjithashtu mungesën e vlerësimeve të mjaftueshme të performancës për nëpunësit e lartë civilë²⁹⁴, dhe mungesën e të dhënave për shpërblimin e nëpunësve civilë, p.sh. paga mesatare mujore për kategori të shërbimit civil.²⁹⁵

TREGUESI 2.3.2 SISTEMI LIGJOR

Deri në çfarë niveli i jep prioritet sistemi ekzekutiv llogaridhënies publike dhe luftës kundër korrupsionit si shqetësim në vend?



Ndonëse ka një sërë reformash të ndërmarra dhe të përkrahura nga organet ekzekutive për të luftuar korrupsionin dhe për të promovuar integritetin, këto janë të fokusuara kryesisht në korrupsionin e vogël që zakonisht lidhet me ofrimin e shërbimeve dhe së fundmi në korrupsionin institucional në disa institucione me rrezik të lartë. Këto nuk janë efektive në arritjen e qëllimeve të tyre për shkak të vullnetit të

kufizuar politik, përpjekjeve të paqëndrueshme dhe burimeve, mjeteve dhe aftësive të pamjaftueshme.

Vitet e fundit, qeveria është angazhuar për të bërë një reformë të thellë në ofrimin e shërbimeve publike përmes krijimit të "One Stop Shops" të integruara për shërbimet dhe digitalizimin. Për shembull, qeveria, së bashku me donatorët ndërkombëtarë, zbatuan projektin "Inovacionin kundër korrupsionit: Krijimi i një modeli të ofrimit të shërbimeve me qendër qytetarin në Shqipëri" (ISDA), qëllimi i të cilit ishte përmirësimi i ofrimit të shërbimeve nëpërmjet digjitalizimit, ndarjes në *Front Office/Back Office* dhe krijimit të qendrave të ofrimit të shërbimeve "One Stop Shop".²⁹⁶ U krijua një agjenci e re përgjegjëse për politikën e ofrimit të shërbimeve, Agjencia për Ofrimin e Shërbimeve të Integruara në Shqipëri (ADISA), dhe cilësia e ofrimit të shërbimeve në vend është përmirësuar, siç tregohet në disa raporte.²⁹⁷ Në maj të vitit 2022, qeveria ndërmori një hap të rëndësishëm në digjitalizimin e shërbimeve të saj publike, duke mbyllur të gjitha "Front Desks" fizike për shërbimet administrative kombëtare (zyrat e ADISA). Ky tranzicion nënkuptonte që të gjitha shërbimet u ofroheshin qytetarëve vetëm online nëpërmjet platformës e-Albania. Qëllimi i këtij ndryshimi ishte përmirësimi i ofrimit të shërbimeve dhe reduktimi i korrupsionit.²⁹⁸ Megjithatë, ky kalim i shpejtë drejt një sistemi plotësisht online ngriti shqetësime në lidhje me aksesin e shërbimit për personat me njohuri të kufizuara digjitale, si dhe shqetësime për sigurinë e të dhënave personale.²⁹⁹

Sidoqoftë, korrupsioni në administratën publike mbetet një problem i rëndësishëm.³⁰⁰ Komisioni Evropian tërheq vëmendjen se në vitin 2022, vazhduan përpjekjet për përmirësimin e historikut të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve për sa i përket luftës kundër korrupsionit, por vullneti më i madh politik dhe përpjekjet më të strukturuar dhe të qëndrueshme, duke përfshirë burimet, mjetet dhe aftësitë e duhura, janë të domosdoshme.³⁰¹

Në vitin 2021, qeveria krijoi Rrjetin e Koordinatorëve Kundër Korrupsionit për të menaxhuar korrupsionin në institucionet me rrezik të lartë si Doganat ose Agjencia e Kadastrës, për shembull. Rrjeti është

pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë.³⁰² Drejtoria është përgjegjëse për programet kundër korrupsionit, si dhe vlerëson dhe merr vendime në bazë të raporteve hetimore që merr nga Koordinatorët e caktuar në institucione. Pavarësisht se Ministria e Drejtësisë i ka përcjellë prokurorisë disa raste të korrupsionit, Drejtoria nuk publikon raporte për punën e saj dhe për këtë arsye është e vështirë të vlerësohet ndikimi i saj.³⁰³ Disa nga detyrat e Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit dhe Drejtorisë së Përgjithshme Kundër Korrupsionit mbivendosen me kompetencat e ILDKPKI-së (shih treguesin 5.2.6) ose njësisë të mbrojtjes së sinjalizuesve në institucionet përkatëse në lidhje me përgjegjësinë për përpunimin e ankesave të sinjalizuesve.³⁰⁴

Koordinatorët mund të nisin një hetim në bazë të një ankesë që u paraqitet drejtpërdrejt nga një qytetar ose nëpunës publik, ose përmes një portali që administrohet nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje.³⁰⁵ Në aspektin ligjor kjo është puna e njësisë së mbrojtjes së sinjalizuesve të institucionit ose e ILDKPKI-së nëse sinjalizuesi i mundshëm vendos të bëjë ankesën drejtpërdrejt në Inspektoratin e Lartë.³⁰⁶

Kryeministri i Shqipërisë deklaroi në fillim të nëntorit 2023 se është e nevojshme të forcohen kapacitetet e brendshme të pushtetit ekzekutiv në luftën kundër korrupsionit.³⁰⁷ Gjithashtu, ka pasur njoftime nga zyrtarë të lartë në lidhje me përdorimin e inteligjencës artificiale për proceset e prokurimit për uljen e korrupsionit dhe rritjen e transparencës.³⁰⁸

NDËRVEPRIMET

Organet ekzekutive ndërveprojnë me Kuvendin, sektorin publik, KLSH-në dhe ILDKPKI-në. Dispozitat kushtetuese, (në rastin e Kuvendit) dhe ligjet dhe rregulloret përkatëse (në rastin e sektorit publik, KLSH-së dhe ILDKPKI-së) rregullojnë marrëdhëniet midis organeve ekzekutive dhe institucioneve të tjera. Kuvendi, KLSH-ja dhe ILDKPKI-ja duhet të mbikëqyrin punën e organeve ekzekutive. Ndërsa

Kuvendi ka një mandat të gjerë kushtetues për të garantuar që organi ekzekutiv po zbaton me efektivitet ligjet që miraton, ILDKPKI-ja duhet të sigurojë që organi ekzekutiv po zbaton me efektivitet dispozitat përkatëse për deklarimin e pasurisë, parandalimin e konfliktit të interesit dhe sinjalizuesit, ndërkohë që KLSH-ja shqyrton me kujdes buxhetet, shpenzimet dhe menaxhimin financiar të qeverisë për të siguruar që burimet publike janë përdorur në mënyrë efektive, efikase dhe në përputhje me ligjin, duke siguruar që organet shtetërore dhe subjektet publike veprojnë në përputhje me rregulloret dhe ligjet financiare.

Kompetenca e organit ekzekutiv për Kuvendin është e rëndësishme dhe dëshmohet përmes sasisë disproporcionale të legjislacionit të ndërmarra nga Këshilli i Ministrave dhe përdorimit të akteve normative për të anashkaluar procedurat standarde parlamentare të mbikëqyrjes. Kompetenca mbikëqyrëse e ILDKPKI-së për organin ekzekutiv është mjaft e kufizuar dhe fokusohet kryesisht në deklaratimet e pasurisë dhe të interesave private. ILDKPKI-ja ka vendosur gjoba për zyrtarët që kanë refuzuar të deklarojnë pasurinë, megjithëse referimet penale dhe administrative janë relativisht të pakta.³⁰⁹ Ndërveprimet e organit ekzekutiv me sektorin publik janë po aq problematike pavarësisht përmirësimeve në kuadrin ligjor për shërbimin civil. Disa organe shtetërore dhe pozicione të sektorit publik që duhet të jenë pjesë e shërbimit civil dhe që i nënshtrohen ligjit për nëpunësin civil përjashtohen nga ligji (si Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Agjencia Kombëtare e Rinisë, Agjencia Shtetërore e Shpronësimit, Instituti Kombëtar për Regjistrimin e Trashëgimisë Kulturore, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit), dhe në këtë mënyrë paraqesin një rrezik të konsiderueshëm për politizim.³¹⁰

Ndërveprimet e këtyre tre organeve me organin ekzekutiv sugjerojnë se ka pak presion mbi ekzekutivin për të hartuar politika efektive kundër korrupsionit. Fuqia e organit ekzekutiv është e tillë që jo vetëm që është në gjendje të anashkalojë mbikëqyrjen, por edhe të cenojë mandatin kundër

korupsionit të një agjencie të pavarur mbikëqyrëse, ILDKPKI-së.

REKOMANDIMET E ORGANIT

- + Organi ekzekutiv duhet të krijojë dhe t'u përmbahet proceseve rigoroze të rekrutimit të bazuar në merita për të siguruar që pozitat e shërbimit civil, sidomos postet e larta, të plotësohen bazuar në ekspertizën dhe kompetencat e lidhura me politikën dhe jo emërimet politike. Kjo duhet të përfshijë reformimin e kornizave aktuale të rekrutimit të pozicioneve të postit të lartë bazuar në një qasje monitorimi duke prezantuar përzgjedhjen e hapur dhe rekrutimin bazuar në kompetenca, si dhe duke ofruar kritere transparente për përzgjedhjet.
- + Organi ekzekutiv duhet të finalizojë reformën gjithëpërfshirëse të pagave, ta bëjë sistemin më të drejtpërdrejtë dhe t'i komunikojë hapur ndryshimet shërbimit civil. Reformat e pagave duhet të jenë transparente, me stimuj të qartë të performancës për të ruajtur dhe nxitur talentin. Sistemi i ri duhet të jetë i drejtë, ku postet e barabarta kanë paga të barabarta, si dhe të shoqërohet nga një strukturë stimuluese financiare e qartë dhe me në fokus rezultatin.
- + ASPA duhet të ketë burime të mjaftueshme për të ofruar trajnime të cilësisë së lartë. Programet e zhvillimit profesional duhet të monitorohen nga afër dhe të vlerësohen kundrejt treguesve të qartë të përafëruar me qëllimet strategjike të organit ekzekutiv.
- + Organi ekzekutiv duhet të publikojë vazhdimisht dokumente dhe raporte kyçe që janë me interes publik, duke përfshirë raportet e mbledhjeve të kabinetit dhe rezultatet e Programit të Transparencës. Duhet të sigurojë gjithashtu që kërkesave për informacion t'u përgjigjet menjëherë në mënyrë që të përmirësohet besimi i publikut dhe aksesit në informacion, duke forcuar një kulturë organizative ndaj transparencës dhe duke siguruar vullnetin politik për transparencë të vazhdueshme. Për të

- përmirësuar më tej transparencën buxhetore, organi ekzekutiv duhet të publikojë në kohën e duhur raportet e auditimit online si dhe të përfshijë të dhëna për gjendjen financiare të qeverisë dhe parashikimin makroekonomik në Propozimin e tij Buxhetor. Të gjitha të dhënat e publikuara duhet të jenë në përputhje me standardet e aftësisë për akses dhe përdorim të të dhënave të aksesueshme.
- + Kuvendi duhet të sigurojë që përdorimi i akteve normative të minimizohet duke forcuar mekanizmat e tij mbikëqyrës dhe duke përmirësuar procedurën e tij legjislative si dhe duke kërkuar raportim të vazhdueshëm dhe të rregullt për aktet normative nga organi ekzekutiv. Organi ekzekutiv duhet të sigurojë që të gjitha ndryshimet e rëndësishme legjislative t'i nënshtrohen shqyrtimit të duhur parlamentar dhe konsultimit publik. Komisioni për çështje juridike i Kuvendit duhet të shqyrtojë çdo përdorim të akteve normative dhe të raportojë publikisht gjetjet e tyre.
- + Kuvendi duhet të përdorë plotësisht mandatin e tij kushtetues për të kontrolluar organin ekzekutiv në mënyrë efektive. Kjo përfshin pranimin dhe veprimin sipas hetimeve parlamentare, mbajtjen e interpelancave më të shpeshta për t'i kërkuar llogari organit ekzekutiv, kërkesën nga ministrat dhe zyrtarët e lartë që të raportojnë në komisionet përkatëse parlamentare dhe ftesën për shoqërinë civile, median dhe palët e tjera të interesit në këto takime.
- + Kuvendi duhet të rishikojë ligjet në lidhje me "sekretin shtetëror" për të përcaktuar qartë se çfarë përbën sekret shtetëror dhe të krijojë një proces transparent shqyrtimi për informacionin e klasifikuar. Ky rishikim duhet të përfshijë kontributin e shoqërisë civile dhe ekspertëve ligjorë për të balancuar sigurinë kombëtare me të drejtën e publikut për informacion.
- + Ekzekutivi duhet të rishikojë kodet në fuqi për integritetin dhe etikën në mënyrë që të adresojë skenarët e "rotacioneve të shpeshta" dhe të sigurojë që ka rregulla të qarta dhe të zbatueshme në lidhje me pas-punësimin dhe

sjelljen në detyrë. Komisioni i Etikës duhet të ristrukturohet për të përfshirë anëtarë nga organi gjyqësor dhe shoqëria civile në mënyrë që të përmirësohet pavarësia e tij. Duhet t'i jepet kompetenca për të zbatuar sanksionet dhe për të shqyrtuar konfliktet e mundshme të interesit, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me Kryeministrin, dhe jo vetëm ministrat dhe zëvendësministrat.

- + Organi ekzekutiv duhet t'i japë përparësi luftës kundër korrupsionit me përpjekje më të qëndrueshme, të vazhdueshme dhe të koordinuara siç duhet dhe burime të përshtatshme, duke synuar si korrupsionin e vogël ashtu edhe atë institucional. Bashkëpunimi ndërmjet organeve kundër korrupsionit duhet të forcohet duke krijuar takime të rregullta koordinimi, shkëmbim informacioni dhe sisteme të integruara të të dhënave, shpërndarjen e fondeve për bashkëpunim dhe prezantimin e matësve të performancës për rezultatet e bashkëpunimit në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe efektiviteti.

BIBLIOGRAFI

- ¹⁹⁵ Komisioni i BE-së, Raporti i *Shqipërisë 2023*, (Bruksel: Komisioni i BE-së, 2023), f. 13-16, gjendet në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf, aksesuar më 21 nëntor 2023.
- ¹⁹⁶ SIGMA. (Raporti i Monitorimit për Shqipërinë 2021, (Paris: OECD Publishing, 2021), f. 812, marrë nga <https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf>, Aksesuar më 21 nëntor 2023.
- ¹⁹⁷ Alban Dafa, WeBER Raporti i Monitorimit për Shqipërinë 2019/2020, (Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2021a), f. 3940, 4547, 5859, 6173, https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/WeBER2.0_National-Monitoring-PAR-ALBANIA_2019-2020-1.pdf
- ¹⁹⁸ Komisioni i BE-së, Raporti i *Shqipërisë 2023*, (Bruksel: Komisioni i BE-së, 2023), f. 15, gjendet në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf, aksesuar më 21 nëntor 2023.
- ¹⁹⁹ Komisioni i BE-së, Raporti i *Shqipërisë 2023*, (Bruksel: Komisioni i BE-së, 2023), f. 14, gjendet në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf, aksesuar më 21 nëntor 2023.
- ²⁰⁰ Alban Dafa, 2021a: 69-71.
- ²⁰¹ SIGMA, Raporti i Monitorimit për Shqipërinë 2021, (Paris: OECD Publishing, 2021), f. 31, 35, 39, 52, 57, 7576, 8286, 8892, <https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf>
- ²⁰² Komisioni i BE-së, Raporti i *Shqipërisë 2023*, (Bruksel: Komisioni i BE-së, 2023), f. 13-16, gjendet në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf, aksesuar më 21 nëntor 2023.
- ²⁰³ *Ibid.*
- ²⁰⁴ SIGMA. (Raporti i Monitorimit për Shqipërinë 2021, (Paris: OECD Publishing, 2021), f.92, marrë nga <https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf>, aksesuar më 21 nëntor 2023.
- ²⁰⁵ SIGMA, 2021, f. 92.
- ²⁰⁶ Neni 92 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- ²⁰⁷ Neni 69 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- ²⁰⁸ Neni 103 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- ²⁰⁹ Neni 105 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- ²¹⁰ Neni 104 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- ²¹¹ Afrim Krasniqi dhe Adrian Haçkaj, *Shqiptarët dhe Modeli Social Evropian: Demokracia e Brendshme në Partitë Politike Shqiptare*, (Tiranë: Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim dhe Friedrich Ebert Stiftung, N.d), <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/11317.pdf>
- ²¹² Kuvendi i Shqipërisë, Buletini Statistikor 2021-2025, f. 4, <http://staging.parlament.al/Files/Informacione/Buletini%20statistikor%202021-2025..pdf>.
- ²¹³ Alban Dafa, 'Albania: Urgjenca e pabazuar dhe përdorimi i akteve normative për t'iu përgjigjur nevojave të sigurisë kombëtare në Mbikëqyrjen e Sektorit të Sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, *Çështjet e Sigurisë*, (Groningen: Qendra për Studime të Sigurisë Evropiane, 2021b), <https://cess.org/wp-content/uploads/2021/03/CESS-Security-Matters-No27.pdf>.
- ²¹⁴ Alban Dafa, "A e vlerëson lidhshipi politik shqiptar një ushtarak profesionist dhe kompetent?", Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 28 shtator 2020, <https://idmalbania.org/political-leadership-value-military/>.
- ²¹⁵ Neni 7 i Ligjit për të Drejtën e Informimit, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/09/18/119>.
- ²¹⁶ Neni 17 i Ligjit për të Drejtën e Informimit.
- ²¹⁷ Neni 17 i Ligjit për Informacionin e Klasifikuar si "Sekret Shtetëror", <https://qbz.gov.al/eli/ligj/1999/02/11/8457>.
- ²¹⁸ Neni 17 pika 2 e Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Ministrave, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2003/01/30/9000>.
- ²¹⁹ Neni 22 pika (1) e Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Ministrave.
- ²²⁰ Ligji Nr.9936, datë 26.6.2008, Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/l-9936 nga kuvendi_2 .pdf dhe për më shumë <https://financa.gov.al/ligjet/>
- ²²¹ Neni 34 i Ligjit për deklarimin e pasurisë dhe zbulimet e tjera financiare të zyrtarëve të caktuar publik, <https://www.ildkpi.al/legjislacioni-3/>.

- ²²² Sipas neneve 7 dhe 8 të ligjit nr. 119/2014 për të drejtën për qasje në informacione publike.
- ²²³ Komisioneri për të Drejtën e Aksesit në Informacion dhe Mbrojtjen e të Dhënave, Raporti Vjetor 2022, f. 10, e disponueshme në <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/Raporti-Vjetor-2022.pdf>, aksesuar më 26.11.2023.
- ²²⁴ Shembull nga faqja zyrtare e Këshillit të Ministrave dhe Zyrës së Kryeministrit, <https://www.kryeministria.al/menu-qeveria/>
- ²²⁵ Shembull nga faqja zyrtare e Këshillit të Ministrave dhe Zyrës së Kryeministrit, <https://kryeministria.al/programi-i-transparences-2/>
- ²²⁶ Shembull nga faqja zyrtare e Këshillit të Ministrave dhe Zyrës së Kryeministrit, <https://kryeministria.al/programi-i-transparences-2/>
- ²²⁷ Shembull nga faqja zyrtare e Këshillit të Ministrave dhe Zyrës së Kryeministrit, https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2023/06/URDHER-NR-74-DATE-09.06.2023_.pdf
- ²²⁸ Më shumë shikoni në faqen zyrtare të Kryeministrit, <https://kryeministria.al/akte-ligjore/>
- ²²⁹ Këshilli i Evropës. (2023). Faza e pestë e vlerësimit: Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeveritë qendrore (funksionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë ligjzbatuese në Shqipëri, f.11, marrë nga <https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6125>, aksesuar më 26.11.2023.
- ²³⁰ Për më shumë shikoni faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, <https://financa.gov.al/buxheti-ne-vite/>
- ²³¹ Komisioneri për të Drejtën e Aksesit në Informacion dhe Mbrojtjen e të Dhënave, Raporti Vjetor 2022, f. 13-14, e disponueshme në <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/Raporti-Vjetor-2022.pdf>, aksesuar më 26.11.2023.
- ²³² Blerjana Bino, 2023, Raporti Vjetor Shqipëri 2022: Treguesit mbi nivelin e lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve, Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt në Ballkanin Perëndimor, f. 21-22, e disponueshme në <https://safejournalists.net/wp-content/uploads/2023/03/ALB-ENG-2022.pdf>, aksesuar më 25.11.2023.
- ²³³ Neni 34 i Ligjit për deklarimin e pasurisë dhe zbulimet e tjera financiare të zyrtarëve të caktuar publik, <https://www.ildkpkj.al/legjislacioni-3/>.
- ²³⁴ ILDKPKJ-ja, Raporti Vjetor 2022, i disponueshëm në <https://www.ildkpkj.al/gloosys/2023/09/Raport-vjetor-2022.pdf>, aksesuar më 22.11.2023.
- ²³⁵ Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/article/legislation>.
- ²³⁶ Ligji nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/11/27/154>.
- ²³⁷ Nenet 11-16, Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2013/05/30/152-2013>.
- ²³⁸ Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/09/18/119>; Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/03/Ligj_Nr.9887_datë_10.3.2008_i_ndryshuar.pdf.
- ²³⁹ Ligji 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve publikë", <https://www.ildkpkj.al/legjislacioni-section2/>; Ligji nr. 60/2016 "Për sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", <https://www.ildkpkj.al/legjislacioni-section3/>.
- ²⁴⁰ Ligji nr. 10 221, më 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/2.pdf>
- ²⁴¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 28.8.2003 "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave", <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2003/08/28/584>.
- ²⁴² Kreu II i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
- ²⁴³ Neni 38 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
- ²⁴⁴ Neni 36 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
- ²⁴⁵ Neni 101 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- ²⁴⁶ Kuvendi i Shqipërisë, *Buletini Statistikor për vitet 2021-2025*, f. 26
- ²⁴⁷ Balkan Insight. (1 nëntor 2023). Pas përplasjes së deputetëve, kuvendi i Shqipërisë njoftoi që të punohet online Marrë nga <https://balkaninsight.com/2023/11/01/albanias-parliament-told-to-work-online-following-mps-clashes/>
- ²⁴⁸ Komisioni i BE-së, Raporti i *Shqipërisë 2023*, (Bruksel: Komisioni i BE-së, 2023), f. 7, gjendet në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf, aksesuar më 21 nëntor 2023.

- ²⁴⁹ Raportet vjetore të ILDKPKI-së mund të gjenden në: <https://www.ildkpkj.al/raporte-vjetore/>.
- ²⁵⁰ Institucioni i Lartë i Auditimit, *2021 Raporti Vjetor i Performancës*, (Tiranë: Institucioni i Lartë i Auditimit, 2022), f. 8, <https://panel.klsh.org.al/storage/phpY6y1k5.pdf>.
- ²⁵¹ Institucioni i Lartë i Auditimit, *2022 Raporti Vjetor i Performancës*, (Tiranë: Institucioni i Lartë i Auditimit, 2023), f. 6, i disponueshëm në https://drive.google.com/file/d/1XZ-FR_lyBJ5dbFUzELyEychi6OX8FpZX/view, aksesuar më 23.11.2023.
- ²⁵² Neni 31 i ligjit nr. 154/2014 për "Organizimin dhe Funksionimin e Institucionit të Lartë të Auditimit", https://www.klsh.org.al/content_text/3714, aksesuar më 23.11.2023.
- ²⁵³ Komisioneri i IMD-së, *Raporti Vjetor 2021*, (Tiranë: Komisioneri i IMD-së, 2022), f. 12-13, 21, <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/RAPORTI-VJETOR-2021.pdf>.
- ²⁵⁴ <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/Raporti-Vjetor-2022.pdf> f. 11
- ²⁵⁵ Komisioneri i IMD-së, *Raporti Vjetor 2020*, (Tiranë: Komisioneri i IMD-së, 2021), f.11, 22, https://www.idp.al/wp-content/uploads/2021/03/Raporti_IDP_2020.pdf.
- ²⁵⁶ Komisioneri i IMD-së, *Raporti Vjetor 2022*, (Tiranë: Komisioneri i IMD-së, 2023), i disponueshëm në <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/Raporti-Vjetor-2022.pdf>, aksesuar më 24.11.2023.
- ²⁵⁷ Komisioni i BE-së, *Raporti i Shqipërisë për vitin 2022*, (Bruksel: Komisioni i BE-së, 2022), f. 90, i disponueshëm në <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>
- Komisioni i BE-së, *Raporti i Shqipërisë për vitin 2023*, (Bruksel: Komisioni i BE-së, 2023), f. 15, i disponueshëm në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf,
- ²⁵⁸ Nenet 14-15 të Ligjit "Për nëpunësin civil".
- ²⁵⁹ Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *Raporti Vjetor për vitin 2022* është akoma i padisponueshëm për publikun.
- ²⁶⁰ Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *Raporti Vjetor 2021*, (Tiranë: Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, 2022), f. 132-138, <https://heyzine.com/flip-book/c7eb3c5db5.html#page/138>.
- ²⁶¹ Raporti mbi Progresin i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023, f. 48, i disponueshëm në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en, aksesuar më 27.11.2023.
- ²⁶² Kodi i Etikës Ministrore, <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2013/09/15/830>.
- ²⁶³ Ligji 9367, më 7.4.2005, 'Për parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve publikë', <https://www.ildkpkj.al/legjislacioni-section2/>.
- ²⁶⁴ Ligji nr. 9131, më 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2003/09/08/9131>.
- ²⁶⁵ Kodi Ministror i Etikës në Shqipëri, i disponueshëm në <https://qbz.gov.al/preview/55dc5c51-1372-4f5f-83d6-993a37192b23>, Aksesuar më 27.11.2023.
- ²⁶⁶ Neni 4 i Kodit Ministror të Etikës, <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2013/09/15/830> dhe në Kodin e ri të Etikës [mbetet i njëjtë](https://standarde.gov.al/vendim-nr-875-date-29-09-2021-per-miratimin-e-kodit-etik-ministror/), <https://standarde.gov.al/vendim-nr-875-date-29-09-2021-per-miratimin-e-kodit-etik-ministror/>
- ²⁶⁷ Neni 29 i Kodit Ministror të Etikës, <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2013/09/15/830> dhe në Kodin e ri të Etikës [mbetet i njëjtë](https://standarde.gov.al/vendim-nr-875-date-29-09-2021-per-miratimin-e-kodit-etik-ministror/), <https://standarde.gov.al/vendim-nr-875-date-29-09-2021-per-miratimin-e-kodit-etik-ministror/>
- ²⁶⁸ Neni 11, Kodi Ministror i Etikës, <https://standarde.gov.al/vendim-nr-875-date-29-09-2021-per-miratimin-e-kodit-etik-ministror/>
- ²⁶⁹ Nenet 15, 16, 18 të Kodit Ministror të Etikës.
- ²⁷⁰ *Ibid*, f. 10.
- ²⁷¹ Këshilli i Evropës. (2023). Faza e pestë e vlerësimit: Parandalimi i Korrupsionit dhe Promovimi i Integritetit në Qeveritë Qendrore (funksionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë ligjzbatuese në Shqipëri, f. 67, marrë nga <https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6125>, Aksesuar më 26.11.2023.
- ²⁷² Këshilli i Evropës. (2023). Faza e pestë e vlerësimit: Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeveritë qendrore (funksionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë ligjzbatuese në Shqipëri, f.12, marrë nga <https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6125>, aksesuar më 26.11.2023.
- ²⁷³ Raporti mbi Progresin i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023, f. 48, i disponueshëm në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en, aksesuar më 27.11.2023.

- ²⁷⁴ Neni 3 i Ligjit për Deklarimin e Pasurisë dhe Deklaratave të tjera Financiare të Zyrtarëve të Caktuar Publikë, <https://www.ildkpkj.al/legjislacioni-3/>.
- ²⁷⁵ Për më shumë, shih: <https://www.ildkpkj.al/legjislacioni-3/>
- ²⁷⁶ Këshilli i Evropës. (2023). Faza e pestë e vlerësimit: Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeveritë qendrore (funksionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë ligjzbatuese në Shqipëri, f. 4, Marrë nga <https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6125>, aksesuar më 26.11.2023.
- ²⁷⁷ Shih https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/Guida_Antikorrupsioni_-EN.pdf
- ²⁷⁸ G. Vurmo, R. Sulstarova, A. Dafa, "Zbërthimi i kapjes së shtetit në Shqipëri: Një shqyrtim i rasteve të korrupsionit të madh dhe ligjeve të posaçme nga 2008 deri në 2020," Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Transparency International, 2021, https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/2021_Report_DeconstructingStateCaptureAlbania_English.pdf, aksesuar më 26.11.2023.
- ²⁷⁹ F. Sinoruka, 2022. Reporter.al "Ligji për investime strategjike cilësohet si mjet klientelist", i disponueshëm në <https://www.reporter.al/2022/04/29/ligji-per-investime-strategjike-cilesohet-si-mjet-klientelist/>, aksesuar më 21 nëntor 2023.
- ²⁸⁰ O. Xama, 2023. Reporter.al, "Investitori strategjik: Si e fali qeveria 'Rama' portin e Vlorës për 1 euro", e disponueshme <https://www.reporter.al/2023/11/23/investitori-strategjik-si-e-fali-qeveria-rama-portin-e-vlores-per-1-euro/>, aksesuar më 26.11.2023.
- ²⁸¹ Komisioni i BE-së, Raporti i *Shqipërisë 2023*, (Bruksel: Komisioni i BE-së, 2023), f. 27, gjendet në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf, aksesuar më 21 nëntor 2023.
- ²⁸² Këshilli i Evropës. (2023). Faza e pestë e vlerësimit: Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeveritë qendrore (funksionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë ligjzbatuese në Shqipëri, f. 14, Marrë nga <https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6125>, aksesuar më 26.11.2023.
- ²⁸³ Jonida Jani, (2023). Forcimi i kuadrit të sinjalizimit të Shqipërisë: Një hap kyç në luftimin efektiv të korrupsionit. Friedrich Ebert Stiftung. Gjendet në <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/20706.pdf>, aksesuar më 26.11.2023.
- ²⁸⁴ Komisioni i BE-së, Raporti i *Shqipërisë 2023*, (Bruksel: Komisioni i BE-së, 2023), f. 26, gjendet në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf, aksesuar më 21 nëntor 2023.
- ²⁸⁵ ILDKPKI, Raporti Vjetor 2022, f. 14, gjendet në <https://www.ildkpkj.al/gloosys/2023/09/Raport-vjetor-2022.pdf>, aksesuar më 16.12.2023.
- ²⁸⁶ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). (2023). Raporti paralel i UNCAC – korrik 2023. Koalicioni UNCAC. f. 56, gjendet në <https://uncaccoalition.org/wp-content/uploads/Republished-Final---UNCAC-Parallel-Report---IDM---UNCAC-Coalition---July-2023.pdf>, aksesuar më 26.11.2023.
- ²⁸⁷ Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", <https://qbz.gov.al/eli/ligji/2008/07/24/9970>.
- ²⁸⁸ Zyra e Kryeministrit, 'Ministrat', <https://www.kryeministria.al/qeveria/> [aksesuar më 11 nëntor 2023].
- ²⁸⁹ Neni 11, Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri".
- ²⁹⁰ Kreu II, pika 10, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. nr. 109, datë 26.2.2014 "Për vlerësimin e performancës së nëpunësve civilë", <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-sherbimin-civil>.
- ²⁹¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1037, datë 16.12.2015 "Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë", <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-sherbimin-civil>.
- ²⁹² Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 8.3.2017, <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/144-vkm-187-pagat-e-nepunesve-civile>.
- ²⁹³ SIGMA, 2021, f. 78.
- ²⁹⁴ SIGMA, 2021, f. 85
- ²⁹⁵ SIGMA, 2021, f. 87.
- ²⁹⁶ Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, "Inovacioni për ofrimin e shërbimeve", <https://www.undp.org/albania/projects/innovation-service-delivery> [aksesuar më 11 nëntor 2022].
- ²⁹⁷ SIGMA, 2021; Alban Dafa, 2021.
- ²⁹⁸ Shih më shumë në: <https://akshi.gov.al/digjitalizimi-mjet-i-fuqishem-per-transparencen-e-sherbimeve-publike/>

- ²⁹⁹ Komisioni i BE-së, Raporti i *Shqipërisë 2023*, (Bruksel: Komisioni i BE-së, 2023), f. 13, gjendet në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf, aksesuar më 21 nëntor 2023.
- ³⁰⁰ Komisioni i BE-së, Raporti i *Shqipërisë 2023*, (Bruksel: Komisioni i BE-së, 2023), f. 22, gjendet në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf, aksesuar më 21 nëntor 2023.
- ³⁰¹ Komisioni i BE-së, Raporti i *Shqipërisë 2023*, (Bruksel: Komisioni i BE-së, 2023), f. 22, gjendet në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf, aksesuar më 21 nëntor 2023.
- ³⁰² Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 20.10.2021 "Për krijimin dhe organizimin e rrjetit të koordinatorëve kundër korrupsionit", <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/10/20/618>.
- ³⁰³ Ilir Vata, "Manja: Rrjeti kundër korrupsionit në 17 institucione, hap pozitiv", Albanian Telegraphic Agency, 18 maj 2022, <https://ata.gov.al/2022/05/18/manja-rrjeti-kunder-korrupsionit-ne-17-institucione-hap-pozitiv/>
- ³⁰⁴ Kreu V, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 20.10.2021.
- ³⁰⁵ Kreu VI, paragrafi 2, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 20.10.2021.
- ³⁰⁶ Kreu II, Ligji nr. 16/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".
- ³⁰⁷ *Agjencia Telegrafike Shqiptare*, 3 nëntor 2023, "Rama: Të forcojmë kapacitetet e brendshme kontrolluese të pushtetit ekzekutiv <https://ata.gov.al/2023/11/03/lufta-kunder-korrupsionit-rama-te-forcojme-kapacitetet-e-brendshme-kontrolluese-te-pushtetit-ekzekutiv/>, aksesuar më 21 nëntor 2023.
- ³⁰⁸ Radio Televizioni Shqiptar, 27 korrik 2023, "Inteligjenca Artificiale do të jetë kryefjala, ndryshim do ketë edhe e-Albania", gjendet në <https://lajme.rtsh.al/artikull/rama-inteligjenca-artificiale-do-te-jete-kryefjala-ndryshim-do-kete-edhe-e-albania>, aksesuar më 21 nëntor 2023.
- ³⁰⁹ Gjatë vitit 2021, ka pasur vetëm 16 referime penale dhe referime të tjera. Shihni ILDKPKI-në, *Raporti Vjetor 2021*, (Tiranë: ILDKPKI, 2022), f. 16, <https://www.ildkpkj.al/gloosys/2022/07/Raport-Vjetor-i-Inspektoratit-te-Larte-te-Deklarimit-dhe-Kontrollit-te-Pasurive-dhe-Konfliktit-te-Interesave-Viti-2021.pdf>.
- ³¹⁰ SIGMA, 2021: 72-73.

SISTEMI GJYQËSOR

PËRMBLEDHJE



Në vitin 2015, komisioni i posaçëm i Kuvendit të Shqipërisë për Reformën në Sistemin e Drejtësisë vlerësoi se “sistemi gjyqësor konsiderohet si një nga fushat me nivel të lartë korrupsioni.”³¹¹ Që atëherë, sistemi i drejtësisë shqiptare është prekur nga një reformë e thellë. Në vitin 2016 u miratua kuadri i ri ligjor, i cili përfshinte ngritjen e institucioneve të vetingut dhe të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED).³¹²

Institucionet e vetingut përfshijnë Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK), i përbërë nga 12 komisionerë, të zgjedhur nga parlamenti në vitin 2017;³¹³ Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA; dhomë e posaçme e Gjykatës Kushtetuese me mandat nëntë vjeçar deri në përfundimin e procesit të vetingut), i përbërë nga shtatë gjyqtarë, të zgjedhur nga parlamenti në vitin 2017;³¹⁴ dhe Institucioni i Komisionerëve Publikë (IKP), i përbërë nga dy komisionerë, të zgjedhur nga parlamenti në vitin 2017.³¹⁵

Institucionet e vetingut mbështeten dhe monitorohen nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, i cili përbëhet nga vëzhgues ndërkombëtarë nga SHBA-ja dhe BE-ja, ku përfshihen gjyqtarë dhe prokurorë me të paktën 15 vjet përvojë profesionale në vendet e tyre përkatëse. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit udhëhiqet nga Komisioni i BE-së.³¹⁶

Në fund të vitit 2018 u krijuan institucionet e reja qeverisëse, si Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), pasuar nga krijimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) në vitin 2020. KLGJ përbëhet nga 11 anëtarë me kohë të plotë, të cilët janë të angazhuar ekskluzivisht me qeverisjen e

sistemit gjyqësor. Për më tepër, Gjykata e Lartë ishte subjekt i reformës në drejtësi.

Harta e re gjyqësore rishikoi kompetencat territoriale të gjykatave, duke mbyllur nëntë gjykata më të vogla të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe katër gjykata administrative dhe pesë gjykata të apelit për të rritur efikasitetin e tyre dhe për të menaxhuar përgjysmimin e numrit të gjyqtarëve, kryesisht si pasojë e procesit të vetingut.³¹⁷

Vendet vakante në gjyqësor janë një nga sfidat kryesore për këtë degë të pushtetit. Deri në fund të korrikut 2023, pas verifikimit të tre komponentëve³¹⁸ të parashikuar me ligj (pasuria, integriteti dhe kapaciteti profesional), KPK-ja ka shkarkuar 138 gjyqtarë dhe 96 prokurorë (shpesh vetëm për një nga tre kriteret).³¹⁹ Kjo ka pasur një ndikim serioz në efikasitetin e gjykatave dhe përpjekjet e tyre për të zgjidhur çështjet e prapambetura të grumbulluara. Në vitin 2022, numri i çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë arriti në mbi 36,000 çështje, ndërsa në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, mbi 28,000 çështje.³²⁰ Ndër mangësitë e evidentuara në vendimet e KPK-së janë kapacitetet e pamjaftueshme profesionale të anëtarëve të saj dhe standardet e dyfishta të vendimeve të saj.³²¹

Sfidat e tjera lidhen me mbështetjen e nevojshme në aspektin e burimeve financiare dhe njerëzore, një sistem funksional për menaxhimin e çështjeve dhe bashkëpunim më i fortë me median dhe shoqërinë civile për të rritur transparencën në mënyrë që të forcohet besimi i publikut tek sistemi gjyqësor.

KAPACITETET

TREGUESI 3.1.1 BURIMET (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë ligje që kërkojnë sigurimin e pagave dhe kushteve të përshtatshme të punës për sistemin gjyqësor?



Ekzistojnë ligje gjithëpërfshirëse që synonë sigurimin e pagave të përshtatshme për sistemin gjyqësor dhe dispozita kundër reduktimit të të ardhurave.

Megjithatë, nuk ka rregullime për përshtatje ndaj inflacionit ose dispozita lidhur një buxhet minimal.

Pagat e gjyqtarëve përcaktohen me ligj sipas kategorisë së gjykatave: Gjykatat e Shkallës së Parë, të Apelit, të Posaçme apo të Lartë. Si rrjedhojë, pagat e gjyqtarëve varen nga posti që kanë dhe nga përvoja e tyre.³²²

Ligji parashikon gjithashtu që pagat e gjyqtarëve duhet të jenë në përputhje me titullin e postit të gjyqtarit, si dhe duhet të jenë të përshtatshme për të garantuar pavarësinë e tyre dhe mbrojtjen nga ndikimet e jashtme.³²³ Për më tepër, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton në nenin 138 se paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarëve nuk mund të ulen.³²⁴

Megjithatë, kushtetuta nuk garanton buxhetin e sistemit gjyqësor në tërësi. Në praktikë, kur ndryshon buxheti,³²⁵ buxheti total i sistemit gjyqësor mund të reduktohet nga legjislativi dhe/ose ekzekutivi, duke mos ulur pagat e gjyqtarëve. Mund të ndodhë që ndërkohë që pagat e gjyqtarëve mbeten të paprekura, shumica e buxhetit të dedikuar për “planifikim, menaxhim dhe administrim” ose “mbështetje për sistemet e IT-së sistemit gjyqësor” mund të reduktohet sepse këto të fundit nuk përfshihen në dispozitën kushtetuese.

Përkufizimi ligjor i “sistemit gjyqësor” në Shqipëri përfshin vetëm Gjykatën e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.³²⁶ Pra, në aspektin juridik, dhe nëse shihet më hollësisht, Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e “sistemit gjyqësor” në Shqipëri. Si rrjedhojë, Gjykata

Kushtetuese ka një buxhet të veçantë, të cilin e administron në mënyrë të pavarur.³²⁷ Buxheti i Gjykatës Kushtetuese, si pjesë e buxhetit të shtetit, hartohet nga ajo gjykatë dhe i paraqitet për miratim Kuvendit.³²⁸ Ashtu si me buxhetin e sistemit gjyqësor, buxheti i Gjykatës Kushtetuese nuk është i garantuar dhe mund të reduktohet nga legjislativi dhe/ose ekzekutivi, siç ka ndodhur në vitet 2016, 2020 dhe 2022 (shih 3.1.2). Kjo nuk është në përputhje me Opinionin Nr. 2 (2001) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian (CCJE) mbi financimin dhe menaxhimin e gjykatave në lidhje me efikasitetin e sistemit gjyqësor.³²⁹

Nuk ka asnjë mekanizëm që siguron rregullimin e pagave në lidhje me inflacionin pasi nuk ka dispozita ligjore që kërkojnë që gjyqësorit t'i ndahet një përqindje minimale të buxhetit të shtetit.

TREGUESI 3.1.2 BURIMET (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli ka sistemi gjyqësor sasi të mjaftueshme të burimeve financiare, personelit dhe infrastrukturës për të funksionuar në mënyrë efektive në praktikë?



Buxheti aktual dhe burimet e sistemit gjyqësor nuk mjaftojnë për të përmbushur detyrat e tyre.

Edhe pse ka pasur një përmirësim të konsiderueshëm në pagat e gjyqtarëve që nga 1 janari 2019, infrastruktura fizike gjyqësore (ndërtesat e gjykatave, sallat e gjyqit, siguria, teknologjia e informacionit dhe komunikimit [TIK], sistemet e menaxhimit të çështjeve,³³⁰ automjetet, etj.) nuk janë të financuara siç duhet. Nevojiten investime masive për të përmirësuar infrastrukturën e pamjaftueshme të sistemit gjyqësor, pavarësisht rritjes së vazhdueshme të buxhetit të tij. Shqipëria shpenzon 10 Euro për frymë për sistemin gjyqësor, ndërsa ndarja mesatare e buxhetit të një shteti anëtar të BE-së për sistemin gjyqësor është 64 euro për frymë.³³¹

Sa i përket buxhetit të Gjykatës Kushtetuese, në vitet 2016 dhe 2020 ka³³² qenë më i ulët se në vitet e mëparshme³³³ Në vitin 2022, Gjykatës Kushtetuese iu akorduan 155.5 milionë lekë (afërsisht 1.5 milionë Euro),³³⁴ që përbën 0.024 përqind të buxhetit të shtetit, ndërsa për vitin 2023 iu akorduan 170.5 milionë lekë (afërsisht 1.62 milionë euro).³³⁵

Në vitin 2022, buxheti i Gjykatës Kushtetuese ishte 0,024% e buxhetit të shtetit, ndërsa buxheti i sistemit gjyqësor në tërësi ishte afërsisht 0,589% e buxhetit të shtetit të Shqipërisë,³³⁶ pra gjithsej 0,613% e buxhetit të shtetit si për Gjykatën Kushtetuese ashtu edhe për sistemin gjyqësor.

Siç u cek më lart, infrastruktura fizike e sistemit gjyqësor nuk është financuar siç duhet. Godina e Gjykatës së Lartë nuk është e përshtatshme dhe nuk ka hapësirë për të akomoduar as 19 gjyqtarët, as stafin administrativ, apo arkivin. Ka mangësi në sistemin uniform të menaxhimit të çështjeve. Dy nga gjykatat përdorin sistemin IT ARK, ndërsa të tjerat përdorin sistemin ICMIS.³³⁷

Për më tepër, raporti i personelit administrativ për gjyqtar në Shqipëri është më pak se 3:1, ndërsa vendet vakante për gjyqtarë vazhdojnë të pakësohen. Nuk ka numër të mjaftueshëm të nëpunësve, burimeve të bibliotekës dhe pajisjeve moderne kompjuterike për gjyqtarët. Vetë gjykatat punësojnë stafin e tyre administrativ, gjë që sjell një shkallë e konsiderueshme stabiliteti tek burimet njerëzore.³³⁸

Pagat aktuale të gjyqtarëve, krahasuar me mesataren kombëtare në Shqipëri, mund të konsiderohen të përshtatshme dhe nuk krijojnë domosdoshmëri një arsye të fortë ekonomike që ata t'i drejtohen korrupsionit. Paga minimale në Shqipëri është 32,000 lekë (rreth 300 Euro),³³⁹ ndërsa paga e një gjyqtari të ri është 224,000 lekë (afërsisht 2,000 Euro). Megjithatë, ka pasur disa raste të gjyqtarëve të akuzuar dhe dënuar për korrupsion nga gjykatat, si dhe gjyqtarë të shkarkuar gjatë procesit të vetingut. 138 gjyqtarë janë shkarkuar për shkak se nuk justifikojnë pasurinë e tyre që nga fillimi i procesit të vetingut në nëntor 2017.³⁴⁰

Anëtarët e stafit kanë mundësi të ndryshme trajnimi brenda vetë sistemit, pra trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe KLJG-ja, ose nëpërmjet partnerëve të ndryshëm: organizata ndërkombëtare si BE-ja, Këshilli i Evropës (KE), OSBE-ja, ose organizatat joqeveritare (OJQ).³⁴¹

Gjyqtarët janë të detyruar me ligj që të ndjekin aktivitetet e vazhdueshme të trajnimeve nga 5 deri në 40 ditë në vit,³⁴² që është pjesë e vlerësimit të performancës së tyre të kryer nga KLJG-ja. Ka aktivitete të mjaftueshme trajnimi për të shtuar njohuritë e gjyqtarëve për ligjin dhe aftësitë e tyre gjyqësore, duke përfshirë menaxhimin e gjykatave dhe çështjeve, hartimin e vendimeve dhe parandalimin e konfliktit të interesit, të organizuara rregullisht nga Shkolla e Magjistraturës³⁴³ në kuadër të procesit të trajnimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve.³⁴⁴

TREGUESI 3.1.3 PAVARËSIA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli është i pavarur me ligj sistemi gjyqësor?



*Pas reformës legjislative të vitit 2016, kuadri ligjor aktual ka forcuar pavarësinë e sistemit gjyqësor në Shqipëri. Ka një boshllëk për sa i përket formës së kompetencës që u jepet prokurorëve të Prokurorisë Speciale, të cilët mund të hetojnë dhe ndjekin penalisht gjyqtarët e gjykatave speciale kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar pa garanci procedurale apo barriera të mëparshme.*³⁴⁵

Gjykatat më të larta, Gjykata Kushtetuese³⁴⁶ dhe Gjykata e Lartë,³⁴⁷ janë të rregulluara në kushtetutë, e cila garanton pavarësinë e tyre. Ndryshimi i Kushtetutës kërkon dy të tretat e votave të Kuvendit (93 vota nga 140).³⁴⁸ Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë gjyqtarë, ndërsa Gjykata e Lartë përbëhet nga 19 gjyqtarë.³⁴⁹

KLJG-ja i cili është organi drejtues i sistemit gjyqësor bën emërimet, shkarkimet, vlerësimet e performancës, masat disiplinore, transferimet dhe

ngritjet në detyrë.³⁵⁰ Nuk ka dispozita që përcaktojnë pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procedurat e emërimit të gjyqtarëve. Shoqëria civile është e përfshirë në procesin e zgjedhjes në radhët e tyre të një prej anëtarëve të KLGJ-së (Kryetari aktual i KLGJ-së vjen nga radhët e shoqërisë civile).³⁵¹

Gjyqtarët emërohen për një afat të pacaktuar nga KLGJ-ja në mënyrë që të paralajmërohen me ndërprerje arbitrare të kontratës.³⁵² Ata emërohen pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës pas përfundimit të trajnimit fillestar tre-vjeçar në Shkollën e Magjistraturës dhe pasi i nënshtrohen një procesi verifikimi të pasurisë dhe kontrollit të formimit.³⁵³

Kushtetuta parashikon garanci si për gjyqtarët ashtu edhe anëtarët e KLGJ-së. Gjyqtarët kanë imunitet në lidhje me mendimet e shprehura dhe vendimet e marra gjatë detyrës, me përjashtim të rasteve të dhënies së një vendimi të qëllimshëm si rezultat i një interesi vetjak ose mashtrimi.³⁵⁴ Në këtë rast, kjo do të konsiderohej "shkelje disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit"³⁵⁵ dhe do t'i nënshtrohej procedimit disiplinor nga ILD-ja dhe përfundimisht shkarkimit nga KLGJ-ja.

KLGJ-ja mund të sanksionojë gjyqtarët në mënyrë disiplinore nëse kryejnë shkelje të rënda profesionale ose etike që zhvlerësojnë postin dhe imazhin e gjyqtarit.³⁵⁶

KLGJ-ja i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë,³⁵⁷ ndërsa ky i fundit i emëron ata.

Procedura për shkarkimin e gjyqtarëve nga detyra³⁵⁸ siguron të gjitha garancitë e procesit të rregullt ligjor.³⁵⁹

Si ILD-ja ashtu edhe Këshillat (KLGJ dhe KLP) duhet të respektojnë dhe synojnë zbatimin e duhur të balancuar të parimeve kushtetuese.³⁶⁰

Rregulloret që mbrojnë gjyqtarët nga ndikimi i paligjshëm³⁶¹ bëjnë pjesë në Kodin Penal, si për të gjithë zyrtarët e tjerë publikë.³⁶²

Ka një boshllëk për sa i përket autoritetit që u jepet prokurorëve të Prokurorisë Speciale, duke u lejuar

ata të hetojnë dhe ndjekin penalisht gjyqtarët e gjykatave speciale që merren me korrupsionin dhe krimin e organizuar pa garanci procedurale apo kontrolle paraprake. Në formën e saj aktuale, kjo dispozitë ngre shqetësime për keqpërdorim detyre të mundshëm nga një prokuror special, pra keqpërdorim të pushtetit për të detyruar ose frikësuar një gjyqtar që kryeson një çështje të ngritur nga i njëjti prokuror. Kjo cenueshmëri do të menaxhohej nëse do të vendosej një masë paraprake, si kërkesa për autorizim nga KLGJ-ja përpara fillimit të hetimeve për gjyqtarët e gjykatave të posaçme.

TREGUESI 3.1.4 PAVARËSIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli funksionon sistemi gjyqësori pa ndërhyrje nga qeveria apo palët të tjerë interesi?



Ka ndërhyrje të jashtme të panevojshme në procedurat gjyqësore, veçanërisht nga organi ekzekutiv dhe media. Sulmet verbale ndaj sistemit gjyqësor vazhdojnë, ndërkohë nuk ka dëshmi të zbatimit efektiv të rregulloreve që mbrojnë gjyqtarët nga ndikimi i paligjshëm.

Procesi i vetingut ka shkaktuar paqartësi të gjyqtarët nëse ata do të vazhdojnë të jenë pjesë e sistemit gjyqësor.³⁶³ Një numër i konsiderueshëm gjyqtarësh janë përjashtuar nga sistemi gjyqësor.³⁶⁴ Përveç procesit të vetingut, është e pazakontë që gjyqtarët të shkarkohen nga detyra para përfundimit të mandatit të tyre, nëse nuk kryejnë një shkelje penale ose disiplinore.

Gjyqtarët nuk transferohen apo zbriten në detyrë për shkak të përmbajtjes së vendimeve që kanë nxjerrë. Madje, edhe KLGJ-ja e ka të ndaluar me ligj që i ndalohet me ligj të ndërhyjë gjatë vlerësimit të performancës së gjyqtarit, si dhe nuk mund të nxjerrë udhëzime për zgjidhjen e një çështjeje konkrete apo të një grupi çështjesh.³⁶⁵

Ka shembuj të ndërhyrjeve të padrejta të jashtme në proceset gjyqësore, veçanërisht nga organi

ekzekutiv,^{366 367} dhe media, si dhe nga politikanët e partive opozitare.³⁶⁸ Gjyqtarët janë fyer duke u konsideruar si "grabitqarë",³⁶⁹ njerëz që nuk arsyetojnë, por shohin vetëm të përfitojnë,³⁷⁰ apo si kriminelë me uniformë.³⁷¹

Politikanët, duke përfshirë ministrat dhe vetë kryeministrin, si dhe liderin e opozitës, kanë bërë komente fyese dhe kërcënuese ndaj gjyqtarëve për shkak të paragjyqimeve të tyre. Përveç kësaj, pronarët e bizneseve të mëdha, të cilët janë në të njëjtën kohë pronarë të shoqërive mediatike, kanë përdorur median e tyre për të sulmuar gjyqtarët që gjykonin çështje që përfshinin bizneset e tyre.³⁷² KLGJ-ja është përpjekur të mbrojë gjyqtarët nga ndikimi i jashtëm,³⁷³ por sulmet verbale ndaj drejtësisë vazhdojnë, pavarësisht reagimit të KLGJ-së. Nuk ka dëshmi të zbatimit efektiv të rregulloreve që mbrojnë gjyqtarët nga ndikimi i paligjshëm.

QEVERISJA

TREGUESI 3.2.1 TRANSPARENCA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë dispozita për të siguruar që publiku të mund të marrë informacione të rëndësishme për aktivitetet dhe proceset e vendimmarrjes të sistemit gjyqësor?



Ka dispozita gjithëpërfshirëse të cilat i mundësojnë publikut të marrë informacione për organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor, për vendimet që kanë të bëjnë me të dhe mënyrën se si janë marrë këto vendime. Megjithatë, dispozitat e paqarta çojnë në anonimizimin e kandidatëve të propozuar për gjykatën më të lartë në vend.

Të gjithë gjyqtarët shqiptarë, përfshirë edhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, duhet të deklarojnë pasurinë çdo vit tek ILDKPKI-ja. Deklarata duhet të përfshijë aksionet që gjyqtarët zotërojnë në një shoqëri, çdo pasuri të luajtshme të regjistruar (makina, anije, avionë), çdo pasuri të paluajtshme, çdo transaksion për transferimin e pronës dhe çdo shpenzim mbi 300,000 lekë (rreth 2,800 euro) që

mund të jenë paguar për arsimim, trajtim mjekësor, pushime, rinovim ose shpenzime të tjera të këtij lloji.³⁷⁴

Gjyqësori duhet të publikojë vazhdimisht në mjediset e tij dhe në faqen zyrtare të internetit informacione mbi gjykimet, statistikat gjyqësore, procesverbalet dhe transkriptet e seancave gjyqësore, anëtarësimin në organizatat përkatëse dhe aktivitete të tjera përkatëse për publikun në kohën e duhur. Nuk ka afat ligjor për publikimet, vetëm për Regjistrin e Kërkesave për Informacion, i cili duhet të përditësohet çdo tre muaj. Kërkohej me ligj që çdo gjykatë, si dhe KLGJ-ja, të ketë një program institucional të Transparencës, i cili përcakton kategorinë e informacionit që duhet të publikohet në mënyrë proaktive dhe mjetet e publikimit.³⁷⁵

Legjislacioni për të drejtën e informimit, i cili përfshin transparencën, zbatohet në të njëjtën mënyrë dhe për sistemin gjyqësor.³⁷⁶ Seancat gjyqësore janë të detyruara me ligj të jenë të hapura për publikun.³⁷⁷

Informacioni për emërimin, transferimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve duhet të bëhet publik, por ka një dispozitë që KLGJ-ja e interpreton si kërkesë për publikimin e vendimeve të veta me arsyetimin përkatës për statusin e gjyqtarëve apo nëpunësve civilë gjyqësorë në faqen e vet zyrtare, por duke fshehur identitetin e gjyqtarit.³⁷⁸ Dispozita konstaton se informacioni për vendimet e KLGJ-së në lidhje me emërimin, transferimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve duhet të jetë anonim para publikimit.³⁷⁹ Kjo nënkupton se publiku nuk do të njihet me emrin e personit që KLGJ-ja i propozon Presidentit të Republikës për t'u bërë anëtar i gjykatës më të lartë në vend.³⁸⁰ Interpretimi i hollësishëm nga KLGJ-ja nënkupton se edhe vendimet e saj për emërimet e gjyqtarëve janë anonime.³⁸¹

TREGUESI 3.2.2 TRANSPARENCA (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli ka akses publiku në informacionin dhe zbatimin e veprimtarive gjyqësore?



Publiku nuk mund të marrë lehtësisht informacion për emërimin, transferimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve për shkak të një dispozite problematike në ligj (shih 3.2.1).

Ekziston një faqe interneti gjithëpërfshirëse për sistemin gjyqësor që menaxhohet nga KLGJ-ja.³⁸² Gjyqësori publikon raporte të rregullta dhe gjithëpërfshirëse lidhur me veprimtaritë, shpenzimet dhe qeverisjen e tij. Të dhënat gjenden në faqet e internetit të gjykatave.³⁸³ Edhe KLGJ-ja publikon në faqen e saj të internetit raporte të plota lidhur me veprimtaritë, shpenzimet dhe qeverisjen e saj.³⁸⁴ Aksesin në informacion mbi procedurat gjyqësore, vendimet, statistikat gjyqësore, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe transkriptet është i besueshëm.³⁸⁵ Procesverbalet dhe transkriptet e seancave gjyqësore u jepen palëve me kërkesë të plotë, ndërsa publiku mund t'i marrë me kërkesë, pas anonimizimit, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave. Publiku ka akses në informacion lidhur me numrin e çështjeve të gjykuara çdo vit.³⁸⁶

Të gjitha gjykatat në Shqipëri publikojnë raporte vjetore në faqet e tyre të internetit që përfshijnë numrin e çështjeve të marra, numrin e çështjeve të gjykuara, numrin e çështjeve të bartura në vitin pasardhës, ngarkesën e çështjeve të gjykimit për gjyqtar, kohëzgjatjen e procedimeve etj. Qytetarët mund të aksesojnë këtë informacion në faqen e internetit të gjykatës përkatëse, por jo të gjitha gjykatat i publikojnë të gjitha dokumentet siç përcaktohet me ligj. Për shembull, Gjykata e Shkallës së Parë Fier nuk i ka publikuar vendimet e Këshillit Gjyqësor prej më shumë se një viti. Gjykata e Shkallës së Parë Berat ka publikuar gjithashtu vetëm një raport të mbledhjeve të Këshillit Gjyqësor për të gjitha vitet.³⁸⁷

TREGUESI 3.2.3 LLOGARIDHËNIA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë dispozita që sigurojnë që raportimin dhe përgjegjësinë e sistemit gjyqësor për veprimet e tij?



Pas reformës gjithëpërfshirëse në 2016, ekziston një kuadër ligjor për llogaridhënien e gjyqtarëve. Nuk ka dispozita në fuqi për të shqyrtimin e meritokracisë së emërimeve dhe ngritjen në detyrë brenda gjyqësorit. Megjithatë, KLGJ-ja kishte përfshirë në Planin e Veprimit 2019-2020 kryerjen e një sondazhi mes gjyqtarëve për të marrë opinionin e tyre në lidhje me meritokracinë e procesit të emërimit dhe ngritjes në detyrë.³⁸⁸ Sidoqoftë, kryerja e këtij sondazhi nuk është përfshirë në Planin Strategjik 2022-2024.³⁸⁹

Gjykatësve u kërkohet nga Kushtetuta që të japin arsytetime për vendimet e tyre³⁹⁰ të cilat mund të kuptohen lehtësisht nga palët e prekura. Nëse ata nuk japin arsyet për vendimet e tyre, ekzistojnë masa të përshtatshme disiplinore, në varësi të shkallës së pakujdesisë.

KLJG-ja vlerëson arsyetimin ligjor të dhënë nga gjyqtarët në vendimet e tyre gjyqësore për tregues si: qartësia dhe gjithëpërfshirja e vendimit; një strukturë e qëndrueshme dhe e zhvilluar e vendimit; cilësia e analizës; dhe argumentimi logjik. Vlerësuesi do të vlerësojë numrin e çështjeve pa gjykuar saktësinë e vendimit apo vlerësimin e çështjes dhe duke mos zëvendësuar interpretimin apo arsyetimin e gjyqtarit të vlerësuar.³⁹¹

Organi i pavarur i cili heton ankesat ndaj gjyqtarëve është Inspektori i Lartë i Drejtësisë, detyrë e parashikuar në Kushtetutë.³⁹² ILD-ja zgjidhet nga Kuvendi nga radhët e kandidatëve të përzgjedhur dhe të renditur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.³⁹³ Të paktën gjysma e inspektorëve të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë duhet të jenë magistratë që janë caktuar nga KLGJ-ja ose KLP-ja në ILD. Pjesa tjetër e inspektorëve do të emërohen nga IGJK-ja pas konsultimit me Komisionin për Emërimin dhe Vlerësimin e Inspektorëve.³⁹⁴ Kompetencat e ILD-së përfshijnë verifikimin e

ankesave, hetimin e shkeljeve me iniciativë dhe fillimin e procedimeve disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, të anëtarëve të KLGJ-së, të KLP-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe inspektimin institucional të gjykatave dhe prokurorive.³⁹⁵

Gjyqtarët nuk kanë imunitet në lidhje me korrupsionin dhe veprat e tjera penale. Ekziston një ankesë formale dhe procedurë disiplinore të iniciuar nga ILD-ja. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të fillojë procedurën disiplinore me mocionin e tij ose me veprimin e ankuesve. ILD-ja pranon ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik.³⁹⁶ ILD-ja është tërësisht e pavarur hetimin e ankesave, por nuk vendos sanksione, vetëm ua propozon këshillave përkatëse, d.m.th. KLGJ-së për gjyqtarët dhe KLP-së për prokurorët. Ankuesit mbrohen në mënyrë efektive dhe nuk janë konstatuar probleme. Pas marrjes së ankesës fillestare, nëse nga provat ILD-ja vlerëson se ka dyshime të arsyeshme për sjelljen e gjyqtarit, do të kryhet një hetim disiplinor. ILD-ja mund të propozojë një ose më shumë nga masat disiplinore të mëposhtme: paralajmërim konfidencial, vërejtje publike, ulje të përkohshme të pagës, ulje në detyrë, pezullim ose largim nga puna.³⁹⁷

TREGUESI 3.2.4 LLOGARIDHËNIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli anëtarët e organit gjyqësorit duhet të raportojnë dhe të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre?



Anëtarët e organit gjyqësorit shqiptar duhet të raportojnë dhe të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre. Megjithatë, dispozitat aktuale kanë qenë vetëm pjesërisht efektive, për arsye të efektivitetit të pjesshëm të organit që shqyrton ankesat dhe të vështirësive në lidhje me burimet njerëzore.

Në përgjithësi, zbatohen dispozitat ligjore për arsyetimin në vendime. Kjo pasqyrohet në vlerësimin e performancës së gjyqtarëve të kryer

nga KLGJ-ja, ku pjesa më e madhe e gjyqtarëve të vlerësuar morën vlerësimin “shumë mirë”, shkalla e dytë më e lartë e vlerësimit.³⁹⁸

Megjithatë, ka pasur një rast të hetuar nga ILD-ja ku KLGJ-ja vendosi në vitin 2021 marrjen e masës disiplinore të shkarkimit të një gjyqtari, i cili përveç lirit të mëhershëm të një të dënuari, nuk kishte dhënë arsytetime në asnjë nga vendimet e tij lidhur me atë të dënuar.³⁹⁹

ILD-ja e ka të vështirë të rekrutojë inspektorë mes gjyqtarëve për shkak të mungesës së stimujve që gjyqtarët të caktohen në ILD. Për shkak të shumë vendeve vakante në organin gjyqësor aktualisht, gjyqtarët preferojnë të rriten në detyrë në gjykata më të larta sesa të caktohen në ILD dhe të punojnë me rastet kur do t'u duhej të hetonin kolegët e tyre.⁴⁰⁰ Kjo nënkupton burime të pamjaftueshme njerëzore për organin përgjegjës për hetimin e ankesave që gjyqtarët të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre, duke ulur efikasitetin e ILD-së.

Procedurat disiplinore kanë qenë relativisht efektive. Gjatë vitit 2021, në përfundim të procedimit disiplinor, ILD ka propozuar shkarkimin e gjashtë gjyqtarëve, ndërsa KLGJ-ja ka shkarkuar dy prej tyre dhe pezulloi nga detyra një gjyqtar. Procesi për një nga tre gjyqtarët e mbetur është në vazhdim, ndërsa dy të tjerët kanë humbur statusin e magistratit. Në vitin 2022, ILD-ja propozoi procedim disiplinor ndaj 3 tre gjyqtarëve të KLGJ-së, e cila më pas u sanksionoi dy gjyqtarë: njëri gjyqtar u shkarkua ndërsa tjetrit iu dha vërejtje publike.⁴⁰¹

TREGUESI 3.2.5 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë mekanizma për të garantuar integritetin e anëtarëve të organit gjyqësorit?



Ndonëse ekziston një kod sjelljeje dhe ligje që sigurojnë integritetin e anëtarëve të organit gjyqësor, dispozitat nuk mbulojnë kufizimet pas punësimit për gjyqtarët që hyjnë në sektorin privat ose publik pas largimit nga organi gjyqësor.

Reforma legjislativë e vitit 2016 preku më shumë se një të tretën e dispozitave të kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe përfshiu miratimin e rreth 40 ligjeve të reja apo ndryshimeve ligjore. Përveç kuadrit ligjor, u hartua edhe kuadri institucional. Institucionet e vetingut janë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelitimit i cili shqyrton vendimet e ankimuar të KPK-së dhe Institucioni i Komisionerëve Publikë, i mbështetur dhe monitoruar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit. KLGJ-ja është krijuar në dhjetor 2018 si organ i pavarur drejtues i organit gjyqësorit shqiptar.

Gjyqtarët duhet të deklarojnë pasurinë e tyre dhe t'i paraqesin dokumentet lidhur me pasurinë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit në përputhje me Ligjin për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive.⁴⁰² Për më tepër, legjislacioni i vetingut i kërkonte gjyqtarëve që, së bashku me deklaratën e pasurisë, të paraqesin të gjitha dokumentet që arsyetojnë vërtetësinë e deklaratave në lidhje me legjitimitetin e burimit të pasurisë. Nëse gjyqtarët kanë pasuri jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ai ose ajo duhet të paraqesë pasqyrat bankare të viteve të fundit, të dhënat aktuale të pasurisë ose dokumente të tjera që tregojnë vlerën e pasurisë që ndodhet jashtë Shqipërisë. Kur ata kanë vepruar si donatorë, huadhënës dhe huamarrës, gjyqtarët duhet të justifikojnë legjitimitetin e burimit të këtyre pasurive.⁴⁰³ Përveç shqyrtimit të deklaratave të

pasurisë, rivlerësimi kryhet mbi dy kritere të tjera: një vlerësim historik dhe një vlerësim i aftësive profesionale.⁴⁰⁴

Kodi i Etikës Gjyqësore u miratua në vitin 2021⁴⁰⁵ dhe është mjaft gjithëpërfshirës.⁴⁰⁶ Ky kod fokusohet në respektimin e parimeve të pavarësisë, paanshmërisë, integritetit, sjelljes së denjë dhe vetëpërbajtjes, kujdesit dhe profesionalizmit të duhur, respektit dhe shqyrtimit të kujdesshëm, trajtimit të barabartë dhe transparencës.⁴⁰⁷ Ai parashikon që çdo gjyqtar mund të kërkojë një mendim këshillues nga Këshilltari i Komisionit të Etikës (aktualisht, një gjyqtar i Gjykatës së Lartë) në rast të një situatë të vështirë etike lidhur me disa veprime ose sjellje gjatë ushtrimit të detyrës gjyqësore ose në jetën private.⁴⁰⁸ Për më tepër, ai parashikon mekanizmin e monitorimit të zbatimit të Kodit, i cili i përket Kryetarit të çdo gjykate, i cili duhet të raportojë çdo problem etik në KLGJ.⁴⁰⁹ Në rastet e shkeljeve të lehta, kur ato nuk arrijnë shkallën e shkeljes disiplinore, ato merren parasysh në vlerësimin e performancës së gjyqtarit.⁴¹⁰

Nuk ka dispozita në Kod që i ndalojnë gjyqtarët të marrin rimbursime, kompensime dhe honorare në lidhje me udhëtimet e sponsorizuara privatisht, por ekziston një dispozitë e përgjithshme që përcakton se gjyqtarët nuk duhet të pranojnë dhurata, favore ose përfitime të tjera për veten e tyre ose për ndonjë prej të afërmeve të tyre, gjë që mund të vërë në pikëpyetje paanshmërinë e tyre.⁴¹¹

Nuk ekziston asnjë kufizim për gjyqtarët që bëhen punësohen në sektor privat ose publik pas largimit nga organi gjyqësor.

Qytetarët mund të kundërshtojnë paanshmërinë e një gjyqtari nëse nuk heqin dorë nga një çështje. Gjyqtari duhet të tërhiqet nëse ata ose të afërmit e tyre (të cilat janë përcaktuar më tej në ligj) interesohen për çështjen, kanë dhënë këshilla ose kanë shprehur një mendim për çështjen në gjykim, ose kanë marrë pjesë në gjykim (për shembull si dëshmitar ose në një gjykim për çështjen në një nivel tjetër).⁴¹²

TREGUESI 3.2.6 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli sigurohet integriteti i anëtarëve të organit gjyqësor?



Në Shqipëri ka pasur një qasje reaguese për të garantuar integritetin e anëtarëve të organit gjyqësor, por procesi nuk ka qenë i vazhdueshëm, duke përfshirë standarde të dyfishta në procesin e vetingut.

Në përgjithësi, procesi i vetingut ka ndikuar pozitivisht në sistemin shqiptar të drejtësisë, duke forcuar luftën kundër korrupsionit të gjyqtarët, të cilët e konsideronin veten si “të paprekshëm” për shkak të garancive që i ofron kushtetuta. Si rezultat i vazhdimit të procesit të vetingut, deri në fund të korrikut 2023, KPK-ja ka shkarkuar 138 gjyqtarë⁴¹³ nga 408 gjyqtarë në total. Procesi i vetingut ka zbuluar raste serioze të mungesës së integritetit të gjyqtarëve. Për shembull, rasti i vitit 2022 i një gjyqtari i cili kishte bërë një deklaram jo të plotë të pasurisë së tij, d.m.th kishte bërë një deklaratë të rreme për të fshehur burimin e vërtetë të këtyre pasurive dhe kishte mungesë provash që nuk justifikonin pasurinë e tij.⁴¹⁴

Megjithatë, pavarësisht monitorimit të rreptë nga vëzhguesit ndërkombëtarë, ka pasur vendime të diskutueshme të institucioneve të vetingut, qoftë kur gjyqtarët janë shkarkuar për shkelje të lehta, ose kur janë konfirmuar si gjyqtarë ndërkohë që ka pasur prova për kontakte të papërshtatshme ose kur ata nuk mund të justifikonin ligjërisht pasurinë e tyre. Një rast i njohur është ai i ish-gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, z. Artur Malaj. Pavarësisht problemeve me historikun dhe pasurinë e tij, KPK-ja e konfirmoi në detyrë në vitin 2018.⁴¹⁵ Një tjetër rast i diskutuar është ai i dy bashkëshortëve, të dy gjyqtarë, të cilët kishin pasuri të përbashkëta, ku bashkëshorti u konfirmua në detyrë⁴¹⁶ ndërsa gruaja e tij u shkarkua nga detyra.⁴¹⁷ Të dyja vendimet u morën nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në të njëjtën ditë, 6 korrik 2022.

Një rast i diskutueshëm është ai i znj. Alma Hicka. Në nëntor 2015, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut urdhëroi Shqipërinë të paguajë mbi 2,000,000 euro për tre familje të shpronësuara nga regjimi komunist. Shqipëria u përfaqësua në seancë gjyqësore nga avokatja e shtetit Alma Hicka, ndërsa kërkuesja u përfaqësua nga bashkëshorti i saj z. E. H. me studion e tij ligjore H. dhe H. Në 60 çështje të paraqitura në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në janar 2014 kundër Shqipërisë, 15 prej tyre përfaqësoheshin nga kjo studio ligjore, ku ortak ishte bashkëshorti i saj. KPK-ja largoi nga detyra gjyqtaren në vitin 2021.⁴¹⁸ Kolegji i Posaçëm i Apelit e riktheu atë në detyrë më 26 tetor 2023.⁴¹⁹

Kodi i Etikës Gjyqësore është miratuar në vitin 2021, por dispozitat e tij nuk janë testuar për të garantuar sjelljen etike të gjyqtarëve pasi në bazë të tij nuk është iniciuar asnjë çështje.⁴²⁰ Kjo mund të vijë si rezultat i procesit të vazhdueshëm të vetingut, ku palët preferojnë t'i referojnë çdo ankesë drejtpërdrejt institucioneve të vetingut sesa organeve drejtuese. Gjyqtari i emëruar nga KLGJ-ja si Këshilltar i Komisionit të Etikës në vitin 2019 ka dhënë në mënyrë proaktive dy opinione për çështje etike në vitin 2023.⁴²¹ Megjithatë, këto opinione bazohen në dispozitat e ligjit për statusin e gjyqtarëve, si dhe në praktikën ndërkombëtare, dhe jo vetëm në Kodin e Etikës Gjyqësore.

Gjyqtarët respektojnë detyrimin ligjor për të deklaruar pasuritë e tyre. Deklaratat e tyre të pasurisë shqyrtohen, por procesi i vetingut zbuloi raste të gjyqtarëve që nuk kishin asnjë arsytim ligjor për pasurinë e tyre. ILDKPI-ja nuk kishte konstatuar probleme gjatë deklaratave të këtyre gjyqtarëve, por KPK-ja i largoi nga detyra pasi nuk mund të siguronin prova që të arsyetonin në rrugë ligjore pasurinë e tyre. Për shembull, ILDKPKI-ja nuk konstatoi probleme për ish-kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, por komisioni i vetingut vendosi se ish-gjyqtarja kishte bërë deklaratë të rremë për burimin e ligjshëm të të ardhurave për një apartament me vlerë 1,959,546 lekë (18,546 euro).⁴²²

Megjithatë, ka pasur raste në të cilat ILDKPKI-ja ka konstatuar parregullsi dhe ka vendosur sanksione ndaj gjyqtarëve. Për shembull, në vitin 2021,

ILDKPKI-ja i vendosi sanksione 128 zyrtarë shtetëror.⁴²³

KLJG-ja nuk ka pasur mundësi të sigurojë respektimin e kodit të etikës pasi nuk ka pasur asnjë rast konkret deri në këtë moment.⁴²⁴

Aktualisht, qytetarët mund të kundërshtojnë paanshmërinë e një gjyqtari nëse ata nuk heqin dorë nga një çështje, dhe kjo zbatohet rregullisht në gjykata.

TREGUESI 3.2.7 NDJESHMËRIA GJINORE

Deri në çfarë niveli mekanizmat e organit gjyqësor marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore?

Rezultati

0

Nuk ekzistojnë udhëzime të caktuara që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore apo të dhëna të ndara sipas gjinisë mbi mekanizmat e organit gjyqësor.

Mekanizmat e ankesave dhe hetimit të organit gjyqësor nuk kanë protokolle dhe udhëzime të caktuara që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore, por përfshijnë punonjëset e vijës së parë.⁴²⁵ Organi gjyqësor nuk gjeneron të dhëna të ndara sipas gjinisë, si p.sh. ankesat e paraqitura nga femrat ose meshkujt, kohën e përpunimit të ankesave të paraqitura nga femrat ose meshkujt, ankesat e zgjidhura ose të shpërfillura nga femrat ose meshkujt, etj.

Bazuar në planin e trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës, nuk ka asnjë provë që organi gjyqësor u siguron zyrtarëve dhe stafit materiale trajnimi dhe ndërgjegjësimi për zbatimin e mekanizmave që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore.⁴²⁶

ROLI

TREGUESI 3.3.1 MBIKËQYRJA E SISTEMIT EKZEKUTIV

Deri në çfarë niveli organi gjyqësor ofron mbikëqyrje efektive të sistemit ekzekutiv?



Ndonëse Gjykata Kushtetuese dhe gjykatat administrative kontrollojnë akteve nënligjore, gjatë një periudhe të caktuar Gjykata Kushtetuese nuk funksiononte për shkak të shkarkimeve dhe dorëheqjeve të gjyqtarëve të lidhur me procesin e vetingut dhe gjykatat administrative morën përgjegjësinë, duke u përballur me sfida siç janë procedurat e zgjatura dhe mungesa e statistikave. Pavarësisht padive të zgjidhura kundër organit ekzekutiv, ekzistojnë raste kur Gjykata Kushtetuese nuk arriti të anulojë disa veprime ekzekutive, duke treguar efikasitetin dhe kufizimet e saj në mbrojtjen kundër praktikave jokushtetuese.

Organi ekzekutivi nxjerr akte nënligjore normative dhe individuale. Aktet nënligjore normative rregullohen nga Gjykata Kushtetuese⁴²⁷ dhe gjykatat administrative,⁴²⁸ ndërsa aktet nënligjore individuale rregullohen nga gjykatat administrative.⁴²⁹ Pas zbatimit të mjeteve efektive juridike, ato mund të kontrollohen nga Gjykata Kushtetuese.⁴³⁰

Gjatë kohës që Gjykata Kushtetuese nuk funksionoi për më shumë se dy vjet (korrik 2018 – dhjetor 2020) për shkak të procesit të vetingut, si rezultat i të cilit u shkarkuan gjyqtarët apo u morën masa për dorëheqjen e tyre, gjykatat administrative bënë kontrollin e organit ekzekutiv. Pasi aktet nënligjore individuale u kundërshtuan zakonisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, aktet nënligjore normative u kundërshtuan në Gjykatën Administrative të Apelit.

Procedimet e gjata, shkalla e ulët e autorizimeve dhe një numër i madh çështjesh të prapambetura vazhdojnë të kenë efekt negativ në efikasitetin e sistemit gjyqësor.⁴³¹ Këto janë raste të zakonshme dhe të shumta në numër, por gjykatat

administrative nuk kanë statistika për numrin e çështjeve ndaj organit ekzekutiv.

Një raport i vitit 2019 nga organizata e shoqërisë civile INFOÇIP tregon se paditë ndaj organit ekzekutiv kanë qenë të suksesshme në pjesën më të madhe të rasteve.⁴³² Vendimet që anulojnë vendimet e organit ekzekutiv zbatohen, pasi Kushtetuta përcakton se organet shtetërore zbatojnë vendimet gjyqësore.⁴³³ Gjykata Kushtetuese shqyrton vazhdimisht veprimet e organit ekzekutiv dhe mund t'i shpallë ato jokushtetuese, duke i bërë të pavlefshme.⁴³⁴ Gjykata Kushtetuese kontrollon aktet normative të organit ekzekutiv nëse ato aktivizohen nga subjektet e parashikuara në Kushtetutë (p.sh. Presidenti, deputetët e Kuvendit, Avokati i Popullit, KLSH-ja, etj.)⁴³⁵ Ka pasur shembuj kyç të rasteve kur Gjykata Kushtetuese ka ndërprerë disa nisma të qeverisë. Për shembull, në vitin 2023, Gjykata Kushtetuese anuloi aktin normativ me anë të cilit u krijua një bord për caktimin e çmimeve për disa produkte ushqimore bazë, sepse aktet normative nuk nxirreshin në kushte nevojë dhe emergjente dhe në këtë mënyrë organi ekzekutiv kishte zbatuar kompetencat që Kushtetuta i jep Kuvendit.^{436 437}

Megjithatë, ka edhe raste kur Gjykata Kushtetuese qartazi nuk ka përmbushur këtë rol. Për shembull, në vitin 2023, Gjykata Kushtetuese nuk arriti të anulojë aktin normativ që krijoi një bord që përcaktonte çmimet e naftës dhe produkteve të saj si dhe një tjetër akt që mundësoi ndërtimet pa leje duke bërë që shoqëritë e ndërtimit të paguajnë një gjobë për të konsideruar ndërtimin si të ligjshëm.

TREGUESI 3.3.2 NDJEKJA PENALE NË RASTET E KORRUPSIONIT

Deri në çfarë niveli është i përkushtuar organi gjyqësor për të luftuar korrupsionin përmes ndjekjes penale dhe veprimtarive të tjera?



Ndërsa kërkon të penalizojë shkelësit në çështjet e lidhura me korrupsionin, përpjekjet e organit gjyqësor shqiptar janë të kufizuara dhe ndonjëherë të pasuksesshme.

Organi gjyqësor angazhohet në mënyrë aktive në ndjekjen penale të korrupsionit të zyrtarëve publikë. Në vitin 2022, prokuroria paraqiti 13 çështje për gjykim nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, nga të cilat katër çështje u gjykuan brenda vitit 2022, tre prej tyre me vendim fajësie.⁴³⁸ Megjithatë, duke pasur parasysh nivelin e korrupsionit në Shqipëri siç paraqitet në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit 2022 (me një rezultat 36/100, duke u renditur 110 nga 180 vende)⁴³⁹, prokuroria dhe gjykatat duhet të rrisin përpjekjet për të zbuluar dhe sanksionuar rastet e korrupsionit në sektorin publik.

Gjykatat e posaçme kanë kompetencë për të gjykuar korrupsionin dhe krimin e organizuar si dhe kallëzimet penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarëve të Këshillit të Ministrave, gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, ILD-së, kryetarët e bashkive, deputetët e Kuvendit, zëvendësministrat, anëtarët e KLGJ-së dhe KLP-së dhe drejtuesit e institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara me Kushtetutë ose me ligj, si dhe akuzat ndaj ish-zyrtarëve të përmendur më lart. Rastet kryesore kundër korrupsionit në vitin 2023 përfshinin ndjekjen penale të ish-Presidentit të Republikës dhe ish-Kryeministrit⁴⁴⁰ (zyrtari publik më i lartë deri tani), ish-zëvendëskryeministrit,⁴⁴¹ ish-ministrit të Mjedisit dhe deputetit të Kuvendit,⁴⁴² ish-ministrit të brendshëm, kryetarëve të bashkive etj.⁴⁴³

Gjyqtarët e gjykatave të posaçme emërohen nga KLGJ-ja. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme mund të

shkarkohen me dy të tretat (tetë nga 11) të anëtarëve të KLGJ-së.⁴⁴⁴

Çështjet e lidhura me korrupsionin paraqiten përpara gjykatës së posaçme, e cila jep statistika të veçanta për rastet e korrupsionit.⁴⁴⁵ Këto statistika janë të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse.⁴⁴⁶

Organi gjyqësori rekomandon masa dhe reforma kundër korrupsionit sepse gjyqtarët janë rregullisht anëtarë të grupeve të punës për reformat ligjore.

Autoritetet gjyqësore sanksionojnë edhe rastet e pastrimit të parave. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krim të Organizuar ka nxjerrë dy vendime për pastrim parash në vitin 2019, tre në vitin 2020, tre në vitin 2021, një në vitin 2022 dhe dy në fund të majit të vitit 2023.⁴⁴⁷

Komisioni i BE-së arriti në përfundimin në raportin e tij të vitit 2022 për Shqipërinë se ka një nivel përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit dhe se Shqipëria ka vazhduar përpjekjet e saj për të krijuar historikun e saj të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit dhe kjo e fundit ka dhënë disa rezultate.⁴⁴⁸

TREGUESI 3.3.3 ASISTENCA E NDËRSJELLËT JURIDIKE

Deri në çfarë niveli autoritetet gjyqësore bashkëpunojnë me agjencitë e huaja ligjzbatuese për të ofruar dhe për të marrë asistencë të ndërsjellët juridike?



Organet gjyqësore u përgjigjen në kohë kërkesave për ndihmë juridike nga agjenci të huaja. Ato përdorin mjetet e ndihmës së ndërsjellë juridike gjatë hetimeve të rasteve. Megjithatë, statistikat për rastet kanë qenë subjekt i ndërhyrjeve të huaja.

Ndërveprimi me partnerët e huaj kryhet në kohën e duhur, por statistikat për rastet lidhur me asistencën e ndërsjellë juridike kanë qenë subjekt i ndërhyrjeve të paligjshme nga shtetet e huaja, të cilat i kanë penguar ato.⁴⁴⁹

Autoritetet gjyqësore u përgjigjen në kohë të gjitha kërkesave për asistencë nga partnerët e huaj nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë. Në Ministrinë e Drejtësisë dhe në Prokurorinë e Përgjithshme është vënë në funksion një sistem elektronik për kërkesat për asistencë nga partnerët e huaj. Ministria e Drejtësisë është e caktuar për ofrimin dhe marrjen e asistencës së ndërsjellë juridike dhe është autoriteti përgjegjës për publikimin e statistikave të rasteve.⁴⁵⁰

NDËRVEPRIMET

Organi gjyqësor ndërvepron më së shumti me prokurorin publik, agjencitë ligjzbatuese dhe mediat. Ndërveprimet janë formale, bazuar në kuadrin ligjor aktual.

Lidhur me dy të parat, ndërveprimet parashikohen në dispozitat specifike të Kodit të Procedurës Penale që rregullon ndërveprimet ndërmjet gjykatave, prokurorisë dhe policisë hetuese. Përveç rregulloreve procedurale, qëllimi i këtyre ndërveprimeve përfshin shkëmbimin e informacionit, bashkëpunimin në programe të përbashkëta dhe shkëmbimin e përvojave. Ato kanë ndikim pozitiv në punën kundër korrupsionit të këtij organi sepse ndikojnë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së organit gjyqësor.

Marrëdhënia e organit gjyqësor me median dhe shoqërinë civile është përmirësuar, por duhet të forcohet më tej në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti dhe ndikimi i përpjekjeve të organit gjyqësor kundër korrupsionit. Ndër përmirësime të tjera, në vitin 2019 janë krijuar institucione të reja brenda organit gjyqësor që nuk ekzistonin më parë, si emërimi i anëtarit të KLGJ-së përgjegjës për marrëdhëniet me publikun,⁴⁵¹ emërimi i gjyqtarëve të dedikuar për marrëdhëniet me publikun në çdo juridiksion apeli,⁴⁵² si dhe miratimin e Planit Strategjik dhe të Planit Strategjik⁴⁵³ të Komunikimit për organin gjyqësor në vitin 2020.⁴⁵⁴ Krijimi i një Këshilli për Marrëdhëniet ndërmjet organit gjyqësor dhe medias me përfaqësues nga të dy aktorët do të ishte një zhvillim i rëndësishëm që do të forconte marrëdhëniet e tyre dhe do të përmirësonte

transparencën dhe llogaridhënien e organit gjyqësor.

REKOMANDIMET E ORGANIT

- + Organi ekzekutiv dhe ai legjislativ duhet të ndryshojnë Kushtetutën për të përfshirë garancitë për buxhetin e organit gjyqësor në tërësi, krahas garancive aktuale të parashikuara nga neni 138 i Kushtetutës për pagat dhe përfitimet e gjyqtarëve; duhet të ketë një dispozitë që përcakton se organi gjyqësor duhet t'i ketë të paktën 1% të buxhetit të shtetit.
- + Organi ekzekutiv dhe legjislativ duhet të rrisin fondet për infrastrukturën fizike të organit gjyqësor në buxhetin e shtetit 2024 për investime në sistemet e menaxhimit të çështjeve, TIK, ndërtesa, sallat e gjyqit, sigurinë dhe automjetet.
- + Organi ekzekutiv dhe legjislativ duhet të ndryshojnë ligjin 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" për të përfshirë si në vijim:
 - + që viti i tretë i studimeve në Shkollën e Magjistraturës të konsiderohet "vit i praktikës profesionale", gjatë të cilit kandidatët gjykojnë çështje më pak të komplikuar;
 - + që procesi i verifikimit të pasurisë dhe kontrollit të historikut të kandidatëve në Shkollën e Magjistraturës të kryhet vetëm në fillim të studimeve.
- + Organi ekzekutiv dhe legjislativ duhet të ndryshojnë ligjin 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", për të shfuqizuar kërkesën e KLGJ-së për anonimizimin e informacionit lidhur me emërimin, transferimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve.
- + KLGJ-ja duhet të marrë iniciativën për krijimin e Këshillit të Marrëdhënieve të Gjyqësorit me Median me përfaqësues nga të dy aktorët.
- + KLGJ-ja duhet të ndryshojë Kodin e Etikës së Organit Gjyqësor, i cili duhet të përfshijë një dispozitë që përcakton se gjyqtarët nuk duhet të marrin rimbursime, kompensime dhe honorare në lidhje me udhëtimet e sponsorizuara në mënyrë private.
- + KLGJ-ja duhet të miratojë një akt për përfshirjen e numrit të çështjeve kundër organit ekzekutiv dhe rezultatit të tyre, si dhe të dhënave të ndara sipas gjinisë, në statistikat e organit gjyqësor.
- + Shkolla e Magjistraturës duhet të përfshijë tema mbi zbatimin e mekanizmave që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore në programin e edukimit në vazhdim.

BIBLIOGRAFI

- ³¹¹ Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë - Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, "Analiza e sistemit të drejtësisë në Shqipëri", qershor 2015, f.10. <https://euralius.eu/images/Justice-Reform/Analysis-of-the-Justice-System-in-Albania.pdf> (konsultuar më 08.08.2023).
- ³¹² http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Funksionet_5588_1.php: KED përbëhet nga nëntë anëtarë, gjyqtarë dhe prokurorë, të zgjedhur me short nga Presidenti i Republikës, nga data 1 deri më 5 dhjetor të çdo viti: dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, një gjyqtar të Gjykatës së Lartë (i cili kryeson Këshillin), një prokuror të Prokurorisë së Përgjithshme, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë të Apelit dhe një gjyqtar të gjykatës administrative. KED kryen verifikimin e kritereve ligjore, profesionale dhe morale, si dhe bën renditjen e kandidatëve për t'u zgjedhur gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektor të Lartë të Drejtësisë. KED rendit kandidatët sipas meritave të tyre profesionale. Presidenti, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë, emërojnë dhe zgjedhin gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese ndërmjet tre kandidateve të renditur në tri vendet e para nga KED. Kuvendi zgjedh Inspektorin e Lartë të drejtësisë ndërmjet pesë kandidatëve të renditur në pesë vendet e para nga KED. Në rastin kur këto organe të emërtesës nuk arrijnë të emërojnë dhe zgjedhin kandidatin, i emëruar në detyrë është kandidati i renditur i pari nga KED.
- ³¹³ <https://kpk.al/>.
- ³¹⁴ <https://kpa.al/>.
- ³¹⁵ <https://ikp.al/>.
- ³¹⁶ https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/international-monitoring-operation_en?s=214 (konsultuar më 31.08.2023)
- ³¹⁷ Këshilli i Lartë Gjyqësor, "Harta e re Gjyqësore": <https://klgj.al/harta-e-re-gjyqesore/> (aksesuar më 24.10.2023)
- ³¹⁸ Megjithatë, në praktikë nuk ka qenë gjithmonë kështu. Autoritetet e vetingut kanë shkarkuar gjyqtarë dhe prokurorë vetëm për një kriter, kryesisht pasurinë, duke mos shqyrtuar dy kriteret e tjera.
- ³¹⁹ Raporti Statistikor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit shkurt 2018-korrik 2023, f.1. <https://kpk.al/wp-content/uploads/2023/08/RAPORTI-STATISTIKOR-2018-KORRIK-2023.pdf> (konsultuar më 09.08.2023).
- ³²⁰ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raporti vjetor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor në vitin 2022, f. 60 dhe 76. <https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/07/RAPORT-VJETOR-2022-shkarko.pdf> (konsultuar më 09.08.2023).
- ³²¹ Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Raport Studimor - Monitorimi i procesit të vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve në periudhën janar 2017 – qershor 2018, f. 45-46. https://www.osfa.al/sites/default/files/raport-studimor-monitorimi-i-procesit-te-vettingut-te-gjyqtareve-dhe-prokuroreve_jan17-qer18.pdf (konsultuar më 09.08.2023).
- ³²² Ligji 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neni 12.
- ³²³ Përfitimet e tjera financiare përfshijnë kompensimin për transfertat e përkohshme ose pjesëmarrjen në skemën e delegimit, pensionin shtetëror suplementar etj. Ligji 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neni 11.
- ³²⁴ Me përjashtim të: a) masave të përgjithshme ekonomiko-financiare në rastet e emergjencave financiare ose emergjencave të tjera kombëtare; b) gjyqtari rikthehet në postin që kishte përpara emërimit; c) gjyqtarit i jepet një masë disiplinore ose performanca e tij vlerësohet si "profesionalisht e pamjaftueshme".
- ³²⁵ Ligji 9936/2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Neni. 46. <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Ligji%209936%2026.6.2008%20P%3%8B%20MENAXHIMIN%20E%20SISTEMIT%20BUXHETOR%20N%3%8B%20REPUBLIK%3%8B%20E%20SHQIP%3%8B%20RIS%3%8B.pdf> (konsultuar më 09.08.2023).
- ³²⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni. 135(1) dhe Ligjit 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", neni 3 (1).
- ³²⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 124 (3).
- ³²⁸ Ligji 8577/2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", neni 6
- ³²⁹ "...megjithëse financimi i gjykatave është pjesë e buxhetit të shtetit të paraqitur në Kuvend nga Ministria e Financave, ky financim nuk duhet të jetë subjekt i luhatjeve politike. Megjithëse niveli i financimit që një vend mund të përballojë për gjykatat e tij është një vendim politik, duhet pasur gjithmonë kujdes, në një sistem të bazuar në ndarjen e pushteteve, për të siguruar që as autoriteti ekzekutiv dhe as ai legjislativ nuk janë në gjendje të ushtrojnë ndonjë presion mbi sistemin gjyqësor kur cakton buxhetin e tij. Vendimet për ndarjen e fondeve për gjykatat duhet të merren me respektimin më të rreptë të pavarësisë së sistemit gjyqësor." <https://rm.coe.int/1680747492> (konsultuar më 9.9.2022).

³³⁰ Ka mangësi në sistemin uniform të menaxhimit të çështjeve. Dy nga gjykatat përdorin sistemin IT-së të ARK-së, ndërsa pjesa tjetër përdorin sistemin ICMS.

³³¹ Andi Hoxhaj, "Iniciativa e BE-së për Shtetin e së drejtës drejt Ballkanit Perëndimor", Revista e Hagës mbi Shtetin e së drejtës 13, 143–172 (2021).

³³² <https://financa.gov.al/ligji-i-buxhetit-2016/> (konsultuar më 17.05.2023).

³³³ Viti 2015: 120.1 milionë lekë afërsisht 850,000 Euro), <https://financa.gov.al/buxheti-2015/>; Viti 2016: 116 milionë lekë (afërsisht 845,000 Euro), <https://financa.gov.al/ligji-i-buxhetit-2016/>; Viti 2019: 162.7 milionë lekë (afërsisht 1.35 milionë Euro), <https://financa.gov.al/buxheti-2019-fillestar/>; Viti 2020: 147 milionë lekë (afërsisht 1.2 milionë euro), <https://financa.gov.al/buxheti-2020/> (konsultuar më 17.05.2023)

³³⁴ Intervistë me Kryetarin e Kabinetit të Gjykatës Kushtetuese, z. Aleksandër Toma, 8 shtator 2022.

³³⁵ <https://financa.gov.al/per-buxhetin-e-vitit-2023/> (konsultuar më 17.05.2023)

³³⁶ Intervistë me Departamentin e Programimit dhe Administrimit të Buxhetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Luljeta Laze dhe z. Xhevdet Haxhiu, 6 shtator 2022.

³³⁷ Raporti analitik i Grupit të Punës të krijuar me Urdhër të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 232, datë 4.11.2019, "Për ngritjen e Grupit të Punës, për kryerjen e një studimi, në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve në gjykata", f.6 (aksesuar më 29.01.2020; raporti nuk disponohet online).

³³⁸ Ligji 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", neni 38.

<https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=193&catid=88&m=0> (aksesuar më 27.10.2023).

³³⁹ <https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/1707/njoftim-per-pagen-minimale-nga-periodha-prill-2022> (konsultuar më 31.08.2023).

³⁴⁰ Raporti Statistikor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit shkurt 2018-korrik 2023, f.1. <https://kpk.al/wp-content/uploads/2023/08/RAPORTI-STATISTIKOR-2018-KORRIK-2023.pdf> (konsultuar më 09.08.2023).

³⁴¹ Programi i trajnimit të Shkollës së Magjistraturës: <https://www.magjistratura.edu.al/sq/programi-i-trajnimeve> (aksesuar më 25.10.2023); Projekti i financuar nga BE-ja EURALIUS "Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri" "Objektivi 5: Rritja e kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës (SM) dhe institucioneve të tjera trajnimi përgjegjëse për trajnimin e nëpunësve civilë (sistemi gjyqësor) në gjykata dhe prokurori..."

<https://www.cilc.nl/project/consolidation-of-justice-system-in-albania-euralius-v/> (aksesuar më 25.10.2023);

Programi i trajnimit të OJQ Infoçip "Gjykata e Hapur përmes Gjyqtarëve për median":

<https://www.infocip.org/al/?p=14466> (aksesuar 25.10.2023).

³⁴² Ligji 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neni 5 (3).

³⁴³ <https://www.magjistratura.edu.al/sq/programi-i-trajnimeve>.

³⁴⁴ *Ibid.*

³⁴⁵ Ligji nr.95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar", neni 14. I disponueshëm në: https://klp.al/wp-content/uploads/2020/02/llogji_nr_95_2016_per_organizimin_dhe_funksionimin_e_institucioneve_per_te_luftuar_korrupsionin_dhe_krimin_e_organizuar_s_1728.pdf (aksesuar më 25.10.2023).

³⁴⁶ Pjesa 8, "Gjykata Kushtetuese", Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni. 124-134.

³⁴⁷ Pjesa 9, "Sistemi Gjyqësor", Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni. 135-147/ç.

³⁴⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 177:

³⁴⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 125.

³⁵⁰ KLGJ-ja përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë gjyqtarë (të zgjedhur nga vetë gjyqtarët) dhe pesë jo-gjyqtarë, nga të cilët dy zgjidhen nga avokatët, dy zgjidhen nga akademia dhe një nga shoqëria civile. Si kryetari i KLGJ-së ashtu edhe deputeti zgjidhen mes jo-gjyqtarëve në mënyrë që të ruhet balanca dhe të zbehur raportin e shumicës (gjashtë me pesë) që gjyqtarët kanë në Këshill.

³⁵¹ Nenet 54-58 të ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë",

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Thirrja_e_Mbledhjes_se_Posacme_te_gjyqtareve_te_Gjykates_se_Larte_per_te_zgjedhur_anetarin_e_Gjykates_Kushtetuese_19897_1-5.php (konsultuar më 19.05.2023).

³⁵² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 140.

³⁵³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 136/a.

³⁵⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 137.

³⁵⁵ Ligji 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neni 102.

³⁵⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 140.

³⁵⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 147/a.

³⁵⁸ Neni 100-150 i ligjit 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ILD-ja hap hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se ka ndodhur sjellja joprofesionale bazuar në faktet dhe provat e mbledhura që justifikojnë hapjen e hetimit (neni 123). Magjistrati është palë në procedurën gjyqësore dhe ka askes duke filluar nga momenti i hapjes së hetimit në masën që është në përputhje me objektin e hetimit (neni 129). Kur ka baza të arsyeshme për të besuar se një gjyqtar ka kryer një sjellje jo profesional, ILD-ja do të fillojë procedimin disiplinor duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen e hetimit në KLGJ. Kjo e fundit përcakton datën e seancës, e cila nuk duhet të jetë më vonë se një muaj pas datës së marrjes së dosjes nga ILD-ja dhe njofton të gjitha palët të paktën 15 ditë përpara seancës. KLGJ-ja duhet të marrë në konsideratë të gjithë faktorët që lidhen me çështjen; të marrë prova shtesë, duke përfshirë thirrjen e dëshmitarëve; sipas rastit, të angazhojë ekspertë ose t'i kërkojë ILD-së të angazhojë ekspertë (neni 138). Magjistrati, i cili informohet se ndaj tij është nisur një procedim disiplinor, duhet të njihet në të njëjtën kohë për të drejtat e tij: a) të paraqesë një mbrojtje me shkrim brenda një afati të caktuar; b) të marrë pjesë në çdo seancë; c) të thërrasë dëshmitarët që mund të japin informacione të rëndësishme për çështjen; ç) të paraqesë dokumente; d) të marrë masa të tjera me qëllim sigurimin e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij/saj; dh) të përfaqësohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, e) të mbulojë shpenzimet e tij ligjore në mënyrë të arsyeshme në rastet kur nuk jepet masë disiplinore (neni 141). Pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe provave, Këshilli ose: a) refuzon kërkesën për procedim disiplinor, me arsyetimin se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose se ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore; b) mbështet pretendimet dhe vendos një ose më shumë masa disiplinore (neni 146). Magjistrati gëzon të drejtën të apelojë vendimin për caktimin e masës disiplinore në gjykatën kompetente (neni 147).

³⁵⁹ ILD-ja ka kompetenca për verifikimin e ankesave, inspektimin institucional të gjykatave, hetimin e shkeljeve me iniciativë dhe fillimin e procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të KLGJ-së, KLP dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 147/d.

³⁶⁰ Ligji 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neni 100.

³⁶¹ Për shembull, përpara zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023, do të konsiderohej ndikimi i paligjshëm për gjyqtarët çdo përpjekje për t'i kërkuar një gjyqtari të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit të vendosë në favor të një parti të caktuar politike. Ose çdo përpjekje për të kërkuar nga një gjyqtar i Gjykatës Speciale për Korrupsion dhe Krim të Organizuar që të lëshojë një vendim të favorshëm për një politikan që është akuzuar për kryerjen e një krimi.

³⁶² Ndikimi i paligjshëm përfshin premtimin, propozimin ose dhënien e ndonjë fitimi të paligjshëm vetë gjyqtarit ose për persona të tjerë dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit (nëse bëhet fjalë për më pak se 50 000 lekë / për afërsisht 480 Euro) ose me burgim nga një deri në tre vjet (nëse është më shumë se 50 000 lekë/afërsisht. përfshihet 480 Euro). Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 245/1.

³⁶³ Studimet e mëparshme kanë arritur në përfundimin se terminologjia e përdorur nga KPK-ja në lidhje me konkluzionet për zhvillimin e hetimit administrativ ka vend për përmirësim. Arsyetimi është kontradiktor, pasi në analizën logjike të përdorur në paragrafin 9 thuhet se trupi gjykues ka vendosur të informojë subjektin se kanë barrën e provës për të kundërshtuar rezultatet e hetimit, ndërsa në fakt subjekti është vënë në dijeni se ka barrën e provës vetëm për kriterin e pasurisë. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Raport Studimor, Vetingu dhe dinamikat e tij, Nëntor 2019-Korrik 2020, f.18-19. I disponueshëm në: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/09/KShH_Raport-studimor--Vetingu-dhe-dinamikat-e-tij--Nentor-2019-Korrik-2020.pdf, vizituar për herë të fundit më 6 tetor 2022.

³⁶⁴ Deri në fund të korrikut 2023, ndërkohë që procesi i vetingut të magjistratëve është në proces e sipër, KPK-ja ka shkarkuar nga detyra 138 gjyqtarë para mandatit të tyre ose për shkak të pamundësisë së tyre për të siguruar prova për pasuritë e tyre ose për shkak të mungesës së aftësive të nevojshme profesionale. Raporti Statistikor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit shkurt 2018-korrik 2023, f. <https://kpk.al/wp-content/uploads/2023/08/RAPORTI-STATISTIKOR-2018-KORRIK-2023.pdf> (konsultuar më 09.08.2023). 49 gjyqtarë të tjerë kanë dhënë dorëheqjen për arsye personale, si rezultat i procesit të vetingut. Raporti Statistikor "Veprimtaria 5 vjeçare". I disponueshëm: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2022/06/Raporti-5-vjecar.pdf>, vizituar për herë të fundit më 3 tetor 2022. Një tjetër gjyqtar ka dhënë dorëheqjen në vitin 2023, duke e çuar deri në 50 gjyqtarë të dorëhequr në total. Intervistë me Drejtoreshën e Departamentit të Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënive Ndërkombëtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Maela Alicanaj, 10 gusht 2023.

³⁶⁵ Ligji 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", neni 97/2.

- ³⁶⁶ Ministri i Punëve të Brendshme ka reaguar ashpër duke akuzuar gjyqtarët dhe prokurorët për butësi ndaj kriminelëve. Reagimi publik i Gjykatës së Fierit: <https://www.tpz.al/reagimi-i-ashper-i-ministrit-te-brendshem-gjykata-e-fierit-i-pergjigjet-akuzave-te-cucit>; <https://www.hashtag.al/index.php/2021/06/28/cuci-akuzoi-prokuroret-dhe-gjykatesit-per-lehtesime-te-masave-te-denimit-reagon-gjykata-e-fierit-sjapim-denime-me-shume-se-sa-kerkojne-prokuroret/>. Kryeministri Edi Rama: “Qasje skandaloze dhe paturpësisht e papërgjegjshme e disa prokurorëve dhe gjyqtarëve nëpër rrethe.”: <https://www.gazetatema.net/politika/zjarrveniet-rama-prokuroret-dhe-gjykatesit-te-zbatojne-rreptesisht-ligj-i400743> (konsultuar më 08.08.2023).
- ³⁶⁷ <https://klgj.al/2022/11/deklarata-e-unionit-te-gjyqtareve-te-republikes-se-shqiperise-ne-lidhje-me-sulmet-mediatike-ndaj-gjyqtareve/> (konsultuar më 09.08.2023).
- ³⁶⁸ Sali Berisha, një nga drejtuesit e Partisë Demokratike (në opozitë), pohoi se “Gjyqtarët janë më kriminelë se çdo kriminel tjetër, por këta janë sërish gjyqtarët e Partisë”. Intervistë në kanalën A2 CNN Tv publikuar më 5 maj 2023. I disponueshëm: <https://a2news.com/2023/05/05/berisha-vrasesi-i-kenianes-fle-ne-qeveri/>, vizituar për herë të fundit më 7 maj 2023.
- ³⁶⁹ <https://lajmifundit.al/politike/uci-paralajmeron-gjyqtaret-kk-te-reflekojne-brenda-javes-nis-ndryshim-i-1144790> (aksesuar më 27.10.2023)
- ³⁷⁰ <https://dosja.al/dosja-edi-rama-dhe-gjyqtarja> (aksesuar më 27.10.2023).
- ³⁷¹ <https://shqiptarja.com/lajm/para-seances-berisha-sulm-gjyqtares-kriminele-me-uniforme-flet-ne-encrochat-me-ramen> (aksesuar më 27.10.2023).
- ³⁷² <https://top-channel.tv/2021/03/24/gjyqtaret-rrihen-me-grushte-skandali-ne-gjykatën-administrative-te-vlores/> (aksesuar më 27.10.2023).
- ³⁷³ <https://www.reporter.al/2021/06/10/ministri-cuci-sulmoi-gjyqtarin-klgj-ankohet-ne-pergjithesi-ndaj-nderhyrjeve/>.
- ³⁷⁴ Ligji 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, detyrimeve financiare të personave të caktuar dhe nëpunësve të caktuar publikë”, neni 3/1/b dhe neni 3/1/dh. <https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=77&catid=13&m=0>. (aksesuar më 27.10.2023).
- ³⁷⁵ Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, neni 4, neni 7 dhe neni 8. <https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=165&catid=55&m=0> (aksesuar më 27.10.2023). <http://www.gjykatatirana.gov.al/kendiinformativ/evidencat-statistikore-specifike/>. <https://www.gjykata.gov.al/rrethi-durr%C3%ABs/gjykata-e-rrethit-durr%C3%ABs/statistika/koh%C3%ABzgjatja-e-c%C3%ABshtj%C3%ABve/>.
- ³⁷⁶ Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, neni 2§1§a dhe neni 4.4. <https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=165&catid=55&m=0> (aksesuar më 27.10.2023).
- ³⁷⁷ Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, Neni 26.
- ³⁷⁸ Ligji 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, neni 98/2.
- ³⁷⁹ Ligji 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, neni 98/2.
- ³⁸⁰ Vendim nr.458, datë 25.07.2023, Propozim për emërim gjyqtar të Gjykatës së Lartë. <https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/07/Vendim-458-i-arsyetuar-propozim-p%C3%ABr-em%C3%ABrim-V.K.pdf> (konsultuar më 09.08.2023).
- ³⁸¹ <https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/10/VENDIM-Nr.-636-dat%C3%AB-19.10.2023-P%C3%8BR-NGRITJEN-N%C3%8B-DETYR%C3%8BN-E-GJYQTARES-S%C3%8B-GJYKAT%C3%8BS-S%C3%8B-POSA%C3%87ME-T%C3%8B-SHKALL%C3%8BS-S%C3%8B-PAR%C3%8B-P%C3%8BR-KORRUPSIONIN-DHE-KRIMIN-E-ORGANIZUAR-T%C3%8B-ZNJ.-%E2%80%A6.pdf>.
- ³⁸² Faqja e internetit e Këshillit të Lartë Gjyqësor: <http://klgj.al/>.
- ³⁸³ Të dhëna për buxhetin dhe procedurat e prokurimit të Gjykatës së Lartë: https://www.gjykataelarte.gov.al/web/Informacion_mbi_buxhetin_dhe_procedurat_e_prokurimit_te_Gjykates_se_Larte_4061_1-10.php.
- ³⁸⁴ Raportet e Këshillit të Lartë Gjyqësor: <http://klgj.al/raporte-klgj/>.
- ³⁸⁵ Informacion mbi procedurat në Gjykatën e Shkallës së Parë, Durrës: <http://www.gjykata.gov.al/rrethi-durr%C3%ABs/gjykata-e-rrethit-durr%C3%ABs/>.
- ³⁸⁶ <http://www.gjykatatirana.gov.al/kendiinformativ/evidencat-statistikore-specifike/>;

<https://www.gjykata.gov.al/rrethi-durr%C3%ABs/gjykata-e-rrethit-durr%C3%ABs/statistika/koh%C3%ABzgjatja-e-c%C3%ABshtj%C3%ABve/>.

³⁸⁷ <https://www.gjykata.gov.al/rrethi-fier/gjykata-e-rrethit-fier/mbledhja-e-k%C3%ABshillit-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs/> (konsultuar më 09.08.2023); <https://www.gjykata.gov.al/rrethi-berat/gjykata-e-rrethit-berat/mbledhja-e-k%C3%ABshillit-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs/> (konsultuar më 09.08.2023).

³⁸⁸ Plani i Veprimit të KLGJ-së për sistemin gjyqësor 2019-2020. <https://klgj.al/2019/10/plani-i-veprimit-i-klgj-se-per-sistemin-gjyqesor-2019-2020-versioni-shqip/> (aksesuar më 27.10.2023).

³⁸⁹ Plani Strategjik i KLGJ-së për sistemin gjyqësor 2022-2024. https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/05/Plani-Strategjik-Final_2022-2024.pdf (aksesuar më 27.10.2023).

³⁹⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 142/1.

³⁹¹ Ligji 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Neni 72. <https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=198&catid=86&m=0> (aksesuar më 27.10.2023).

³⁹² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 147/d-147/ë. ILD-ja zgjidhet me një shumicë prej tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për një mandat nëntë vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje nga radhët e juristëve të shquar me jo më pak se 15 vjet përvojë profesionale dhe me reputacion të lartë dhe integritetin profesional.

³⁹³ Ligji 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Neni 201.

³⁹⁴ Ligji 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Neni 209. Komisioni për Emërimin dhe Vlerësimin e Inspektorëve përbëhet nga tre inspektorë të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, të zgjedhur me short për një mandat një vjeçar.

³⁹⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 147/d.

³⁹⁶ Ligji 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Neni 119.

³⁹⁷ Ligji 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Neni 105.

³⁹⁸ Vendimi nr. 432, datë 18.07.2023, "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2022".

<https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/07/VENDIM-Nr.-432-dat%C3%AB-18.07.2023-P%C3%8BR-VLER%C3%8BSIMIN-ETIK-DHE-PROFESIONAL-T%C3%8B-GJYQTARIT-...},-p%C3%8BR-VITIN-2022-1.pdf> (aksesuar më 27.10.2023).

³⁹⁹ Vendimi i KLGJ-së Nr.92, datë 17.03.2021. I disponueshëm në: <https://klgj.al/wp-content/uploads/2021/10/V-E-N-D-I-M-Nr.-92-dat%C3%ab-17.03.2021-P%C3%8BR-CAKTIMIN-E-MAS%C3%8BS-DISIPLINORE-NDAJ-GJYQTARES-...pdf>.

⁴⁰⁰ Intervista me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Z. Artur Metani, 13.06.2023.

⁴⁰¹ Raporti Vjetor i ILD-së për vitin 2022, f. 21. I disponueshëm në: <https://ild.al/wp-content/uploads/2023/05/RAPORTI-I-PUNES-VITI-2022.pdf>.

⁴⁰² Ligji 9049/2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve të caktuar publikë", Neni 3/1/dh.

⁴⁰³ Ligji nr.84/2016, datë 30.8.2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (Ligji i Vetingut), Neni 32 <https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=1&catid=98&m=0> (aksesuar më 27.10.2023).

⁴⁰⁴ *Ibid.*, Neni 4

⁴⁰⁵ Vendimi i KLGJ-së nr. 171, datë 22.4.2021, Kodi i Etikës Gjyqësore. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 66, datë 29.4.2021.

⁴⁰⁶ I disponueshëm në:

https://www.gjp.gov.al/rc/doc/KODI_I_ETIKES_GJYQESORE_VKLGJ_nr_271_date_22_4_2021_4666.pdf.

⁴⁰⁷ Kodi i Etikës Gjyqësore, Pjesa II.

⁴⁰⁸ *Ibid.* Neni III (14).

⁴⁰⁹ *Ibid.* Neni III (15).

⁴¹⁰ *Ibid.* Neni III (16).

⁴¹¹ *Ibid.* Neni B/7/gj.

⁴¹² Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, Neni 74.

⁴¹³ Raporti Statistikor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit shkurt 2018-korrik 2023, f.1. <https://kpk.al/wp-content/uploads/2023/08/RAPORTI-STATISTIKOR-2018-KORRIK-2023.pdf> (konsultuar më 09.08.2023).

⁴¹⁴ Vendim i Kolegjit i Posaçëm të Apelit nr. 23, datë 28.06.2022 https://kpa.al/wp-content/uploads/2022/09/Vendim_Astrit_SHEMA_anonimizuar.pdf (aksesuar më 27.10.2023).

- ⁴¹⁵ Vendimi nr.62, datë 03.08.2018. <https://kpk.al/wp-content/uploads/2018/10/Vendimi-Artur-Malaj.pdf> (konsultuar më 10.08.2023). Pas Rekomandimit nga Operacioni Ndërkombëtar të Monitorimit (<https://ikp.al/wp-content/uploads/2018/10/Rekomandim-dat%C3%ab-10.8.2018.pdf>), Komisioneri Publik paraqiti një ankim në Kolegjin e Posaçëm i Apelit (<https://ikp.al/wp-content/uploads/2018/10/Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-62-dat%C3%AB-3.8.2018-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%ABr-subjektin-e-rivler%C3%ABsimit-z.-Artur-Malaj.pdf>), i cili rrëzoi vendimin e KPK-së dhe shkarkoi gjyqtarin me Vendimin Nr. 27, datë 24.10.2019. <https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/12/Vendimi-A-Malaj-i-anonimizuar-pdf.pdf> (konsultuar më 10.08.2023).
- ⁴¹⁶ Vendim i Kolegjit i Posaçëm të Apelimit nr. 27, datë 06.07.2022. https://kpa.al/wp-content/uploads/2022/11/VENDIMI_GERD-HOXHA_perfshire_mendimin_paralel_dhe_mendimin_e_pakices_anonimizuar.pdf (aksesuar më 27.10.2023).
- ⁴¹⁷ Vendim i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 26, datë 06.07.2022. https://kpa.al/wp-content/uploads/2022/10/Vendim_Elbona_Lluri_p%C3%ABrfshir%C3%AB_mendimet_e_pakic%C3%ABs_anonimizuar.pdf (aksesuar më 27.10.2023).
- ⁴¹⁸ Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 364, datë 02.04.2021, paragrafi 21.2-21.4, <https://kpk.al/wp-content/uploads/2021/07/Vendim-Alma-Hicka.pdf> (aksesuar më 27.10.2023).
- ⁴¹⁹ <https://www.reporter.al/2023/10/27/kpa-rikthen-ne-detyre-gjyqtaren-alma-hicka/>.
- ⁴²⁰ Kjo ndodhi ndoshta si rezultat i nevojës për aktivitete më intensive ndërgjegjësuere në lidhje me Kodin e Etikës mes gjyqtarëve dhe publikut. Intervista me znj. Albana Boksi, gjyqtare e Komisionit të Etikës, 14.06.2023.
- ⁴²¹ Opinione për përdorimin e celularit nga gjyqtarët gjatë seancave gjyqësore dhe për përdorimin e rrjeteve sociale. I disponueshëm në: <https://klgj.al/opinione-2/>, konsultuar më 14 qershor 2023.
- ⁴²² Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (Veting) Nr. 24, datë 13.06.2018, f. 3 dhe f. 38. I disponueshëm në: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-Bashkim-Dedja.pdf>, konsultuar më 14.06.2023.
- ⁴²³ Raporti Vjetor i ILDKPKI-së 2022. <https://www.ildkpk.al/gloosys/2023/09/Raport-vjetor-2022.pdf> (aksesuar më 27.10.2023).
- ⁴²⁴ Supra, shënimi 82.
- ⁴²⁵ Intervista me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Z. Artur Metani, 13.06.2023.
- ⁴²⁶ Planet e trajnimeve nuk përfshijnë tema mbi protokollet dhe mekanizmat që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore. I disponueshëm në: <https://www.magjistratura.edu.al/sq/kalendari-i-trajnimeve>, konsultuar më 14.06.2023.
- ⁴²⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 131, paragrafi 1c.
- ⁴²⁸ Gjykatat administrative rregullojnë aktet nënligjore normative të organit ekzekutiv me anë të dy llojeve të procedurave të parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Neni 10 paragrafi 1b, i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".
- ⁴²⁹ Nenet 15 dhe 17 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".
- ⁴³⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 131 Paragrafi 1f:1. Kjo dispozitë kushtetuese plotësohet më tej me nenet 71, 71/a, 71/b dhe 71/c të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese".
- ⁴³¹ Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, "Gjetjet kryesore të Raportit 2022 për Shqipërinë". https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/key-findings-2022-report-albania_en?s=214.
- ⁴³² Në rastet e largimit të padrejtë nga puna të punonjësve të administratës shtetërore, për vitin 2018 vendimet në favor të paditësit (kundër organit ekzekutiv) kanë qenë të suksesshme në 72 % të rasteve. INFOÇIP, "Vlerësimi tematik kombëtar – kohëzgjatja e procedimeve administrative gjyqësore 2017-2018". I disponueshëm në: <https://www.gjykataehapur.al/wp-content/uploads/2019/02/Kohezgjatja-e-shqyrtimit-gjyqesor-administrativ-2017-2018-gjykataehapur.pdf>.
- ⁴³³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 142/3.
- ⁴³⁴ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 25/2014. I disponueshëm në: https://www.gjk.gov.al/web/Lista_e_Vendimeve_92_1.php, konsultuar më 14 qershor 2023.
- ⁴³⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 134.
- ⁴³⁶ Vendimi nr. 8, datë 22.02.2023.
- ⁴³⁷ Vendimi nr. 21, datë 18.04.2023; Vendimi nr. 35, datë 15.06.2023.

⁴³⁸ Bazuar në nenin 259 të Kodit Penal, “Korrupsioni pasiv i zyrtarëve publikë”: Prokuroria gjatë vitit 2022 ka paraqitur për gjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë 13 çështje, nga të cilat katër janë gjykuar në vitin 2022, tre prej tyre me vendim fajësie. Bazuar në nenin 319/ç të Kodit Penal, “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të sistemit të drejtësisë”: Prokuroria gjatë vitit 2022 ka paraqitur dy çështje për gjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, ku për këto dy çështje u morën vendime fajësie. I disponueshëm në: https://www.gjp.gov.al/rc/doc/Analiza_Vjetore_e_punes_viti_2022_4814.pdf (f.58).

⁴³⁹ Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, Transparency International, 2022, <https://www.transparency.org/en/cpi/2022>

⁴⁴⁰ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-22-10-2023/>.

⁴⁴¹ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-10-07-2023-a-ahmetaj/>

⁴⁴² <https://spak.gov.al/njoftim-date-10-03-2023/>.

⁴⁴³ <https://www.gjykata.gov.al/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/njoftime-p%C3%ABr-median/>.

⁴⁴⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 135.

⁴⁴⁵ Neni 244/2 i Kodit Penal – Korrupsioni aktiv i zyrtarëve publikë; Neni 245 i Kodit Penal - Korrupsioni aktiv i zyrtarëve të lartë publikë dhe zyrtarëve të pushtetit vendor; Neni 259/2 i Kodit Penal – Korrupsioni pasiv i zyrtarëve publikë; Neni 260 - Korrupsioni pasiv i zyrtarëve të lartë publikë dhe të pushtetit vendor.

⁴⁴⁶ I disponueshëm në: https://www.gjp.gov.al/rc/doc/Analiza_Vjetore_e_punes_viti_2022_4814.pdf.

⁴⁴⁷ Intervista me znj. Dinora Aleksi, Zëdhënëse e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krim të Organizuar, 13.06.2023.

⁴⁴⁸ Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë 2022, f. 4. I disponueshëm në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en_vizituar_për_herë_të_fundit më 13 tetor 2022.

⁴⁴⁹ Sulmi kibernetik iranian pati një efekt të dëmshëm në sistemet elektronike të Shqipërisë në vitin 2022. Intervista me znj. Kejti Hoxha, Drejtoreshë e Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë, 14.06.2023.

⁴⁵⁰ Statistikat më të fundit i referohen vitit 2021. I disponueshëm në: <https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/REPUBLIKA-E-SHQIP%C3%8BRIS%C3%8B-Vjetari-Statistikor-2021-pdf.pdf> Konsultuar më 15.06.2023. Nuk janë publikuar akoma statistikat për vitin 2022.

⁴⁵¹ Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 68, datë 24.04.2019, “Për emërimin e Anëtarit të KLGJ-së përgjegjës për Marrëdhëniet me Publikun.

⁴⁵² Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për emërimin e gjyqtarëve për mediat në çdo juridiksion apeli”

⁴⁵³ Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 126, datë 19.07.2019, “Për miratimin e Planit Strategjik të KLGJ-së për Sistemin Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë për vitet 2019-2020”

⁴⁵⁴ Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 590, datë 26.11.2020, “Për miratimin e Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor”. Të gjitha vendimet e KLGJ-së janë të disponueshme në: <https://klgj.al/vendime/> (Konsultuar më 30.08.2023).

PROKURORIA

PËRMBLEDHJE



Prokuroria e Republikës së Shqipërisë përbëhet nga Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm (GJP)⁴⁵⁵ dhe Prokuroria e Posaçme.⁴⁵⁶ Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm ishte prokuroria e vetme në Shqipëri deri sa u bë reforma në drejtësi në 2016, e cila krijoi Prokurorinë e Posaçme për të ndjekur penalisht rastet lidhur me Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe njësinë e pavarur të hetimit, Byronë Kombëtare të Hetimit, të cilat së bashku përbëjnë Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

Sistemi i drejtësisë së Republikës së Shqipërisë është prekur nga një reformë e thellë. Kuadri i ri ligjor është miratuar në vitin 2016, ndërsa institucionet e reja qeverisëse, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), janë krijuar në vitin 2018, pas ngritjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) në 2020. KLP-ja përbëhet nga 11 anëtarë me kohë të plotë dhe emëron, vlerëson, rrit në detyrë dhe transferon të gjithë prokurorët e të gjitha hierarkive, vendos për masat disiplinore të caktuara ndaj të gjithë prokurorëve të të gjitha hierarkive, propozon kandidatët për prokuror të përgjithshëm në Kuvend, miraton rregullat e etikës për prokurorët dhe mbikëqyr zbatimin e tyre, propozon dhe administron buxhetin e vet dhe informon publikun dhe parlamentin për gjendjen e prokurorive.⁴⁵⁷

Skema e re e organit gjyqësor rishikoi kompetencat territoriale të gjykatave, duke mbyllur 9 gjykata më të vogla të juridiksionit të përgjithshëm dhe pesë gjykata të apelit. Si rrjedhojë, në të njëjtën mënyrë janë ndikuar edhe prokuroritë.

Prokurori publik përballet me sfida të rëndësishme për shkak të vendeve vakante si rezultat i procesit të vetingut, ku KPK-ja ka shkarkuar 96 prokurorë⁴⁵⁸ që në shtator të vitit 2023. Kjo ndikon në efikasitetin e prokurorisë. Sfidat shtesë përfshijnë nevojën për rritje të burimeve financiare dhe njerëzore, si dhe bashkëpunim të zgjeruar me median dhe shoqërinë civile për të rritur transparencën dhe besimin e publikut. Kushtetuta nuk parashikon garanci që buxheti i prokurorisë të parashikojë që kësaj të fundit t'i ndahet një përqindje e buxhetit të përgjithshëm për të kryer punën e saj me efikasitet.

Për më tepër, KLP-ja dhe Prokuroria e Përgjithshme nuk kanë përcaktuar ngarkesën optimale të prokurorit, e cila kërkon një analizë gjithëpërfshirëse. Derisa të plotësohen vendet vakante të konsiderueshme, është e rëndësishme të bëhet një shpërndarje e balancuar e ngarkesës së punës ndërmjet prokurorëve për rritjen e efikasitetit.

Programi i trajnimit fillestar për prokurorët nuk përfshin diferencimin nga gjyqtarët dhe duhet të fokusohet në ligjin penal. Kushtetuta nuk parashikon garanci lidhur me buxhetin e prokurorisë, duke penguar përmbushjen efikase të punës.

Prokuroria është më reaktive sesa proaktive në transparencë, duke iu përgjigjur kërkesave për informacion sipas ligjit të së drejtës për informim.

Boshllëqet kritike të llogaridhënies përfshijnë mungesën e vlerësimeve të performancës për prokurorët për të udhëzuar ngritjet në detyrë dhe mungesën e dispozitave specifike që i pengojnë

prokurorët të marrin rimbursime, kompensime dhe honorare në lidhje me udhëtimet e sponsorizuara në mënyrë private të përcaktuara në standarde dhe rregulla.

KAPACITETET

TREGUESI 4.1.1 BURIMET (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë ligje që kërkojnë sigurimin e pagave dhe kushteve të përshtatshme të punës për prokurorët?



Ekzistojnë ligje gjithëpërfshirëse që kërkojnë sigurimin e pagave të përshtatshme për prokurorët dhe dispozita kundër reduktimit të të ardhurave. Megjithatë, nuk ka rregullime të inflacionit të përshkruara ose dispozita lidhur një buxhet minimal.

Sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, pagat e prokurorëve përcaktohen në bazë të pozicionit të prokurorit, d.m.th. nëse ai është prokuror në gjykatën e shkallës së parë, në gjykatën e apelit, në Prokurorinë e Përgjithshme apo Prokurorinë e Posaçme. Si rrjedhojë, pagat e prokurorëve varen nga pozicioni që kanë dhe jo nga përvoja e tyre. Një prokuror më i ri që ka 10 vite përvojë por që është Kryetar i Prokurorisë së Shkallës së Parë paguhet më shumë se një koleg më i vjetër në Prokurorinë e Shkallës së Parë që ka 15 vite përvojë por është vartës i tij. Përveç pozicionit që mban prokurori, paga e prokurorit përcaktohet në bazë të gradës në profesion dhe pozitës drejtuese.⁴⁵⁹

Paga e një prokurori është e njëjtë me atë të një drejtori të përgjithshëm në kryeministri. Ajo përfshin një pagesë referencë, bonus përvojë, bonus kualifikimi, bonus për pozicionin dhe një bonus vështirësie.⁴⁶⁰ Paga e referencës është 118,100 lekë (afërsisht 1,000 euro). Në vitin 2019, u miratua një sistem i ri pagash. Aktualisht ekzistojnë 3 kategori: Prokurorët e gjykatës së shkallës së parë të G-1, prokurorët e gjykatës së apelit G-2 dhe prokurorët G-3 të prokurorëve të Prokurorisë së

përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme, ku këta të fundit, përveç pagës dhe pagesës së vjetërsisë, marrin një shpërblim si kompensim për vështirësitë në punë dhe heqjen dorë nga privatësia.^{461 462}

Pagat e magjistratëve përcaktohen në nenin 12 të ligjit nr. 96/2016, për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, ligji nuk parashikon asnjë dispozitë kundër uljes së pagave të prokurorëve.

Për më tepër, nuk ekziston asnjë mekanizëm që siguron rregullimin e pagave lidhur me inflacionin. Nuk ekzistojnë dispozita ligjore që kërkojnë që një përqindje minimale e buxhetit të shtetit duhet t'i alokohet prokurorisë. Buxheti ndahet përmes një procesi komunikimi dhe negociimi ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nga njëra anë dhe Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme nga ana tjetër.⁴⁶³

TREGUESI 4.1.2 BURIMET (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli prokurori publik ka burime financiare, staf dhe infrastrukturë të përshtatshme për të vepruar në mënyrë efektive?



Prokuroria ka disa burime. Megjithatë, reduktimet e konsiderueshme financiare dhe të burimeve njerëzore çojnë në një nivel të caktuar joefektiviteti në kryerjen e detyrave të saj.

Në vitin 2021, buxheti i Prokurorisë së Përgjithshme u reduktua me afro 500 milionë lekë (afërsisht 4 milionë), nga 2,178,800,000 (17,8 milionë euro) në 1,680,000,000 lekë (rreth 13.7 milionë),⁴⁶⁴ për shkak të krizës financiare. Në vitin 2022, buxheti i Prokurorisë së Përgjithshme ishte 2,424,270,000 lekë (20.2 milionë euro), pothuajse në të njëjtin nivel me periudhën para pandemisë.⁴⁶⁵ Nga ana tjetër, për shkak të fokusit në luftën kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar, Prokuroria e Posaçme është themeluar me ligj në vitin 2016⁴⁶⁶ dhe ka filluar punën në dhjetor 2019. Krahasuar me vitin e

parë financiar (2020), buxheti aktual është rritur ndjeshëm,⁴⁶⁷ me më shumë se 300 %.⁴⁶⁸

Pavarësisht përmirësimeve, buxheti i prokurorisë mjafton për të kryer detyrat e saj.

Pagat e prokurorëve përcaktohen në mënyrë të ngjashme. Në skemën kombëtare të pagave, nivelet aktuale të pagave për prokurorët janë të kënaqshme, d.m.th nuk ka arsye të forta ekonomike që ata të priren drejt korrupsionit.^{469 470}

Pagat e prokurorëve nuk mund të krahasohen me pagat e avokatëve, pasi tek këta të fundit ka një nivel të lartë informaliteti. Të gjithë avokatët janë persona juridikë, pavarësisht të pagave tyre, ku pagat e avokatëve të njohur janë shumë më të larta se prokurorët.

Nuk ka nëpunës të mjaftueshëm, burime të bibliotekës dhe pajisje moderne kompjuterike për prokurorët, dhe as hapësira për zyra. Veçanërisht në Prokurorinë e Tiranës situata është më e vështirë për shkak të ngarkesës më të madhe të çështjeve. Për më tepër, për shkak të distancës nga prokuroria në gjykatë, ata shpesh duhet të udhëtojnë disa herë në ditë, përpara dhe mbrapa, me efikasitet më të ulët në punë.⁴⁷¹ Mbështetja duhet t'u ofrohet prokurorëve të paktën përmes asistentëve administrativë për t'i ndihmuar ata të përballojnë ngarkesën e tyre të punës.

Burimet njerëzore janë prekur seriozisht nga procesi i vetingut. Deri në fund të shtatorit 2023, 96 prokurorë janë shkarkuar nga KPK-ja.⁴⁷² Përveç shkarkimeve, duke marrë parasysh numrin e prokurorëve të dorëhequr dhe të atyre që janë transferuar në institucione të tjera të sistemit të drejtësisë, janë 223 prokurorë në detyrë, nga 341 në total.⁴⁷³ Anëtarët e stafit kanë mundësi trajnime nëpërmjet Shkollës së Magjistraturës dhe Shkollës së Administratës Publike. Ofrohen trajnime të shumta për të rritur njohuritë e prokurorit lidhur me ligjin dhe njohuritë ligjore, duke përfshirë menaxhimin e çështjeve dhe parandalimin e konfliktit të interesit, të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.⁴⁷⁴

TREGUESI 4.1.3 PAVARËSIA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli prokurori publik është i pavarur sipas ligjit?



*Pas reformës legislative të vitit 2016, kuadri ligjor aktual ka forcuar pavarësinë e prokurorisë në Shqipëri. Megjithatë, ata janë të detyruar me ligj t'u binden udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të eprorëve të tyre.*⁴⁷⁵

Pavarësia e prokurorit publik garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ku nevojiten dy të tretat e votave në parlament për të ndryshuar atë.⁴⁷⁶

Prokurorët duhet të jenë shtetas shqiptarë të emëruar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pasi të kenë përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe procesin paraprak të verifikimit të pasurisë dhe të historikut të tyre.⁴⁷⁷ Emërimet e prokurorëve janë të afat dhe duhet të bazohen në kritere të përcaktuara profesionale.⁴⁷⁸

KLP-ja është përgjegjëse për emërimin e prokurorëve. Prokurorët emërohen për një afat të pacaktuar nga KLP-ja⁴⁷⁹ që ata të paralajmërohen me ndërprerje arbitrare të kontratës. Prokurorët emërohen pas verifikimit të aftësive të tyre profesionale (kriteri profesional) dhe verifikimit të pasurisë së tyre dhe historikut të tyre (kriteri moral).⁴⁸⁰ Megjithatë, pas emërimit të tyre, nuk ka pasur vlerësime të performancës së prokurorëve, e cila duhet të jetë baza për rritjen në detyrë dhe progresin e tyre në karrierë.⁴⁸¹

Prokurori i Përgjithshëm emërohet vetëm nga tre të pestat e deputetëve mes tre kandidatëve të propozuar nga KLP-ja për një mandat shtatëvjeçar, pa të drejtë riemërimi. Tre kandidatët më të kualifikuar duhet të zgjidhen në bazë të një procedure të hapur dhe transparente nga juristëve e njohur me jo më pak se 15 vjet përvojë profesionale, me integritet të lartë moral dhe profesional, të cilët kanë përfunduar Shkollën e

Magjistraturës ose kanë diplomë akademike në drejtësi.⁴⁸²

Gjithashtu, prokurorët në Prokurorinë e Posaçme emërohen⁴⁸³ nga KLP-ja.⁴⁸⁴ Këta prokurorët punojnë në Prokurorinë e Posaçme, me mandat për ndjekjen penale të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Nën autoritetin e saj funksionon njësi e pavarur e hetimit, Byroja Kombëtare e Hetimit. Të dyja, Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit përbëjnë Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK).

KLP-ja është organi i pavarur me mbrojtje të parashikuar në kushtetutë për emërimin dhe shkarkimin e prokurorëve.⁴⁸⁵ Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) është organi përgjegjës për kryerjen e hetimeve disiplinore lidhur me rastet e shkeljeve disiplinore. Gjetjet e hetimit i dërgohen KLP-së, e cila mund të vendosë zgjidhjen e kontratës së prokurorëve nëse konstatohet se kanë kryer shkelje të rënda profesionale ose etike ose kur dënohen me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi.⁴⁸⁶ Procedura e shkarkimit të prokurorëve është iniciuar nga ILD-ja⁴⁸⁷ dhe ofron të gjitha garancitë e procesit të rregullt ligjor.⁴⁸⁸

Rregulloret që mbrojnë prokurorët nga ndikimi i panevojshëm janë të përfshira në Kodin Penal, si për të gjithë zyrtarët e tjerë publikë dhe përgjithësisht konsiderohen të mjaftueshme. Ato ndalojnë premtimin, propozimin ose ofertën e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ndonjë përfitimi të paligjshëm për zyrtarin publik, si dhe kërkimin, marrjen ose pranimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ndonjë përfitimi të tillë të paligjshëm.⁴⁸⁹

Shoqëria civile nuk përfaqësohet në procedurat e emërimit, por një nga pesë anëtarët porotë të zgjedhur në KLP vjen nga shoqëria civile, dy nga akademia ndërsa dy të tjerë janë avokatë mbrojtës.⁴⁹⁰ Kryetari aktual i KLP-së është nga shoqëria civile.⁴⁹¹

TREGUESI 4.1.4 PAVARËSIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli vepron prokurori publik pa ndërhyrje nga qeveria apo aktorë të tjerë?



Ka ndërhyrje të panevojshme të jashtme, veçanërisht nga organi ekzekutiv dhe media. Sulmet verbale ndaj prokurorisë vazhdojnë, ndërkohë që nuk ka dëshmi të zbatimit efektiv të rregulloreve që mbrojnë prokurorët nga ndikimi i padrejtë. Gjithashtu, procedurat e pabarabarta në procesin e vetingut kanë sjellë pasiguri tek prokurorët, duke bërë që ata të jenë të pambrojtur ndaj ndikimeve të jashtme.

Vetingu ka sjellë paqartësi në prokurori⁴⁹² nëse prokurorët do të vazhdojnë të jenë pjesë e prokurorisë, apo nëse karriera e tyre do të përfundojë me shkarkimin nga organet e vetingut. Gjatë periudhës 2019-2020 është vënë re se procedura e ndjekur nga organet e vetingut për administrimin e raporteve (nga KLP-ja dhe KLGJ-ja) nuk ka qenë e njëjta. Konkretisht, ka pasur raste kur procesi i vetingut të disa prokurorëve kishte nisur pas krijimit të KLP-së (dhjetor 2018), por nuk është ndjekur e njëjta procedurë. Në përgjithësi, KPK-ja (vetingu në shkallë të parë) pas krijimit të KLP-së duhet t'i kërkonte kësaj të fundit një raport të posaçëm për cilësitë profesionale të prokurorit, por nuk hartoi një raport të tillë. Ajo mori vendime duke u bazuar vetëm në raportin e grupit të punës të ngritur pranë Prokurorisë së Përgjithshme, duke analizuar vetëm cilësitë profesionale të prokurorit.⁴⁹³ Standardet nuk janë zbatuar në mënyrë uniforme për të gjithë prokurorët.

Deri në fund të shtatorit 2023, pas verifikimit të tre komponentëve të parashikuar në ligj (pasuria, integriteti dhe kapaciteti profesional), KPK-ja ka shkarkuar 96 prokurorë.⁴⁹⁴ Ka pasur raste të diskutueshme të shkarkimeve të prokurorëve nga institucionet e vetingut, një prej tyre është vlerësuar si shkelje e të drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare të prokurorit. Në këtë rast, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut urdhëroi rihapjen e procedurave të vetingut.⁴⁹⁵

Jashtë procesit të vetingut, ndodh rrallë që prokurorët të shkarkohen nga detyra para përfundimit të mandatit të tyre.

Gjatë vitit 2022, ILD-ja i propozoi KLP-së procedim disiplinor për tre prokurorë, duke përfshirë shkarkimin nga puna për dy prej tyre dhe uljen e përkohshme të pagës për prokurorin tjetër. Për arsye se dy nga këta prokurorë janë duke iu nënshtruar procesit të vetingut, ndaj tyre është pezulluar procedimi disiplinor, ndërsa prokurori i tretë është pushuar nga puna.⁴⁹⁶

Prokurorët nuk transferohen apo zbriten në detyrë për shkak të përmbajtjes së vendimeve të tyre.

Megjithatë, ekzistojnë raste të ndërhyrjeve të padrejta të jashtme në procedimet e prokurorisë, veçanërisht nga organi ekzekutiv⁴⁹⁷ dhe media, në formën e presionit të ushtruar ndaj prokurorëve nga organi ekzekutiv, duke i fyer publikisht dhe duke i akuzuar për “rritje të shumave të rryshfetit”. Pretendimet ishin se edhe pas disa akuzave të ngritura në Prokurorinë e Tiranës nga institucione të ndryshme, si Drejtoria e Tatimeve dhe Drejtoria e Doganave, nuk është marrë asnjë masë nga prokurorët.⁴⁹⁸ Kjo ka bërë që edhe prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, të cilët marrin trajtim të veçantë financiar dhe të sigurisë personale, të heqin dorë nga rastet që kanë në hetim.⁴⁹⁹

Në vitin 2022, KLP-ja ka bërë përpjekur që të mbronte prokurorët nga ndikimi i jashtëm,⁵⁰⁰ kryesisht përmes deklaratave publike, duke denoncuar përpjekjet për të ndikuar në punën e prokurorëve, por sulmet verbale ndaj prokurorisë vazhdojnë, pavarësisht reagimit të KLP-së. KLP-ja ishte në fokus të një debati mediatik mes kryeministrit dhe ambasadorit amerikan, lidhur me përpjekjet e pretenduara të organit ekzekutiv për të ndërhyrë në procesin zgjedhor të kreut të Prokurorisë së Posaçme.⁵⁰¹ Ambasadori amerikan ka vendosur të jetë i pranishëm në mbledhjen e KLP-së për zgjedhjen e kryetarit të Prokurorisë së Posaçme.⁵⁰²

Nuk ka dëshmi të zbatimit efektiv të rregulloreve që mbrojnë prokurorët nga ndikimi i padrejtë.

QEVERISJA

TREGUESI 4.2.1 TRANSPARENCA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë dispozita për të siguruar që publiku mund të marrë informacione të rëndësishme për aktivitetet dhe proceset e vendimmarrjes së prokurorit publik?



Ekzistojnë dispozita të cilat i mundësojnë publikut të marrë informacione për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë për vendimet që kanë të bëjnë me to dhe se si janë marrë këto vendime nëpërmjet Ligjit për të Drejtën e Informimit. Megjithatë, nuk ka dispozita specifike për transparencën e prokurorisë në ligjin e saj specifik dhe mungon transparenca proaktive e përcaktuar.

Legjislacioni për të drejtën e informimit është zbatohet në të njëjtën mënyrë edhe për prokurorin publik.⁵⁰³

Nuk ka dispozita specifike për transparencën e prokurorisë në ligjin e saj specifik, përveç dispozitës që parashikon që prokurorët gjatë kryerjes së detyrës të respektojnë Kushtetutën, marrëveshjet ndërkombëtare dhe ligjet e tjera në fuqi dhe se ata respektojnë parimin e procedurave të drejta, të barabarta dhe të nevojshme ligjore dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të interesit publik.⁵⁰⁴

Prokurori publik duhet që në kohën e duhur t'i ofrojë publikut informacione për statistikën, anëtarësimin në organizatat përkatëse dhe aktivitetet tjera të lidhura me të. Nuk ka afat ligjor për publikimet, vetëm për Regjistrin e Kërkesave për Informacion, i cili duhet të përditësohet çdo tre muaj. Kërkohej me ligj që çdo prokurori, si dhe KLP-ja, të ketë një Program institucional të Transparencës, i cili përcakton kategoritë e informacionit që duhet të publikohet në mënyrë proaktive dhe mjetet e publikimit.⁵⁰⁵ Nuk ka transparencë proaktive,⁵⁰⁶ por publiku ka të drejtë të informohet për numrin e rasteve që trajtohen çdo vit. Qytetarët mund ta aksesojnë këtë informacion

nëpërmjet një kërkesë që mund t'i dërgohet çdo prokurorie, e cila duhet të përgjigjet brenda 10 ditëve.⁵⁰⁷

KLP-ja duhet t'i ofrojë publikut informacion mbi aktivitetet dhe vendimet e saj, si dhe statistikave dhe aktivitetet e tjera përkatëse në kohën e duhur.⁵⁰⁸ Regjistrimi audio i mbledhjes plenare duhet të bëhet publik në faqen zyrtare të KLP-së brenda 24 orëve nga dita e mbledhjes, ndërsa procesverbal i mbledhjes me një diskutim të përmbledhur duhet të publikohet në faqen zyrtare të Këshillit pasi të miratohet në mbledhjen e radhës plenare të Këshillit. Regjistrimet audio të mbledhjeve të KLP-së dhe procesverbal i përmbledhës duhet të ruhen për të paktën 10 vjet, në përputhje me Ligjin për Arkivat.⁵⁰⁹

Emërimet, transferimet dhe shkarkimet e prokurorëve vendosen në mbledhjet plenare të KLP-së, ndaj edhe këto duhet të bëhen publike në faqen zyrtare të KLP-së brenda 24 orëve nga dita e mbledhjes. Procesverbal i mbledhjes me diskutim të përmbledhur duhet të publikohet në faqen zyrtare të Këshillit pas miratimit të tij në mbledhjen e ardhshme plenare të Këshillit.⁵¹⁰

TREGUESI 4.2.2 TRANSPARENCA (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli publiku ka akses në informacion mbi aktivitetet dhe proceset e vendimmarrjes së prokurorit publik?



Mungon transparenca proaktive për shkak të mungesës së detyrimit ligjor, e cila sjell mungesë informacioni të disponueshëm për kriteret e emërimeve paralele të prokurorëve për plotësimin e vendeve vakante të përkohshme.

Prokuroria publikon raporte të rregullta për aktivitetet, shpenzimet dhe qeverisjen e saj. Të gjitha të dhënat gjenden në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme⁵¹¹ dhe në faqen e Prokurorisë së Posaçme.⁵¹² KLP-ja publikon raporte të rregullta për aktivitetet, shpenzimet dhe

qeverisjen e saj. Këto raporte janë gjithëpërfshirëse dhe të disponueshme për publikun në faqes zyrtare të internetit të KLP-së.⁵¹³

Në përgjithësi, informacioni mbi emërimin, transferimin dhe shkarkimin e prokurorëve nga KLP-ja bëhet publik dhe të gjitha vendimet e tilla gjenden në faqen zyrtare të KLP-së.⁵¹⁴

Megjithatë, procedurat e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për plotësimin e vendeve vakante në prokurori dhe transferimet e përkohshme të prokurorëve duhet të bazohen në kriteret e qarta të përcaktuara nga KLP-ja.⁵¹⁵ Pavarësisht detyrimit ligjor të KLP-së për përcaktimin e kriterëve për transferimet paralele (ndërmjet prokurorëve të së njëjtës shkallë) dhe përshtatjes së këtyre kriterëve për emërimet e prokurorëve për të plotësuar pozicionet vakante të përkohshme, kjo nuk është realizuar akoma. Këto kriteret të përcaktuara qartë do të rrisnin transparencën e procesit të transferimeve dhe emërimeve paralele të prokurorëve për plotësimin e vendeve vakante të përkohshme.

Informacionet mbi menaxhimin e rasteve, statistikave apo veprimtaritë e prokurorëve nuk publikohen në mënyrë proaktive, por ato mund të aksesohen sipas kërkesës në përputhje me dispozitat e Ligjit për të Drejtën e Informimit.⁵¹⁶ Për më tepër, qytetarët mund të marrin lehtësisht informacion për emërimin, transferimin dhe shkarkimin e prokurorëve. Ky informacion disponohet për publikun në faqen e internetit të KLP-së.⁵¹⁷

Prokurori i Përgjithshëm ka pranuar se ka probleme lidhur me performancën e kryetarëve të prokurorëve në cilësinë e informacionit dhe në raportimin dhe dhënien e statistikave. Ata nuk respektojnë detyrimet ligjore për raportimin dhe dhënien e informacionit.⁵¹⁸ Informacioni i dhënë është i paplotë dhe i vonuar. Gjithashtu, vlerësimet që prokurorët bëjnë për profesionalizmin dhe integritetin e oficerëve të policisë gjyqësore janë formale dhe jo objektive.⁵¹⁹

TREGUESI 4.2.3 LLOGARIDHËNIA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë dispozita për të siguruar që prokurori publik duhet të raportojë dhe të mbajë përgjegjësi për veprimet e tij?



Pas reformës gjithëpërfshirëse të vitit 2016, ekziston një kuadër ligjor për llogaridhënien e prokurorëve. Megjithatë, nuk ka dispozita në fuqi për shqyrtimin e meritokracisë së emërimeve dhe ngritjes në detyrë në prokurori.

Organi i pavarur që heton ankesat kundër prokurorëve është ILD-ja, i përcaktuar në Kushtetutë.⁵²⁰ Prokurorët nuk kanë imunitet për korrupsion dhe vepra të tjera penale. Ekziston një ankesë formale dhe procedurë disiplinore e iniciuar nga ILD-ja. ILD-ja mund të iniciojë procedurën disiplinore ose procedura mund të iniciohet me veprimin e ankuesve, të cilët mund të jenë persona fizikë ose juridikë, Ministri i Drejtësisë, anëtarë të KLP-së ose kryetarë të prokurorive.⁵²¹

Ankuesit mbrohen me ligj. Ata gëzojnë të drejtën ligjore që identiteti i tyre të mbetet konfidencial nëse dëshirojnë.⁵²² ILD-ja mund të propozojë një ose më shumë nga masat disiplinore të mëposhtme: paralajmërim konfidencial, vërejtje publike, ulje të përkohshme të pagës, ulje në detyrë, pezullim ose largim nga puna.⁵²³

TREGUESI 4.2.4 LLOGARIDHËNIA (ZBATIMI)

Në çfarë niveli prokurorët raportojnë dhe mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre?



Pas reformës gjithëpërfshirëse të vitit 2016, ekziston një kuadër ligjor për llogaridhënien e prokurorëve. Megjithatë, nuk janë bërë vlerësime të shpeshta etike dhe profesionale të prokurorëve.

Ankuesit mbrohen në mënyrë efektive dhe nuk janë përballur me asnjë pasojë për shkak të ankesave të

tyre. Nuk është konstatuar asnjë rast i pasojave si rezultat i një ankese.

Procedurat disiplinore kanë qenë efektive.⁵²⁴ Lidhur me arkivimet e vendimeve të arkivimit të ILD-së, ankimimet kanë qenë shumë të pakta dhe këshillat përkatës kanë lënë në fuqi vendimet. Lidhur me kërkesat për procedim të nisur nga ILD-ja, rezultojnë se deri më tani janë pranuar të gjitha kërkesat, me përjashtim të një kërkesë e cila është refuzuar nga KLP-ja.⁵²⁵ Që nga themelimi i ILD-së në shkurt 2020, në përfundim të procedimit disiplinor, ILD-ja ka propozuar shkarkimin e shtatë prokurorëve, ndërsa KLP-ja ka shkarkuar katër prej tyre.⁵²⁶

Gjatë vitit 2022, ILD-ja i propozoi KLP-së procedim disiplinor për tre prokurorë, duke përfshirë shkarkimin e dy prej tyre dhe uljen e përkohshme të pagës për prokurorin e tretë. Për arsye se dy nga këta prokurorë janë duke iu nënshtruar procesit të vetingut, ndaj tyre është pezulluar procedimi disiplinor, ndërsa prokurori i tretë është pushuar nga puna.⁵²⁷

KLP-ja i ka kushtuar tre programet e para të "Planit Strategjik 2021 – 2024 për Këshillin e Lartë të Prokurorisë" administrimit të karrierës së prokurorëve bazuar në profesionalizmin dhe integritetin e tyre individual të performancës profesionale të siguruar nëpërmjet vlerësimeve periodike etike dhe profesionale, si dhe llogaridhënies së prokurorëve të siguruar nëpërmjet sistemit disiplinor.⁵²⁸ Megjithatë, nuk janë bërë vlerësime të shpeshta etike dhe profesionale të prokurorëve.

TREGUESI 4.2.5 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë mekanizma që garantojnë integritetin e prokurorëve?



Duke qenë se ekziston një Kod Sjelljeje dhe ligje që sigurojnë integritetin e anëtarëve të prokurorisë, dispozitat nuk mbulojnë kufizimet pas punësimit jashtë

prokurorisë, duke çuar në mungesën e masave për të shmangur "rotacionet e shpeshta" midis prokurorisë dhe sektorit privat ose prokurorisë dhe organit ekzekutiv.

"Standardet etike dhe rregullat e sjelljes së prokurorëve" janë miratuar në vitin 2022⁵²⁹ dhe janë gjithëpërfshirëse.⁵³⁰

Prokurorët duhet të deklarojnë pasuritë e tyre dhe t'i vënë ato në dispozicion të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit.⁵³¹

Nuk ekzistojnë dispozita në Standardet dhe Rregullat që i ndalojnë prokurorët të marrin rimbursime, kompensime dhe honorare në lidhje me udhëtimet e sponsorizuara në mënyrë private. Standardet dhe Rregullat përmbajnë dispozita që përcaktojnë se prokurorët duhet të shmangin përfitimet personale, për anëtarët e familjes ose të tjerët që vijnë si rezultat i detyrës së tyre si prokuror.⁵³² Prokurorëve u ndalohet të kërkojnë ose pranojnë dhurata, hua ose favore që lidhen me detyrën e tyre.⁵³³ Ata mund të marrin dhurata ose përfitime simbolike, sipas ligjit,⁵³⁴ me kusht që dhurata, çmimi ose përfitimi të mos perceptohet si dëmtrim i paanësisë, ose si qëllim për të ndikuar tek ata gjatë ushtrimit të detyrës.⁵³⁵

Qytetarët mund të kundërshtojnë paanshmërinë e një prokurori, i cili më pas mund të zëvendësohet nga një prokuror tjetër me vendim të epropolit të tyre.⁵³⁶

Nuk ekziston asnjë kufizim për prokurorët që punësohen në sektorin privat apo publik pas largimit nga detyra. Nuk ka kufizime pas punësimit të prokurorëve jashtë prokurorisë. Nuk ka masa që shmangin "rotacionet e shpeshta" mes prokurorisë dhe sektorit privat apo prokurorisë dhe organit ekzekutiv.

Nëse një prokuror shkarkohet si rezultat i procesit të vetingut, ose nëse jep dorëheqjen vullnetarisht gjatë procesit të vetingut, ai nuk mund të emërohet si gjyqtar, prokuror, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë prej pesëmbëdhjetë vjetësh.⁵³⁷

TREGUESI 4.2.6 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli sigurohet integriteti i prokurorëve?



Procesi i vetingut ka zbuluar raste të verifikimit të pamjaftueshëm të deklaratave të pasurisë dhe interesave nga ILDKPKI-ja. Për më tepër, mungesa e kufizimeve pas punësimit sjell rastet e "rotacioneve të shpeshta".

"Standardet etike dhe rregullat e sjelljes së prokurorëve" u miratuan në shkurt 2022, dhe për këtë arsye gjatë hartimit, dispozitat nuk janë testuar për të siguruar sjelljen etike të prokurorëve.⁵³⁸

Prokurorët respektojnë detyrimin ligjor për të deklaruar pasuritë e tyre. Deklaratat e tyre të pasurisë shqyrtohen, por procesi i vetingut zbuloi raste të prokurorëve që nuk kishin asnjë arsyetim ligjor për pasurinë e tyre dhe megjithatë nuk ishin konstatuar nga ILDKPKI-ja.⁵³⁹ Kjo nënkupton se procesi i rishikimit nuk ka qenë efektiv. Shkeljet sanksionohen nga ILDKPKI-ja.

KLP-ja ka detyrimin ligjor që të sigurojë respektimin e Standardeve Etike dhe Rregullave të Sjelljes, por deri më tani nuk ka konstatuar raste.


Prokurorët duhet të deklarojnë pasurinë e tyre dhe t'i vënë ato në dispozicion të ILDKPKI-së,⁵⁴⁰ por këto deklarata nuk publikohen nga kjo e fundit.⁵⁴¹ Prokurorët në Prokurorinë e Posaçme duhet të zbulojnë historikun e integritetit personal dhe profesional, pasuritë dhe interesat e tyre përpara se të emërohen.⁵⁴²

Duke qenë se nuk ka kufizime pas punësimit për ish-prokurorët, kjo lejon rastet e "rotacioneve të shpeshta". Ministri⁵⁴³ aktual i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë është ish-prokuror. Në korrik 2023, motra e nënkryetarit të Kuvendit u emërua në prokurorinë e Tiranës.⁵⁴⁴

Qytetarët mund të kundërshtojnë paanshmërinë e një prokurori nëse ata nuk heqin dorë nga një çështje dhe kjo zbatohet rregullisht.⁵⁴⁵

TREGUESI 4.2.7 NDJESHMËRIA GJINORE

Deri në çfarë niveli mekanizmat e prokurorisë marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore?



Nuk ekzistojnë udhëzime të caktuara që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore ose të dhëna të ndara sipas gjinisë për mekanizmin e prokurorisë, por mekanizmat e ankesave përfshijnë personelin femëror të vijës së parë.

Mekanizmat e ankesës dhe hetimit të Prokurorisë nuk kanë protokolle dhe udhëzime të qarta që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore.⁵⁴⁶ Bazuar në planin e trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës, nuk ka asnjë provë që vërteton se prokuroria u siguron zyrtarëve dhe stafit materiale trajnimi dhe ndërgjegjësimi për zbatimin e mekanizmave që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore. Megjithatë, mekanizmat e ankesave dhe hetimit përfshijnë personelin femëror të vijës së parë. Prokuroria nuk gjeneron të dhëna të ndara sipas gjinisë.⁵⁴⁷

ROLI

TREGUESI 4.3.1 NDJEKJA PENALE NË RASTET E KORRUPSIONIT

Deri në çfarë niveli prokurori publik i heton dhe ndjek penalisht rastet e korrupsionit në vend?



Prokuroria angazhohet për sanksionimin e korrupsionit. Prokuroria është angazhuar në mënyrë në këtë detyrë dhe janë mbajtur statistika gjithëpërfshirëse. Megjithatë, rastet e pastrimit të parave ndiqen penalisht rrallë dhe nivelet e korrupsionit mbeten të larta, gjë që tregon se shumë raste të korrupsionit nuk janë ndjekur penalisht ose nuk janë paraqitur në prokurori. Kohët e fundit ka një rritje të rasteve të ndjekjes penale të politikanëve të lartë për veprën penale të korrupsionit nga Prokuroria

e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Rastet e lidhura me korrupsionin paraqiten në Gjykatën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Nivelit të Lartë.⁵⁴⁸ Statistikat janë të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse. Ato përfshijnë numrin e çështjeve të hetuara, numrin e çështjeve të paraqitura në gjykatë, numrin e personave nën hetim, numrin e çështjeve të transferuara në Prokuroritë e Përgjithshme, numrin e çështjeve të pezulluara, numrin e çështjeve ku i akuzuari është dënues me burg me vendim gjykate, numri i çështjeve për ekzekutimin e vendimeve etj.⁵⁴⁹

Shqipëria ka bërë progres në luftën kundër korrupsionit. Ndërsa në vitin 2013, Shqipëria shënoi Indeks të Sjajmë të Ulët të Perceptimit të Korrupsionit (CPI) me 31/100, ndërsa në vitin 2022, indeksi i korrupsionit në Shqipëri ishte në vlerën 36 nga 100, duke e renditur atë në vendin e 110-të mes 180 vendeve. Këto statistika tregojnë se pavarësisht progresit, korrupsioni është akoma i përhapur në Shqipëri.⁵⁵⁰

Organi gjyqësor angazhohet në mënyrë aktive për ndjekjen penale të korrupsionit të zyrtarëve publikë. Në vitin 2022, prokuroria ka paraqitur 13 çështje për gjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, nga të cilat katër janë gjykuar brenda vitit 2022, ndërsa për tre prej tyre janë marrë vendime fajësie.⁵⁵¹ Megjithatë, duke pasur parasysh nivelin e korrupsionit në Shqipëri, prokuroria do duhet të përpiqet më shumë për të ndjekur penalisht korrupsionin në sektorin publik.

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Prokuroria Speciale) ka ngritur 43 procedime penale për korrupsion në vitin 2020, ku janë përfshirë 95 persona të akuzuar dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka nxjerrë 20 vendime me të cilat janë dënues 29 persona. Dënimet variojnë nga një vit në tetë vjet burgim.⁵⁵²

Gjatë vitit 2021, Prokuroria e Posaçme ka ngritur 33 procedime penale për korrupsion, në të cilat janë përfshirë 115 persona të akuzuar, ndërsa Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka nxjerrë 46 vendime, me të cilat janë dënues 90 persona.

Gjatë vitit 2022, Prokuroria e Posaçme ka ngritur 33 procedime penale për korrupsion, në të cilat janë përfshirë 146 të akuzuar, ndërsa Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka nxjerrë 22 vendime, me të cilat janë dënuar 76 persona.⁵⁵³ Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar jep statistikën e veta.⁵⁵⁴

Rastet kryesore kundër korrupsionit përfshijnë ndjekjen penale në tetor 2023 ndaj ish-presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe ish-kryeministrit (zyrtari publik më i lartë në Shqipëri),⁵⁵⁵ ish-zëvendëskryeministrit,⁵⁵⁶ ndjekjen penale ndaj ish-ministrit të mjedisit dhe deputetit në 2023,⁵⁵⁷ ish-ministrit të Brendshëm në 2022,⁵⁵⁸ kryebashkiakëve në 2023 etj.⁵⁵⁹

Rastet e pastrimit të parave të paraqitura para gjykatave janë të rralla. Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të Shkallës së Parë ka nxjerrë dy vendime për pastrim parash në vitin 2019, tre vendime në vitin 2020, tre vendime në vitin 2021, një vendim në vitin 2022 dhe dy deri në fund të majit 2023.⁵⁶⁰

Nuk ka pasur raste të fundit të përfshirjes së prokurorëve publikë në sugjerimin e masave apo reformave kundër korrupsionit në qeveri bazuar në përvojën dhe ekspertizën e tyre. Ministri i Drejtësisë është i detyruar ligjërisht të kërkojë mendimin e KLP-së përpara hartimit të projektakteve ligjore në sistemin e drejtësisë penale.⁵⁶¹

Në vitin 2022, Komisioni i BE-së arriti në përfundimin se Shqipëria ka një nivel përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit dhe se ka vazhduar përpjekjet e saj për të ndërtuar historikun e saj të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit dhe ka dhënë disa rezultate.⁵⁶²

NDËRVEPRIMET

Prokuroria ndërvepron më shumë me organin gjyqësor, policinë dhe median. Ndërveprimet janë formale, bazuar në detyrimet ligjore. Lidhur me dy të parat, ndërveprimet parashikohen në dispozitat specifike të Kodit të Procedurës Penale që rregullon ndërveprimet ndërmjet gjykatave, prokurorisë dhe policisë hetuese. Megjithatë, dispozita e Kodit të Procedurës Penale që rregullon seancën paraprake nuk ka pasur ndikim pozitiv në gjykimin e çështjeve të ngritura nga prokuroria në gjykatë. Kjo dispozitë ligjore nuk ka rritur efikasitetin e punës së prokurorisë, apo gjykatave; por ka ndodhur e kundërta. Gjykata duhet të vendosë për kërkesën për fillimin e gjyimit brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së saj nga prokuroria.⁵⁶³ Në fakt, në disa raste është nevojitur shumë më tepër kohë.

Përveç rregulloreve procedurale, qëllimi i këtyre ndërveprimeve përfshin shkëmbimin e informacionit, bashkëpunimin në programe të përbashkëta dhe shkëmbimin e përvojave. Ato kanë ndikim pozitiv në luftën kundër korrupsionit të këtij organi sepse ndikojnë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së prokurorisë.

REKOMANDIMET E ORGANIT

- + Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet t'i propozojnë Këshillit të Ministrave (i cili më pas i propozon parlamentit) ndryshime kushtetuese që garantojnë buxhetin e prokurorisë, duke shtuar një dispozitë që parashikon që prokurorisë t'i caktohet një përqindje e caktuar e buxhetit të përgjithshëm.
- + Organi ekzekutiv dhe ai legjislativ duhet të ndryshojnë ligjin 96/2016 për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, me qëllim që të reduktohet nga tre në dy vjet afati kohor për emërimin e prokurorëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës. si dhe që procesi i verifikimit të pasurisë dhe të historikut të kandidatëve në Shkollën e Magjistraturës të kryhet vetëm në fillim të studimeve.
- + Organi ekzekutiv dhe legjislativ duhet të ndryshojnë ligjin 96/2016 për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, në mënyrë që të ndryshojë programi fillestar i trajnimit për prokurorët. Programi i tyre i studimit duhet të jetë i posaçëm, d.n.th. duhet të fokusohet më shumë në ligjin penal, në vend që të thellohet në të drejtën civile, siç bëjnë gjyqtarët.
- + KLP-ja duhet të miratojë dispozita specifike në Standarde dhe Rregulla që parandalojnë prokurorët të marrin rimbursime, kompensime dhe honorare në lidhje me udhëtimet e sponsorizuara në mënyrë private.
- + KLP-ja duhet të miratojë rregulla të hollësishme në lidhje me transferimet e përkohshme për plotësimin e vendeve vakante në prokurori dhe të kryejë vlerësimet e performancës së prokurorëve. Ngritja në detyrë e prokurorëve duhet të bazohet në këto vlerësime të performancës.
- + KLP-ja dhe Prokuroria e Përgjithshme duhet të kryejnë një vlerësim për të përcaktuar ngarkesën e punës që një prokuror mund dhe duhet të përballojë brenda orarit të punës, e cila nënkupton përcaktimin e një standardi maksimal. Ky standard duhet të përcaktohet pas

një studimi dhe një analize gjithëpërfshirëse të të gjithë faktorëve përcaktues që ndikojnë në ngarkesën e punës së prokurorit, duke filluar nga ndryshimet që janë bërë në Kodin e Procedurës Penale, të cilat rritin ndjeshëm ngarkesën e prokurorit, kohën e nevojshme për hetimin e një çështjeje, dhe pjesëmarrjen në seancat gjyqësore, duke pasur parasysh kushtet aktuale të punës. Më pas, numri i prokurorëve që i nevojiten sistemit nuk duhet të përcaktohet duke iu referuar vetëm vendeve vakante aktuale, apo duke bërë krahasime me vitet e mëparshme, por bazuar në ngarkesën aktuale të punës dhe ngarkesën e punës që mund të përballojë një prokuror. Derisa prokuroria të plotësojë vendet vakante, duhet të merren masa për një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mes prokurorëve në të gjithë vendin (dhe jo vetëm mes prokurorëve të së njëjtës zyrë), duke qenë se ka dallime të theksuara në ngarkesën e punës, ndërkohë që pagat e tyre janë të njëjta.

BIBLIOGRAFI

- ⁴⁵⁵ Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm përfshin prokuroritë që procedojnë çështjet në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë, në gjykatat e apelit dhe në Prokurorinë e Përgjithshme. Ligji nr.97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë", Neni 25d. <https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=181&catid=89&m=0> (aksesuar më 05.11.2023)
- ⁴⁵⁶ Prokuroria e Posaçme ndjek dhe përfaqëson padinë në emër të shtetit në Gjykatën e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në Gjykatën e Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe në Gjykatën e Lartë, merr masa dhe mbikëqyr zbatimin e vendimeve penale dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj. Ligji nr.95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", Neni 4. I disponueshëm në: https://klp.al/wp-content/uploads/2020/02/llogji_nr_95_2016_per_organizimin_dhe_funksionimin_e_institucioneve_per_te_luftuar_korrupsionin_dhe_krimin_e_organizuar_s_1728.pdf Konsultuar më 16.06.2023.
- ⁴⁵⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 149/a. <https://klp.al/>.
- ⁴⁵⁸ Raport Statistikor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit shkurt 2018-shtator 2023, f.1. <https://kpk.al/wp-content/uploads/2023/10/RAPORTI-STATISTIKOR-2018-SHTATOR-2023-.pdf> (aksesuar më 01.11.2023).
- ⁴⁵⁹ Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neni 11.
- ⁴⁶⁰ Vendim i KM nr. 187, datë 08.03.2017, "Për strukturën dhe nivelet e pagave...". I disponueshëm në: <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/144-vkm-187-pagat-e-nepunesve-civile> konsultuar më 14.06.2023.
- ⁴⁶¹ Për shembull: $118,100 + (118,100 * 106 \text{ për qind}) = 243,286$ lekë (rreth 2000 euro) për pagën e prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme. Kësaj shume i shtohet edhe bonusi i vjetërsisë. Ajo llogaritet në masën 2 % të pagës bazë referuese për çdo vit shërbimi në punë, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.
- ⁴⁶² VKM-ja nr.187, datë 8.3.2017, "Për strukturën dhe nivelet e pagave" https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/09/VKM_187_08032017_perditesuar_2018.pdf (aksesuar më 01.11.2023).
- ⁴⁶³ Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 8, datë 21.02.2022, "Për ndryshimin e Udhëzimit Nr. 5, datë 9.3.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore..." <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Udhezimi-nr.-5-versioni-final.pdf> (aksesuar më 01.11.2023).
- ⁴⁶⁴ Buxheti për Prokurorinë e Përgjithshme për vitin 2021. I disponueshëm në: <https://financa.gov.al/buxheti-2021/>; Buxheti për Prokurorinë e Përgjithshme për vitin 2020. I disponueshëm në: <https://financa.gov.al/buxheti-2020/> konsultuar më 17.06.2023.
- ⁴⁶⁵ Buxheti për vitin 2022. <https://financa.gov.al/per-buxhetin-e-vitit-2022/> (aksesuar më 01.11.2023).
- ⁴⁶⁶ Ligji 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".
- ⁴⁶⁷ Deklarata e Prokurorit në Prokurorinë e Posaçme z. Edvin Kondili në Komisionin Evropian, Bruksel, 24 nëntor 2022.
- ⁴⁶⁸ Buxheti për Prokurorinë e Posaçme për vitin 2023 është 1 111 000 000 lekë (rreth 9.2 milionë euro). I disponueshëm në: <https://financa.gov.al/per-buxhetin-e-vitit-2023/> konsultuar më 17.06.2023.
- ⁴⁶⁹ Për shembull: $118,100 + (118,100 * 106 \text{ për qind}) = 243,286$ lekë (rreth 2000 euro) për pagën e prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme. Kësaj shume i shtohet edhe bonusi i vjetërsisë. Ajo llogaritet në masën 2 % të pagës bazë referuese për çdo vit shërbimi në punë, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.
- ⁴⁷⁰ Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.187, datë 8.03.2017, "Për strukturën dhe nivelet e pagave...". I disponueshëm në: <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/144-vkm-187-pagat-e-nepunesve-civile> konsultuar më 16.06.2023.
- ⁴⁷¹ Intervista me prokuroren e Prokurorisë së Tiranës, znj. Elsa Miha. Zhvilluar më 3 tetor 2023.
- ⁴⁷² Raport Statistikor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit shkurt 2018-shtator 2023, f.1. <https://kpk.al/wp-content/uploads/2023/10/RAPORTI-STATISTIKOR-2018-SHTATOR-2023-.pdf> (aksesuar më 01.11.2023).
- ⁴⁷³ Intervista me znj. Arta Mandro, anëtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Zhvilluar më 2 nëntor 2023.
- ⁴⁷⁴ Programi i trajnimeve për prokurorët dhe gjyqtarët. I disponueshëm në: <https://www.magjistratura.edu.al/sq/kalendari-i-trajnimeve> Konsultuar më 17.06.2023.

- 475 Ligji nr.97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë", Neni 6. <https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=181&catid=89&m=0> (aksesuar më 05.11.2023).
- 476 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 124 (3).
- 477 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 148/ç.
- 478 Ligji 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neni 32 dhe 35.
- 479 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 148/ç
- 480 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 148/ç.
- 481 <https://klp.al/category/vendime-akte-administrative/> (aksesuar më 05.11.2023).
- 482 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 148/a. .
- 483 Prokuroria e Posaçme ka 18 prokurorë. <https://spak.gov.al/prokuroret-spak/> Konsultuar më 20.09.2023. Pritet që numri i këtyre prokurorëve të rritet deri në fund të shtatorit 2023, pasi KLP-ja ka shpallur tre vende vakante për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme <https://klp.al/wp-content/uploads/2023/09/Axhenda-dt-29.09.2023.pdf> (Konsultuar më 27.09.2023).
- 484 Ligji nr.95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", Neni 4. I disponueshëm në: https://klp.al/wp-content/uploads/2020/02/llogji_nr_95_2016_per_organizimin_dhe_funksionimin_e_institucioneve_per_teluftuar_korrupsionin_dhe_krimin_e_organizuar_s_1728.pdf Konsultuar më 16.06.2023.
- 485 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 149: 1.
- 486 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 148/d/2.
- 487 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 147/d.
- 488 Ligji 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neni 100-150.
- 489 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Neni 245/1.
- 490 <https://klp.al/>.
- 491 <https://klp.al/stafi-yne/>.
- 492 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Raport Studimor, Vetingu dhe dinamikat e tij, Nëntor 2019-Korrik 2020, f.18-19. I disponueshëm në: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/09/KShH_Raport-studimor--Vettingu-dhe-dinamikat-e-tij--Nentor-2019-Korrik-2020.pdf vizituar për herë të fundit më 6 tetor 2022.
- 493 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Raport Studimi, Vetingu dhe dinamikat e tij, Nëntor 2019-Korrik 2020, f. 25. I disponueshëm në: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/09/KShH_Raport-studimor--Vettingu-dhe-dinamikat-e-tij--Nentor-2019-Korrik-2020.pdf vizituar për herë të fundit më 17 qershor 2023.
- 494 Raport Statistikor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit shkurt 2018-shtator 2023, f.1. <https://kpk.al/wp-content/uploads/2023/10/RAPORTI-STATISTIKOR-2018-SHTATOR-2023-.pdf> (aksesuar më 01.11.2023).
- 495 Rasti i Sevdari-t kundër Shqipëri, Kërkesa Nr. 40662/19. <https://hudoc.echr.coe.int/#%22itemid%22:%22001-221482%22> (aksesuar më 05.11.2023).
- 496 Raporti Vjetor i ILD-së për vitin 2022, f. 20. I disponueshëm në: <https://ild.al/wp-content/uploads/2023/05/RAPORTI-I-PUNES-VITI-2022.pdf> konsultuar më 17.06.2023.
- 497 <https://tvklan.al/rama-prokuroria-e-tiranes-eshte-nje-zullum-i-madh-atje-rritet-pazari-i-prokuroreve/>.
- 498 Kryeministri e quajti Prokurorinë e Tiranës "të korruptuar", ku "rritet pazari". *Ibid.* (aksesuar më 01.11.2023).
- 499 <https://www.reporter.al/2023/03/10/prokurore-te-dorehequr-dhe-spak-nen-presion-nga-portalet/>.
- 500 Reagimi i Kreut të Këshillit të Lartë të Prokurorisë ndaj deklaratës së Kryeministrit të Shqipërisë se gjyqtarët dhe prokurorët veprojnë me moton: "Kap çka të kapësh". <https://abcnews.al/deklarata-e-rames-per-kck-kreu-i-klp-politike-nuk-mund-ta-paragjykojme-nje-proces-gjyqesor/> konsultuar më 22.09.2023.
- 501 Gjergj Erebara, "SHBA nxjerr në pah shqetësimet për zgjedhjen e kryeprokurorit të prokurorisë kundër korrupsionit në Shqipëri". <https://balkaninsight.com/2022/12/14/new-spak-chief-election-stirs-anxiety-in-albania/> (aksesuar më 02.11.2023).
- 502 <https://www.tpz.al/aktualitet/e-paprecedent-zgjedhja-e-kreut-te-spak-yuri-kim-zbarkon-ne-mbledhjen--i198890> (aksesuar më 02.11.2023).
- 503 Ligji nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit". <https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=165&catid=55&m=0> (aksesuar më 01.11.2023). Programi i Transparencës i Këshillit të Lartë të Prokurorisë https://klp.al/wp-content/uploads/2022/05/Programi_i_transparences.1-1.html (aksesuar më 01.11.2023).

- ⁵⁰⁴ Ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, Neni 4.
<https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=181&catid=89&m=0>
 (aksesuar më 05.11.2023) konsultuar më 17.06.2023. Megjithatë, Prokuroria e Përgjithshme publikoi Programin e Transparencës në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit. I disponueshëm më:
[https://www.pp.gov.al/Programi_i_Transparences_per_Prokurorine/ konsultuar më](https://www.pp.gov.al/Programi_i_Transparences_per_Prokurorine/konsultuar_më) 17.06.2023.
- ⁵⁰⁵ Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, neni 4, neni 7 dhe neni 8.
<https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=165&catid=55&m=0>
 (aksesuar më 01.11.2023).
- ⁵⁰⁶ Prokuroria e Tiranës nuk ka publikuar statistika për dy vitet e fundit. Raporti i fundit vjetor është për vitin 2020.
<https://www.pp.gov.al/Tirane/Dokumente/> (aksesuar më 01.11.2023).
- ⁵⁰⁷ Ligji për të Drejtën e Informimit, nr. 119/2014, neni 3 dhe neni 15.
- ⁵⁰⁸ <https://klp.al/category/vendime-akte-administrative/> (vizituar për herë të fundit më 30 nëntor 2022).
- ⁵⁰⁹ Ligji 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, neni 167.
<https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=107&catid=87&m=0>
 (aksesuar më 02.11.2023).
- ⁵¹⁰ *Ibid.*
- ⁵¹¹ https://www.pp.gov.al/Programi_i_Transparences_per_Prokurorine/ (vizituar për herë të fundit më 30 nëntor 2022).
- ⁵¹² <https://spak.gov.al/programi-i-transparences/> konsultuar më 17.06.2023.
- ⁵¹³ <https://klp.al/buxheti-dhe-raportime/> (vizituar për herë të fundit më 30 nëntor 2022).
- ⁵¹⁴ <https://klp.al/2021/07/08/vendime-date-05-07-2021/> (vizituar për herë të fundit më 30 nëntor 2022).
- ⁵¹⁵ Neni 43§12 i ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- ⁵¹⁶ Ligji për të Drejtën e Informimit, nr. 119/2014, neni 3 dhe neni 11.
- ⁵¹⁷ <https://klp.al/category/vendime-akte-administrative/> (vizituar për herë të fundit më 30 nëntor 2022).
- ⁵¹⁸ Raportimi i Prokurorit të Përgjithshëm në Këshillin e Lartë të Prokurorisë për vitin 2022. I disponueshëm në:
<https://www.reporter.al/2023/04/13/prokurori-i-pergjithshem-ankohet-per-punen-e-drejtuesve-te-prokurorive-por-nuk-i-adreson-ne-ild/> konsultuar më 17.06.2023.
- ⁵¹⁹ *Ibid.*
- ⁵²⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 147/d-147/ë.
- ⁵²¹ Ligji 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 119.
<https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=216&catid=103&m=0>
 (aksesuar më 04.11.2023).
- ⁵²² *Ibid.* Neni 119/3.
- ⁵²³ Ligji 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 105.
- ⁵²⁴ Fakti që ankuesit nuk janë të shkurajuar nga depozitimi i ankesave të tyre tregon se nuk ka pasur pasoja për shkak të ankesave të tyre. Vetëm gjatë muajit maj 2023, në ILD janë depozituar 85 ankesa. Buletini i ILD-së, maj 2023. I disponueshëm në: <https://ild.al/en/2023/06/01/newsletter-may-2023/> Konsultuar më 17.06.2023.
- ⁵²⁵ Reforma në drejtësi: roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Instituti i Studimeve Politike, 2023, f. 8. I disponueshëm në: <https://isp.com.al/wp-content/uploads/2023/04/IPS-Justice-reform-The-role-of-the-High-Inspector-of-Justice-HIJ.pdf> konsultuar më 17.06.2023.
- ⁵²⁶ <https://ild.al/sq/2022/02/01/mesazh-i-inspektorit-te-larte-te-drejtësisë-ne-2-vjetorin-e-krijimit-te-institucionit/>.
- ⁵²⁷ Raporti Vjetor i ILD-së për vitin 2022, f. 20. <https://ild.al/wp-content/uploads/2023/05/RAPORTI-I-PUNES-VITI-2022.pdf>.
- ⁵²⁸ Plani Strategjik 2021 – 2024 për Këshillin e Lartë të Prokurorisë”, f.10. https://klp.al/wp-content/uploads/2021/03/PLANI-STRATEGJIK-2021-2024_KLP.pdf (aksesuar më 05.11.2023).
- ⁵²⁹ Vendimi i KLP-së nr. 32, datë 24.2.2022, “Standardet etike dhe rregullat e sjelljes së prokurorëve”. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 33, datë 1.3.2022, f. 3692.
- ⁵³⁰ “Standardet etike dhe rregullat e sjelljes së prokurorëve”. I disponueshëm në: “Standardet dhe rregullat e sjelljes etike së prokurorëve”, konsultuar më 17.06.2023.
- ⁵³¹ Ligji 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, detyrimeve financiare të personave të caktuar dhe nëpunësve të caktuar publikë”, Neni 3/1/dh: “*Të deklarojnë rregullisht pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit: dh) Prokurorët, gjyqtarët dhe përmbauesit gjyqësorë të të gjitha niveleve.*”

⁵³² Standardet etike dhe rregullat e sjelljes së prokurorëve, neni 6/dh.

⁵³³ *Ibid.*, Neni 6/ë.

⁵³⁴ Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat etike në administratën publike" përcakton se "...ndalimi i mospranimit të dhuratave, favoreve apo përfitimeve nuk zbatohet në rastet e ftesave normale, mikpritjes tradicionale, dhuratave simbolike, që nuk krijojnë dyshime për paanshmërinë..." I disponueshëm më:

<https://www.kryeministria.al/wp-content/uploads/2021/10/ligj-2003-09-08-9131.pdf> konsultuar më 17.06.2023.

⁵³⁵ Standardet etike dhe rregullat e sjelljes së prokurorëve, neni 6.

⁵³⁶ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Neni 27§1.

⁵³⁷ Shtojcë e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Vlerësimi i Përkohshëm i Kualifikimit, Neni G.

⁵³⁸ Nuk janë identifikuar raste të bazuara në "Standardet dhe Rregullat e Sjelljes Etike të Prokurorëve".

⁵³⁹ Vendimi i ILDKPKI-së për deklarimin e pasurisë nga Kreu i Prokurorisë së Sarandës, z. Edison Ademi, 18.01.2018: deklarimi nuk është i saktë sepse prokurori ka fshehur pasurinë dhe ka bërë deklarim të rremë. Përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit Nr.137, datë 09.04.2019, f. 5. I disponueshëm në: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2019/05/Vendim-Edison-Ademi-1.pdf> konsultuar më 17.06.2023.

⁵⁴⁰ Ligji nr. 9049/2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, detyrimeve financiare të personave të caktuar dhe nëpunësve të caktuar publikë", Neni 3/1/dh.

⁵⁴¹ Megjithatë, të gjitha deklaratat e prokurorëve janë shqyrtuar dhe bërë publike nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. <https://kpk.al/vendime/> (aksesuar më 01.11.2023).

⁵⁴² Ligji nr.95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", Neni 6. I disponueshëm në: https://kpl.al/wp-content/uploads/2020/02/llogji_nr_95_2016_per_organizimin_dhe_funksionimin_e_institucioneve_per_te_luftuar_korrupsionin_dhe_krimin_e_organizuar_s_1728.pdf Konsultuar më 16.06.2023.

⁵⁴³ Në kohën e hartimit të këtij raporti, 22 shtator 2023. <https://www.drejtesia.gov.al/ministri/> konsultuar më 22.09.2023.

⁵⁴⁴ <https://euronews.al/en/albanian-opposition-accuses-assembly-deputy-speaker-of-influencing-justice/> (aksesuar më 05.11.2023).

⁵⁴⁵ Intervistë me gjyqtaren Brunilda Kadi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale, 03.11.2023.

⁵⁴⁶ Planet e trajnimeve nuk përfshijnë tema mbi protokollet dhe mekanizmat që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore. I ndjeshëm: <https://www.magjistratura.edu.al/sq/kalendari-i-trajnimeve> (aksesuar më 05.11.2023).

⁵⁴⁷ Intervistë me Kryetarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Alfred Balla, 16.06.2023.

⁵⁴⁸ Neni 244/2 i Kodit Penal – Korrupsioni aktiv i zyrtarëve publikë; Neni 245 i Kodit Penal – Korrupsioni aktiv i zyrtarëve të lartë publikë dhe zyrtarëve të pushtetit vendor; Neni 259/2 i Kodit Penal – Korrupsioni pasiv i zyrtarëve publikë; Neni 260 – Korrupsioni pasiv i zyrtarëve të lartë publikë dhe atyre të pushtetit vendor. <https://spak.gov.al/veprimtaria/>.

⁵⁴⁹ Raporti Vjetor 2022 i SPAK-ut. I disponueshëm në: https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/raporti-vjetor-2022_Publikuar.pdf.

⁵⁵⁰ Sara Mahilaj dhe Marko Cenaj, "Kontributi i Komisionit të Venecias në masat kundër korrupsionit: Rast Studimor i Shqipërisë, Gjeorgjisë dhe Ukrainës", European Journal of Law and Political Science, Vol. 2, Numri 2, prill 2023, f. 71. https://www.venice.coe.int/coecentre/Mahilaj_Cenaj_VeniceCommissionContributiontoAnti-CorruptionMeasuresAlbaniaGeorgiaUkraine.pdf (konsultuar më 30 gusht 2023).

⁵⁵¹ I disponueshëm në: https://www.gjp.gov.al/rc/doc/Analiza_Vjetore_e_punes_viti_2022_4814.pdf (f. 58).

⁵⁵² https://www.gjp.gov.al/Kendi_informativ/Ceshtje_te_perfunduara/Dosje_penale/#/details/2022-55-9-4.

⁵⁵³ Statistikat e siguruara gjatë intervistës me znj. Julinda Mansaku, Këshilltare në Prokurorinë e Posaçme, 23 nëntor 2022.

⁵⁵⁴ Statistikat e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë të disponueshme për çdo vit. Statistikat për vitin 2022 janë të disponueshme në: <https://www.gjykata.gov.al/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/statistika/c%C3%ABshtjet-penale/> konsultuar më 17.06.2023.

⁵⁵⁵ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-22-10-2023/>.

⁵⁵⁶ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-10-07-2023-a-ahmetaj/>.

⁵⁵⁷ <https://spak.gov.al/njoftim-date-10-03-2023/>.

⁵⁵⁸ <https://www.gjykata.gov.al/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/njoftime-p%C3%ABr-median/>.

⁵⁵⁹ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-02-11-2023/>.

⁵⁶⁰ Intervista me znj. Dinora Aleksi, Zëdhënëse e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krim të Organizuar, 13.06.2023.

⁵⁶¹ Ligji 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", neni 169.

<https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=107&catid=87&m=0> (aksesuar më 02.11.2023).

⁵⁶² Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë 2022, f. 4. I disponueshëm në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en vizituar për herë të fundit më 2 dhjetor 2022.

⁵⁶³ Kodi i Procedurës Penale, Neni 332. <https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=172&catid=11&m=0> (aksesuar më 05.11.2023).

SEKTORI PUBLIK

PËRMBLEDHJE



Sektori publik shqiptar ofron paga të ulëta, standarde të paqarta profesionale dhe të llogaridhënies dhe është i prekur nga korrupsioni dhe ndërhyrjet politike. Shqipëria ka zbatuar një agjendë ambicioze të reformës së administratës publike që nga viti 2015. Me anë të reformave janë përmirësuar disa aspekte të procesit të rekrutimit (si standardizimi i përshkrimeve të vendeve të punës, rekrutimi online i shërbimit civil dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të favorshme për nëpunësit civilë të shkarkuar) dhe mekanizmat e transparencës (rritja e numrit të institucioneve që publikojnë programe të transparencës, regjistri elektronik kërkesave dhe përgjigjeve, publikimi i dokumenteve kryesore buxhetore), por ato nuk e kanë adresuar në mënyrë efektive nevojën për një sektor publik profesional dhe të përgjegjshëm.

Shumë agjenci dhe drejtues drejtorish si Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Agjencia Kombëtare e Rinisë, Agjencia Shtetërore e Shpronësimit, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, të cilët duhet të jenë pjesë e shërbimit civil, nuk përfshihen në legjisacionin e shërbimit civil dhe për rrjedhojë janë të emëruar politikë. Mekanizmat e brendshëm të llogaridhënies për të nxitur integritetin dhe për të parandaluar konfliktet e interesit nuk janë efektive, ndërsa përdorimi i burimeve publike gjatë fushatave politike është dokumentuar pothuajse në çdo raund zgjedhor. Mungesa e transparencës mbetet një pengesë kryesore për llogaridhënien e sektorit publik. Disa raporte nga OShC-të shqiptare paraqesin nevojën për një zbulim më të madh proaktiv të informacionit dhe një zbatim më të fortë të Ligjit për të Drejtën e

Informimit nëpërmjet një regjimi më rigoroz të sanksioneve nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave.

KAPACITETET

TREGUESI 5.1.1 BURIMET (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase sektori publik ka burime të mjaftueshme për të kryer me efektivitet detyrat e tij?



Sektori publik nuk ka burimet e mjaftueshme financiare dhe teknike për të kryer me efektivitet detyrat e tij.

Bazuar në të dhënat zyrtare për tremujorin e dytë të vitit 2022, paga mesatare e punonjësve në sektorin publik është 19 % më e lartë se në sektorin privat. Paga mesatare bruto në sektorin publik është 68,245 lekë (610 euro) në muaj, ndërsa paga mesatare bruto në sektorin privat është 57,327 lekë (512 euro) në muaj.⁵⁶⁴ Megjithatë, këto vlerësime nuk marrin parasysh informalitetin e sektorit privat dhe prirjen e punëdhënësve për të deklaruar një pagë më të ulët për punonjësit e tyre se ajo aktuale për të shmangur pagesën e më shumë kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe një taksë më të lartë mbi të ardhurat. Shqipëria renditet e fundit në rajonin e Ballkanit Perëndimor për sa i përket pagës mesatare në sektorin publik.⁵⁶⁵ Ndarja e pagave mesatare sipas kategorive në sektorin publik është si në vijim: (i) ligjvënësit, nëpunësit e lartë civilë dhe drejtuesit e tjerë të lartë

– 102,156 lekë (843 euro); (ii) nëpunësit publikë me arsim të lartë – 79 925 lekë (660 euro); (iii) nëpunësit publikë – 63 363 lekë (524 euro); (iv) forcat e armatosura – 65 359 lekë (583 euro).⁵⁶⁶ Çmimi mesatar i qirasë për një apartament me një dhomë gjumi në Tiranë janë rreth 400-500 euro në muaj⁵⁶⁷, ndërsa në qytetet e tjera, çmimi është më i ulët në varësi të qytetit. Për më tepër, ndryshimi nga viti në vit në indeksin e çmimeve të pasurive të paluajtshme për vendin u rrit me 39.2 %, ⁵⁶⁸ ndërsa paga mesatare u rrit afërsisht 7 % për të njëjtin periudhë.⁵⁶⁹

Ligji për pagat përfshin dispozita shtesë për anëtarët e bordeve dhe këshillave, të cilët ushtrojnë funksionet e tyre me kohë të pjeshme.⁵⁷⁰ Vendimi i Këshillit të Ministrave për strukturën e pagave në shërbimin civil nuk parashikon shpërblime, por paga e tyre varet nga niveli arsimor, titujt akademikë dhe shoqata institucionale.⁵⁷¹ Kodi Shqiptar i Punës përfshin dispozita për shpërblimin e orëve jashtë orarit nëpërmjet ditëve të pushimit ose pagës shtesë;⁵⁷² megjithatë, puna jashtë orarit kompensohet kryesisht përmes ditëve shtesë të pushimit.⁵⁷³

Megjithëse ka pasur hapa të rëndësishëm për digjitalizimin e ofrimit të shërbimeve,⁵⁷⁴ shërbimet kryesore si arsimi dhe kujdesi shëndetësor po preken gjithnjë e më shumë nga cilësia e ulët dhe mungesa e profesionistëve.⁵⁷⁵

Disa institucione publike në Shqipëri janë ndeshur me kufizime buxhetore. Ndërkohë që ka pasur zhvillim të konsiderueshëm në infrastrukturë në qendrat urbane, në disa zona, veçanërisht ato rurale, mund të mos bëhen investime aq sa duhet. Fondet e BE-së⁵⁷⁶ dhe institucionet financiare ndërkombëtare kanë luajtur rol të rëndësishëm në ofrimin e mbështetjes financiare për projekte të ndryshme për institucionet publike në nivel qendror dhe në atë lokal (p.sh. mbështetja e BE-së për administratën publike për programet për trajnimin e stafit të 61 bashkive, luftën kundër korrupsionit, reformën në drejtësi, programi i bursave për nëpunësit e rinj civilë etj. është 125 milionë euro; mbështetja për administratën publike nga Banka

Botërore në nëntë vitet e fundit është 21,45 milionë dollarë).⁵⁷⁷

TREGUESI 5.1.2 PAVARËSIA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli mbrohet me ligj pavarësia e sektorit publik?



Ligjet në fuqi për të garantuar paanshmërinë politike të sektorit publik janë mjaft të dobëta dhe mungojnë dispozitat për parandalimin e anshmërisë politike në rekrutimin, promovimin dhe shkarkimin e punonjësve publikë, veçanërisht ata me kontrata të përkohshme.

Vetëm ligji "Për nëpunësin civil" përfshin dispozita për të drejtat politike,^{578 579} paanshmërinë, dhe arsyet objektive për shkarkim.⁵⁸⁰

Ligji për shërbimin civil në Shqipëri zbatohet për të gjithë punonjësit që mbajnë funksione publike në institucionet shtetërore ose të pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore. Megjithatë, ky ligj nuk përfshin zyrtarët e zgjedhur, personat e emëruar të rangut të lartë të qeverisë nga Kuvendi, Presidenti i Republikës ose Këshilli i Ministrave, gjyqtarët, prokurorët, personeli i forcave të armatosura, agjentët e inteligjencës shtetërore, punonjësit e shërbimit të drejtpërdrejtë publik, anëtarët e caktuar të komisionit, stafin administrativ, agjentë/oficerë të policisë gjyqësore, civilë në strukturat ushtarake, punonjës të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, punonjës të pikave kufitare dhe avokatë në Avokatinë e Shtetit.⁵⁸¹ Për pjesën tjetër të punonjësve të sektorit publik, nuk ka dispozita për të siguruar që ata të mos rekrutohen, promovohen ose shkarkohen në bazë të kritereve politike.


Nëpunësit civilë mund të jenë anëtarë të një partie politike dhe të angazhohen në mënyrë aktive në fushatë, me kusht që të mos jenë pjesë e strukturave drejtuese të partisë, ndërsa nëpunësve të lartë civilë u ndalohej të jenë anëtarë të partive politike.⁵⁸² Pavarësisht këtij ndalimi, nuk ka rregullore që verifikon statusin e tyre përpara se të

bëhen pjesë e korpusit të lartë drejtues të shërbimit civil.⁵⁸³ Për më tepër, ka disa agjenci/drejtori dhe pozicione drejtuese që nuk përfshihen në objektin e ligjit për nëpunësin civil, por që megjithatë duhet të jenë pjesë e tij.⁵⁸⁴ Për shembull, drejtuesit e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, drejtuesit e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, drejtuesit e Agjencisë Shtetërore të Shpronësimit, drejtuesit e Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e qeverisjes së shërbimit civil është Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Komisioneri emërohet nga Kuvendi për një mandat pesëvjeçar me shumicë të thjeshtë.⁵⁸⁵ Ata kanë kompetencën të kryejnë hetime administrative dhe të vendosin gjoba, si dhe të lëshojnë urdhra detyrues për institucionet publike që nuk zbatojnë siç duhet dispozitat ligjore dhe të vendosin gjoba nëse institucionet publike nuk i zbatojnë ato.⁵⁸⁶

Të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të tjerë të sektorit publik me kontrata të përkohshme rregullohen nga Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i cili nuk përfshin asnjë dispozitë për të garantuar që procesi i rekrutimit, promovimit ose largimit nga puna të punonjësve të sektorit publik me kontrata të përkohshme nuk ndikohet politikisht. Për më tepër, Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e standardeve për kryerjen e disa veprimtarive me punonjës të përkohshëm në njësitë e qeverisjes qendrore" përcakton llojin e pozicioneve për angazhime të përkohshme, por nuk përfshin kriteret e punësimit. Sipas vendimit, punonjësit me kontratë të përkohshme punësohen në bazë të kërkesave të pozicionit të punës që pritet të mbajnë.⁵⁸⁷

TREGUESI 5.1.3 PAVARËSIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli nuk ndikohet sektori publik i lirë nga ndërhyrjet e jashtme në aktivitetet e tij?



Aktorët politikë ndërhyjnë zakonisht në aktivitetet e sektorit publik, veçanërisht pas ndryshimeve në partinë apo koalicion qeverisës, dhe duke emëruar individë të lidhur politikisht në pozicione të sektorit publik të niveleve të ndryshme.

Koalicioni qeverisës ndryshoi pas zgjedhjeve të vitit 2013 nga koalicioni mes Partisë Demokratike (PD) dhe LSI-së në koalicionin mes Partisë Socialiste (PS) dhe LSI-së. Pas zgjedhjeve parlamentare të 2017-ës, PS-ja ka qeverisur pa u përfshirë në koalicione. Raporti i monitorimit të SIGMA-s 2021 thekson se zgjidhjet e kontratave të punës në shërbimin civil në Shqipëri janë ulur me 31% në vitin 2020 krahasuar me 2019-ën, shkarkimet e paarsyetuara vazhdojnë të jenë një shqetësim i rëndësishëm.⁵⁸⁸ Këtë e vërtetojnë çështjet gjyqësore që janë duke u shqyrtuar, deklaratat nga institucionet shtetërore dhe vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me zgjidhjen e kontratave të punës për shkak të bindjeve politike.⁵⁸⁹ Raporti vjetor i KLSH-së për vitin 2021 thekson implikimet financiare të këtyre zgjedhjeve të paligjshme të kontratave, duke përcaktuar shpenzimet prej rreth 108 milionë euro (13.3 miliardë lekë) nga viti 2014 deri në vitin 2021 për penalitetet dhe tarifrat përkatëse për shkak të shkarkimeve të paligjshme.⁵⁹⁰ Sipas raporteve të qeverisë, niveli i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për shkarkimet dhe rikthimet në shërbimin civil u rrit nga 79.5 % në 2021 në 81.5 % në vitin 2022, me një ulje të ndjeshme të shkarkimeve (19 në 2022 krahasuar me 346 në 2021 dhe 619 në vitin 2020), të gjitha në përputhje me ligjin e shërbimit civil.⁵⁹¹

Për shkak të mungesës së mbrojtjes ligjore, rregulloreve të qarta dhe mekanizmave mbikëqyrës, situata me nëpunësit publikë me kontrata të përkohshme është më e serioze. Raporti SIGMA

2021⁵⁹² përshkruan se si nëpunësit e sektorit publik emërohen dhe shkarkohen sipas dëshirës, pa respektimin e duhur për efektivitetin dhe stabilitetin institucional. Duke qenë se nuk ka raporte gjithëpërfshirëse që shpjegojnë qartë shkallën e problemit, një rast që ka tërhequr shumë vëmendjen e medias ka qenë ai i drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Kadastrës Vlorë, në jug të Shqipërisë. Nga tetori i vitit 2013 deri në fund të vitit 2019, asnjë drejtor nuk ka qëndruar në pozicionin e tij për më shumë se 14 muaj, ndërsa koha më e shkurtër në detyrë ka qenë vetëm dhjetë ditë.⁵⁹³ Megjithatë, ata nuk janë shkarkuar zyrtarisht, por kanë dhënë dorëheqje. Një nga drejtorët, së bashku me punonjës të tjerë të Drejtorisë, u arrestua në vitin 2021 për falsifikim dokumentesh në lidhje me pretendimet për pronësinë e tokave.⁵⁹⁴ Në të vërtetë, ky është një ndryshim i jashtëzakonshëm lidhur me shkallën e qarkullimit gjatë mandatit të një partie qeverisëse, jo pas ndryshimit në qeveri, dhe shkeljeve ligjore përkatëse. Megjithatë, pasi PS fitoi e vetme zgjedhjet e 2017, pa LSI, filloi të shkarkojë zyrtarë publikë që kishin lidhje me LSI-në.⁵⁹⁵ Të dhënat nga BIRN tregojnë se përpara zgjedhjeve të 14 majit 2023, bashkitë e kontrolluara nga PS punësuan mijëra punonjës të rinj si strategji për të siguruar vota.⁵⁹⁶ Të dhënat e INSTAT tregojnë se fuqia punëtore e administratës publike në Shqipëri arriti nivelin më të lartë në 184,111 në 2022, një rritje prej 8 % gjatë pesë viteve, duke përcaktuar zgjerimin e administratës publike për qëllime elektorale.⁵⁹⁷

Politizimi i sektorit publik ka sjellë rrezikun e anulimit të vendimeve të politikave publike për të favorizuar objektivat elektorale. Për shembull, 30 % e fondeve të rikuperimit të akorduara në buxhetin vjetor 2021 për zonat e prekura nga tërmeti i nëntorit 2019 u shpërndanë gjatë muajit para zgjedhjeve të prillit 2021; 56 % e fondeve u akorduan midis janarit dhe prillit 2021.⁵⁹⁸ Përpara zgjedhjeve vendore të majit 2023, qeveria shqiptare akordoi rreth 10 miliardë lekë (89 milionë euro) për projektet bashkiake dhe 8 miliardë lekë (29 milionë euro) shpërblime në para cash për qytetarët në dhjetor 2022, veprime që aktivistët e shoqërisë civile i kritikojnë si planifikim elektorale dhe jo në shërbim

të interesave të publikut.⁵⁹⁹ Për më tepër, Raporti i OSBE/ODIHR për zgjedhjet lokale në Shqipëri më 14 maj 2023,⁶⁰⁰ vuri re keqpërdorime të burimeve shtetërore në nivel qendror dhe në atë lokal, duke përfshirë pretendimet për presion ndaj punonjësve të sektorit publik dhe votuesve, ku autoritetet vendore angazhohen në aktivitete si restaurimet e infrastrukturave, shpërndarja e ushqimit dhe ofertat e punësimit afatshkurtër (duke përfshirë komunitetet e pakicave kombëtare), duke bërë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të vendosë sanksione ndaj administratave lokale për keqpërdorim të burimeve administrative për fushatë, megjithëse këto sanksione nuk janë zbatuar në nivel qendror.

QEVERISJA

TREGUESI 5.2.1 TRANSPARENCA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë dispozita që garantojnë transparencë në menaxhimin financiar, të burimeve njerëzore dhe informacionit të sektorit publik?



Ekzistojnë disa ligje dhe dispozita në Shqipëri që trajtojnë transparencën, duke përfshirë publikimin e deklaratave të pasurisë për zyrtarët publikë, por ato nuk përfshijnë të gjitha aspektet (për shembull, shpalljen e vendeve vakante të përkohshme në sektorin publik) dhe ofrojnë liri të konsiderueshme në kufizimin ose refuzimin e aksesit ndaj informacionit.

Sipas ligjit "Për deklarimin e pasurisë dhe detyrimeve financiare të disa nëpunësve civilë", ILDKPKI-ja është institucioni përgjegjës për administrimin, verifikimin dhe publikimin online të deklaratave të pasurisë dhe informacioneve të tjera financiare për punonjësit e sektorit publik civil (niveli i mesëm dhe i lartë), shërbimet e sigurisë, agjencitë e zbatimit të ligjit, administrata tatimore dhe doganore, njësia e inteligjencës financiare dhe drejtorët e institucioneve publike në nivel rajonal.⁶⁰¹ Në Shqipëri, të dhënat e mbledhura nga deklaratat e

interesit privat janë të aksesueshme për publikun në përputhje me ligjet që rregullojnë të drejtat e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Këto deklarata publikohen zyrtarisht me informacion konfidencial të redaktuar dhe çdo e dhënë e marrë gjatë kontrolleve ose hetimeve të përputhshmërisë përdoret në mënyrë rigorozë për qëllime ligjore dhe nuk mund të shpërndahet pa autorizim.⁶⁰²

Menaxhimi i informacionit rregullohet me Ligjin për të Drejtën e Informimit. Ligji përfshin dispozita për publikimin e informacionit. Institucionet publike duhet të publikojnë një sërë dokumentesh duke përfshirë, ndër të tjera, raportet buxhetore dhe planet dhe raportet e prokurimit (shih pikën 2.2.2). Për më tepër, ligji përfshin dispozita për aksesin e informacionit që nuk publikohet në faqet e internetit të institucioneve publike. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e Dhënave mbikëqyr zbatimin e ligjit dhe ka një mandat për ta zbatuar atë nëpërmjet gjobave dhe masave të tjera administrative (shih pikën 2.2.2). Megjithatë, autoritetet mund të fshehin hollësi për arsye të sigurisë kombëtare, privatësisë dhe hetimeve në vazhdim. Natyra e paqartë e klauzolës së "interesit publik" u siguron institucioneve liri të konsiderueshme në kufizimin ose mospranimin e aksesit në informacion.⁶⁰³ Ndryshimet në Ligjin për Aksesin në Informacion në pranverën e vitit 2023 pritet të forcojnë rolin që luan Komisioneri.⁶⁰⁴ Vendet vakante në shërbimin civil duhet të publikohen online në portalin e Departamentit të Administratës Publike dhe në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.⁶⁰⁵ Megjithatë, nuk ka dispozita për shpalljen e detyrueshme të konkurseve për pozicionet e sektorit publik me kontrata të përkohshme.

TREGUESI 5.2.2 TRANSPARENCA (ZBATIMI)

Në çfarë mase zbatohen në mënyrë efektive dispozitat për transparencën në menaxhimin financiar, të burimeve njerëzore dhe informacionit në sektorin publik?



Megjithëse ekzistojnë kornizat ligjore për transparencën dhe aksesin në informacion, zbatimi i tyre është shpesh i pabarabartë dhe i cenuar nga sfidat burokratike dhe mungesa e vullnetit politik, si dhe nga kompetenca e kufizuar zbatuese e Komisionerit për të Drejtën e Informacionit, parregullsitë e rëndësishme dhe moszbulimi në prokurimet publike dhe ngurrimi i subjekteve publike për të publikuar të dhëna të ndjeshme, të gjitha të përkeqësuar nga sistemet jo të përshtatshme të grumbullimi të të dhënave.

Komisioneri për të Drejtën e Informacionit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka për detyrë të mbikëqyrë respektimin e Ligjit për të Drejtën e Informacionit dhe mund të penalizojë autoritetet për refuzime të pajustificuara për të shpërndarë informacionin. Ligji për të Drejtën e Informacionit cakton një proces për kërkesat për informacion, por institucionet shpesh vonojnë përgjigjet përtej kufirit prej dhjetë ditësh ose japin të dhëna të panevojshme. Konkretisht, në vitin 2022, zyra e Komisionerit trajtoi 1081 ankesa, nga të cilat 456 vinin nga gazetarët të cilëve iu mohua aksesin në informacion, një rritje nga 409 në vitin 2021. Më shumë se gjysma (643 nga 1081) e ankesave janë zgjidhur duke siguruar të dhënat e kërkuara gjatë hetimit dhe Zyra e Komisionerit ka marrë vendime formale për 61 ankesa.⁶⁰⁶ Aksesin në informacion vazhdon të jetë një problem në Shqipëri, veçanërisht për gazetarët investigativë, shoqërinë civile dhe profesionistët e medias.⁶⁰⁷ Komisioneri shpesh vepron si ndërmjetës për institucionet që nuk përmbushin detyrimet e tyre, në vend që të shërbejë si një subjekt i pavarur i fuqishëm me kompetencën për të vendosur sanksione. Krijimi i Agjencisë për Media dhe Informacion në vitin 2021⁶⁰⁸ ka centralizuar më tej kontrollin e

përmbajtjes informative që bëhet publike nga institucionet qeveritare.⁶⁰⁹

Në portalin qendror elektronik i prokurimit publik në Shqipëri publikohen tenderët, kontratat dhe udhëzimet. Faqja e internetit e Agjencisë së Prokurimit Publik ofron dokumente të standardizuara të tenderit dhe një regjistër online i parashikimeve të prokurimit përditësohet vazhdimisht për arsye transparence.⁶¹⁰ KLSH-ja ka zbuluar parregullsi në prokurimin publik, me një humbje të llogaritur për buxhetin e shtetit prej rreth 3.1 milion euro, ndërsa Agjencia e Prokurimit Publik vendosi gjoba për 102 punonjës dhe propozoi masa disiplinore për 145 punonjës.⁶¹¹ Në tetor 2021, Komisioni i Prokurimit Publik prezantoi një sistem digjital për kërkesat në format elektronik dhe ankesat në format elektronik, i cili, pavarësisht se ofron të dhëna në kohë reale dhe veçori të aksesueshmërisë, kërkon konsolidim dhe trajnim të stafit për funksionalitet optimal.⁶¹² Për më tepër, informacioni mbi prokurimin dhe shpenzimet shpeshherë nuk është i plotë. Një raport i vitit 2023 nga koalicioni i Konventës së OKB-së Kundër Korrupsionit zbulon se Komiteti i Prokurimit Publik duhet të publikojë vendimet për ankesat online në faqen e tij të internetit, por nuk e ka bërë këtë gjë për një pjesë të vitit 2021 dhe për vitin 2022.⁶¹³ Agjencia e Prokurimit Publik ndan çdo vit raportet e prokurimit publik, kryesisht me të dhëna statistikore. Përditësimet e tyre javore renditin njoftimet e prokurimit dhe operatorët e përjashtuar. Këto raporte shpesh nuk kanë të dhëna të plota për zbatimin e kontratës dhe Agjencia e Trajtit të Koncesioneve, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk publikojnë hollësi të zbatimit të koncesioneve apo partneriteteve publik dhe private.⁶¹⁴

Në mënyrë të ngjashme, informacioni për vendet e lira të shërbimit civil publikohet rregullisht, ndërsa informacioni për vendet e lira të punës jashtë objektit të shërbimit civil nuk publikohet rregullisht.⁶¹⁵

Për më tepër, ILDKPKI-ja nuk publikon asnjë deklaratë pasurie.

Subjektet publike shpesh ngurojnë të publikojnë vullnetarisht të dhëna të ndjeshme si kontratat e prokurimit publik ose vlerësimet e rrezikut të korrupsionit, pavarësisht interesit të tyre të lartë publik dhe potencialit për korrupsion.⁶¹⁶

Mekanizmat aktual të ankesave shpesh nuk arrijnë të ofrojnë akses në kohë në informacione të tilla kritike.⁶¹⁷ Për më tepër, nuk ka udhëzime të unifikuar për të balancuar interesin publik ndaj kufizimeve ligjore për informacionin, duke çuar në keqpërdorime të përjashtimeve dhe përgjigje të paplota ose të parëndësishme.⁶¹⁸ Për më tepër, mungesa e sistemeve të fuqishme dhe të detajuara të mbledhjes së të dhënave në organet publike e ndërlikon aftësinë e tyre për t'iu përgjigjur në mënyrën e duhur kërkesave specifike për informacion.

TREGUESI 5.2.3 LLOGARIDHËNIA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë dispozita që sigurojnë që punonjësit e sektorit publik duhet të raportojnë dhe të përgjigjen për veprimet e tyre?



Ndonëse ekzistojnë disa ligje për llogaridhënien e sektorit publik, ka boshllëqe, pasi rrejetet kundër korrupsionit mbulojnë vetëm 44 institucione, dispozitat për trajtimin e ankesave janë të cenueshme ndaj abuzimit, kodeve administrative u mungojnë mandatet arsyetimin e refuzimeve të ankesave dhe mekanizmat mbikëqyrës, veçanërisht kontrollet financiare vonojnë dhe janë të kufizuara.

Sektori publik është subjekt i mekanizmave të ndryshëm të llogaridhënies. Shërbimi civil veçanërisht i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ndërsa Inspektorati Shtetëror për Punën dhe Shërbimet Sociale është përgjegjës për të siguruar që kushtet e punës të ofruara nga punëdhënësit publikë dhe privatë të jenë në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.⁶¹⁹ Institucionet e pavarura mbikëqyrëse si Avokati i Popullit ose Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe

Mbrojtjen e të Dhënave ushtrojnë kompetencat e tyre mbikëqyrëse në sektorin publik në përputhje me mandatin e tyre (shih gjithashtu 2.2.2). Ligji për sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve përfshin dispozita përkatëse për krijimin e njëjësive përgjegjëse për përpunimin e ankesave të sinjalizuesve nga punonjësit e sektorit publik (shih 2.2.6).

Qytetarët mund të paraqesin ankesa përmes kanaleve të ndryshme, duke përfshirë platformën e centralizuar online për bashkëqeverisjen,⁶²⁰ portalin e-Albania, duke paraqitur ankesën drejtpërdrejt tek institucioni i sektorit publik nëpërmjet pikës së tyre të kontaktit, ose përmes institucioneve përkatëse të pavarura mbikëqyrëse. Rrjeti i koordinatorëve kundër korrupsionit, pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme kundër Korrupsionit, ofron një tjetër mundësi për të paraqitur ankesa; megjithatë, shtrirja institucionale e rrjetit është e kufizuar në 44 institucione publike.⁶²¹ Kodi i Procedurave Administrative përfshin dispozita të përgjithshme për paraqitjen dhe trajtimin e ankesave. Ai përcakton afatet kohore për dorëzimet (30 ditë pas nxjerrjes ose refuzimit të aktit administrativ),⁶²² dhe përfshin dispozita kur ankimi nuk sjell pezullimin e aktit administrativ.⁶²³ Megjithatë, këto dispozita janë gjithëpërfshirëse dhe mund të shkelen.

Kuvendi mund t'u kërkojë agjencive të sektorit publik të raportojnë dhe të dëshmojnë në seancat e zakonshme dëgjimore të komisioneve parlamentare⁶²⁴ dhe si pjesë e hetimeve të kuvendit.⁶²⁵ Gjithashtu, sektori publik përcakton kriteret për pranimin e ankesave,⁶²⁶ por nuk përfshin asnjë dispozitë që detyron autoritetin publik që përpunon ankesën të arsyetojë refuzimin.⁶²⁷

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë përfshin dispozita për kriminalizimin e ryshfetit, korrupsionit, shpërdorimit të pushtetit dhe burimeve shtetërore, zhvatjes, refuzimit të deklarimit të pasurisë dhe interesave të tjera financiare, shkeljes së trajtimit të barabartë në tenderët publikë dhe keqpërdorimit të informacionit të privilegjuar shtetëror.⁶²⁸

Për sa i përket mbikëqyrjes financiare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për mbikëqyrjen e brendshme financiare publike duke përcaktuar standarde për mbikëqyrjen e brendshme të shpenzimeve publike dhe duke monitoruar zbatimin e tyre nga njësitë administrative të sektorit publik.⁶²⁹ Ministri i Financave i paraqet Këshillit të Ministrave dhe KLSH-së raportin vjetor për cilësinë e mbikëqyrjes së brendshme financiare publike brenda muajit qershor të vitit pasardhës.⁶³⁰ Për më tepër, KLSH -ja kryen auditime të jashtme të institucioneve të sektorit publik (shih gjithashtu organin e KLSH-së).

TREGUESI 5.2.4 LLOGARIDHËNIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli punonjësit e sektorit publik duhet të raportojnë dhe të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre?



Organet e mbikëqyrjes publike, duke përfshirë Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Institucionin e Lartë të Auditimit, shpesh i japin prioritet subjekteve private ndaj institucioneve publike, nuk zbatojnë sa duhet rekomandimet dhe hasin pengesa ligjore në referimet penale, ndërsa agjencitë si Komisioneri i IMD-së shfaqin veprime penale dhe zbatojnë urdhra detyrues jo konsistent, dhe Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje nuk është e qartë për ankesat e qytetarëve, duke çuar në mungesë llogaridhënieje në sektorin publik.

Raportet e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale, i cili duhet të mbikëqyrë kushtet e punës së punonjësve të sektorit publik, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës, tregojnë se inspektimet e institucioneve publike janë në numër të ulët gjatë punës së tyre. Në vitin 2020, 99,1 % e inspektimeve u kryen në subjekte private, ndërsa në vitin 2021, ky numër shënoi 98,7 %.⁶³¹ Të dhënat e paraqitura nga Inspektorati nuk shqyrtojnë në mënyrë specifike gjendjen e kushteve të punës në institucionet publike dhe nuk ofrojnë statistika specifike për

institucionet publike. Raportet e ILDKPKI-së për deklarimin dhe auditimin e pasurisë dhe interesave të tjera financiare dhe sinjalizimet sugjerojnë zbatimin në një nivel shumë bazë administrativ dhe jo në një nivel të rëndësishëm të dispozitave ligjore.⁶³² Kjo sjell një numër të ulët të rasteve në organet penale në vitin 2021, zakonisht për mosdeklarim të pasurisë dhe interesave të tjera financiare, dhe akoma më pak raste të sinjalizimit (shih 2.2.6).

Të dhënat e siguruar nga Institucioni i Lartë i Auditimit në raportet vjetore tregojnë se institucionet publike zbatojnë më pak se gjysmën e rekomandimeve të bëra në raportet e auditimit, ndërsa numri i rasteve penale që shkojnë për gjykim është jashtëzakonisht i ulët. Gjatë vitit 2021, KLSH-ja ka paraqitur 14 padi penale: 12 raste janë pushuar nga gjykata në fazën paraprake, ndërsa dy prej tyre që ishin kundër dy komunave janë kthyer në prokurori për hetime të mëtejshme.⁶³³ Gjatë vitit 2022, KLSH-ja ka referuar katër kallëzime penale pranë organeve kompetente, Prokurorive të rretheve gjyqësore, për 16 zyrtarë të pozicioneve të ndryshme.⁶³⁴

Sanksionet administrative të Komisionerit të IMD-së (gjobat) nuk janë gjithmonë zgjidhja e duhur. Në vitin 2021, Komisioneri i IMD-së vendosi katër gjoba, ndërsa një vit më parë kishte vendosur tre të tilla në lidhje me udhëzimin e tij për transparencën institucionale.⁶³⁵ Në lidhje me zbatimin e udhëzimit të tij për mbrojtjen e të dhënave personale, Komisioneri i IMD-së vendosi 16 gjoba për institucionet publike dhe 14 për subjektet private në vitin 2021 dhe 37 (si për institucionet publike ashtu edhe për subjektet private) në vitin 2020.⁶³⁶ Në vitin 2022, Komisioneri i IMD-së vendosi 63 sanksione administrative në lidhje me aksesin në informacion. Në përgjigje të ekspozimeve masive të të dhënave personale në vitin 2021, Komisioneri i IMD-së nxori një vendim në nëntor 2022 me anë të të cilit vendosi gjoba për Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Drejtorinë e Përgjithshme për Shërbimet e Transportit Rrugor për përgjegjësinë e tyre përkatëse lidhur me shkeljet.⁶³⁷

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mund të lëshojë urdhra detyrues për institucionet publike që nuk zbatojnë siç duhet dispozitat ligjore dhe gjobit institucionet publike që nuk i zbatojnë këto dispozita ligjore.⁶³⁸ Megjithatë, sipas raportit vjetor të Komisionerit për 2021, urdhrat e dhëna institucioneve publike ishin zbatuar plotësisht ose ishin në proces zbatimi.⁶³⁹

Lidhur me ankesat e qytetarëve, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, e cila është organi përgjegjës për koordinimin e platformës qendrore të ankesave, nuk ka publikuar asnjë raport për ankesat dhe rezultatin e tyre.

TREGUESI 5.2.5 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë dispozitat për të garantuar integritetin e punonjësve të sektorit publik?



Ndonëse Shqipëria ka hartuar ligje si Ligji për Konfliktin e Interesit dhe Ligji për Etikën e Administratës Publike, ka ende paqartësi në lidhje me llojin e kufizimeve, sanksioneve për shkelje dhe udhëzimeve specifike për përdorimin e pronës qeveritare, dhe përmbushjen e kontratave të punësimit dhe etikës.

Ligjet kryesore për rregullimin e mekanizmave të integritetit përfshijnë ligjin e vitit 2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave të zyrtarëve publikë" dhe ligjin e vitit 2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike" (shih 2.2.6).

Objekti i ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit është gjithëpërfshirës. Ky ligj përfshin zyrtarët publikë që kanë interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket se ndikojnë negativisht në përmbushjen e përgjegjësive dhe detyrave të tyre publike dhe që marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes së një institucioni publik.⁶⁴⁰ Për deklaratimet e rregullta në Shqipëri, vetëm bashkëshorti dhe fëmijët në moshë madhore të një

zyrtari duhet të deklarojnë interesat e tyre. Personave të tjerë që kanë lidhje me zyrtarin mund t'u kërkohej të deklarojnë nëse Inspektori i Përgjithshëm e konsideron të nevojshme të kontrollojë të dhënat e zyrtarit. Për më tepër, sipas këtij ligji, një administrator konsiderohet si dikush që ka lidhje me zyrtarin.⁶⁴¹ Objekti i ligjit përfshin edhe dhuratat, favoret dhe trajtimin preferencial, por dhuratat dhe trajtimi preferencial me vlerë më të vogël se përafërsisht 100 euro nuk deklarohen.⁶⁴² ILDKPKI-ja duhet të verifikojë rregullisht deklaratat e zyrtarëve publikë.⁶⁴³

Ligji për Etikën në Administratën Publike përfshin dispozita për përdorimin e duhur të pronës shtetërore (duke përfshirë dokumentet dhe informacionin), punën shtesë dhe kufizimet pas punësimit.⁶⁴⁴ Dispozitat janë mjaft të dobëta dhe nuk përfshihen dispozita për "rotacionet e shpeshita". Dispozitat e ligjit janë mjaft të përgjithshme dhe ngjajnë me ato të udhëzimeve sesa të një akti ligjor me mekanizma specifikë dhe standarde të qarta për të siguruar zbatimin efektiv të tyre. Kufizimet pas punësimit janë mjaft të kufizuara në shtrirje dhe kohë pasi i ndalojnë një ish-zyrtari publik për dy vjet pas largimit nga sektori publik të përfaqësojë një person ose organizatë të përfshirë në një konflikt ose marrëdhënie tregtare me administratën publike shqiptare në lidhje me veprimet e kryera nga zyrtar gjatë kohës që ishte në detyrë. Për më tepër, këto dispozita nuk përshkruajnë qartë natyrën e kufizimeve dhe sanksioneve për shkeljen e tyre (shih 2.2.6).

Ligji "Për deklarimin e pasurisë dhe detyrimeve financiare të zyrtarëve të zgjedhur dhe të disa nëpunësve civilë" rregullon deklarimin e pasurisë dhe të dhëna të tjera financiare për punonjësit e sektorit publik në shërbimin civil (të nivelit të mesëm dhe të lartë), shërbimet e sigurisë, agjencitë ligjzbatuese, administratën tatimore dhe doganore, njësinë e inteligjencës financiare dhe drejtorët e institucioneve publike në nivel rajonal.⁶⁴⁵ Ata duhet të dorëzojnë deklarata përpara se të marrin detyrën, çdo vit gjatë kohës që janë në detyrë dhe pasi të largohen nga detyra.⁶⁴⁶ Ligji përfshin dispozita për verifikimet periodike të deklaratave të

dorëzuara.⁶⁴⁷ Në Shqipëri, verifikimi i plotë i saktësisë dhe vërtetësisë së informacionit që përmban deklaratat e pasurisë dhe interesave private kryhet nga Inspektori i Përgjithshëm sa herë që ka të dhëna me burim ligjor që vënë në dyshim saktësinë dhe vërtetësinë e deklaratës së një zyrtari publik. Gjithashtu, kjo ndodh kur lindin mospërputhje nga kontrollet aritmetike dhe logjike, që tregojnë se burimet e deklaruara nuk mbulojnë ose arsyetojnë pretendimet e pasurisë të bëra nga deklaruesi.⁶⁴⁸

Neni 122 i Ligjit të Prokurimit Publik përcakton përgjithësisht rregullat që zbatohen për kontratën dhe pika 2 përcakton se kushtet e kontratës të lidhura sipas këtij ligji duhet të përmbushen në mirëbesim nga të dyja palët e përfshira. Për më tepër, ligji përcakton që autoriteti ose subjekti kontraktor dhe operatorët ekonomikë duhet të respektojnë standardet më të larta etike dhe të mos përfshihen në mashtrim, korrupsion ose sjellje të tjera të pahijshme gjatë zbatimit të kontratës.⁶⁴⁹ Ndërsa neni 122 përcakton një standard ligjor themelor, mjaftueshmëria e tij varet nga fuqia e mekanizmave të tij zbatues dhe niveli i transparencës dhe llogaridhënies që siguron.

TREGUESI 5.2.6 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli sigurohet integriteti i punonjësve të sektorit publik?



Ekzistojnë disa mekanizma për garantimin e integritetit të sektorit publik, por ekzistojnë boshllëqe të rëndësishme në zbatimin e ligjeve të sinjalizuesve dhe konfliktit të interesit, si dhe në menaxhimin dhe zbatimin gjithëpërfshirës të standardeve etike në të gjithë sektorin publik.


I themeluar në vitin 2003, ILDKPKI-ja është organ i pavarur përgjegjës për shqyrtimin e deklaratave të pasurisë dhe interesave private. Inspektori i Përgjithshëm mbikëqyr rolin e tij për trajtimin e

deklarimit të pasurive dhe detyrimeve financiare dhe auditimin pasues. Ndërsa ILDKPKI-ja siguron raporte vjetore për Kuvendin, ai gjithashtu përgjigjet kur i kërkohet nga Kuvendi dhe mund të kërkojë në mënyrë proaktive një seancë dëgjimore. Këto raporte vjetore, të cilat janë të disponueshme në internet,⁶⁵⁰ theksojnë rolet e saj në parandalimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit. GRECO ka rekomanduar fusha të ndryshme përmirësimi për ILDKPKI-në, veçanërisht në kapacitetin e saj për të kryer verifikimin efikas të deklarave të pasurisë dhe interesave private.⁶⁵¹ ILDKP-ja publikon rregullisht një regjistër të kërkesave për informacion dhe përgjigje, por ai është shumë i përgjithshëm dhe përmban vetëm statistika rreth numrit të kërkesave të pranuar dhe përgjigjeve të dërguara.⁶⁵² ILDKPKI-ja nuk publikon deklaratat e konfliktit të interesit siç parashikon ligji. Ndonëse dorëzimi elektronik i deklarave të pasurisë është një progres teknik në përputhje me rekomandimet e GRECO, zbatimi i kufizuar praktik i ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve (mungesa e qartësisë së mbrojtjeve ligjore dhe zbatimi i kufizuar në praktikë) dhe ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, në pritje të një iniciative të re ligjore, tregojnë se ILDKPKI-ja ka nevojë për më shumë burime ose përpjekje të intensifikuara për zbatimin gjithëpërfshirës të ligjit.⁶⁵³

Ministritë e linjës kanë miratuar plane integriteti, të cilat lidhen kryesisht me menaxhimin e riskun financiar.⁶⁵⁴ Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ka hartuar një kurrikul për luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e konfliktit të interesit dhe ka zhvilluar seanca trajnimit në vitin 2022 për hartimin e planeve të integritetit dhe kryerjen e vlerësimeve të riskut. ASPA ka organizuar seanca trajnimit për koordinatorët kundër korrupsionit në institucionet përkatëse dhe zyrtarë të tjerë publikë sipas nevojave të tyre përkatëse.⁶⁵⁵

TREGUESI 5.2.7 NDJESHMËRIA GJINORE

Deri në çfarë niveli mekanizmat e shërbimit publik marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore?



Ndonëse ekzistojnë disa protokolle që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore, ato nuk përfshijnë të gjithë sektorin publik dhe nuk disponohen të dhëna për zbatimin e tyre.

Ekziston një udhëzues për parandalimin e dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës me në bazë gjininë, i cili përcakton parimet bazë të sjelljes etike në marrëdhëniet gjinore dhe ofron dy qasje për trajtimin e ankesave: qasja joformale dhe formale.⁶⁵⁶ Procedura joformale përfshin dialogun ose komunikimin ndërmjet personit të prekur dhe dhunuesit të të drejtave, drejtpërdrejt ose nëpërmjet lehtësimit të palëve të treta ose ndërmjetësimit të specializuar. Për sa i përket rregulloreve për procedurën formale, aktet aktuale ligjore dhe nënligjore për masat disiplinore dhe shqyrtimin e shkeljeve disiplinore të kryera nga nëpunësit civilë do të zbatohen sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin e shërbimit civil.⁶⁵⁷ Është në gjykimin e punonjësit të dëmtuar të përcaktojë procedurën më efektive. Udhëzimi zbatohet vetëm për administratën e nivelit qendror, duke përfshirë drejtoritë rajonale ose njësitë e institucioneve të nivelit qendror.

Institucionet që i nënshtrohen udhëzimit duhet t'i raportojnë Departamentit të Administratës Publike (DAP) statistika të hollësishme për rastet e dhunës dhe ngacmimeve çdo tremujor.⁶⁵⁸ Megjithatë, këto dhëna nuk mund të gjenden në raportet vjetore të DAP për shërbimin civil dhe⁶⁵⁹ as në raportet vjetore të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.⁶⁶⁰

Për më tepër, ASPA ofron trajnime për zbatimin e dy qasjeve për trajtimin e dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës.⁶⁶¹ Ndonëse ASPA ofron module trajnimit për buxhetimin gjinor dhe integrimin gjinor, ai nuk përfshin një modul specifik për trajtimin e dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës.

ROLI

TREGUESI 5.3.1 ARSIMI PUBLIK

Në çfarë niveli sektori publik informon dhe udhëzon publikun mbi rolin e tij në luftën kundër korrupsionit?



Përpjekjet e sektorit publik për të informuar publikun mbi korrupsionin nuk janë mjaftueshëm të qarta, gjithëpërfshirëse, të hartuara mirë apo të matura qartë.

Ministria e Drejtësisë është koordinatore kombëtare kundër korrupsionit. Informimi i publikut për korrupsionin është pjesë e bazës së ndërgjegjësimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020⁶⁶² (plani i veprimit zgjatet deri në vitin 2023). Baza e ndërgjegjësimit përfshin tre objektiva kryesore: (i) ndërgjegjësimi i publikut rreth pasojave të korrupsionit; (ii) promovimi i përdorimit të mjeteve të raportimit të korrupsionit; dhe (iii) nxitja e bashkëpunimit me shoqërinë civile. Masat specifike në kuadër të këtyre objektivave përfshijnë miratimin e kurrikulave kundër korrupsionit në shkollat e mesme, organizimin e konferencave kombëtare kundër korrupsionit, krijimin e një fondi për të mbështetur projektet kërkimore të korrupsionit të OShC-ve dhe fushatat ndërgjegjësuese për të drejtën për të aksesuar informacionin publik dhe konsultimet publike. Është e rëndësishme të theksohet se jo vetëm institucionet e qeverisë qendrore, por edhe Komisioneri i IMD-së, Avokati i Popullit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë përgjegjës për zbatimin e këtyre masave.⁶⁶³


Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit përfshin tregues dhe objektiva specifike për të gjitha vitet për të rritur ndërgjegjësimin e publikut lidhur me pasojat e korrupsionit.⁶⁶⁴ Raportet e monitorimit për zbatimin e raportit të strategjisë bazuar në këta tregues.⁶⁶⁵ Raportet e monitorimit sugjerojnë se zbatimi i aktiviteteve të ndryshme ndërgjegjësuese bazohet në mbështetjen e jashtme nga Delegacioni i

BE-së ose programet e vendeve të tjera anëtare.⁶⁶⁶ Për vitin 2021 nuk ka pasur progres në lidhje me masën specifike për nxitjen e bashkëpunimit me shoqërinë civile për ndërgjegjësimin e publikut për strategjinë. Megjithatë, raporti i monitorimit thekson se Ministria e Drejtësisë është duke zbatuar masa të ndryshme për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, duke përfshirë publikimin e një udhëzuesi në anglisht dhe shqip.⁶⁶⁷ Mungon një raport i pavarur monitorimi për zbatimin e bazës së ndërgjegjësimit publik të strategjisë. Është duke u hartuar një strategji e re për 2023-2030.⁶⁶⁸

Qeveria, Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Drejtësisë, ka nxitur vazhdimisht qytetarëve që të përdorin portalin e centralizuar⁶⁶⁹ për të paraqitur ankesa dhe për të denoncuar praktikat dhe zyrtarët korruptiv, si dhe për të promovuar aktivitetet kundër korrupsionit të Drejtorisë së Përgjithshme Kundër Korrupsionit.⁶⁷⁰ Megjithatë, nuk ka një raportim gjithëpërfshirës në dispozicion të publikut për statusin e ankesave.

TREGUESI 5.3.2 BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET PUBLIKE, OSHC-TË DHE AGJENCITË PRIVATE PËR PARANDALIMIN DHE ADRESIMIN E KORRUPSIONIT.

Deri në çfarë niveli bashkëpunon sektori publik me agjencitë mbikëqyrëse publike, bizneset dhe shoqërinë civile për nismat kundër korrupsionit?



Institucionet publike angazhojnë në mënyrë të parregullt OSHC-të ose agjencitë private për të parandaluar ose adresuar korrupsionin.

Në përgjithësi, institucionet publike në bashkëpunojnë me OSHC-të për nismat kundër korrupsionit në kuadër të projekteve të financuara nga donatorët. Për shembull, nga viti 2020 deri në vitin 2023, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë, ministritë e linjës dhe bashkitë për hartimin e planeve të integritetit për

këto institucione. Hartimi dhe miratimi i planeve të integritetit është një nga masat e Planit të Veprimit për Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit që është pjesë e veprimeve parandaluese. Një shembull tjetër është bashkëpunimi me Akademinë e Integritetit Evropian dhe Negociatave, e cila ofron trajnime mbi krerët specifikë të negociatave të *acquis* të BE-së si dhe për grupin themelor të kuadrit negociues që nga viti 2019.⁶⁷¹

Dy forume të rëndësishme të sektorit publik ku OSHC-të mund të ndihmojnë për adresimin e korrupsionit konkretisht, Komiteti Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi dhe Komiteti Drejtues Sektorial për Çështjet e Brendshme, nuk janë pjesëmarrëse. Megjithatë, Urdhri i Kryeministrit që përcakton përbërjen e komiteteve drejtuese sektoriale nuk parashikon pjesëmarrjen e OSHC-ve.⁶⁷²

TREGUESI 5.3.3 ULJA E RREZIQEVE TË KORRUPSIONIT DUKE RUAJTUR INTEGRITETIN NË PROKURIMIN PUBLIK

Deri në çfarë niveli ekziston një kuadër efektiv për të mbrojtur integritetin në procedurat e prokurimit publik, duke përfshirë sanksione të rëndësishme për sjellje të pahijshme nga furnitorët dhe nga zyrtarët publikë, si dhe mekanizmat e shqyrtimit dhe ankesave?



Ndonëse ligji i miratuar së fundi për prokurimin publik në Shqipëri paraqiti masa si procedurat e hapura të tenderit për të reduktuar rreziqet e korrupsionit, ai sërish nuk siguron integritetin dhe nxitjen e llogaridhënies, me parregullsi të konstatuara në financimin pas fatkeqësive dhe çështje të vazhdueshme si ofertat fiktive, konfliktet e interesit dhe kriteret e paqarta të përzgjedhjes së ekipit.

Kuvendi miratoi në dhjetor 2020 një ligj të ri për prokurimin publik,⁶⁷³ i cili ka filluar të zbatohet nga data 31 mars 2021, duke e përafuar me standardet e BE-së, duke i dhënë përparësi tenderit më të lirë.

Ligji i ri hoqi kërkesat për propozime, një procedurë e kufizuar e përdorur gjërësisht në të kaluarën.⁶⁷⁴

Procedurat e tenderit janë të hapura, me përjashtim të procedurës së negociimit pa njoftim paraprak.⁶⁷⁵ Megjithatë, procedura e negociimit pa njoftim paraprak përdoret pasi të gjitha procedurat e tjera përkatëse të tenderit të hapura janë zbatuar nga autoriteti kontraktor dhe nuk është zgjedhur oferta e duhur. Për shembull, pas pasojave shkatërruese nga tërmetit i nëntorit të viti 2019, qeveria shqiptare miratoi një akt normativ⁶⁷⁶ për zhvillimin e procedurave të veçanta dhe të përsheptuara të prokurimit.⁶⁷⁷ KLSH-ja konstatoi parregullsi të ndryshme në lidhje me dokumentacionin e procedurave të financimit dhe tenderimit për rindërtimin pas tërmetit, si dhe për përdorimin e fondeve publike për t'iu përgjigjur pandemisë COVID-19.⁶⁷⁸

Bazuar në raportin e vitit 2021 nga Hertie School of Governance dhe Instituti Shqiptar i Shkencave, i cili shqyrtoi procedurat e prokurimit publik në sektorin e shëndetësisë dhe infrastrukturës, është zbuluar se prokurimi publik përballet me disa çështje, duke filluar nga ofertat fiktive deri te mungesa e mbikëqyrjes efektive. Raporti ka identifikuar raste në të cilat procesi i tenderimit mund të duket konkurrues për shkak të pjesëmarrjes së shumë operatorëve ekonomikë, megjithatë, vetëm njëri prej tyre paraqet një ofertë pak më poshtë kufirit maksimal të kërkesës për prokurim.⁶⁷⁹

Agjencia e Prokurimit Publik është organi rregullator kombëtar i prokurimit, i cili është përgjegjës, ndër të tjera, për sigurimin e procedurave standarde të prokurimit, administrimin e portalit të prokurimit publik, përcaktimin dhe zbatimin e standardeve të prokurimit publik dhe mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjeve të prokurimit pas nënshkrimit të tyre.⁶⁸⁰ Operatorët ekonomikë mund të paraqesin kërkesa për sqarime gjatë procesit të prokurimit dhe përgjigjet nga autoriteti kontraktor duhet të ndahen me pjesën tjetër të ofertuesve. Gjithashtu, operatorët ekonomikë mund të paraqesin ankesa tek autoritetet kontraktore dhe tek Komisioni i Prokurimit Publik (KPP).⁶⁸¹ Pas konfirmimit nga autoriteti kontraktor se ankesa është paraqitur

pranë KPP-së gjatë procesit të tenderit, ankesa shqyrtohet dhe procesi pezullohet derisa KPP-ja të nxjerrë një vendim, i cili merr parasysh edhe vendimin e dhënë nga autoriteti kontraktor për vlerësimet e ankesave dhe veprimet e mëvonshme për ta adresuar atë.⁶⁸²

Legjislacioni i prokurimit kërkon që zyrtarët publikë që hartojnë dokumentet e tenderit të mos përfshihen në vlerësimin e ofertave të dorëzuara pranë autoritetit kontraktor;⁶⁸³ megjithatë, ky legjislacion nuk përfshin asnjë dispozitë që do të ndalonte ndonjë nga këta zyrtarë të jetë pjesë e ekipit që vlerëson zbatimin e kontratës.⁶⁸⁴ Për më tepër, nuk përcaktohen kriteret e nevojshme për t'u anëtarësuar në njësinë që harton dokumentet e tenderit apo në njësinë që vlerëson ofertat. Legjislacioni përcakton thjesht se të paktën një nga anëtarët e secilit grup duhet të jetë ekspert prokurimi.⁶⁸⁵

KPP-ja është organi më i lartë i ankimimit administrativ për prokurimin publik. Komisioni ka pesë anëtarë të emëruar me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi i Shqipërisë; megjithatë, kandidatët vlerësohen dhe përzgjidhen nga Këshilli i Ministrave.⁶⁸⁶ Në mënyrë të ngjashme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara është vartëse e Ministrisë së Brendshme dhe mbështetet në burimet e ministrisë për mbështetjen dhe funksionet e saj financiare.⁶⁸⁷

NDËRVEPRIMET

Sektori publik kryen ndërveprime të rëndësishme me organin ekzekutiv, agjencitë kundër korrupsionit dhe organet e KLSH-së. Marrëdhëniet ndërmjet sektorit publik dhe organit ekzekutiv rregullohen nga Ligji për Nëpunësin Civil, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë dhe ligje të tjera përkatëse të miratuara nga Kuvendi dhe akte nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve të qeverisë qendrore.

Gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, punonjësit e sektorit publik⁶⁸⁸ i nënshtrohen shqyrtimit nga dy

institucione kryesore të pavarura mbikëqyrëse: ILDKPKI-ja dhe Institucioni i Lartë i Auditimit. Mandati i KLSH-së rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe përcaktohet më tej në ligjin organik të tij. KLSH-ja mund të kryejë auditime të përputhshmërisë, performancës, financiare dhe të teknologjisë së informacionit (IT) të veprimeve të punonjësve të sektorit publik si pjesë e auditimeve të tyre në institucionet publike. Po kështu, punonjësit e sektorit publik duhet të dorëzojnë deklaratën e tyre të pasurisë pranë ILDKPKI-së në përputhje me Ligjin për Deklarimin e Pasurive. ILDKPKI-ja shqyrton deklaratat dhe jep sanksione në rast shkeljesh. ILDKPKI-ja është përgjegjëse edhe për përcaktimin e standardeve për parandalimin e konfliktit të interesit dhe informimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve, monitorimin e zbatimit të tyre dhe vendosjen e sanksioneve administrative për të zbatuar standardet ligjore.⁶⁸⁹ Për më tepër, ajo mund të marrë ankesa nga sinjalizuesit dhe të kryejë hetime në bazë të ankesave.⁶⁹⁰

Organi ekzekutiv ka tendencën për të ushtruar kontroll politik mbi sektorin publik kryesisht përmes përjashtimit të drejtorive dhe agjencive shtetërore nga objekti i ligjit për nëpunësin civil, mungesës së standardeve të qarta ligjore për punësimin e punonjësve të sektorit publik që nuk janë pjesë e shërbimit civil dhe keqpërdorimi i burimeve shtetërore gjatë zgjedhjeve (shih gjithashtu shtyllat e Organit Ekzekutiv dhe të Organit Drejtues të Zgjedhjeve). KLSH-ja ka nënvizuar dëmtimet financiare të buxhetit të shtetit dhe në disa raste ka nisur procedimin penal,⁶⁹¹ ndërsa ILDKPKI-ja është përqendruar kryesisht në administrimin dhe auditimin e pjesshëm të deklaratave të pasurisë. KLSH dhe ILDKPKI-ja duhet të përfitojnë plotësisht nga mandatet e tyre ligjore përkatëse. Në veçanti, ILDKPKI-ja duhet të rrisë mbikëqyrjen dhe ndërhyrjen rregullatore për politikën e sinjalizuesve dhe për parandalimin e konfliktit të interesit.⁶⁹²

REKOMANDIMET E ORGANIT

- + Kuvendi i Shqipërisë dhe organi ekzekutiv duhet të rishikojnë kuadrin ligjor të prokurimit publik për të adresuar parregullsitë nëpërmjet:
 - + Forcimi i shërbimeve të prokurimit të digjitalizuara për të garantuar që nuk ekziston ofertë fiktive duke siguruar integritimin me Regjistrin Kombëtar të Bizneseve për kontrolle të vazhdueshme, duke përfshirë monitorimin e treguesve të riskut, dhe publikimin e të gjitha kontratave dhe koncesioneve rregullisht në një format të hapur dhe garantimin e publikimit të raporteve të kontrollit të tërthortë.
 - + Prezantimit të shërbimeve të digjitalizuara të prokurimit, një bazë të dhënash të konfliktit të interesit të të gjithë ofertuesve ku kërkohet dhe kontrollohet zbulimi i detyrueshëm i interesave për të parandaluar konfliktet e interesit.
 - + Krijimit të një organi të pavarur rishikues për të mbikëqyrur procedurat e prokurimit dhe për të zbatuar sanksionet parandaluese kundër sjelljes së pahijshme të furnitorëve dhe zyrtarëve publikë.
- + Kuvendi i Shqipërisë dhe organi ekzekutiv duhet të ndryshojnë Ligjin për Nëpunësin Civil, Ligjin për Pagat dhe Kodin e Punës dhe aktet nënligjore dhe rregulloret përkatëse për të rritur profesionalizmin dhe kompetencën në sektorin publik nëpërmjet:
 - + Përfshirjes së drejtorëve punonjës të shërbimit civil për të shmangur të emëruarit politikë.
 - + Përcaktimit dhe zbatimit të qartë të standardeve meritokratike për punësimin e punonjësve të sektorit publik, veçanërisht të personave që nuk janë nëpunës civilë dhe me kontrata të përkohshme. Kjo përfshin ndryshimin e dispozitave për të forcuar kriteret e standardizuara për të gjitha pozicionet brenda dhe jashtë shërbimit civil.
 - + Krijimit të proceseve transparente të punësimit duke e bërë të detyrueshëm publikimin e vendeve të lira të punës, kriterëve të përzgjedhjes, afateve dhe rezultateve të procesit të aplikimit për vendet e lira të nëpunësve civilë ashtu edhe për ato jashtë shërbimit civil dhe publikimin e vendeve vakante për pozicionet e sektorit publik me kontratë të përkohshme.
- + Sigurimit të përzgjedhjeve të bazuara në merita duke e bërë të detyrueshme zhvillimin dhe publikimin e kriterëve të qarta të bazuara në merita për të gjitha pozicionet (edhe për ato jashtë shërbimit civil), duke përfshirë vendet e lira të punës me kontratë të përkohshme, duke përshkruar në detaje procesin e përzgjedhjes, duke kryer testimet dhe vlerësime të standardizuara, duke zbatuar mekanizmat e reagimit për kandidatët për të marrë komente dhe për të apeluar vendimet, duke kryer rishikime të rregullta dhe përmirësime të procesit të përzgjedhjes, duke kryer rishikime të brendshme të qëndrueshme dhe duke siguruar mbrojtje ligjore të sinjalizuesve që raportojnë rastet e shkeljeve.
- + Trajnimit të detyruar dhe formimit të rregullt të punonjësve për transparencën e rekrutimit, proceset e përzgjedhjes së bazuar në merita, rreziqet që lidhen me shkeljet e politikave në fuqi, rëndësinë e integritetit dhe profesionalizmit dhe në fushat prioritare që kanë të bëjnë me pozicionin e tyre të punës.
- + Paraqitjes së vlerësimeve të fuqishme të performancës.
- + Zbatimit të politikave kundër nepotizmit duke vendosur dhe zbatuar dënime të qarta për shkeljet e politikave të tilla, duke krijuar mekanizma të brendshëm raportues dhe duke siguruar mbrojtjen ligjore të sinjalizuesve që raportojnë rastet e nepotizmit ose sjellje të tjera joetike dhe duke kryer auditime dhe kontrolle të rregullta.
- + Kuvendi i Shqipërisë dhe organi ekzekutiv duhet të sigurojnë mbrojtje më të forta ligjore për punonjësit e punësuar me kontratë të përkohshme të rregulluar nga Kodi i Punës. Kuvendi i Shqipërisë dhe organi ekzekutiv duhet të shqyrtojnë hartimin e një kuadri ligjor të

- ndryshëm që rregullon marrëdhëniet e punonjësve të sektorit publik që nuk janë nëpunës civilë. Ky kuadër mund të ofrojë garanci që ndodhen ndërmjet dispozitave të Kodit të Punës dhe Ligjit për nëpunësin civil, të cilat duhet të përfshijnë, për shembull kontrata afatgjata dhe masa mbrojtëse shtesë si mbrojtja e sinjalizuesve, mekanizmat e arbitrazhit për mosmarrëveshjet e punësimit dhe masat mbrojtëse kundër shkarkimit arbitrar.
- + Kuvendi i Shqipërisë dhe organi ekzekutiv duhet të rishikojnë legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit në sektorin publik për të garantuar qartësi dhe zbatim më të mirë. Duke përfshirë:
 - + Paraqitjen e udhëzimeve të qarta për përdorimin e pronës shtetërore.
 - + Vendosjen e sanksioneve të qarta në rast të përdorimit të burimeve publike gjatë fushatave politike.
 - + Përcaktimin e kufizimeve të qarta pas punësimit, natyrës së këtyre kufizimeve dhe sanksioneve si rrjedhojë e shkeljes së tyre.
 - + Përmbushjen etike të kontratës me masa të qarta sanksionesh në rast shkeljesh.
 - + Përcaktimi në hollësi i kufizimeve, sanksioneve për shkelje dhe procedurave për rastet e "rotacioneve të shpeshta".
 - + Zbatimin e mekanizmave të brendshëm të llogaridhënies për të nxitur integritetin dhe për të parandaluar konfliktin.
 - + ILDKPKI-ja duhet të forcojë shqyrtimin e deklaratave të pasurisë në sektorin publik, duke zbatuar një qasje më të fuqishme dhe sistematike për verifikimin e saktësisë dhe plotësinë e këtyre deklaratave. Kjo përfshin si në vijim:
 - + Kryerjen e vlerësimeve proaktive dhe hetimeve të plota për të zbuluar çdo shkelje ose mospërputhje të mundshme.
 - + Publikimin e deklaratave të pasurisë dhe deklaratave të konfliktit të interesit siç kërkohet nga ligji për të rritur transparencën dhe llogaridhënien.
 - + Pajisjen e ILDKPKI-së me burime të mjaftueshme dhe autoritet ligjor për të kryer kontrollë verifikimi efikase dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë mundësinë për të kryer auditime në vend dhe kontrollë të tërthorta me bazat e tjera të të dhënave dhe regjistrat e pasurive.
 - + Forcimin e kapaciteteve të ILDKPKI-së për përmbartim duke i dhënë asaj mundësinë për të vendosur dhe mbledhur gjopa në mënyrë efektive dhe për të referuar çështjet për ndjekje penale kur zbulohen shkelje të mëdha.
 - + Kuvendi i Shqipërisë duhet të rishikojë kuadrin ligjor për mbrojtjen e sinjalizuesve. Sinjalizimet brenda sektorit publik duhet të nxiten në mënyrë aktive. Megjithatë, siguria nuk duhet të jetë vetëm në njësitë e brendshme të sinjalizimit. Ligji duhet të ndryshohet duke përcaktuar qartë se çfarë përbën zbulim të mbrojtur, të krijojë kanale raportimi të sigurt dhe konfidenciale dhe të ndalojë në mënyrën e duhur hakmarrjen. Për më tepër, organet mbikëqyrëse si ILDKPKI-ja duhet të fuqizohen për të zbatuar ligjin në mënyrë efektive duke siguruar burime të mjaftueshme (njerëzore, financiare, teknologjike); zhvillimi i kapaciteteve të specializuara të stafit të ILDKPKI-së për teknikat hetimore, procedurat ligjore, protokollet e mbrojtjes, konfidencialitetin dhe sigurinë si dhe shërbimet mbështetëse dhe shmangien e hakmarrjes; bashkëpunimi i vazhdueshëm me autoritetet e tjera ligjzbatuese dhe luftën kundër korrupsionit; sigurimi i përgjigjes në kohë ndaj raporteve; dhe një qark të rregullt reagimesh. Sinjalizuesit duhet të kenë lirinë që të angazhohen me anëtarët e Kuvendit të Shqipërisë, institucionet e pavarura mbikëqyrëse dhe median. Gjatë gjithë këtij procesi, atyre duhet t'u sigurohet mbrojtje e plotë ligjore.
 - + Kuvendi i Shqipërisë dhe organi ekzekutiv duhet të rishikojnë legjislacionin në mënyrë që funksioni i Departamentit të Administratës Publike dhe i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil të shtrihet përtej shërbimit civil që të përfshijë të gjithë sektorin publik. Duke zgjeruar funksionet e tyre, si qeverisja ashtu edhe mbikëqyrja do të ishin tërësore, duke

përfshirë tërësinë e sektorit publik dhe jo vetëm shërbimin civil. Për të përmbushur në mënyrë efektive këtë funksion të zgjeruar, është e rëndësishme që ata të marrin burime dhe mbështetje shtesë për të përmbushur përgjegjësitë e tyre të reja, gjithëpërfshirëse.

- + Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje duhet të fillojë menjëherë publikimin e rregullt të raporteve të hollësishme lidhur me ankesat e qytetarëve. Këto raporte duhet të përfshijnë statistika për numrin e ankesave të marra, klasifikimin e çështjeve, veprimet e ndërmarra lidhur me këtë të fundit dhe rezultatet përfundimtare.

BIBLIOGRAFI

- ⁵⁶⁴ INSTAT, *Statistikat e Pagave: Tremujori II 2022*, (Tirana: INSTAT, 2022), f. 3, <http://www.instat.gov.al/media/10483/statistikat-e-pagave-tr-2-2022.pdf>.
- ⁵⁶⁵ Tregu i punës në Ballkanin Perëndimor, https://www.rcc.int/download/pubs/Employment%20report_web.pdf/bd4ac07658b29ab7f7899680cbe90107.pdf, aksesuar më 26 gusht 2023.
- ⁵⁶⁶ INSTAT, 2022: 4.
- ⁵⁶⁷ Dorina Azo, "Ikin shqiptarët, vijnë të huajt, rriten çmimet e qirave", Monitor, 22 tetor 2022, <https://www.monitor.al/iken-shqiptaret-vijne-te-huajt-rriten-cmimet-e-qirave-2/>.
- ⁵⁶⁸ Banka e Shqipërisë, *Rezultatet e vërtimit "Tregu i pasurive të paluajtshme" dhe indeksi i çmimit të banesave: Gjashtëmujori i parë 2022*, (Tirana: Banka e Shqipërisë, 2022), https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Analiza_dhe_studime/Vrojtime/Vrojtim_mbi_Ecuria_e_Tregut_te_Pasurive_te_Paluajtshme_ne_Shqiperi.html.
- ⁵⁶⁹ INSTAT, 2022.
- ⁵⁷⁰ Ligji Nr. 9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, krijuara me ligj" (ndryshuar), <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2006/07/17/9584>.
- ⁵⁷¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 8.7.2017, <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/144-vkm-187-pagat-e-nepunesve-civile>.
- ⁵⁷² Neni 81, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, <https://qbz.gov.al/preview/c1c18a6c-5f3e-457d-b931-de505b3c7ed0>.
- ⁵⁷³ Intervista e nëpunësit civil me autorin, Tiranë, 8 nëntor 2022.
- ⁵⁷⁴ SIGMA, 2021: 116-118.
- ⁵⁷⁵ Maghnouj, S., et al, "Rishikimet e OECD-së për Vlerësimin në Arsim: Shqipëri" në *Rishikimet e OECD-së për Vlerësimin në Arsim*, (Paris: Publikime të OECD-së, 2020), <https://doi.org/10.1787/d267dc93-en>; Alice Taylor, "Punonjësit shqiptarë të kujdesit shëndetësor ikin masivisht, qeveria e patrazua", *Euractiv*, 5 maj 2022, https://www.euractiv.com/section/politics/short_news/albanian-healthcare-workers-flee-en-masse-government-unfazed/.
- ⁵⁷⁶ Më shumë për fondet IPA të BE-së për Shqipërinë https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/overview-instrument-pre-accession-assistance/albania-financial-assistance-under-ipa_en.
- ⁵⁷⁷ Anxhelo Haruni, "20 milionë euro në vit për trajnimin e administratës përfundojnë në "kosh", për shkak të shkarkimeve të padrejta", Rrjeti Investigativ në Shqipëri, 3 gusht 2022, <https://ina.media/?p=6237&lang=en>, aksesuar më 25 gusht 2023.
- ⁵⁷⁸ Neni 37, ligji "Për nëpunësin civil".
- ⁵⁷⁹ Neni 5, ligji "Për nëpunësin civil".
- ⁵⁸⁰ Kreu XII, ligji "Për nëpunësin civil".
- ⁵⁸¹ Neni 2,, Ligji "Për nëpunësin civil", <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-sherbimin-civil>, aksesuar më 28.08.2023.
- ⁵⁸² Neni 37, pika 2 e Ligjit "Për nëpunësin civil".
Pavarësisht disa rasteve ku janë kapur dhe dënuar punonjës të korrumpuar policie, kjo çështje vazhdon të mbetet sfida kryesore e integritetit të ASP-së. Trajnimet për sfidat, mekanizmat dhe planet e integritetit zakonisht kryhen në bashkëpunim me donatorët ndërkombëtarë.⁷⁵⁸

TREGUESI 6.2.7 NDJESHMËRIA GJINORE

Deri në çfarë mase mekanizmat e zbatimit të ligjit janë të ndjeshëm ndaj gjinisë?



Ndonëse ekzistojnë disa protokolle që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore, trajnimi për zbatimin e tyre varet kryesisht nga ekspertët e kontraktuar nëpërmjet donatorëve ndërkombëtarë.

Mekanizmat e ankesave dhe hetimit të organeve ligjzbatuese kanë protokolle dhe udhëzime të qarta që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore. Protokollet trajtojnë në mënyrë specifike rastet e abuzimit seksual dhe dhunës në familje, por nuk kanë një politikë specifike për punonjëset.⁷⁵⁹ Për më tepër, ASP-ja ka një numër mjaft të ulët të femrave police në radhët e saj. Në ASP punojnë 1,562 punonjëse: 979 punonjëse policie dhe 583 punonjëse civile.⁷⁶⁰ Ata janë caktuar në njësi të ndryshme në ASP duke përfshirë krimin ekonomik, qendrën operative, patrullën e përgjithshme, drogën dhe trafikun, forcat speciale (dy punonjëse) dhe shërbimet mbështetëse.⁷⁶¹

ASP-ja zhvillon seanca trajnimi për zbatimin e dispozitave të legjislacionit për barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore; megjithatë, pjesa më e trajnimeve ofrohet nga organizata joqeveritare të financuara nga donatorë ndërkombëtarë.⁷⁶²

Regjistrohen disa të dhëna të lidhura me gjininë për hetimet dhe ankesat, dhe ato përfshijnë kategori bazë si gjinia e autorit të krimit dhe e viktimës ose e personit që paraqet ankesën.⁷⁶³

ROLI

TREGUESI 6.3.1 NDJEKJA PENALE NË RASTET E KORRUPSIONIT

Në çfarë mase agjencitë e zbatimit të ligjit zbulojnë dhe hetojnë rastet e korrupsionit në vend?



Ndërsa ASP-ja heton rastet e korrupsionit, puna është përgjithësisht reaktive dhe nuk përqendrohet në korrupsionin e nivelit të lartë.

Legjislati në fuqi ofron dispozita gjithëpërfshirëse për të luftuar korrupsionin, por hetimi i korrupsionit nuk është një prioritet kryesor për ASP-në; krimi i organizuar dhe trafiku i drogës kanë qenë prioritetet kryesore të policisë.⁷⁶⁴ Sipas qasjes zbatuese ("Repressive") të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, dy nga katër objektivat i referohen përmirësimit të kuadrit ligjor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Nga dy objektivat e tjerë, një objektiv synon bashkëpunimin ndërinstucional kryesisht për ndarjen e të dhënave, ndërsa objekti tjetër synon hetimet financiare.⁷⁶⁵ Pavarësisht theksimit të nevojës për hetime financiare efektive, në njësitë e hetimit të korrupsionit dhe krimin ekonomik mungojnë ekspertë dhe kapacitete teknike (shih 6.1.1).

Ligji për Policinë e Shtetit përfshin dispozita gjithëpërfshirëse që i mundësojnë ASP-së të mbledhë dhe të përdorë të dhëna inteligjente dhe⁷⁶⁶ ⁷⁶⁷ personale, të angazhojë informatorë,⁷⁶⁸ ⁷⁶⁹ ⁷⁷⁰ të kryejë kontrolle dhe sekuestime, dhe të ndalojë të personat e dyshuar.⁷⁷¹ Kodi i Procedurës Penale siguron hollësi të mëtejshme dhe përshkruan në dispozitat e tij sjelljen e policisë dhe bashkëpunimin e saj me prokurorinë dhe gjykatat.

Policia ka kryer një sërë operacionesh të profilit të lartë për të synuar grupet e organizuara kriminale⁷⁷² dhe kriminelët e profilit të lartë,⁷⁷³ por ajo nuk ka demonstruar se lufta kundër korrupsionit, veçanërisht korrupsionit të nivelit të lartë, është një prioritet operacional. Gjithsesi, rastet e korrupsionit hetohen dhe në prill 2022 ka pasur një operacion të drejtuar nga AMP-ja që synonte korrupsionin brenda radhëve të ASP-së (konkretisht Policisë Kufitare).⁷⁷⁴

NDËRVEPRIMET

Disa nga ndërveprimet kryesore të ASP-së realizohen me organin ekzekutiv, Kuvendin, prokurorinë dhe organin gjyqësor si dhe me median. Marrëdhëniet ndërmjet ASP-së dhe këtyre organeve të tjera rregullohen nëpërmjet ligjeve dhe rregulloreve. Ndërveprimet ndërmjet organit ekzekutiv dhe ASP-së janë më të rëndësishmet në luftën kundër korrupsionit. Lufta kundër korrupsionit është e orientuar drejt institucioneve qeveritare; prandaj, një polici e pavarur dhe profesionale është parësore. Sipas ligjit dhe zbatimit, organ ekzekutivi ka demonstruar përpjekje të vazhdueshme për ta mbajtur ASP-në të varur politikisht dhe tepër joefektive për të hetuar në mënyrë proaktive korrupsionin.

Pushteti i organit ekzekutiv mbi ASP-në ndërlidhet nëpërmjet kompetencës së tij për të ndikuar në legjislati dhe llogaridhënien e Kuvendit ndaj ASP-së. Në vend që të vepronte si kontroll mbi pushtetin e organit ekzekutiv mbi ASP-në, Kuvendi ka miratuar, pa i shqyrtuar, nismat legjislative antikushetuese të organit ekzekutiv për të zgjeruar kompetencat e ASP-së për mbikëqyrje, duke zgjeruar hapësirën për keqpërdorimin e policisë nga organi ekzekutiv.

Ndërveprimi ndërmjet ASP-së, organit gjyqësor dhe prokurorisë karakterizohet nga simbioza dhe mosmarrëveshja. Efikasiteti operacional i ASP-së mbështetet në udhëzimin e prokurorisë gjatë hetimeve penale. Ndonëse policia drejton hetimet paraprake, prokuroria drejton trajektoren më të hollësishme hetimore. Ky bashkëpunim procedural është i detyrueshëm për kalimin pa probleme të çështjeve në organin gjyqësor. Megjithatë, ekuilibri mund të prishet nga divergjencat e mundshme në qasje, prioritete ose interpretim të ligjit. Për më tepër, roli drejtues i prokurorisë për drejtimin e hetimeve paraqet sfida kur ka mospërputhje në objektivat apo strategjitë ndërmjet prokurorisë dhe policisë. Në disa raste, ASP-ja është shprehur e zhgënjyer për përpjekjet e tyre për arrestim që janë penguar nga vendimet gjyqësore për lirimin e personave të dyshuar. Kjo dinamikë mund të

tensionojë raportin ndërinstytucional dhe të sfidojë efikasitetin e përpjekjeve të zbatimit të ligjit, duke humbur potencialisht besimin e publikut në koherencën dhe efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale.

Marrëdhënia e ASP-së me median është kritike lidhur me krijimin e besimit dhe bashkëpunimit me shoqërinë shqiptare dhe për të pasur një publik të informuar. ASP-ja informon publikun për operacionet në vazhdim dhe media raporton gjerësisht mbi gjendjen e sigurisë publike dhe krimin në shoqëri. Megjithatë, ndonjëherë, ASP-ja dhe media keqpërdorin njëra-tjetrën: ASP-ja është e prirur të tregojë se po lufton fuqishëm krimin, ndërsa mediat janë të prirura të raportojnë lajme që mund të tërheqin vëmendjen e publikut. Këto dinamika çojnë, nganjëherë, në mbulim të bujshëm që nuk krijon besimin e publikut dhe as nuk e informon atë. Për më tepër, ASP-ja përpiket të japë informacion bazë për veprimet e ndërmarra gjatë një operacioni, ndërsa raportet hetimore kufizohen kryesisht në dhënien e informacionit mbi *modus operandi* të kriminelëve dhe rrallë hetojnë lidhjet politike.

REKOMANDIMET E ORGANIT

- + ASP-ja duhet të rishikojë kriteret e saj për emërimin dhe ecjen përpara në karrierë. Sistemi aktual nuk nxit lëvizshmërinë në polici dhe nuk është i përshtatshëm për cilësi të lartë dhe pavarësi profesionale. Si rrjedhojë, duhet të krijohet një sistem i ri që përfshin kritere të qarta profesionale për rritjen në karrierë, një kufi maksimal për kohën në gradë dhe një strukturë dhe organizim të mirëplanifikuar ku marrja e gradës nuk kushtëzohet me një vend të lirë pune.
- + DPP-ja dhe deputeti duhet të konfirmohen me dekret të presidentit. Kjo procedurë është e ngjashme me atë që përdoret për konfirmimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura shqiptare dhe komandantëve të ushtrisë, marinës dhe forcave ajrore në punë. Kjo nuk e ndalon politizimin, por shton një kontroll të pavarur mbi fuqinë e organit ekzekutiv për emërimin e këtyre dy zyrtarëve.
- + Duhet të hiqet dispozita e kthimit, e cila mundëson që ish-anëtarët e ASP-së të kthehen në detyrë. Siç është hartuar aktualisht, dispozita në radhë të parë nuk ka kufizime në rang ose pozicion që mund të zënë të kthyerit në detyrë, përfshirë atë të DPP-së, ndërkohë që nevoja dhe vlera e saj për ASP-në nuk është hartuar në asnjë dokument zyrtar të politikës.
- + AMP-ja duhet të publikojë deklaratat e pasurisë së punonjësve të policisë, kurse ASP-ja duhet të publikojë të dhënat për donacionet e marra në faqet e tyre të internetit. Kjo rrit transparencën dhe fuqizon integritetin e policisë.

BIBLIOGRAFI

- ⁶⁹³ Shihni të dhënat buxhetore në faqen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: <https://financa.gov.al/buxheti-ne-vite/>, aksesuar më 4 janar 2023.
- ⁶⁹⁴ Shih 'Tabela-5-shoqeruese-Shpenzimet-sipas-institucioneve-2023' në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, "Buxheti 2023", <https://financa.gov.al/per-buxhetin-e-vitit-2023/>. Aksesuar më 12 janar 2023.
- ⁶⁹⁵ Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), Raporti i Vlerësimit: Shqipëri (Faza e pestë e Vlerësimit), (Strasburg: Këshilli i Evropës, 2020), f. 32, <https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680a0923d>.
- ⁶⁹⁶ Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), Raporti i Vlerësimit: Shqipëri (Faza e pestë e Vlerësimit), (Strasburg: Këshilli i Evropës, 2020), f. 32.
- ⁶⁹⁷ Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), Raporti i Vlerësimit: Shqipëri (Faza e pestë e Vlerësimit), f. 31.
- ⁶⁹⁸ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 15.3.2017 "Për pagën bazë dhe shtesat për Policinë e Shtetit Shqiptar", <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/03/15/200>.
- ⁶⁹⁹ Neni 8 i Ligjit për Policinë e Shtetit, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/07/31/108>.
- ⁷⁰⁰ Kandidati duhet të ketë të paktën 15 vjet përvojë në polici, një nivel të lartë integriteti, nuk duhet të jetë dënuar për një vepër penale dhe nuk duhet të ketë bërë shkelje të rënda disiplinore në tre vitet e fundit. Shih nenin 13 të ligjit për Policinë e Shtetit,
- ⁷⁰¹ Neni 13 i Ligjit për Policinë e Shtetit, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/07/31/108>.
- ⁷⁰² Neni 14 i Ligjit për Policinë e Shtetit, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/07/31/108>.
- ⁷⁰³ Neni 13 (1) i Ligjit për Policinë e Shtetit.
- ⁷⁰⁴ Ato përfshijnë pamundësinë për të ushtruar funksione publike për më shumë se 6 muaj, arritjen e moshës së pensionit, dorëheqjen vullnetare, dënimin penal ose invaliditetin, duke rezultuar kështu në një vendim gjykatë që kufizon ose heq të drejtën për veprim të pavarur. Shih nenet 15 dhe 16 të ligjit për Policinë e Shtetit.
- ⁷⁰⁵ Neni 15 pika 2/b dhe neni 16 pika 2/b i Ligjit për Policinë e Shtetit.
- ⁷⁰⁶ Shih nenin 55 të ligjit për Policinë e Shtetit.
- ⁷⁰⁷ Neni 54 (2) i Ligjit për Policinë e Shtetit.
- ⁷⁰⁸ Neni 43 (1) i Ligjit për Policinë e Shtetit.
- ⁷⁰⁹ Neni 43 (5) i Ligjit për Policinë e Shtetit.
- ⁷¹⁰ Neni 179 (4/a) i Rregullores së Policisë së Shtetit, https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/RREGULLORE_E_POLICISE_SE_SHTETIT_-_2015.pdf. Përjashtimet e tjera përfshijnë ristrukturimin, arsyet familjare ose shëndetësore, situata kërcënuese për jetën e punonjësit të policisë ose familjes së tij, ndryshimi i statusit të funksionit dhe pamundësia për të kryer detyrat e dikujt tjetër.
- ⁷¹¹ Neni 49 (1) i Ligjit për Policinë e Shtetit.
- ⁷¹² "Ardi Veliu emërohet zv. ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë", *Euronews Albania*, 10 nëntor 2021, <https://euronews.al/ardi-veliu-merr-post-ne-qeveri-emerohet-zv-minister-i-infrastruktures-dhe-energjetikes/>. Aktualisht, ai është drejtor i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- ⁷¹³ "Haki Çako emërohet drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile", *Agjencia Telegrafike Shqiptare*, 21 nëntor 2019, <https://ata.gov.al/2019/11/20/haki-cako-emerohet-drejtor-i-pergjithshem-i-agjencise-kombetare-te-mbrojtjes-civile/>.
- ⁷¹⁴ Ligji për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave synonte të trajtonte korrupsionin në polici. Shih gjithashtu Mimoza Agolli, Rovena Sulstarova dhe Besjana Kuçi, Integriteti i Policisë dhe Korrupsioni në Shqipëri 3.0 (Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2020), <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Police-Integrity-Report-3-1.pdf/>.
- ⁷¹⁵ Transparency International, "Trafikimi i narkotikëve (Tahiri)", <https://www.transparency.org/en/projects/cases-project/data/narcotics-trafficking-tahiri>. Aksesuar më 9 janar 2023.
- ⁷¹⁶ Gjergj Erebara, "Nuk kryen asnjë veprim": Roli i munguar i policisë në vrasjen e Pjerin Xhuvanit", *Reporter.al*, 29 shtator 2022, <https://www.reporter.al/2022/06/29/nuk-kryen-asnje-veprim-rol-i-munguar-i-policise-ne-vrasjen-e-pjerin-xhuvanit/>.
- ⁷¹⁷ Raport monitorimi "Lufta ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar", Qendra Fol, f. 8, korrik 2023, <https://fol.org.al/wp-content/uploads/2023/07/Qendra-Fol-5.pdf> Aksesuar më 22 gusht 2023.

- ⁷¹⁸ Edmond Hoxhaj, “Metamorfoza”: Investitori strategjik arrestohet për vrasje dhe organizatë kriminale”, *Reporter.al*, <https://www.reporter.al/2023/07/28/metamorfoza-investitori-strategjik-arrestohet-per-vrasje-dhe-organizate-kriminale/>, 28 korrik 2023. Aksesuar më 22 gusht 2023.
- ⁷¹⁹ <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2018/03/05/12-2018>.
- ⁷²⁰ Neni 65 (1) e ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave”.
- ⁷²¹ Shih nenin 3 (1/e) dhe nenin 7 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të të zgjedhurve dhe nëpunësve publikë”, <https://www.ildkpkj.al/legjislacioni/>.
- ⁷²² Neni 34 i Ligjit për Deklarimin e Pasurive.
- ⁷²³ Neni 79 (2) i Ligjit për Policinë e Shtetit.
- ⁷²⁴ Neni 58 (1/d) i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, <https://qbz.gov.al/preview/b4819f4d-c246-49b3-87a9-2e6c8512c975>.
- ⁷²⁵ “Shqipëria pëson sulmin e dytë kibernetik, fajëson Iranin”, *Zëri i Amerikës*, 10 shtator 2022, <https://www.voanews.com/a/albania-suffers-2nd-cyberattack-blames-iran/6739582.html>.
- ⁷²⁶ Policia e Shtetit Shqiptar, “Programi i transparencës”, https://www.asp.gov.al/?page_id=600. Aksesuar më 10 janar 2023.
- ⁷²⁷ Policia e Shtetit Shqiptar, “Njoftime”, <https://www.asp.gov.al/?cat=3>. Aksesuar më 10 janar 2023.
- ⁷²⁸ Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, “Programi i Transparencës”, <https://amp.gov.al/programi-i-transparences-2/>. Aksesuar më 10 janar 2023.
- ⁷²⁹ Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, “Programi i Transparencës”, <http://kqv.al/program-transparence/>. Aksesuar më 10 janar 2023.
- ⁷³⁰ Shih nenet 94-96 të Ligjit për Policinë e Shtetit dhe Pjesën V të Rregullores së Policisë së Shtetit.
- ⁷³¹ Neni 40 (3) i Ligjit për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.
- ⁷³² Neni 40 (5) i Ligjit për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.
- ⁷³³ Nenet 27-29 të Ligjit për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.
- ⁷³⁴ Neni 21 (d) dhe (e) i Ligjit për Avokatin e Popullit, <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/article/legislation>.
- ⁷³⁵ <https://amp.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/Rregullore-AMP.pdf>.
- ⁷³⁶ Shih nenin 14 të Ligjit për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore. Përveç emërimit të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm dhe të Drejtorit të Përgjithshëm për emërim nga Kryeministri, Ministri i Brendshëm miraton programin, objektivat dhe qasjet strategjike të zhvillimit të AMP-së; merr vendime për aktivitetet kryesore të punës në të cilat Agjencia duhet të fokusohet; dhe propozon strukturën dhe organizimin e saj.
- ⁷³⁷ Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), Raporti i Vlerësimit: Shqipëri (Faza e pestë e Vlerësimit), (Strasburg: Këshilli i Evropës, 2020), f. 50, <https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680a0923d>
- ⁷³⁸ Në vitin 2021, AMP-ja ka kryer 67 inspektive të paplanifikuara në bazë të raportimeve të mediave dhe ankesave të qytetarëve apo institucioneve publike. Shih Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, *Raporti Vjetor 2021*, f. 11.
- ⁷³⁹ Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, *Raporti Vjetor 2021*, f. 8.
- ⁷⁴⁰ Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, *Raporti Vjetor 2021*, f. 10, <https://amp.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/RAPORTI-VJETOR-2021.pdf>.
- ⁷⁴¹ Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, *Raporti Vjetor 2021*, f. 11, 14.
- ⁷⁴² Ligji Nr. 133/2020, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/10/29/133/14f57a5a-5963-45c4-9a0f-6c898f25f77c;q=ligjin%20nr.%20133%2F2020.%20dat%C3%AB%2029.10.2020>.
- ⁷⁴³ Shih Vendimin nr. 30, datë 5.7.2021 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.
- ⁷⁴⁴ Neni 120 i Rregullores së Policisë së Shtetit.
- ⁷⁴⁵ Nenet 205 dhe 208 të Rregullores së Policisë së Shtetit.
- ⁷⁴⁶ Neni 246 i Rregullores së Policisë së Shtetit.
- ⁷⁴⁷ Neni 91 i Ligjit për Policinë e Shtetit.
- ⁷⁴⁸ Neni 92 i Ligjit për Policinë e Shtetit.
- ⁷⁴⁹ Neni 40 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe verifikimin e pasurisë të të zgjedhurve dhe nëpunësve publikë”.
- ⁷⁵⁰ Neni 62 i Ligjit për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave.

⁷⁵¹ Rovena Sulstarova, Armela Xhaho dhe Mimoza Agolli, *Raport i Monitorimit të Procesit të Vetingut në Polici* (Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2020), f. 26, <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Monitoring-report-on-the-Police-Vetting-Process-2020-1.pdf>.

⁷⁵² Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, *Raporti Vjetor 2021*, f. 17.

⁷⁵³ Rovena Sulstarova, Armela Xhaho dhe Mimoza Agolli, *Raport i Monitorimit të Procesit të Vetingut në Polici*, f. 23.

⁷⁵⁴ Shih Rovena Sulstarova, Armela Xhaho dhe Mimoza Agolli, *Raport i Monitorimit të Procesit të Vetingut në Polici*.

⁷⁵⁵ "Dekonspirimi i operacioneve, Çuçi: Gledis Nano do hetohet për deklaratën që bëri", *Euronews Albania*, 7 shtator 2022, <https://euronews.al/dekonspirimi-i-operacioneve-cuci-gledis-nano-do-hetohet-per-deklaraten-qe-beri/>.

⁷⁵⁶ "Jeton Lami "tregon shokët", kush janë "ushtarët" e Ervis Martinajt në Policinë e Shtetit: Emrat që shkarkuan Gledis Nanon?", *ABC News*, 5 shtator 2022, <https://abcnews.al/jeton-lami-tregon-shoket-kush-jane-ushtar-et-ervis-martinajt-ne-policine-e-shtetit-emrat-qe-shkarkuan-gledis-nanon/>; Edison Vatnikaj, "EKSKLUZIVE/ Foto e Jeton Lamit, ish-agjenti i forcave operacionale, akuzohet se shoqëroi Ervis Martinaj", *Ora News*, 27 gusht 2022, <https://www.oranews.tv/vendi/ekskluzive-foto-e-jeton-lamit-ish-agjenti-i-forcave-operacionale-akuzohet-i1054564>.

⁷⁵⁷ Elvis Hila, "Arrest me burg oficerit të policisë që shoqëronte Ervis Martinajn", *Reporter.al*, 25 gusht 2022, <https://www.reporter.al/2022/08/25/arrest-me-burg-oficerit-te-policise-qe-shoqeronte-ervis-martinajn/> Aksuesar më 26 gusht 2023.

⁷⁵⁸ Shih për shembull projektin mbi integritetin e policisë të siguruar nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes nga Norvegjia: <https://cids.no/albania/>. Projekti për asistencëne policisë nga BE-ja PAMECA V ka zhvilluar trajnime/seminare dhe ka asistuar në hartimin e planit të integritetit të Policisë së Shtetit Shqiptar së bashku me Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura me seli në Gjenevë (DCAF): <https://pameca.org.al/6395/>; plani i integritetit mund të gjendet në: http://pameca.org.al/wp-content/uploads/2021/06/Integrity_Plan_ENG.pdf.

⁷⁵⁹ Intervista e koordinatorit të Policisë së Shtetit Shqiptar për barazinë gjinore dhe diversitetin me autorin, Tiranë, 11 janar 2023.

⁷⁶⁰ GRECO, 2020: 31.

⁷⁶¹ Intervista e koordinatorit të Policisë së Shtetit Shqiptar për barazinë gjinore dhe diversitetin me autorin, Tiranë, 11 janar 2023.

⁷⁶² Intervista e koordinatorit të Policisë së Shtetit Shqiptar për barazinë gjinore dhe diversitetin me autorin, Tiranë, 11 janar 2023.

⁷⁶³ Intervista e koordinatorit të Policisë së Shtetit Shqiptar për barazinë gjinore dhe diversitetin me autorin, Tiranë, 11 janar 2023.

⁷⁶⁴ Kjo u nënvizua edhe nga ministri i Brendshëm në fillim të janarit 2023, kur paraqiti planet për ristrukturimin e Departamentit për Policinë Kriminale. "Policia Kriminale, Çuçi: Drejtori të posaçme për narkotikët, krimin e organizuar dhe krimet e rënda", *TV Klan*, 12 janar 2023, <https://tvklan.al/policia-kriminale-cuci-drejtori-te-posacme-per-narkotiket-krimin-e-organizuar-dhe-krimet-e-renda/>.

⁷⁶⁵ Këshilli i Ministrave, *Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (2015-2020)*, f. 17-19, https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/7.-STRATEGJIA-ND%C3%8BRSEKTORIALE-KUND%C3%8BR-KORRUPSIONIT-2015-2020_EN.pdf.

⁷⁶⁶ Neni 132 i Ligjit për Policinë e Shtetit.

⁷⁶⁷ Nenet 124, 128-129 të Ligjit për Policinë e Shtetit.

⁷⁶⁸ Nenet 130 dhe 138 të Ligjit për Policinë e Shtetit.

⁷⁶⁹ Neni 113, 116-117 i Ligjit për Policinë e Shtetit

⁷⁷⁰ Neni 121 i Ligjit për Policinë e Shtetit.

⁷⁷¹ Neni 111 i Ligjit për Policinë e Shtetit.

⁷⁷² Elvis Myrta, "Operacioni "Volvo 4", si u goditën njëherësh 4 grupe kriminale me 44 urdhër-arreste, 27 në pranga, Shijaku ende në "shtetrrëthim", *Sot*, 23 tetor 2018, <https://sot.com.al/aktualitet/operacioni-volvo-4-si-u-goditen-njeheresh-4-grupe-kriminale-me-44-urdher-arreste-27-ne>.

⁷⁷³ "E BUJSHME/ Arrestohet i plagosur vrasësi serial Nuredin Dumani", *ABC News*, 29 mars 2022, <https://abcnews.al/e-bujshme-arrestohet-i-plagosur-vrasesi-serial-nuredin-dumani/>.

⁷⁷⁴ Arsen Rusta, "EKSKLUZIVE/ Korrupsioni në Morinë, GJKKO lë në burg 15 policë, 12 në arrest shtëpie, pezullohen 4 të tjerë! Pak ditë para se t'iu viheshin prangat pikasën kamerat e përgjuesit e BKH dhe i thyen", *Shqiptarja.com*,

10 prill 2022, <https://shqiptarja.com/lajm/merrnin-leket-nen-dore-dhe-ndanin-ryshfetin-me-njeritjetrin-report-tv-zbardh-emrat-e-32-policeve-te-arrestuar-ne-morine-pak-dite-para-se-tiu-viheshin-prangat-pikasen-kamerat-e-pergjuesit-dhe-i-thyen>.

ORGANI I ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE

PËRMBLEDHJE



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organi drejtues i zgjedhjeve përgjegjës për mbikëqyrjen dhe administrimin e zgjedhjeve në Shqipëri. KQZ-ja është përgjegjëse për detyra të ndryshme që lidhen me zgjedhjet, duke përfshirë regjistrimin e votuesve, emërimin dhe regjistrimin e kandidatëve, mbikëqyrjen e financimit të fushatës, trajnimin e zyrtarëve të zgjedhjeve, organizimin e qendrave të votimit, kryerjen e fushatave për trajnimin e votuesve dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve. Për më tepër, ai trajton ankesat dhe mosmarrëveshjet në lidhje me procesin zgjedhor. KQZ-ja drejtohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i cili asistohet nga Zëvendës Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Në korrik 2020, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një projektligj për ndryshimin e Kodit Zgjedhor,⁷⁷⁵ i cili ndryshoi strukturën institucionale të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe administrimin e procesit zgjedhor. Komisioni i mëparshëm përbëhej nga shtatë anëtarë, duke përfshirë kryetarin dhe zëvendëskryetarin, të cilët zotëronin kompetencën për të miratuar rregullore dhe për të vendosur sanksione për shkeljet gjatë zgjedhjeve. Bazuar në amendamentet e korrikut 2020 u krijuan dy komisione prej pesë anëtarësh: një anëtar përgjegjës për rregulloret (Komisioni Rregullator) dhe anëtari tjetër përgjegjës për adresimin e ankesave dhe sanksioneve (Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve).

Marrëveshja e re ka përmirësuar menaxhimin e procesit zgjedhor, ndërsa ndryshimet kanë përmirësuar rregulloren për financimin e fushatës. Megjithatë, ka mangësi në kuadrin rregullator për financimin e partive politike dhe zbatimin e dispozitave nga KQZ-ja nuk është proaktiv. Kjo ndodh sepse KQZ-së i mungojnë burimet e mjaftueshme për të qenë në gjendje të monitorojë në mënyrë efektive financimin e partive politike dhe të vendosë sanksione në kohë dhe efektive ndaj partive politike që nuk respektojnë dispozitat e Kodit Zgjedhor. Për më tepër, politizimi i KQZ-së vazhdon të jetë një çështje e rëndësishme. Për më tepër, ka vështirësi me aksesin në zgjedhje për minoritetet dhe votuesit me aftësi të veçanta. Ekzistojnë dispozita për promovimin e pjesëmarrjes politike të femrave në zgjedhje, por mungon zbatimin në mënyrë efektive, duke sjellë përfaqësimin në numra të ulët.

KAPACITETET

TREGUESI 7.1.1 BURIMET (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli organi i menaxhimit të zgjedhjeve ka burime të përshtatshme për të arritur qëllimet e tij?



Organi i administrimit të zgjedhjeve ka disa burime financiare dhe njerëzore. Fondet për zgjedhje nuk alokohen në kohën e duhur dhe mungesa e stafit të përhershëm çon në mosvlerësimin e raporteve dhe ankesave në kohë.

KQZ-ja merr buxhetin vjetor si pjesë e buxhetit të shtetit dhe një buxhet të veçantë për zgjedhjet, të cilat financohen nga fondi rezervë i shtetit.⁷⁷⁶ Pas rritjes nga 181.5 milionë lekë (afërsisht 1.5 milionë euro) në vitin 2021⁷⁷⁷ në 275 milionë (afërsisht 2.3 milionë euro) në vitin 2022,⁷⁷⁸ buxheti i KQZ-së ra në 233.8 milionë lekë (afërsisht 2.1 milionë euro) në vitin 2023.⁷⁷⁹ Sipas KQZ-së, fondet shtesë të ndara për organizimin e zgjedhjeve nuk janë ndarë në kohë. Ndonëse këto vonesa nuk duket se kanë efekte negative të rëndësishme në punën e KQZ-së, ato e bëjnë organizimin dhe planifikimin më të vështirë për stafin e KQZ-së.⁷⁸⁰ Fondet shtesë që i janë alokuar KQZ-së për organizimin e zgjedhjeve parlamentare 2021 ishin 1.46 miliardë lekë (12.5 milionë euro)⁷⁸¹, ndërsa fondet për zgjedhjet vendore 2023 ishin 2.6 miliardë lekë (22.3 milionë euro).⁷⁸²

Numri i anëtarëve të stafit të KQZ-së nga 71 në 2020⁷⁸³ është rritur në 85 në 2021⁷⁸⁴ dhe në 95 në 2023.⁷⁸⁵ KQZ-ja ka aktualisht 62 nëpunës civilë dhe asnjë punonjës me kontratë të përkohshme⁷⁸⁶ dhe numri aktual i anëtarëve të stafit konsiderohet e mjaftueshme nga ana e KQZ-së. Kuvendi cakton staf shtesë të përkohshëm për organizimin e zgjedhjeve. Për shembull, për zgjedhjet e ardhshme lokale në maj 2023, Kuvendi ka një staf shtesë prej 352 personash.⁷⁸⁷ Gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021, KQZ rekrutoi 64 monitorues si dhe 59 trajnerë për anëtarët e Komisioneve të Zonave të

Administrimit Zgjedhor (KZAZ), 234 trajnerë për anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV) dhe 92 trajnerë për ekipet në Qendrat e Numërimit të Votave (QNV).⁷⁸⁸ Stafit të përhershëm i caktuar në KQZ nuk mjafton për të siguruar vlerësimin në kohë të raporteve dhe ankesave të paraqitura nga partitë politike, vëzhguesit e zgjedhjeve, audituesit, mediat dhe votuesit e rregullt (shih gjithashtu 7.3.1).⁷⁸⁹

Kriteret e rekrutimit dhe rritjes në detyrë për personelin e përhershëm të KQZ-së, të cilët janë kryesisht nëpunës civilë, miratohen në përputhje me dispozitat e ligjit për nëpunësin civil. Ato publikohen në portalin e DAP-it dhe i nënshtrohen procedurës së përzgjedhjes së parashikuar në Ligjin për Nëpunësin Civil. Kriteret për punonjësit e përkohshëm përfshihen në njoftimet përkatëse, të cilat gjenden në faqen e KQZ-së dhe në portalin online të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.⁷⁹⁰ Kriteret për këtë të fundit janë të përgjithshme.⁷⁹¹ Megjithatë, procesi është i hapur dhe komisioni i veçantë përzgjedhës mbledhet për të vlerësuar kandidatët.⁷⁹² Shkolla Shqiptare të Administratës Publike trajnon personelin e përhershëm dhe të përkohshëm.⁷⁹³ Megjithatë, trajnimi nëpërmjet ASPA-s nuk është i mjaftueshëm dhe plotësohet nga trajnimet e ofruara nëpërmjet programeve të asistencës ndërkombëtare.⁷⁹⁴

TREGUESI 7.1.2 PAVARËSIA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli është organi i administrimit të zgjedhjeve i pavarur me ligj?



Emërimi i anëtarëve të KQZ-së dhe administratës zgjedhore është i ndikuar politikisht. Ndryshimet e bëra në korrik të vitit 2020 në Kodin Zgjedhor synuan të depolitizojnë KQZ-në, por partitë kryesore politike paraqitën boshllëqe ligjore nëpërmjet dispozitave kalimtare të ligjit, të cilat bënë që komisionerët e KQZ-së të mbeten të ndarë sipas partive politike.

Sipas Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, KQZ-ja është institucion i pavarur. 12 komisionerët e tij duhet të zgjidhen nga tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë që të emërohen.⁷⁹⁵ Ata nuk duhet të jenë anëtarë të partive politike ose të kenë subjekte private, veprimtaria e të cilave varet nga vendimet e pushtetit qendror ose vendor.⁷⁹⁶

Mandatet e tyre ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme: Kryekomisioneri emërohet për shtatë vjet; Zëvendës Kryekomisioneri për katër vjet; anëtarët e Komisionit Rregullator (KR) për pesë vjet; anëtarët e Komisionit i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) për nëntë vjet.

Ndryshimet e korrikut 2020 në Kodin Zgjedhor përfshijnë dispozita kalimtare për emërimin për herë të parë të kryesisë së KQZ-së. Ndryshimet parashikojnë kryesisht ndarjen e komisionerëve si në vijim: partia qeverisëse emëron Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe tre komisionerë në KR dhe KAS, ndërsa partia opozitare emëron Zëvendës Komisionerin Zgjedhor dhe dy komisionerë në KR dhe KAS.⁷⁹⁷ Ndryshimet nuk kanë arritur të depolitizojnë KQZ-në dhe administratën zgjedhore dhe i kanë mbajtur ato të ndara sipas partive politike.

Për më tepër, anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor,⁷⁹⁸ Komisioneve të Qendrave të Votimit,⁷⁹⁹ dhe Qendrave të Numërimit të Votave⁸⁰⁰ emërohen nga partitë politike për kohëzgjatjen e zgjedhjeve.

Emërimi i stafit të KQZ-së, d.m.th. Administratës së saj, rregullohet nga Ligji për nëpunësin civil (shih gjithashtu 5.1.2). Nëpunësi civil më i lartë i KQZ-së është Sekretari i Përgjithshëm. Në përputhje me dispozitat e Ligjit për nëpunësin civil, Sekretari i Përgjithshëm dhe nëpunësit e tjerë të lartë civilë emërohen dhe mund të shkarkohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Arsyet për pezullimin ose shkarkimin përshkruhen në Kreun IX dhe XI të Ligjit për nëpunësin civil dhe përfshijnë, ndër të tjera, rastet e konfliktit të interesit, shkeljet disiplinore, aftësitë intelektuale, anëtarësimin në parti politike, dy vlerësime të njëpasnjëshme mospërbushëse të performancës dhe nëse

nëpunësi civil nuk është emëruar në një vend pune për të paktën tetë muaj në pesë vjet.⁸⁰¹

TREGUESI 7.1.3 PAVARËSIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli organi i administrimit të zgjedhjeve funksionon në mënyrë të pavarur?



KQZ-ja dhe administrata zgjedhore nuk janë të pavarura. Komisionerët e saj janë të emëruar politikë. Ata zgjidhen nga Kuvendi, që nënkupton se nuk shkarkohen para përfundimit të mandatit të tyre, por vendimmarrja e tyre zakonisht ndahet sipas partive partiake.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit⁸⁰² dhe Instituti i Studimeve Politike⁸⁰³ vëzhguan zgjedhjet parlamentare të vitit 2021. Të dyja këto të fundit shqyrtuan një model të vendimeve të publikuar nga KAS dhe konstatuan se ato janë ndarë sipas partive partiake.

Sipas raportit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, vendimi i KR-së është miratuar unanimisht nga pesë komisionerët; megjithatë, KQZ-ja nuk mori të drejtën e votës për qytetarët e infektuar me Sars-Cov-2 dhe la në fuqi vendimin e nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vetëm gjashtë ditë para ditës së zgjedhjeve, i cili detyroi shqiptarët që udhëtonin nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut të një karantinë 14-ditore.

Gjithashtu, KRIIK (Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara), një koalicion vëzhguesish që monitoron rregullisht zgjedhjet në Shqipëri, ka theksuar se në momentin e fundit u sjell ndërmend komisionerëve të nivelit më të ulët duke qenë se pengojnë veçanërisht procesin zgjedhor pasi komisionerët e rinj nuk marrin trajnimin e duhur për të administruar procesin zgjedhor.⁸⁰⁴ Partitë politike mund të vendosin të tërheqin përfaqësuesit e tyre në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor ose Komisionet e Qendrave të Votimit duke penguar në këtë mënyrë procesin nëse është në interesin e tyre politik.⁸⁰⁵ Për më

tepër, çështjet e blerjes së votave, presioni i panevojshëm për të ndikuar në sjelljen e votuesve dhe keqpërdorimi i burimeve shtetërore nga qeveria e kryesuar nga Partia Socialiste nuk janë trajtuar plotësisht nga KAS (shih gjithashtu Treguesin 7.3.2).⁸⁰⁶

QEVERISJA

TREGUESI 7.2.1 TRANSPARENCA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë dispozita për të siguruar që publiku të mund të marrë informacion përkatës mbi aktivitetet dhe proceset vendimmarrëse të organit të administrimit të zgjedhjeve?



Ekzistojnë dispozita të mjaftueshme ligjore që garantojnë transparencën e KQZ-së dhe të procesit zgjedhor.

Transparenca e KQZ-së rregullohet me Ligjin për të Drejtën e Informimit, Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Partitë Politike.⁸⁰⁷ Në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit, KQZ-ja duhet të publikojë informacione dhe dokumente mbi strukturën e saj organizative, aktivitetet dhe vendimet rregullatore, planet dhe raportet e prokurimit, raportet e auditimit dhe buxhetet.⁸⁰⁸ Kjo përfshin të gjithë gamën e informacionit që KQZ-ja duhet të publikojë si institucion.

Gjithashtu, Kodi Zgjedhor përfshin dispozita që KQZ-ja të sigurojë transparencën e procesit zgjedhor duke publikuar listën e zgjedhësve,⁸⁰⁹ ⁸¹⁰ rezultatet e zgjedhjeve dhe raportet e auditimit,⁸¹¹ ndërsa Ligji për partitë politike përfshin një dispozitë për publikimin e raporteve financiare vjetore dhe zgjedhore të partive politike.⁸¹² Lista e zgjedhësve përfshin edhe qendrat e votimit. Për më tepër, seancat e mbajtura nga organet e KQZ-së,⁸¹³ si dhe nga KZAZ-të⁸¹⁴ dhe KQV-të,⁸¹⁵ duhet të bëhen publike.

Kodi Zgjedhor kërkon që partitë politike duhet t'u mundësojnë audituesve akses të plotë në bazat e të dhënave të tyre për të gjitha kontributet financiare me shumë të barabartë ose më të madhe se 50 000 lekë (afërsisht 480 euro), duke përfshirë identitetin e donatorëve.⁸¹⁶ Raportet financiare duhet të përfshijnë të dhëna rreth kredive, donacionet monetare dhe në natyrë, të gjitha zërat e shpenzimeve dhe një bilanc të aktiveve dhe pasiveve për kohëzgjatjen e zgjedhjeve.⁸¹⁷ Megjithatë, legjislacioni në fuqi për financimin e partive politike nuk rregullon financimin e fushatave politike nga palë të treta që nuk janë subjekte zgjedhore. Kjo është një boshllëk i rëndësishëm që mund t'u mundësojë partive politike të anashkalojnë kërkesat e transparencës për financimin e partive politike (shih gjithashtu 7.3.1 dhe 11.2.1).

TREGUESI 7.2.2 TRANSPARENCA (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli bëhen aktualisht publike raportet dhe vendimet e organit të administrimit zgjedhor?



KQZ-ja publikon kryesisht pjesën më të madhe të informacionit sipas përcaktimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit, por nuk publikon procesverbalet e mbledhjeve të organeve të niveleve më të ulëta të administratës zgjedhore.

KQZ-ja lëshon deklarata për shtyp, informon publikun për vendimet që marrin organet e saj, jep raporte për veprimtarinë e saj, publikon raportet e auditimit dhe financiare të paraqitura nga partitë politike dhe transmeton seancat e Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse. Megjithatë, KQZ-ja nuk ka publikuar strukturën e saj organizative⁸¹⁸ dhe as raportet e auditimit të brendshëm.⁸¹⁹

Në faqen e saj të internetit, ajo ka një seksion për Programin e Transparencës,⁸²⁰ ⁸²¹ raportet, rezultatet e zgjedhjeve,⁸²² vendimet e organeve të

KQZ-së^{823 824} dhe procesverbalet e seancave përkatës. KQZ-ja komunikon rregullisht përmes Facebook,^{825 826 827 828} Twitter, LinkedIn dhe Instagram. Seancat e organeve të KQZ-së transmetohen drejtpërdrejt në Facebook dhe Youtube.⁸²⁹

KQZ-ja nuk publikon një plan gjithëpërfshirës të veprimeve, regjistrimi i partive/koalicioneve politike, komisionerëve dhe transferimi i materialeve zgjedhore në qendrat e votimit, por publikon vendimet e nxjerra nga Komisioni Rregullator për secilën nga këto çështje. Vendimet dhe procesverbalet nga seancat e KZAZ-ve dhe KQV-ve nuk publikohen. Në raportin vjetor të veprimtarisë për vitin 2021, KQZ-ja u shpreh se disa KZAZ nuk kanë dorëzuar provat e nevojshme dokumentare të vendimeve që kishin marrë dhe materiale të tjera votimi nga qendrat e votimit dhe qendrat e numërimit të votave.⁸³⁰

KQZ-ja ka ofruar një mundësi që qytetarët të raportojnë shkeljet e Kodit Zgjedhor në faqen e saj të internetit⁸³¹ dhe përmes aplikacionit në telefonin inteligjent.

TREGUESI 7.2.3 LLOGARIDHËNIA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë dispozita për të siguruar që organi i administrimit zgjedhor duhet të raportojë dhe të përgjigjet për veprimet e tij?



Legjislacioni përmban dispozita gjithëpërfshirëse për raportimin dhe përpunimin e ankesave nga KQZ-ja, por nuk përcakton formatin e raportimit të KQZ-së.

KQZ-ja duhet të raportojë çdo vit në Kuvendin e Shqipërisë⁸³² dhe i nënshtrohet auditimit të jashtëm nga KLSH-ja sipas Kodit Zgjedhor. Edhe pse Kodi Zgjedhor nuk përcakton një datë deri kur KQZ-ja duhet të raportojë në Kuvend, Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë parashikon që raportimi në Kuvendin e institucioneve kushtetuese dhe të atyre të themeluara me ligj duhet të përfundojë brenda muajit qershor.⁸³³ Nuk ka kërkesa specifike ligjore

për përmbajtjen e raporteve të KQZ-së në Rregulloren e Kuvendit. Duhet të dorëzohet një raport vjetor i auditimit të brendshëm deri në shkurt të vitit të ardhshëm në përputhje me Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin,⁸³⁴ i cili gjithashtu duhet të publikohet (shih 7.2.2). KQZ ka gjithashtu një njësi të auditimit të brendshëm.⁸³⁵

KZAZ-të dhe KQV-të nuk kanë mekanizma për të menaxhuar ankesat. Partitë politike dhe kandidatët e pavarur mund të ankimojnë vendimet e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor pranë KQZ-së; ankesat duhet të paraqiten brenda tre ditëve nga marrja e vendimit.⁸³⁶ Vendimet e lëshuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mund të ankimohen në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, ndërsa vendimet e KAS mund të ankimohen në Kolegjin Zgjedhor, i cili është një gjykatë e posaçme e përbërë nga tetë gjyqtarë të zgjedhur rastësisht nga Këshilli i Lartë Gjyqësor nga gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit, gjykatat administrative të shkallës së parë dhe gjykata administrative e apelit për një mandat katër vjeçar.⁸³⁷

Ankesat lidhur me vendimet e lëshuara nga KQZ-ja dhe KZAZ-të për rezultatet e zgjedhjeve mund të depozitohen në KQZ brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit. Refuzimet për regjistrimin e subjekteve zgjedhore nga KQZ-ja mund të ankimohen në Kolegjin Zgjedhor,⁸³⁸ një organ i cili ka pesë gjyqtarësh që gjykojnë ankesat.⁸³⁹

Ankesat mund të paraqiten edhe nga palët e treta, vëzhgues vendas dhe ndërkombëtarë, media dhe qytetarë me interes të justifikuar për vendimet e marra nga KQZ-ja.⁸⁴⁰ Nëse ato janë depozituar gjatë periudhës së zgjedhjeve, ato duhet të depozitohen brenda tre ditëve nga marrja e vendimit; dhe nëse depozitohen pas periudhës së zgjedhjeve, duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit.⁸⁴¹

Pasi KQZ-ja pranon ankesën, duhet të nisë vlerësimin jo më parë se 24 orë dhe jo më vonë se 48 orë pasi ka marrë vendimin për pranimin e saj.⁸⁴² Vendimi për ankesat lidhur me rezultatet e zgjedhjeve duhet të merret brenda 10 ditëve nga dita e regjistrimit të

ankesës; në të gjitha rastet e tjera, ankesat vendimi duhet të merret brenda dy ditësh.⁸⁴³ Kolegji Zgjedhor duhet të gjykojë ankesat brenda 10 ditëve nga dita e paraqitjes së tyre.⁸⁴⁴ Raportet kombëtare dhe ndërkombëtare nuk kanë vendosur theksin në ndonjë çështje lidhur me përshtatshmërinë e këtyre afateve, prandaj ato janë të përshtatshme për të siguruar korigjimin në kohë të ankesave të partive politike si dhe mediave dhe vëzhguesve të zgjedhjeve.

TREGUESI 7.2.4 LLOGARIDHËNIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli organi i administrimit zgjedhor duhet të raportojë dhe të përgjigjet për zbatimin e veprimeve të tij?



Edhe pse KQZ-ja raporton për veprimet e saj, raportet përiken të jenë sipërfaqësore në natyrë dhe nuk ofrojnë një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të detajuar të punës së KQZ-së për të siguruar zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Raportet vjetore të KQZ-së për Kuvendin bëhen publike në faqen e internetit të KQZ-së.⁸⁴⁵ Ato ofrojnë një përmbledhje të organizimit dhe strukturës së brendshme të KQZ-së dhe të veprimtarive të saj për organizimin e zgjedhjeve. Kuvendi i Shqipërisë i shqyrton dhe i pranon këto raporte çdo vit si pjesë e funksionit të tij mbikëqyrës dhe nxjerr një Rezolutë për Vlerësimin e Performancës së KQZ-së duke përfshirë rekomandime.⁸⁴⁶ Këto dokumente janë vënë në dispozicion të publikut si në faqet e internetit të KQZ-së ashtu edhe të Kuvendit, duke ofruar akses dhe shqyrtim për publikun.

Pjesa më e madhe e informacionit të përfshirë në raport në lidhje me zgjedhjet ka në fokus detaje teknike ose administrative. Pavarësisht rëndësisë së këtij informacioni, ky i fundit tenton të ketë natyrë përshkruese. Për shembull, ndërsa vëren se numërimi i votave ishte ndërprerë gjatë zgjedhjeve parlamentare të 2021 për shkak të lodhjes së personelit, raporti nuk shtjellon më tej shkaqet ose

nëse ky rezultat ka qenë për shkak të mungesës së personelit dhe fondeve për ekipet e numërimit të votave.⁸⁴⁷ Nga ana tjetër, raporti i vitit 2021 ofron statistika të plota për përbërjen e KZAZ-ve, KQV-ve dhe grupeve të numërimit.

Raporti nuk jep informacion lidhur me kualifikimet e komisionerëve. Ky informacion është i rëndësishëm duke qenë se KQZ-ja emëron komisionerët e propozuar nga partitë politike dhe nuk ka kontroll mbi ta. Megjithatë, raporti ofron të dhëna që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore për të vlerësuar nëse kriteret ligjore për përfaqësimin gjinor përmbushen nga partitë politike.⁸⁴⁸

Duke qenë se raporti ka një objekt të gjerë, ndonjëherë mungojnë të dhëna dhe informacione të rëndësishme për punën e KQZ-së për financimin e fushatës, monitorimin e mediave dhe monitorimin e fushatave politike. Raporti vjetor i vitit 2021 ofron një përshkrim mjaft të thjeshtë të monitorimit të shpenzimeve të fushatës, raportimit në media (i cili është përpiluar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive) dhe auditimit të financimit të fushatës, pa shqyrtuar përmbajtjen dhe pa nxjerrë në pah çështjet dhe nevojat për të përmirësuar proceset e monitorimit.⁸⁴⁹

Raporti paraqet statistikat për sanksionet, gjë që sugjeron se ato vendosen kryesisht për shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor, si paaftësia për të menaxhuar ose plotësuar dokumente nga KQV-të apo KZAZ-të,⁸⁵⁰ apo mosrespektimi i afateve ligjore për paraqitjen e raporteve financiare nga partitë politike.⁸⁵¹ Megjithatë, KAS-i vendosi të rrëzojë sanksionet ndaj KQV-ve dhe partive politike përkatëse pas ankimit të tyre.⁸⁵²

KQZ-ja mban takime të rregullta me përfaqësues të partive politike, medias dhe vëzhgues për të diskutuar rregulloret, sanksionet dhe mosmarrëveshjet. Pavarësisht përkushtimit dhe transparencës së KQZ-së në organizimin e këtyre takimeve, ka tregues se ndonjëherë ato mund të përdoren për të vonuar veprimet duke e çuar më tej debatin pa kërkuar zgjidhje.⁸⁵³

TREGUESI 7.2.5 INTEGRITETI (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekzistojnë mekanizma të cilat garantojnë integritetin e organit të administrimit të zgjedhjeve?



Edhe pse ka disa dispozita për të vendosur standarde etike, atyre u mungojnë specifikat për ngacmimin seksual, mbrojtjen e të dhënave dhe bashkëpunimin me palët e treta. Për më tepër, dispozitat aktuale nuk kërkojnë që personeli të angazhohet zyrtarisht për këto standarde dhe as të krijojë një mekanizëm të brendshëm zbatimi.

Kodi i Etikës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (për komisionerët dhe stafin) është miratuar më 23 shkurt 2022.⁸⁵⁴ Ai përmban dispozita të përgjithshme për objektivitetin, paanshmërinë, mosdiskriminimin, transparencën, profesionalizmin, parandalimin e konflikteve të interesit dhe jo të qenit partiak dhe drejtësinë ndaj partive politike dhe palëve të tjera të interesit gjatë zbatimit të detyrave të tyre zyrtare. Kodi ndalon stafin dhe komisionerët e KQZ-së që të pranojnë dhurata, favore ose premtime monetare ose në natyrë, bursa studimi ose çdo lloj sigurimi financiar për veten, anëtarët e familjes ose bashkëpunëtorët e tyre të ngushtë.⁸⁵⁵ Kodi përfshin më tej dispozita për ngacmimin në vendin e punës, përdorimin e orarit të punës, punësimin dytësor, kufizimet pas punësimit, përdorimin e burimeve zyrtare dhe parandalimin e konfliktit të interesit.⁸⁵⁶ Këto dispozita janë mjaft të përgjithshme dhe kryesisht bazohen në Ligjin për Etikën në Administratën Publike (shih gjithashtu 5.2.5). Në vitin 2021, KQZ-ja lëshoi një urdhër specifik për miratimin e rregullores për hetimin administrativ të raportimit, për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen nga hakmarrja në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.⁸⁵⁷ Megjithatë, këto dispozita nuk trajtojnë në mënyrë specifike ngacmimin seksual, ruajtjen e të dhënave dhe informacionit ose bashkëpunimin me palët e treta. I vetmi kufizim pas punësimit për zyrtarët e KQZ-së është ai i përfaqësimit të subjekteve private në konflikt ose në një marrëdhënie kontraktuale me

KQZ-në, që mund të lidhet me detyrat dhe përgjegjësitë e mëparshme të zyrtarit në KQZ.⁸⁵⁸

Departamenti i burimeve njerëzore është i detyruar të njoftojë stafin e KQZ-së për përmbajtjen e Kodit të Etikës,⁸⁵⁹ por punonjësit nuk kanë nevojë të zotohen se do të respektojnë parimet dhe dispozitat e Kodit dhe as ta nënshkruajnë atë. Për më tepër, Kodi nuk parashikon një mekanizëm zbatues brenda KQZ-së.

TREGUESI 7.2.6 INTEGRITETI (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli sigurohet zbatimi i integritetit të organit të administrimit të zgjedhjeve?



Veprimet të cilat garantojnë integritetin e anëtarëve të KQZ-së janë të pakta. Kufizohen në përcaktimin e udhëzimeve bazë, por nuk ka asnjë provë që sugjeron se KQZ-ja është po ndërmerr veprime për të siguruar që anëtarët e saj t'i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe të paanshme.

Ka dy çështje kyçe lidhur me zbatimin e politikës së integritetit në KQZ: njëra është strukturorë dhe tjetra institucionale. Meqenëse KQZ-ja dhe nivelet e ulëta të administratës zgjedhore janë të natyrës partiake, një pjesë e vendimmarrjes në nivel të KQZ-së dhe më e rëndësishmja në nivelet më të ulëta të administratës zgjedhore është e njollosur nga të qenit politik partiak (shih gjithashtu 7.1.2 dhe 7.1.3). Si rrjedhojë, KQZ-ja dhe veçanërisht nivelet më të ulëta të administratës zgjedhore e kanë pothuajse të pamundur në strukturën e tyre që të respektojnë parimin e jo të qenit partiak. Kjo duket qartë në vendimmarrjen e KAS-it (shih 7.1.3) siç është shqyrtuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Instituti i Studimeve Politike.

Në rang institucional, KQZ-ja, ashtu si institucionet e tjera publike, ngarkon departamentin e burimeve njerëzore me përgjegjësitë kryesore për regjistrimin, gjurmimin dhe hetimin e konflikteve të interesit në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.⁸⁶⁰ Megjithatë, as ILDKPKI, që është institucioni kyç

rregullator, dhe as KQZ-ja nuk kanë ofruar asnjë raport mbi zbatimin e legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesit.⁸⁶¹ Nuk ka asnjë provë që sugjeron se ndonjë hetim ose proces dëgjimor në lidhje me konfliktin e interesit ka çuar në ndonjë veprim disiplinor ose penal.

Stafi i KQZ-së nuk është i detyruar me ligj që të zotohet se mund të verë në zbatim këtë gjë.

ROLI

TREGUESI 7.3.1 RREGULLORJA E FUSHATËS

A rregullon në mënyrë efektive organi i administrit të zgjedhjeve financat e kandidatëve dhe partive politike?



Kuadri rregullator për financimin e partive politike ka boshllëqe të dukshme dhe mungesa e një qasjeje proaktive nga KQZ-ja pengon më tej zbatimin efektiv të dispozitave ekzistuese, duke çuar në sfida në mbikëqyrje dhe zbatim. Boshllëqet kryesore përfshijnë trajnimin e pamjaftueshëm për monitoruesit e shpenzimeve të fushatës, përpunimin joefikas të raporteve të auditimit dhe mospërputhjet ndërmjet Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për Partitë Politike, duke çuar në sfida të vonuara të zbatimit dhe mbikëqyrjes.

Kodi Zgjedhor për financimin e fushatave për zgjedhjet lokale dhe të përgjithshme dhe Ligji për partitë politike (LPP)⁸⁶² për financimin e përgjithshëm të partive rregullon financimin e partive politike. Kodi Zgjedhor ka dispozita më të rrepta krahasuar me LPP-në. Kodi Zgjedhor parashikon që të gjitha donacionet, përfshirë ato në natyrë, duhet të regjistrohen dhe palët e treta duhet të kenë akses në identitetin e dhuruesit për donacione të barabarta ose më të mëdha se 50,000 lekë (rreth 430 euro).⁸⁶³ Donacionet mbi 50,000 lekë duhet të bëhen me transfertë bankare,⁸⁶⁴ por nuk mund të jenë më të mëdha se 1 milion lekë (rreth 8700 euro).⁸⁶⁵ Kufizime ka edhe për donacionet nga subjektet që kanë përfituar nga kontrata publike ose janë të angazhuara në shoqëri mediatike. Partitë

politike nuk mund të marrin donacione nga shoqëritë mediatike, bizneset që kanë marrë kontrata qeveritare në tre vitet e fundit të paktën 10 milionë lekë (rreth 87,000 euro), kanë qenë partnerë përmes projekteve të financuara nga publiku ose që janë borxhli ndaj institucioneve publike dhe buxhetit të shtetit.⁸⁶⁶ Shpenzimet e fushatës nuk mund të jenë më të mëdha se trefishi i sasisë më të madhe të fondeve publike të akorduara për një parti politike, ndërsa financimi nga burime të huaja është i ndaluar.⁸⁶⁷

LPP-ja nuk ndalon financimin nga fondacionet e huaja politike⁸⁶⁸ dhe ka vlerë më të lartë për pragun minimal të donacioneve për transfertat bankare, 100,000 ALL⁸⁶⁹ (afërsisht 860 euro) dhe pa kufi të sipërm. Nuk ka kufizime për donacionet në natyrë në LPP, ndërsa zbulimi i financimit nga fushatat në favor të një partie politike nga palët e treta nuk rregullohet as nga Kodi Zgjedhor dhe as nga LPP-ja.

KQZ-ja duhet të mbikëqyrë dhe auditojë burimet e financimit të partive politike dhe shpenzimet e tyre (shih gjithashtu 11.2.4). Edhe pse KQZ-ja është përgjegjëse për auditimin e financave vjetore dhe të fushatës së partive politike shqiptare, ajo e bën këtë në mënyrë të tërthortë duke ia pasuar këtë proces audituesve të pavarur të certifikuar,⁸⁷⁰ megjithatë, nevojitet që të ⁸⁷¹ publikojë si auditimin ashtu edhe raportet financiare të partive politike në faqen e saj zyrtare.

KQZ-ja duhet të caktojë monitorues që supozohet të mbikëqyrin shpenzimet e fushatës së partive politike për të krahasuar shpenzimet e raportuara me ato aktuale në terren, si dhe mund të vendosë sanksione nëse partitë politike shkelin dispozitat për financimin e fushatës. KQZ-ja konstatoi parregullsi gjatë⁸⁷² zgjedhjeve parlamentare të prillit 2021 dhe vendosi sanksionet vetëm në dhjetor 2022 për 14 subjekte zgjedhore (parti politike dhe kandidatë të pavarur).⁸⁷³ Kjo ndodhi kryesisht për shkak të kohës së nevojshme për të shqyrtuar raportet e auditimit dhe ato financiare, në mënyrë që të identifikonte shkeljet dhe lejonte partitë politike dhe kandidatët e pavarur të ofronin prova për të kundërshtuar gjetjet e KQZ-së.⁸⁷⁴ Procesi është veçanërisht joefikas për shkak të një sistemi të bazuar në letër për

mbledhjen dhe vlerësimin e raporteve të auditimit dhe mungesës së stafit të mjaftueshëm për të përpunuar raportet e paraqitura nga audituesit e jashtëm.⁸⁷⁵ Për të zbutur këto mangësi, KQZ-ja lançoi një platformë të raportimit financiar digjital⁸⁷⁶ për publikimin e raporteve të monitorimit të fushatës zgjedhore, raportet financiare të partive politike dhe raportet e auditimit në prill 2023.⁸⁷⁷ Sipas KQZ-së, kjo platformë është zhvilluar me qëllim të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse të KQZ-së dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së partive politike duke ofruara më shumë transparencë dhe lehtësi në përdorim për organizatat e shoqërisë civile, median dhe palët e tjera përkatëse.⁸⁷⁸ Megjithatë, efektiviteti i kësaj platforme në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies mbetet për t'u vlerësuar bazuar në vënien në zbatim dhe përdorimin praktik të saj nga partitë politike dhe palët e tjera të interesuara.

Sipas raportit të OSBE/ODIHR për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, vëzhguesit e caktuar nga KQZ-ja për të monitoruar shpenzimet e fushatës nuk kishin as trajnimin dhe as metodologjinë e duhur për të kryer me efektivitet punën e tyre meqenëse KQZ-ja kishte shumë peshë dhe pak kohë për të organizuar zgjedhjet e 2021 në prill pasi u miratuan ndryshimet e reja në Kodin Zgjedhor në korrik 2020.⁸⁷⁹ Kjo bëri që koha në dispozicion të ishte e pamjaftueshme për të planifikuar dhe ofruar si duhet modulet e trajnimit në përputhje me ndryshimet në monitorimin e shpenzimeve të fushatës dhe për të rekrutuar monitoruesit më të aftë.⁸⁸⁰ Për më tepër, ka pasur disa raportime në media që sugjerojnë se shkeljet e dispozitave të financimit të fushatës shkojnë përtej aktiviteteve për të cilat KQZ-ja ka vendosur sanksione. Ato përfshijnë mosdeklarimin e shpenzimeve⁸⁸¹ dhe shpenzimet më shumë se kufiri i caktuar nga Kodi Zgjedhor.⁸⁸²

TREGUESI 7.3.2 ADMINISTRATA ZGJEDHORE

A garanton organi i administrimit të zgjedhjeve integritetin e procesit zgjedhor?



Edhe pse KQZ-ja përpaket të garantojë organizimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, ajo ka kontroll të kufizuar tek nivelet më të ulëta të administratës, gjë që e bën të vështirë monitorimin e zbatimit të procesit dhe sigurimin e efektivitetit të saj.

Kushtetuta garanton të drejtën e votës për qytetarët që janë 18 vjeç e lart.⁸⁸³ Për më tepër, ndarja e fundit administrative dhe territoriale e vendit ka krijuar tre komuna/zona të administrimit zgjedhor për minoritetet: dy për minoritetin grek dhe një për minoritetin maqedonas.⁸⁸⁴ Megjithatë, ka pakica të caktuara që nuk kanë akses të plotë në procesin e votimit. Minoriteti rom, për shembull, është më i prekuri, sepse shumë prej tyre nuk kanë karta identiteti.⁸⁸⁵ KQZ-ja duhet të publikojë listat e zgjedhësve në faqen e saj të internetit,⁸⁸⁶ por nuk e bën këtë gjë. Megjithatë, ajo siguron një link të e-Albania, portalin qeveritar elektronik të vendit, përmes së cilës votuesit mund të verifikojnë statusin e tyre të regjistrimit.⁸⁸⁷ KZAZ-të duhet të publikojnë gjithashtu listat e votuesve në hapësira publike që janë të aksesueshme lirisht në afërsi të qendrave të votimit.⁸⁸⁸ Listat vendosen jashtë qendrave të votimit, të cilat zakonisht janë shkolla publike, por vëzhguesit e zgjedhjeve kanë gjetur raste ku aksesit në listë është i kufizuar në orarin e punës, sepse hapësirat janë të mbyllura.⁸⁸⁹

KQZ-ja është përgjegjëse për informimin e votuesve. Ajo ofron informacion për votimin nën rubrikën "Këndi i votuesit" në faqen e vet të internetit, e cila shpërndahet përmes medias sociale.⁸⁹⁰ Fushatat informuese për grupet minoritare gjatë zgjedhjeve të vitit 2021 janë zhvilluar në partneritet me organizatat ndërkombëtare.⁸⁹¹ Sipas misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve të ODIHR-it, fushatat informuese nisën me vonesë procesin e tyre të informimit, veçanërisht në lidhje me identifikimin

elektronik të votuesve, që ishte një hap i ri, si dhe njohjen me fletët e votimit.⁸⁹²

Aksesi në qendrat e votimit nuk ka qenë përgjithësisht problem, edhe në zonat rurale, por janë hasur disa vështirësi për personat me aftësi të kufizuara, sepse disa qendra votimi nuk kanë infrastrukturën e nevojshme për aksesin e karrigeve me rrota dhe fletët e votimit braile.⁸⁹³ Gjithashtu nuk ka asnjë mekanizëm që mbështet votimin nga vendbanimi i 1.2 milionë shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.⁸⁹⁴ Neni 25 i Kodit Zgjedhor parashikon votimin jashtë vendit,⁸⁹⁵ por nuk përcakton hapat e qartë për krijimin e infrastrukturës institucionale dhe procedurave për ta arritur votimin jashtë vendit.

Materialet e votimit janë të vulosura dhe kanë numër rendor. Ato shpërndahen nga KQZ-ja në KZAZ.⁸⁹⁶ Më pas KZAZ-të shpërndajnë materialet në qendrat e votimit në zonën e tyre të përkatëse.⁸⁹⁷ Të gjitha qendrat e votimit janë të pajisura me sisteme elektronike për identifikimin e zgjedhësve.⁸⁹⁸ Policia e Shtetit është përgjegjëse për sigurimin e godinave ku ruhen materialet e votimit, për të mos penguar procesin e votimit, për shoqërimin e materialeve të votimit deri në qendrat e numërimit dhe për zbatimin, së bashku me policinë bashkiake, të dispozitave për vendosjen e materialeve të fushatës në vendet e caktuara.⁸⁹⁹ KZAZ-të janë përgjegjëse për përpilimin e numërimit të votave dhe dërgimin e rezultateve, listës së votimit, regjistrit dhe materialeve të tjera përkatëse në KQZ, e cila verifikon dhe konfirmon rezultatet. Sipas vëzhguesve të shoqërisë civile, janë hasur pasur disa problematika gjatë numërimit të votave. Zakonisht ka vonesa në procesin e numërimit për shkak të lodhjes së të grupeve të numërimit të votave,⁹⁰⁰ gjë që sugjeron se numri i tyre nuk është i mjaftueshëm.

Vëzhguesit e partive politike, media dhe vëzhguesit e tjerë të akredituar vendas dhe ndërkombëtarë mund të jenë të pranishëm në qendrat e numërimit.⁹⁰¹

TREGUESI 7.3.3 NDJESHMËRIA GJINORE

Deri në çfarë niveli promovon organi i administrimit të zgjedhjeve pjesëmarrjen e grave në politikë?



Edhe pse ka një sërë dispozitash ligjore që nxisin pjesëmarrjen e grave në procesin zgjedhor, KQZ-ja nuk siguron gjithmonë zbatimin efektiv të tyre. KQZ-ja nuk kryen monitorim të rreptë të zbatimit të dispozitave dhe nuk ka qëndrueshmëri për sa i përket politikave të saj sanksionuese.

Kushtetuta garanton të drejtën e grave për të votuar⁹⁰² dhe kandiduar në zgjedhje. Kodi Zgjedhor parashikon që të paktën një në tre kandidatë për deputetë për çdo zonë zgjedhore duhet t'i përkasë gjinisë së nënpërfaqësuar, kurse në zgjedhjet për këshillat bashkiakë një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet të përfshijë të dyja gjinitë.⁹⁰³ Nuk ka dispozita lidhur me përqindjen e kandidatëve për kryetar bashkie. Nëse partitë politike nuk i zbatojnë këto dispozita, KQZ-ja mund të vendosë sanksione sipas nenit 175 të Kodit Zgjedhor.⁹⁰⁴

Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2021, 40 % e kandidatëve në shkallë vendi ishin gra,⁹⁰⁵ ndërsa 50 % e kandidatëve për këshilla bashkiakë kanë qenë gra.⁹⁰⁶ KQZ-ja vendosi sanksione prej 1 milion lekësh (9700 euro) ndaj Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe Partisë Socialiste për mosrespektim të kuotës gjinore në qarqet Tiranë dhe Berat, por nuk arriti të sanksionojë Partinë Demokratike për mosrespektim të kuotës në të 12 qarqet e vendit.⁹⁰⁷

Ligji për Barazinë Gjinore parashikon pjesëmarrjen e më shumë se 30 për qind të secilës gjini në organet administrative të zgjedhjeve parlamentare dhe lokale.⁹⁰⁸ Megjithatë, kjo nuk zbatohet gjithmonë në praktikë. Për shembull, Raporti i OSBE/ODIHR për Zgjedhjet Parlamentare 2021 zbuloi se gratë janë të nënpërfaqësuar në të gjithë administratën zgjedhore me rreth 30 % të anëtarëve të KZAZ-ve që janë gra, ku vetëm 15 % mbajnë postin e kryetares.⁹⁰⁹ Më tej, Kodi Zgjedhor kërkon që partitë

më të mëdha të shumicës dhe pakicës të propozojnë të paktën 30 për qind të komisionerëve të tyre për Zonën e Administrimit të Zgjedhjeve për secilën gjini. Nuk ka dispozita për sa i përket përbërjes së komisionerëve në qendrat e votimit apo grupet e numërimit të votave.⁹¹⁰ KQZ-ja rekrutoi 214 gra dhe 171 burra për të trajnuar anëtarët e KZAZ-ve, KQV-ve dhe grupeve të numërimit të votave. Megjithatë, raportet e KQZ-së⁹¹¹ dhe OSCE/ODIHR⁹¹² dëshmojnë se gratë kanë qenë të nënpërfaqësuar në të gjithë zinxhirin e administrimit zgjedhor, por veçanërisht në KQV-të dhe grupet e numërimit të votave.

Mbulimi mediatik ka qenë i njëanshëm ndaj burrave, ndërsa gratë nuk janë përfaqësuar në mënyrë adekuate.⁹¹³ Kjo kryesisht për shkak se në qendër të vëmendjes së fushatës janë përqendruar kryesisht kryetarët e partive politike, të cilët janë meshkuj.⁹¹⁴

NDËRVEPRIMET

Puna e KQZ-së përcaktohet kryesisht përmes marrëdhënies së saj me palët në vijim: partitë politike, organi legjislativ dhe ai ekzekutiv. Marrëdhënia me partitë politike, veçanërisht dy më të mëdhatë, është jashtëzakonisht e rëndësishme. Kjo marrëdhënie ndikon në punën e KQZ-së dhe nëpërmjet marrëveshjeve ndërpartiake për ndryshimin e Kodit Zgjedhor mund të ndryshojë të gjithë strukturën e KQZ-së, siç tregohet në ndryshimet e fundit të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë. Neni 81 i Kushtetutës parashikon që dy pjesët më të rëndësishme të legjislacionit që ndikojnë thellësisht në rezultatet e zgjedhjeve, Kodi Zgjedhor dhe Ligji për Ndarjet Territoriale dhe Administrative duhet të miratohen nga tre të pestat e Kuvendit të Shqipërisë (84 nga 140 deputetë të Kuvendi). Pavarësisht marrëdhënieve armiqësore⁹¹⁵ mes dy partive kryesore politike, Partisë Socialiste në pushtet dhe Partisë Demokratike në opozitë, ato janë të bashkuara kur vjen puna për mbajtjen e KQZ-së të kontrolluar politikisht dhe relativisht të dobët në aspektin institucional, në mënyrë që ajo të jetë në gjendje të organizojë zgjedhje, por sipas kushteve politike të dy partive kryesore politike.⁹¹⁶

Praktikisht, kjo nënkupton se polarizimi i fortë ndërmjet PS-së dhe PD-së kontribuon në një interes të ndërsjellë për ruajtjen e kontrollit mbi proceset zgjedhore pa interes të vërtetë për mekanizma zbatues efektivë për të monitoruar dhe hetuar financimet dhe shpenzimet e partive politike.⁹¹⁷ Për shembull, KQZ-ja iu nënshtrua ristrukturimit si pjesë e reformave zgjedhore të vitit 2020. Këto reforma, të iniciuara nga parlamenti, ku partitë kryesore kanë ndikim të rëndësishëm, synuan të depolitizojnë administratën zgjedhore dhe të prezantojnë teknologji të reja votimi. Megjithatë, nxitimi me të cilin këto ndryshime u miratuan nga parlamenti, i kontrolluar nga këto parti kryesore, ngre pikëpyetje në lidhje me angazhimin e tyre për përmirësimin aktual të pavarësisë së KQZ-së.⁹¹⁸

Për më tepër, marrëdhënia ndërmjet KQZ-së dhe organit ekzekutiv është jashtëzakonisht e rëndësishme për të garantuar integritetin e zgjedhjeve. KQZ-ja mbështetet në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe në Policinë e Shtetit Shqiptar,⁹¹⁹ që varen nga Ministria e Brendshme, për përgatitjen dhe publikimin e listave të zgjedhësve dhe për të garantuar përkatësisht transferimin e sigurt të materialeve të votimit. Këto marrëdhënie rregullohen nëpërmjet Kodit Zgjedhor⁹²⁰ dhe marrëveshjeve përkatëse ndërmjet KQZ-së dhe secilit prej dy institucioneve.⁹²¹

REKOMANDIMET E ORGANIT

- + KQZ-ja duhet të rishikojë strukturën e saj të brendshme dhe proceset që kanë të bëjnë me rolin e saj në monitorimin dhe hetimin e financimit të partive politike. Hapi i rishikimit ka për qëllim vlerësimin e performancës aktuale në lidhje me zbatimin e këtyre detyrave dhe përvijimin e ndryshimeve të nevojshme rregullatore dhe burimeve të nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv të dispozitës ligjore për financimin e partive politike. Në mënyrë më specifike:
 - + KQZ-ja duhet të përmirësojë efikasitetin e përpunimit të raportit të auditimit duke garantuar zhvillimin dhe integrimin e mëtejshëm të platformës elektronike të raportimit financiar të nevojshëm për të siguruar që kjo e fundit do të rrisë në mënyrë efektive transparencën dhe llogaridhënien. Kjo platformë duhet të zgjerohet për të përfshirë funksione gjithëpërfshirëse si monitorimi në kohë reale, sinjalizimet për kundërvajtje ose shkelje të mundshme, dhe një bazë të dhënash të integruar për kontroll të informacionit rreth donacioneve dhe raporteve të shpenzimeve nga partitë politike.
 - + KQZ-ja duhet të rrisë kapacitetet e burimeve njerëzore të dedikuara për monitorimin e shpenzimeve të fushatës, si dhe të përmirësojë trajnimin e ofruar për këtë personel. Kjo do të mundësonte një krahasim më efektiv të shpenzimeve të raportuara me shpenzimet aktuale në terren dhe dhënien në kohë të sanksioneve për shkeljet.
 - + KQZ-ja duhet të paraqesë kërkesën tek Kuvendi i Shqipërisë, në mënyrë që ky i fundit të ndryshojë Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Partitë Politike për të përfshirë rregullore për financimin e fushatave politike nga palët e treta që nuk janë subjekte zgjedhore. Ky ndryshim do të adresonte një boshllëk të rëndësishëm që u mundëson partive politike të anashkalojnë kërkesat e transparencës.
- + KQZ-ja duhet të paraqesë kërkesën që Kuvendi i Shqipërisë të bëjë ndryshimet e nevojshme ligjore për të harmonizuar mospërputhjet ndërmjet Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për Partitë Politike (LPP) për të siguruar qëndrueshmëri në zbatimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive politike. Kodi Zgjedhor aktualisht është më i rreptë se LPP-ja dhe harmonizimi i këtyre ligjeve do të eliminonte çdo paqartësi dhe do të siguronte rregullimin e të gjitha llojeve të donacioneve në mënyrë uniforme. Për të arritur këtë, ndryshimet specifike mund të përfshijnë standardizimin e pragjeve dhe kufijve të donacioneve në të dy ligjet, sigurimin e raportimit të vazhdueshëm të donacioneve në natyrë, harmonizimin e kërkesave të auditimit dhe prezantimin e rregulloreve për financimin e fushatës nga palët e treta në LPP. Për më tepër, përafrimi i sanksioneve për shkeljet, standardizimi i kërkesave për raportim transparent dhe akses publik, detyrimi i transfertave bankare për donacione të mëdha dhe garantimi i transparencës në raportimin e shpenzimeve përbëjnë hapa thelbësorë. Këto ndryshime do të siguronin një mënyrë uniforme për rregullat e financimit të fushatës, do të rrisnin transparencën dhe do të përmirësonin integritetin e procesit zgjedhor.
- + KQZ-ja duhet të rekomandojë reforma specifike për të adresuar anshmërinë politike në proceset e emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV) dhe Qendrave të Numërimit të Votave. Kjo mund të përfshijë krijimin e një procesi përzgjedhjeje më të rreptë dhe më pak të ndikuar politikisht me mandat më të gjatë për të shmangur zëvendësimet e momenteve të fundit; duke bërë transparent procesin e emërimit; duke zbatuar një program trajnimi të detyrueshëm shumë përpara zgjedhjeve për të siguruar gatishmëri; duke përcaktuar qartë arsyet për shkarkimin e anëtarëve dhe duke u fokusuar në kritere objektive si performanca, shkeljet etike ose paaftësia për të kryer detyrat dhe jo në vëmendjen politike.

- + KQZ-ja duhet të marrë një rol më aktiv dhe bindës në sanksionimin e shkeljeve të Kodit Zgjedhor nga partitë politike, një qasje që do t'i nxiste partitë politike të harmonizojnë politikatat e tyre të brendshme me dispozitat e Kodit. Në mënyrë që kjo qasje të jetë sa më konkrete dhe më pak të detyrueshme, duhet të zbatohen dispozitat specifike ligjore dhe ndryshimet operacionale vijim: KQZ-ja duhet të zhvillojë një kuadër specifik për identifikimin, hetimin dhe sanksionimin e shkeljeve të partive politike; caktojë afate të qarta kohore për lëshimin e sanksioneve pas zbulimi të shkeljeve, për të shmangur vonesat; fillojë hetimet sipas detyrës zyrtare, pa pritur ankesa të jashtme për të adresuar më shpejt dhe me efikasitet shkeljet e Kodit Zgjedhor nga partitë politike; si dhe të forcojë më tej disponueshmërinë e gjetjeve të raportit nga auditimet dhe hetimet, duke përfshirë detajet e çdo sanksioni të vendosur, për publikun e gjerë dhe palët përkatëse të interesit.
- + KQZ-ja duhet të publikojë raportet e auditimit të brendshëm, si dhe të garantojë raportim gjithëpërfshirës për çështjet kryesore në lidhje me organizimin e zgjedhjeve si dhe veprimet e saj për të garantuar integritetin e procesit zgjedhor dhe zbatimin efektiv të dispozitave që rregullojnë zgjedhjet dhe financimin e partive politike.
- + KQZ-ja duhet të zbatojë mekanizma më efektive lidhur me pjesëmarrjen e grave në procesin zgjedhor. Iniciativat mund të përfshijnë zbatimin e gjobave për partitë politike që nuk respektojnë kuotën përfaqësimit gjinor, prezantimin e rekomandimeve për barazi gjinore për kandidatët për kryetar bashkie, programe informuese për të inkurajuar kandidatet femra, seminare trajnimi dhe fushata ndërgjegjësimi publik për të adresuar barrierat shoqërore dhe forcimin e bashkëpunimit të mëtejshëm me shoqërinë civile.
- + KQZ-ja duhet të zbatojë masa më efektive për të garantuar që minoritetet dhe votuesit me aftësi të kufizuara të kenë akses të barabartë në procesin zgjedhor. Kjo mund të përfshijë ofrimin e vendeve më të aksesueshme të votimit, ofrimin e ndihmës për votim dhe sigurimin që materialet zgjedhore të jenë të disponueshme në gjuhët e pakicave dhe forcimin e bashkëpunimit të mëtejshëm me shoqërinë civile.

BIBLIOGRAFI

- ⁷⁷⁵ Ligji nr. 101/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”, <https://qbz.gov.al/eli/ligji/2020/07/23/101>.
- ⁷⁷⁶ Shih për shembull Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 73, datë 5.2.2021 “Për alokimin e fondit shtesë në buxhetin vjetor 2021 të miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për organizimin e zgjedhjeve për Kuvendin me datë 25 prill 2021”, <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/02/05/73>.
- ⁷⁷⁷ Përafësisht 1.57 milionë euro. Shih buxhetin vjetor 2021 në adresën: <https://financa.gov.al/buxheti-2021/>.
- ⁷⁷⁸ Përafësisht 2.37 milionë euro. Shih buxhetin vjetor 2022 në adresën: <https://financa.gov.al/buxheti-2022/>.
- ⁷⁷⁹ Përafësisht 2.00 milionë euro. Shih buxhetin vjetor 2023 në adresën: <https://financa.gov.al/per-buxhetin-e-vitit-2023/>.
- ⁷⁸⁰ Intervistë me përfaqësuesin e Departamentit Ligjor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me autorin, Tiranë, 24 janar 2023.
- ⁷⁸¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 73, datë 5.2.2021.
- ⁷⁸² Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 37, datë 27.1.2023 “Për alokimin e fondit shtesë në buxhetin vjetor 2023 të miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për organizimin e zgjedhjeve për organet e vetëqeverisjes vendore më 14 maj 2023”.
- ⁷⁸³ Ministria e Financave, “Buxheti 2020”, <https://financa.gov.al/buxheti-2020/>.
- ⁷⁸⁴ Ministria e Financave, “Buxheti 2021”, <https://financa.gov.al/buxheti-2021/>.
- ⁷⁸⁵ Ministria e Financave, “Buxheti 2023”, <https://financa.gov.al/per-buxhetin-e-vitit-2023/>.
- ⁷⁸⁶ Informacioni i dhënë nga KQZ-ja në përgjigje të një kërkesë për të drejtën e informimit të dërguar më 15 nëntor 2022.
- ⁷⁸⁷ Vendimi nr. 75/2022 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organizimit dhe nivelit të pagave për personelin e përkohshëm të rekrutuar për zbatimin nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të procesit zgjedhor për institucionet e qeverisjes vendore në vitin 2023”, <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/09/22/75>.
- ⁷⁸⁸ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Raport i Veprimtarisë Vjetore 2021*, (Tiranë: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 2022), f. 17, https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/kqz_raport_kuvend_2021.pdf.
- ⁷⁸⁹ Intervistë me ekspertin zgjedhor, Tiranë, 25 janar 2023.
- ⁷⁹⁰ Informacioni i dhënë nga KQZ-ja në përgjigje të një kërkesë për të drejtën e informimit të dërguar më 15 nëntor 2022.
- ⁷⁹¹ Shih për shembull Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Njoftim për vende të lira pune <https://kqz.gov.al/category/vende-te-lira-pune-sq/>”.
- ⁷⁹² Informacioni i dhënë nga KQZ-ja në përgjigje të një kërkesë për të drejtën e informimit të dërguar më 15 nëntor 2022.
- ⁷⁹³ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Raport i Veprimtarisë Vjetore 2021*, f. 18.
- ⁷⁹⁴ Shih për shembull International IDEA, “Seminaret e BRIDGE në Shqipëri”, aksesuar më 15 shkurt 2023, <https://www.idea.int/news-media/events/bridge-workshops-albania>.
- ⁷⁹⁵ Neni 17 pika 1 e Kodit Zgjedhor.
- ⁷⁹⁶ Shih nenet 13-16 të Kodit Zgjedhor.
- ⁷⁹⁷ Shih Nenin 183 të Kodit Zgjedhor.
- ⁷⁹⁸ Neni 29 i Kodit Zgjedhor.
- ⁷⁹⁹ Neni 36 i Kodit Zgjedhor.
- ⁸⁰⁰ Neni 95 i Kodit Zgjedhor.
- ⁸⁰¹ Kreu IX dhe XI, Ligji për nëpunësin civil.
- ⁸⁰² Komiteti Shqiptar i Helsinkit, *Raport Përfundimtar mbi Gjetjet dhe Konkluzionet e Monitorimit të Zgjedhjeve Parlamentare për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë 25 prill 2021*, (Tiranë: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2021), <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/06/Raport-Monitorimi-Zgjedhje-per-Kuvendin-Prill-2021--5-Bashki.pdf>.
- ⁸⁰³ Instituti i Studimeve Politike, *Raport mbi Monitorim dhe Analizën e Vendimeve të KAS*, (Tiranë: Instituti i Studimeve Politike, 2021), <https://isp.com.al/wp-content/uploads/2021/07/ISP-Raport-IV-UK-maj-2021.pdf>.
- ⁸⁰⁴ KRIIK, “Prezantimi i Deklaratës së Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake – Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 25 prill 2021”, 26 prill 2021, <https://kriik.al/home/en/2021/04/26/press-conference/>. Aksesuar më 22 dhjetor 2022.

- ⁸⁰⁵ Shih Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Shqipërisë, 25 prill 2021*, (Varshavë: OSCE, 2021), f.8, <https://www.osce.org/files/f/documents/5/1/493687.pdf>.
- ⁸⁰⁶ Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Shqipërisë 25 prill 2021*, f. 2-3, 15; Instituti i Studimeve Politike, *Raport mbi Monitorim dhe Analizën e Vendimeve të KAS*.
- ⁸⁰⁷ Ligji nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike", <https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/ligji-per-partite-politike-2020.pdf>.
- ⁸⁰⁸ Neni 7 i Ligjit për të Drejtën e Informimit.
- ⁸⁰⁹ Neni 48 (2/ç) i Kodit Zgjedhor.
- ⁸¹⁰ Neni 119 pika 2 e Kodit Zgjedhor.
- ⁸¹¹ Neni 92/6, pika 4 Kodit Zgjedhor.
- ⁸¹² Neni 23 (5) i Ligjit për Partitë Politike.
- ⁸¹³ Neni 12 i Kodit Zgjedhor.
- ⁸¹⁴ Neni 35 pika 1 e Kodit Zgjedhor.
- ⁸¹⁵ Neni 42 pika 1 e Kodit Zgjedhor.
- ⁸¹⁶ Nenet 91/2 (5) dhe 92/2 (2) të Kodit Zgjedhor
- ⁸¹⁷ Neni 92/3, pika 2 Kodit Zgjedhor.
- ⁸¹⁸ Shih Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Struktura", aksesuar më 13 shkurt 2023, <https://kqz.gov.al/struktura/>.
- ⁸¹⁹ Shih Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Raporte", aksesuar më 13 shkurt 2023, <https://kqz.gov.al/raporte/>.
- ⁸²⁰ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Programi i Transparencës", aksesuar më 28 dhjetor 2022, <https://kqz.gov.al/programi/>.
- ⁸²¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Raporte KQZ", aksesuar më 28 dhjetor 2022, <https://kqz.gov.al/raporte-kqz/>.
- ⁸²² Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Rezultate", aksesuar më 28 dhjetor 2022, <https://kqz.gov.al/zgjedhje-per-kuvendin/>.
- ⁸²³ Shih, për shembull, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Akte të Komisionerit", aksesuar më 28 dhjetor 2022, <https://kqz.gov.al/akte-te-komisionerit/>; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Vendime të Rregullatorit", aksesuar më 28 dhjetor 2022, <https://kqz.gov.al/udhezime/>.
- ⁸²⁴ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Procesverbalet e mbledhjeve", aksesuar më 28 dhjetor 2022, <https://kqz.gov.al/procesverbalet-e-mbledhjeve/>.
- ⁸²⁵ <https://www.facebook.com/KQZShqiperi>.
- ⁸²⁶ <https://twitter.com/KQZShqiperi>.
- ⁸²⁷ <https://www.linkedin.com/company/kqzshqiperi/posts/?feedView=all>.
- ⁸²⁸ <https://www.instagram.com/kqzshqiperi/>.
- ⁸²⁹ <https://www.youtube.com/@KQZShqiperi/streams>.
- ⁸³⁰ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Raporti për Veprimtarinë Vjetore 2021*, f. 54-55.
- ⁸³¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Denonco parregullsitë zgjedhore", aksesuar më 13 shkurt 2023, <https://kqz.gov.al/denonco/>.
- ⁸³² Neni 19 (1/II) i Kodit Zgjedhor.
- ⁸³³ Neni 103 pika 10 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, <http://www.parlament.al:5000/Files/RregullorjaeKuvenditeperditesuar.pdf>.
- ⁸³⁴ Neni 18 pika 1 e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2010/07/08/10296>.
- ⁸³⁵ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/09/22/74>.
- ⁸³⁶ Neni 124 pika 1 e Kodit Zgjedhor.
- ⁸³⁷ Neni 146 i Kodit Zgjedhor.
- ⁸³⁸ Neni 124 pika 1 e Kodit Zgjedhor.
- ⁸³⁹ Neni 155 pika 2 e Kodit Zgjedhor.
- ⁸⁴⁰ Neni 124/1 pika 1 e Kodit Zgjedhor.
- ⁸⁴¹ Neni 124/1 pika 2 Kodit Zgjedhor.
- ⁸⁴² Neni 131 pika 2 e Kodit Zgjedhor.
- ⁸⁴³ Neni 143 pika 3 e Kodit Zgjedhor.
- ⁸⁴⁴ Neni 157 pika 2 e Kodit Zgjedhor.
- ⁸⁴⁵ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Raporte".

⁸⁴⁶ Rezoluta më e fundit e nxjerrë nga Kuvendi për vlerësimin e performancës së KQZ-së ka qenë e datës 24.07.2023, e disponueshme në https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/230724_Rezoluta-e-Kuvendit_2023.pdf.

⁸⁴⁷ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Raporti për Veprimtarinë Vjetore 2021*, f. 72.

⁸⁴⁸ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Raporti për Veprimtarinë Vjetore 2021*, f. 41-44.

⁸⁴⁹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Raporti për Veprimtarinë Vjetore 2021*, f. 66-67, 81-82, 90.

⁸⁵⁰ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Raporti për Veprimtarinë Vjetore 2021*, f. 89.

⁸⁵¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Raporti për Veprimtarinë Vjetore 2021*, f. 97.

⁸⁵² Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Raporti për Veprimtarinë Vjetore 2021*, f. 89, 97.

⁸⁵³ Një shembull i spikatur ka qenë diskutimi për të drejtën e votës të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, të cilën KQZ-ja duhet ta sigurojë sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor. Organizimi i tryezave të rrumbullakëta për të trajtuar këtë çështje thjesht ka bërë të mundur zvarritjen e debatit mes KQZ-së dhe partive politike në përpjekje për të fajësuar njëra-tjetrën për moszbatimin e dispozitave për votimin jashtë vendit dhe jo zgjidhjen e çështjes. Shih Esiona Konomi, "Vota e emigrantëve, Celibashi kundër Pandeli Majkos", ABC News, 28 dhjetor 2022, <https://abcnews.al/vota-e-emigranteve-celibashi-kunder-pandeli-majkos/>; "Vota e emigrantëve, Celibashi: Palët treguan pasiguri dhe mosbesim, synojmë të realizohet në vjeshtën tjetër" (Votat e emigrantëve, Celibashi: Palët treguan pasiguri dhe mosbesim, synojmë të realizohet në vjeshtën tjetër), ABC News, 24 maj 2022, <https://abcnews.al/vota-e-emigranteve-celibashi-duhet-te-konsiderohet-nga-te-gjithe-faktoret-synojme-te-realizohet-ne-vjeshten-tjeter/>.

⁸⁵⁴ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Kodi i Etikës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve*, https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/kqz_220222_KODI_ETIKES-1.pdf.

⁸⁵⁵ Neni 14 i Kodit të Etikës.

⁸⁵⁶ Nenet 7, 10, 12-15 të Kodit të Etikës.

⁸⁵⁷ Shih https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/Akte-komisioneri/2021/03/DKFAB_210316_Urdher-nr.139-date-210316.pdf.

⁸⁵⁸ Neni 15 i Kodit të Etikës.

⁸⁵⁹ Neni 16, pika 1 e Kodit të Etikës.

⁸⁶⁰ Shih Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike, <https://www.ildkpkj.al/legjislacioni-section2-en/?lang=en> dhe Udhëzimin e ILDKPKI-së nr. 1, datë 27.6.2014 "Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit në institucionet publike.", <https://www.ildkpkj.al/gloosys/2018/11/UDH%C3%8BZUES-P%C3%8BR-AUTORITETET-P%C3%8BRJEGJ%C3%8BSE-2014.pdf>.

⁸⁶¹ Raportet vjetore të ILDKPKI-së japin të dhëna për zbatimin e legjislacionit për deklarimin dhe auditimin e pasurisë dhe për denoncimin. Raportet vjetore mund të aksesohen në: <https://www.ildkpkj.al/raporte-vjetore/>.

⁸⁶² Ligji nr. 8580, datë 17.02.2020 për Partitë Politike, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2000/02/17/8580>.

⁸⁶³ Nenet 91/2 (5) dhe 92/2 (2) të Kodit Zgjedhor

⁸⁶⁴ Neni 92/2, pika 2 Kodit Zgjedhor.

⁸⁶⁵ Neni 92/1, pika 2 Kodit Zgjedhor.

⁸⁶⁶ Neni 92/1 i Kodit Zgjedhor.

⁸⁶⁷ Neni 92/2, pika 4 Kodit Zgjedhor.

⁸⁶⁸ Neni 21 i Ligjit për Partitë Politike.

⁸⁶⁹ Neni 23/1 i Ligjit për Partitë Politike.

⁸⁷⁰ Neni 92 pika 6 e Kodit Zgjedhor.

⁸⁷¹ Neni 23 (5) i Ligjit për Partitë Politike.

⁸⁷² Ato përfshijnë mosdorëzimin e raporteve financiare në formatin e duhur, pranimin e donacioneve mbi 50,000 (480 euro) lekë shqiptare në rrugë të tjera përveç transferimeve bankare, shkeljen e dispozitave të financimit të fushatës nga personi përgjegjës për financat e subjektit zgjedhor dhe pengimin e procesit të verifikimit të KQZ-së.

⁸⁷³ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Zgjedhjet për Kuvend të vitit 2021 – Gjjobiten 14 subjekte zgjedhore", 7 dhjetor 2022, <https://kqz.gov.al/2022/12/07/zgjedhjet-per-kuvend-te-viti-2021-sanksione-administrative-per-14-subjekte-zgjedhore-dhe-49-oshma/>, aksesuar më 7 dhjetor 2022.

⁸⁷⁴ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Mbledhja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve", 7 dhjetor 2022, KQZ Faqja në Facebook, <https://www.facebook.com/KQZShqiperi/videos/668300301403290/>, aksesuar më 7 dhjetor 2022.

- ⁸⁷⁵ Intervistë e ekspertit zgjedhor me autorin, Tiranë, 25 janar 2023.
- ⁸⁷⁶ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Platforma e Raportimit Digjital, gjendet në <https://fpp.kqz.gov.al/kreu/reports>.
- ⁸⁷⁷ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Prezantohet Platforma Elektronike për Raportimin Financiar të Partive Politike", 5 prill 2023, <https://kqz.gov.al/2023/04/05/prezantohet-platforma-elektronike-per-raportimin-financiar-te-partive-politike/> aksesuar më 18.11.2023.
- ⁸⁷⁸ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Platforma Elektronike e Raportimit Financiar (PERF) – Trajnohen financiarët e subjekteve zgjedhore", 6 maj 2023, <https://kqz.gov.al/2023/05/06/platforma-elektronike-e-raportimit-financiar-perf-trajnohen-financieret-e-subjekteve-zgjedhore/> aksesuar më 18.11.2023.
- ⁸⁷⁹ Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Shqipërisë, 25 prill 2021*, (Varshavë: OSCE, 2021), f. 18.
- ⁸⁸⁰ Intervistë e përfaqësuesit të Departamentit Ligjor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me autorin, Tiranë, 24 janar 2023. Intervistë e ekspertit zgjedhor me autorin, Tiranë, 25 janar 2023.
- ⁸⁸¹ Klementina Cenkolari, "Fushata zgjedhore, partitë "fshehën" shpenzimet e mitingjeve dhe kandidatëve", Fakte.al, 2 nëntor 2021, <https://faktoje.al/fushata-zgjedhore-partite-fshehen-shpenzimet-e-mitingjeve-dhe-kandidateve/>.
- ⁸⁸² Besar Likmeta, "Partitë fshehën miliona euro shpenzime për propagandë elektorale në zgjedhje", *Reporter.al*, 23 nëntor 2021, <https://www.reporter.al/2021/11/23/partite-fshehen-miliona-euro-shpenzime-per-propagande-elektorale-ne-zgjedhje/>.
- ⁸⁸³ Neni 45, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>.
- ⁸⁸⁴ Bashkitë me shumicë të qytetarëve greke janë Dropulli dhe Finiqi. Bashkia me shumicë të qytetarëve maqedonas është ajo e Pustecit. Shih gjithashtu Ligjin nr. 115/2014 "Për ndarjet administrative dhe territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.", <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/07/31/115>.
- ⁸⁸⁵ Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Shqipërisë 25 prill 2021*, f. 22.
- ⁸⁸⁶ Neni 48 (2/ç), Kodi Zgjedhor.
- ⁸⁸⁷ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Ku është QV ime?", aksesuar më 15 shkurt 2023, <https://kqz.gov.al/ku-eshte-qv-ime/>.
- ⁸⁸⁸ Neni 56 (3), Kodi Zgjedhor.
- ⁸⁸⁹ Komiteti Shqiptar i Helsinkit, *Raport Përfundimtar mbi Gjetjet dhe Konkluzionet e Monitorimit të Zgjedhjeve Parlamentare për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë 25 prill 2021*, f. 1112.
- ⁸⁹⁰ Shih, për shembull, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, "Si votohet", aksesuar më 27 dhjetor 2022, <https://kqz.gov.al/si-votohet/>.
- ⁸⁹¹ Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Shqipërisë 25 prill 2021*, f.21.
- ⁸⁹² Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Shqipërisë 25 prill 2021*, f.8.
- ⁸⁹³ KRIIK, Deklarata e Gjetjeve dhe Konkluzioneve Paraprake, (Tiranë: KRIIK, 2021), f. 9, <https://kriik.al/home/wp-content/uploads/2021/04/KRIIK-StatementPreliminaryFindingsConclusionsParliamentElection21-210426.pdf>.
- ⁸⁹⁴ INSTAT, *Diaspora e Shqipërisë në Shifra*, (Tiranë: INSTAT, 2020), <http://www.instat.gov.al/media/7848/diaspora-ne-shifra-2020.pdf>.
- ⁸⁹⁵ Neni 25 i Kodit Zgjedhor, disponohet në <https://qbz.gov.al/preview/75122d2e-9ebc-45de-b0ea-b5efde2f6836>.
- ⁸⁹⁶ Neni 34 i Kodit Zgjedhor.
- ⁸⁹⁷ Neni 41 i Kodit Zgjedhor.
- ⁸⁹⁸ Neni 179 i Kodit Zgjedhor.
- ⁸⁹⁹ Shih Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, "Rregullat e veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve", https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/Vendime-Regullatori/2021/02/Vendim_Nr.012_201230_Per-miratimin-e-rregullave-te-veprimtarise-se-Policise-se-Shtetit-ne-sherbim-te-zgjedhjeve..pdf.
- ⁹⁰⁰ Intervistë e një përfaqësuesi të OSHC-ve të angazhuar në monitorimin e zgjedhjeve, Tiranë, 26 janar 2023.
- ⁹⁰¹ Neni 94 i Kodit Zgjedhor.
- ⁹⁰² Votat e grave shkelen në raste të rralla të votimit familjar. Intervistë e përfaqësuesit të OSHC-ve të angazhuara në monitorimin e zgjedhjeve, Tiranë, janar 2023.
- ⁹⁰³ Neni 67 pika 6 e Kodit Zgjedhor.

⁹⁰⁴ Neni 29 (1/ç) i Kodit Zgjedhor.

⁹⁰⁵ Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Shqipërisë 25 prill 2021*, f. 2.

⁹⁰⁶ Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Zgjedhjet Vendore të Republikës së Shqipërisë, 21 qershor 2015*, (Varshavë: OSCE, 2015), f. 2, <https://www.osce.org/files/f/documents/f/2/180731.pdf>.

⁹⁰⁷ Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Shqipërisë 25 prill 2021*, f. 11.

⁹⁰⁸ Neni 15 (1/d) i ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore", <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2008/07/24/9970>.

⁹⁰⁹ OSCE – ODIHR Deklarata e Gjetjeve dhe Konkluzioneve paraprake për Zgjedhjet Parlamentare, 25 prill 2021, f.5-6, <https://www.oscepa.org/en/documents/election-observation/election-observation-statements/albania/statements/4191-2021-parliamentary-3/file> aksesuar më 18 nëntor 2023.

⁹¹⁰ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Raporti për Veprimtarinë Vjetore 2021*, f. 17.

⁹¹¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Raporti për Veprimtarinë Vjetore 2021*, f. 41-44.

⁹¹² Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Shqipërisë 25 prill 2021*, f.7; Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Shqipërisë, 25 qershor 2017*, (Varshavë: OSCE, 2017), f. 6, <https://www.osce.org/files/f/documents/4/d/346661.pdf>.

⁹¹³ Shihni raportet e monitorimit të mediave të dorëzuara nga Autoriteti i Mediave Audio-vizive në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në: <https://kqz.gov.al/raporte/>. Shih gjithashtu Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Shqipërisë 25 prill 2021*, f.21.

⁹¹⁴ Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Shqipërisë 25 prill 2021*, f. 12.

⁹¹⁵ "Shqipëria voton mes bojkotit të opozitës", BBC, 30 qershor 2019, <https://www.bbc.com/news/world-europe-48763803>; "Opozita shqiptare kërcënon të bojkotojë zgjedhjet", *Euractiv*, 5 prill 2017, <https://www.euractiv.com/section/enlargement/news/albanian-opposition-threatens-to-boycott-elections/>.

⁹¹⁶ "Zgjedhjet e reja me problemet e vjetra! Kodi përfundoi, por çfarë "frutash" do të vjelim?", A2CNN, 2 tetor 2020, gjendet në https://a2news.com/video/zgjedhjet-e-reja-me-problemet-e-vjetra-kodi-perfundoi-por-çfare-frutash-do-te-vjelim/?fbclid=IwAR3oq2_5xia2wGho3eBxYGQRKXYFx3SjZU2ftSfoa3KcU6TVBtixgQoaWAw aksesuar më 18 nëntor 2023.

⁹¹⁷ Freedom House, Freedom in the World Report 2022: Shqipëri, gjendet në

<https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2023#:~:text=Albania%20has%20a%20record%20of,address%20corruption%20in%20the%20judiciary> aksesuar më 18 nëntor 2023.

⁹¹⁸ "Reformat zgjedhore në vendnumëro, 15 ndërhyrje në ligj dhe ende nevojiten ndryshime", *Faktoje.al*, 07 korrik 2022, gjendet në <https://faktoje.al/reformat-zgjedhore-ne-vendnumero-15-nderhyrje-ne-ligj-dhe-ende-nevojiten-ndryshime/>, aksesuar më 18 nëntor 2023.

⁹¹⁹ Ligji nr.10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012, ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015, ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020, ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020; një pikë e shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 28, datë 30.6.2021, një dënim i shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 31, datë 4.10.2021, gjendet në https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Kodi-Zgjedhor-2020_perditesuar1.pdf, aksesuar më 18 nëntor 2023.

⁹²⁰ *Ibid.*

⁹²¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Zgjedhjet vendore – Nis trajnimi i Policisë së Shtetit mbi detyrat dhe rolin e saj gjatë procesit zgjedhor", 6 mars 2023, gjendet në <https://kqz.gov.al/2023/03/06/zgjedhjet-vendore-nis-trajnimi-i-policise-se-shtetit-mbi-detyrat-dhe-rolin-e-saj-gjate-procesit-zgjedhor/>, aksesuar më 18 nëntor 2023.

AVOKATI I POPULLIT

PËRMBLEDHJE



Institucioni i Avokatit të Popullit është parashikuar në Kushtetutë dhe është caktuar si promotor i standardeve më të larta të drejtave dhe lirive të njeriut në përputhje me Kushtetutën, ligjet kombëtare dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.⁹²² Avokati i Popullit menaxhon çështjet që lidhen me shkeljen e të drejtave nga administrata publike, edhe pse fushëveprimi i tij nuk mbulon të gjithë ekzekutivin.⁹²³ Avokati i Popullit raporton drejtpërdrejt tek Kuvendi.⁹²⁴ Avokati i Popullit zgjidhet me shumicë votash nga tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje,⁹²⁵ me Zyrën e Avokatit të Popullit të ndarë në pesë seksione të specializuara, me në krye Komisionerin përkatës të zgjedhur nga Kuvendi nga kandidatët e propozuar nga Avokati i Popullit.⁹²⁶ Përfaqësuesit vendorë mund të emërohen sipas nevojës, ndërsa institucionet e qeverisjes vendore ofrojnë lehtësirat dhe kushtet e nevojshme.⁹²⁷

Avokati i Popullit gëzon një mandat kushtetues të përshatshëm për të promovuar të drejtat e njeriut dhe për të parandaluar shkeljet dhe kufizimet e pajustificueshme.⁹²⁸ Pavarësisht kuadrit ligjor, veprimtaria e Avokatit të Popullit pengohet nga burimet e pamjaftueshme financiare dhe njerëzore (seksioni 8.1.1), mosreagimi në kohë i organeve të administratës publike dhe shkalla e ulët e zbatimit të rekomandimeve të tij (seksioni 8.3.1). Avokati i Popullit ka kërkuar vazhdimisht më shumë mbështetje nga Ekzekutivi dhe Kuvendi për të kryer detyrat e tij, por shpesh janë hedhur poshtë kërkesat e tij.⁹²⁹ Mirëfunksionimi i institucionit pengohet herë pas here nga ngërçet politike, veçanërisht në lidhje me emërimin e Avokatit të

Popullit.⁹³⁰ Edhe pse nuk njihet gjerësisht nga qytetarët, Avokati i Popullit gëzon një nivel të lartë të besimit publik.⁹³¹

Një ndër mangësitë e vazhdueshme është zbatimi i pamjaftueshëm i rekomandimeve të tij nga administrata publike, pavarësisht thirrjeve të shpeshta për tu zbatuar rregullisht. Si rezultat, Avokati i Popullit has vështirësi në garantimin e llogaridhënies institucionale publike (neni 8.3.1).

KAPACITETET

TREGUESI 8.1.1 BURIMET (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase ka Avokati i Popullit burime adekuate për të arritur qëllimet e tij në praktikë?



Avokati i Popullit ka burime të moderuara financiare dhe njerëzore. Buxheti i institucionit dhe numri i anëtarëve të stafit të tij aktualisht janë të pamjaftueshëm për të përmbushur plotësisht përgjegjësitë e tij të caktuara.

Buxheti i Avokatit të Popullit është rritur në mënyrë graduale që nga viti 2014.⁹³² Megjithatë, buxheti pësoi një rënie në vitin 2020⁹³³ për shkak të krizës së COVID-19 përpara se të kthehej në trajektoren e vet rritëse në 2021 (Tabela 2). Gjatë riakreditimit të Avokatit të Popullit në vitin 2020, Nën-Komiteti i Akreditimit të Aleancës Globale të Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut vuri në dukje se niveli i financimit është i pamjaftueshëm që institucioni të kryejë funksionet e tij, si në aspektin e mbajtjes së stafit ashtu edhe shtatë zyrave të veta

Tabela 2: Ndarja e buxhetit për Avokatin e Popullit për periudhën 2014-2023

Viti	Shuma në lekë	Shuma në Euro (përafërsisht)
2023	138.000.000	1.314.285
2022	129.200.000	1.230.476
2021	119.000.000	1.133.333
2020	116.500.000	1.109.523
2019	125.100.000	1.191.428
2018	116.000.000	1.104.761
2017	106.500.000	1.014.285
2016	105.578.000	1.005.504
2015	95.500.000	909.523
2014	95.500.000	909.523

rajonale.⁹³⁴ Kjo ndikon në aftësinë e tij për të menaxhuar siç duhet të gjitha rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut.⁹³⁵

Avokati i Popullit kontribuon në kërkesat e tij për hartimin e buxhetit, por shpeshherë këto kërkesa mbeten të pa adresuara. Në disa raste, kërkesa e Avokatit të Popullit për rritjen e kapacitetit të burimeve njerëzore të institucionit u hodh poshtë nga Kuvendi.⁹³⁶ Gjatë diskutimit për kërkesën buxhetore për vitin 2022, Komisioni parlamentar për Administratën Publike u shpreh se është e pamundur të sigurohen mjete për tre ndihmës komisionerët e rinj, pavarësisht se Avokati i Popullit argumentoi se nuk janë miratuar kapacitete shtesë të burimeve njerëzore që nga viti 2016.⁹³⁷ Numri i stafit të tij u rrit nga 56 në 2016 në 59 në 2023, me rritje graduale të një anëtarë shtesë të stafit në 2022 dhe dy në 2023.⁹³⁸ Avokati i Popullit pranoi në vitin 2023 se efektiviteti i ushtrimit të mandatit të tyre ishte komprometuar për shkak të numrit të kufizuar të anëtarëve të stafit në lidhje me detyrat që u kërkohet të kryejnë.⁹³⁹ Avokati i Popullit përfiton nga mbështetja e donatorëve të huaj, kryesisht përmes programeve të ngritjes së kapaciteteve dhe jo përmes kontributeve të drejtpërdrejta në buxhetin e tij.⁹⁴⁰ Sipas marrëveshjeve me Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) dhe Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), Avokati i Popullit asistohet nga katër

ekspertë të jashtëm që punojnë përkatësisht në monitorimin e operacioneve të emigrantëve në pikat kufitare dhe asistimin e seksionit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.⁹⁴¹ Që nga viti 2022, Avokati i Popullit është përfitues i një projekti të financuar nga BE-ja, me në fokus përmirësimin e proceseve të brendshme, identifikimin e kërkesave për trajnim dhe kryerjen e seminareve trajnuese për menaxhimin e ankesave.⁹⁴² Megjithatë, financimi nga donatorët e huaj nuk duhet të kompensojë mungesën e fondeve adekuate operacionale nga buxheti i shtetit.

Rregullorja e brendshme e Avokatit të Popullit përfshin një dispozitë për trajnimin e stafit,⁹⁴³ por programi i trajnimit dhe treguesit shtjellohen në vijim në Planin e tij Strategjik.⁹⁴⁴ Zyra e Avokatit të Popullit përfiton rregullisht nga partnerët dhe rrjetet ndërkombëtare që ofrojnë mundësi trajnimi për stafin e tij. Vitin e kaluar, anëtarët e stafit morën pjesë në sesione trajnimi me fokus në treguesit gjinorë për monitorimin e të drejtave të njeriut, aftësitë e komunikimit, të drejtat e fëmijëve, përdorimin e softuerit për menaxhimin e ankesave dhe trajnimin për vëzhguesit e përfshirë në operacionet e kthimit të detyruar të migrantëve. Gjithashtu, stafi trajnohet nga Shkolla e Administratës Publike dhe përmes bashkëpunimeve të ndryshme me shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare. Edhe pse punësimi i stafit të

Avokatit të Popullit bëhet sipas rregulloreve të shërbimit civil që lehtësojnë përparimin në karrierë dhe transferimet brenda shërbimit, ky proces ushtron presion mbi burimet e tyre njerëzore, pasi rezulton në vende të lira pune për shkak të largimeve të stafit në role të tjera në administratën publike, duke bërë të nevojshme një proces të gjatë rekrutimi të parashikuar me ligj për zëvendësimin e tyre.

TREGUESI 8.1.2 PAVARËSIA (LIGJI)

Në çfarë mase është i pavarur me ligj Avokati i Popullit?



Ekziston një kuadër i fortë ligjor që garanton pavarësinë e Avokatit të Popullit. Megjithatë, vazhdojnë të mbeten boshllëqe të vogla, si mungesa e dispozitave të qarta që parandalojnë direktivat e qeverisë, të cilat mund t'i lënë vend ndikimit të jashtëm të paarsyeshëm.

Pavarësia e Avokatit të Popullit ruhet në Kushtetutë⁹⁴⁵ dhe në ligjin e tij për Avokatin e Popullit.⁹⁴⁶ Sipas dispozitave kushtetuese,⁹⁴⁷ Avokati i Popullit është i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, ndërsa ligji organik i tij pohon se Avokati i Popullit drejtohet, ndër të tjera, nga parimi i pavarësisë.⁹⁴⁸

Avokati i Popullit emërohet nga shumica e kualifikuar e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.⁹⁴⁹ Kriteret për zgjedhjet janë të sakta dhe kërkojnë ekspertizën e duhur për çështjet e të drejtave të njeriut në mënyrë që kandidati të merret parasysh.⁹⁵⁰ Fakti që mandati i lejon Avokatit të Popullit të mbajë postin e tij më gjatë se sa periudha në Kuvend që drejton procesin e emërimit ndihmon në zbutjen e çdo tensioni të mundshëm ndërmjet institucioneve.

Në lidhje me veprimtarinë e ndaluar, Avokati i Popullit nuk mund të bëjë pjesë në asnjë parti politike, nuk mund të kryejë veprimtari tjetër politike apo profesionale dhe nuk mund të mbajë poste të tjera publike dhe as të marrë pjesë në organet

drejtuese të organizatave shoqërore, ekonomike dhe tregtare.⁹⁵¹ Megjithëse pasqyron të njëjtin standard, ligji organik përcakton se Avokati i Popullit mund të angazhohet në veprimtari si autor ose profesor.⁹⁵² Kufizime të ngjashme vlejné edhe për komisionerët, por ata emërohen nga shumica pas konsultimit me shoqërinë civile.⁹⁵³

Avokati i Popullit zgjidhet për një mandat pesëvjeçar dhe gëzon të drejtën për t'u zgjidhur përsëri.⁹⁵⁴ Paga e tyre është e njëjtë me pagën e Kryetarit në Gjykatës e Lartë⁹⁵⁵ dhe gëzojnë imunitet të njëjtë me atë të gjykatësit në Gjykatës e Lartë.⁹⁵⁶ Avokati i Popullit shkarkohet me shumicë të kualifikuar sipas kërkesës së arsyetuar nga të paktën një e treta e Kuvendit dhe ligji organik parashikon arsytet për shkarkim.⁹⁵⁷ Si masë mbrojtëse shtesë, menjëherë pas përfundimit të mandatit të tij, Avokati i Popullit gëzon të drejtën të vazhdojë postin publik që ka mbajtur para emërimit, ose një post të ngjashëm.⁹⁵⁸

Masat mbrojtëse legjislative për pavarësinë e Avokatit të Popullit janë vlerësuar shumë lart në raportin e monitorimit të OECD-së për Shqipërinë.⁹⁵⁹ Mirëpo, studime të tjera pohojné për faktin se ligji që nuk ndalon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në mënyrë të qartë udhëzimet nga qeveria mund të krijojë shtigje të mundshme për ndërhyrje.⁹⁶⁰

Struktura organizative dhe institucionale themelohet nga Avokati i Popullit në mënyrë të pavarur.⁹⁶¹ Kjo bën të mundur që institucioni të ruajë fleksibilitetin dhe të përshtatë strukturën në bazë të prioriteteve të tij. Vendet e lira plotësohen në bazë të dispozitave të Ligjit për Nëpunësit civilë, i cili i kalon procedurat e rekrutimit tek vetë institucionet e pavarura. Megjithatë, detyra e Avokatit të Popullit, siç është paraqitur në Planin e saj Strategjik, e pranon rrezikun e mundshëm që stafi teknik mund të emërohet në bazë të përkrahjes politike.⁹⁶²

TREGUESI 8.1.3 PAVARËSIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase është Avokati i Popullit i pavarur në praktikë?



Avokati i Popullit nuk përballet me ndërhyrje të mëdha të qeverisë gjatë mandatit të tij dhe shmanget nga përfshirja në veprimtari të ndaluara politike, por politizimi i vazhdueshëm i procesit të emërimit nga partitë politike përbën një kërcënim të vazhdueshëm për natyrën jopartiake të institucionit.

Avokati i Popullit në detyrë u zgjodh në vitin 2017 si pjesë e një marrëveshjeje politike dypartiake⁹⁶³ e cila trajtoi një situatë pa rrugëzgjdhje dhe të gjatë politike.⁹⁶⁴ Një nga dispozitat e marrëveshjes cilësonte se partia kryesore e opozitës do të emëronte Avokatin e Popullit dhe kreun e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Duke vepruar në këtë mënyrë, anashkaloi hapat e parashikuar në procesin e konsultimit, të cilat zakonisht përfshijnë qytetarët e përshtatshëm që paraqesin kandidaturën e tyre me anë të një ftese publike, e ndjekur nga komisioni i çështjeve ligjore të Kuvendit që kryen vlerësimet e kandidatëve dhe paraqet nominimet.⁹⁶⁵ Devijimi nga procedura standarde thekson sesi politika e përditshme shpeshherë mund të ndërhyjë në procesin e emërimit të një institucioni të pavarur, duke ndikuar kështu në pavarësinë dhe e jo të qenit partiak.⁹⁶⁶

Nuk ekzistojnë raste të njohura në publik të ndikimit të qeverisë në veprimtarinë e Avokatit të Popullit për të imponuar një veprim ose mosveprim ose përfshirje të Avokatit të Popullit në ndonjë veprimtari të ndaluar politike që mund të ndikojë në pavarësinë e tyre. Shpeshherë përfaqësuesit e shoqërisë civile diskutojnë se kjo mund të ndodhë për shkakun se dega e organit ekzekutiv nuk ndihet e kërcënuar nga veprimet e Avokatit të Popullit, që reflektohet në shkallën e ulët të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.⁹⁶⁷ Përveç kësaj, nuk janë raportuar raste të zbuluara për shkelje të konfidencialitetit apo ankesa.

Mandati i është rinovuar vetëm Avokatit të Popullit të parë (2000-2010), ndërsa rinovimi i mandatit të komisionerëve ndodh më shpesh.⁹⁶⁸ Ndonëse procesi për shkarkimin e Avokatit të Popullit është relativisht i drejtpërdrejtë, nuk ka pasur raste të zgjidhjes së parakohshme nga detyra të Avokatit të Popullit nga Kuvendi, gjë që tregon për një mandat të qëndrueshëm për këtë detyrë.

QEVERISJA

TREGUESI 8.2.1 TRANSPARENCA (LIGJI)

Deri në çfarë mase ekzistojnë dispozita për të siguruar që publiku të mund të marrë informacionin përkatës mbi aktivitetet dhe proceset vendimmarrëse të Avokatit të Popullit?



Ekzistojnë dispozita gjithëpërfshirëse të cilat i mundësojnë publikut të marrë informacion për organizimin dhe funksionimin e Avokatit të Popullit për vendimet që kanë të bëjnë me të dhe mënyrën se si janë marrë këto vendime.

Në bazë të ligjit, Avokati i Popullit publikon raportet vjetore dhe të posaçme, rezolutën e Kuvendit dhe çdo reagim tjetër të Kuvendit ndaj raportit vjetor.⁹⁶⁹ Raportet vjetore publikohen pasi të diskutohen në Kuvend ose jo më vonë se tre muaj pas dorëzimit të tyre. Informacioni i mundësuar në raportin vjetor duhet t'i përmbahet standardit të parashikuar në manualin e monitorimit të Kuvendit për institucionet e pavarura kushtetuese.⁹⁷⁰ Informacioni për veprimtarinë e Avokatit të Popullit është i aksesueshëm edhe nëpërmjet Ligjit për të Drejtën e Informimit.⁹⁷¹ Konfidencialiteti është një parim themelor i Avokatit të Popullit.⁹⁷² Në rastet e ankesave, konfidencialiteti duhet të ruhet nëse gjykohet përshtatshme nga Avokati i Popullit ose nëse kërkohet nga ankuesi.⁹⁷³ Klauzolat e konfidencialitetit shtjellohen në mënyrë të hollësishme në rregulloren e brendshme.

Avokati i Popullit dhe personeli i lartë duhet t'i dorëzojnë ILDKPKI-së deklaratatë të vazhdueshme për

pasurinë. Platforma në të cilën duhet të publikohen deklaratat është akoma jofunksionale. Mirëpo, deklaratat e pasurisë mund të zbulohen sipas kërkesës dhe Avokati i Popullit nuk i publikon në mënyrë vullnetare deklaratat e tyre të pasurisë. Avokati i Popullit bashkëpunon ngushtësisht me organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe kërkohet të marrë opinionin e tyre mbi çështjet për të drejtat e njeriut.⁹⁷⁴ Për më tepër, duke bashkëpunuar me shoqërinë civile Avokati i Popullit organizon një konferencë vjetore kombëtare për situatën e të drejtave të njeriut dhe lirive të qytetarëve. OShC-të duhet të konsultohen si pjesë e procesit të rekrutimit të komisionerëve.⁹⁷⁵

TREGUESI 8.2.2 TRANSPARENCA (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase ka transparencë në aktivitetet dhe proceset vendimmarrëse të Avokatit të Popullit në praktikë?



Megjithëse Avokati i Popullit mundëson informacion të aksesueshëm për organizimin dhe funksionimin e institucionit, informacioni dhe statistikën nuk përditësohen në mënyrë të rregullt.

Seksioni i transparencës në faqen e internetit të Avokatit të Popullit mundëson informacion gjithëpërfshirës, ndër të tjera, për buxhetin e tij, duke përfshirë pagën dhe stafin, procedurat e prokurimit publik dhe rekrutimit, raportet e monitorimit, regjistrin e ankesave, regjistrin e rekomandimeve, informacion të përgjithshëm për institucionin dhe informacione të tjera që gjykohen të rëndësishme për publikim.⁹⁷⁶ Mirëpo, seksioni i transparencës nuk përditësohet në mënyrë të vazhdueshme me informacione të viteve të fundit. Shumica e informacionit mundësohet edhe në gjuhën angleze. Zakonisht, Avokati i Popullit i përbahet afateve ligjore duke i publikuar raportet e tij vjetore dhe të posaçme në faqen e tij të internetit, ku ato janë të organizuara mirë në një seksion të dedikuar për aksesim të lehtë. Avokati i Popullit filloi të publikojë statistikën për rastet e

trajtuar, duke përfshirë shpërndarjen gjeografike, numrin specifik të rasteve dhe rekomandimet e dhëna organeve të administratës publike në vitin 2017 dhe 2020, por kjo praktikë nuk vazhdoi rregullisht gjatë viteve të tjera.⁹⁷⁷

Avokati i Popullit ka miratuar një program transparence që specifikon se çfarë informacioni duhet të jetë në dispozicion të publikut pa pasur nevojë për kërkesë dhe si duhet të ndahet me publikun, por programi nuk bëhet publik. Është caktuar një koordinator për të drejtën e informimit dhe informacioni i kontaktit të tyre aksesohet lehtësisht.

Bashkëpunimi me shoqërinë civile është përgjithësisht konstruktiv. Gjatë intervistës, Avokati i Popullit pohoi se ata konsultohen vazhdimisht me ekspertë dhe përfaqësues të shoqërisë civile gjatë procesit të hartimit të raporteve vjetore/të posaçme dhe publikimeve të tjera.⁹⁷⁸ Bashkëpunimi vihet re edhe në zbatimin e projekteve të përbashkëta, dhënien e nismave ligjore, koordinimin e fushatave advokuese dhe ndërgjegjësuere dhe mbajtjen e komunikimit për çështjet ndërsektoriale. Avokati i Popullit ka finalizuar disa memorandume mirëkuptimi me OShC-të. Mirëpo, dyshohet se bashkëpunimi ndërmjet Avokatit të Popullit dhe shoqërisë civile nuk është i rregullt apo i mirë strukturuar.⁹⁷⁹ Vlen të përmendet fakti se grupet dhe lëvizjet joformale mbështeten në mënyrë të vazhdueshme nga shërbimi i Avokatit të Popullit, qoftë duke ofruar ekspertizën apo hapjen e çështjeve me iniciativë të vet.⁹⁸⁰

TREGUESI 8.2.3 LLOGARIDHËNIA (LIGJI)

Deri në çfarë mase ekzistojnë dispozita për të siguruar që Avokati i Popullit duhet të raportojë dhe të jetë përgjegjës për veprimet e tij?



Ekzistojnë dispozita gjithëpërfshirëse për të siguruar që Avokati i Popullit të raportojë dhe të mbajë përgjegjësi për veprimet e tyre.

Avokati i Popullit duhet të mbajë përgjegjësi përpara Kuvendit. Kuvendi duhet të rishikojë dhe miratojë mandatin, buxhetin dhe strukturën drejtuese të Avokatit të Popullit.⁹⁸¹ Avokati i Popullit kërkohet në mënyrë ligjore që të raportojë të paktën çdo vit në Parlament, duke siguruar një raport që përshkruan veprimtarinë e institucionit për vitin aktual.⁹⁸²

Raportet vjetore janë subjekt i shqyrtimit parlamentar, qoftë në agjendën e seancave plenare të Kuvendit ose të Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.⁹⁸³

Raporti vjetor duhet të dorëzohet përpara datës 30 prill të vitit pasues dhe duhet t'i dërgohet një kopje Presidentit të Republikës dhe Këshillit të Ministrave.⁹⁸⁴ Pas diskutimeve për raportin, Kuvendi duhet të miratojë një rezolutë që përmban rekomandime për çështjet kryesore për përmirësim të mëtejshme.⁹⁸⁵ Për më tepër, Avokati i Popullit mund të dorëzojë raporte të posaçme për çështje të ndryshme brenda kompetencave të tij, nëse kërkohet nëpërmjet një kërkesë me shkrim të Kryetarit të Parlamentit ose të një grupi deputetësh ose prej nismës së tyre.⁹⁸⁶ Debati për raportin vjetor duhet të zhvillohet brenda tre muajve që nga dorëzimi i tij, por periudha kohore për raportet e posaçme është dy muaj.⁹⁸⁷ Në rast se Kuvendi nuk respekton periudhën kohore, Avokati i Popullit mund të publikojë raportin vjetor me nismën e tij.⁹⁸⁸

Instrumentet e tjera mbikëqyrëse të Kuvendit përfshijnë interpelancat plenare, pyetjet me gojë dhe me shkrim, si dhe krijimin e komisioneve hetimore për çështje specifike që lidhen me punën e Avokatit të Popullit. Në lidhje me auditimet financiare dhe të performancës, Avokati i Popullit jep llogari para KLSH-së⁹⁸⁹ dhe i kërkohet të dorëzojë të dhënat për⁹⁹⁰ të ardhurat dhe pagesat që burojnë nga donacionet në KLSH dhe në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave.

Gjykatat kanë autoritetin të kontrollojnë dhe vlerësojnë të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës së institucionit. Dispozitat e Ligjit për sinjalizimin janë të zbatueshme për personelin e Avokatit të Popullit.⁹⁹¹

TREGUESI 8.2.4 LLOGARIDHËNIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase Avokati i Popullit raporton dhe është përgjegjës për veprimet e tij në praktikë?



Megjithëse Avokati i Popullit duhet të raportojë dhe të japë llogari për veprime të caktuara përmes raportit të tij vjetor, mekanizmi i shqyrtimit nga Kuvendi shpeshherë është sipërfaqësor dhe nuk arrin të analizojë nevojat financiare dhe burimet njerëzore të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit kryesisht angazhohet me Kuvendin nëpërmjet diskutimeve në komisionin legjislativ parlamentar për raportin vjetor, ku Avokati i Popullit nuk i paraqet raportet në seancat plenare. Raporti vjetor mbulon trajtimin e ankesave nga ana e Avokatit të Popullit, rekomandimet e dërguara për organet e administratës publike dhe shkallën e zbatimit të tyre, progresin në rezolutat e Kuvendit dhe çështjet e menaxhimit të brendshëm.⁹⁹² Raporti vjetor i vitit 2021 është dorëzuar sipas afatit,⁹⁹³ por raporti i vitit 2022 është dorëzuar dy ditë pas afatit.⁹⁹⁴

Mirëpo, diskutimi për raportin vjetor është thjesht sipërfaqësor dhe nuk arrin të kryejë një analizë të thellë për sfidat, nevojat dhe prioritetet e institucionit.⁹⁹⁵ Veçanërisht, i mungon vlerësimi i duhur i boshllëqeve dhe mangësive në burimet e duhura financiare dhe njerëzore të Avokatit të Popullit për të kryer mandatin e tyre. Kuvendi kryen një vlerësim të performancës së Avokatit të Popullit pas shqyrtimit të raportit vjetor nga komisioni i tij legjislativ, por rekomandimeve të tij u mungon një plan i qartë për monitorimin e rregullt të zbatimit të tyre.⁹⁹⁶

Të dhënat tregojnë se Kuvendi nuk e shfrytëzon plotësisht gamën e gjerë të instrumenteve të mbikëqyrjes që disponon dhe se deputetët mbështeten në mënyrë ekskluzive në raportimin vjetor.⁹⁹⁷ Bazuar në një sondazh të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në Shqipëri, deputetët rrallëherë marrin pjesë në seancat ku institucionet e pavarura paraqesin rekomandime

ligjore, seanca për emërimin e drejtuesve apo sesione të planifikimit financiar. Mirëpo, Avokati i Popullit angazhohet më shumë në raportimin vjetor të veprimtarive, në veprimtaritë e monitorimit të zbatimit të rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve të bëra nga kjo e fundit.⁹⁹⁸ Megjithatë, deputetët pohojnë se komunikimi ndërmjet Kuvendit dhe institucioneve të pavarura, duke përfshirë Avokatin e Popullit, shihet si transparent dhe mbështetës.⁹⁹⁹

Në lidhje me politikën e sinjalizimit, përgjegjësia e Avokatit të Popullit për të mbrojtur sinjalizuesit është e mirë vendosur në parimet e konfidencialitetit të përshkruara në ligjin organik dhe në rregullat brenda rregulloreve të brendshme të institucionit.¹⁰⁰⁰

TREGUESI 8.2.5 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (LIGJI)

Deri në çfarë mase ekzistojnë dispozita për të garantuar integritetin e Avokatit të Popullit?

Rezultati 100

Janë zbatuar masa gjithëpërfshirëse për të mbrojtur integritetin e Avokatit të Popullit, duke përfshirë krijimin e një kodi të brendshëm që garanton pavarësinë dhe paanshmërinë, bashkë me dispozitat që lidhen me prirjet, konfliktin e interesit dhe konfidencialitetin e komunikimit. Përveç kësaj, Avokati i Popullit është subjekt i kufizimeve në përfshirjen politike.

Kodi i Sjelljes së Mirë Administrative, i miratuar dhe publikuar nga Avokati i Popullit, përshkruan standardet për sjelljen etike dhe sjelljen profesionale që duhet të ndjekin të gjithë punonjësit, personat e kualifikuar dhe partnerët e jashtëm të institucionit.¹⁰⁰¹ Kodi nxjerr në pah parime si mosdiskriminimi, proporcionaliteti, shmangia e abuzimit të pushtetit, pavarësia, paanshmëria, objektiviteti, pritshmëria ligjore, qëndrueshmëria dhe drejtësia. Dispozitat e Kodit rregullojnë mbrojtjen e informacionit personal, detyrimet e konfidencialitetit, konfliktet e

mundshme të interesit dhe komunikimin e brendshëm. Çdo shkelje çon në masë disiplinore siç përcaktohet në Ligjin për Statusin e Nëpunësve Civil, rregulloren e brendshme të institucionit ose kontratën e punës. Kodi i kërkon personelit të zbulojë menjëherë çdo konflikt interesi që mund të ndikojë në paanshmërinë e tyre.

Avokati i Popullit mund të pranojë donacione përderisa ato nuk cenojnë pavarësinë, paanshmërinë dhe funksionin e duhur të tyre.¹⁰⁰² Detajet e hollësishme të donacioneve regjistrohen në një regjistër të posaçëm, i cili përfshin informacion për llojin e donacionit, shumën, datën, identitetin dhe nënshkrimin e donatorit dhe mënyrën e dorëzimit.¹⁰⁰³ Avokati i Popullit duhet t'i dorëzojë KLSH-së dhe Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave një kopje të regjistrit në fund të çdo viti.¹⁰⁰⁴

Kodi nuk parashikon shprehimisht kufizime për përfshirjen në politikë, por këto dispozita parashikohen në ligjin organik i cili thotë se Avokati i Popullit nuk lejohet të marrë pjesë në parti politike apo ndonjë grup social, ekonomik apo biznesi. Personeli nuk lejohet të bëjë asnjë punë tjetër, me pagesë ose pa pagesë, në asnjë subjekt publik, privat ose jofitimprurës.¹⁰⁰⁵ Megjithatë, ata mund të jenë profesorë, të fitojnë para nga të drejtat e autorit ose të marrin pjesë si folës në ngjarje. Personeli duhet t'i ruajë informacionet konfidenciale, por duhet të respektojë dispozitat e Ligjit për të Drejtën e Informimit.¹⁰⁰⁶

TREGUESI 8.2.6 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase sigurohet integriteti i Avokatit të Popullit në praktikë?

Rezultati 75 | 100

Avokati i Popullit ka hartuar një kod të brendshëm të përshtatshëm të sjelljes për të ruajtur integritetin e personelit të tij, me prova të zbatimit në rastet e sjelljes së pahijshme. Për më tepër, ai ofron trajnime të

vazhdueshme për etikën. Mirëpo, nuk ekzistojnë raporte zyrtare që lidhen me zbatimin e legjislacionit për të parandaluar konfliktin e interesit.

Strukturës organizative të Avokatit të Popullit i mungon një departament i posaçëm për trajtimin e çështjeve etike dhe përgjegjësia për trajtimin e rasteve të mundshme të konfliktit të interesit i është caktuar kryesisht njësisë së burimeve njerëzore. Avokati i Popullit raportoi se nuk ka pasur raste të raportimit të konfliktit të interesit dhe se regjistri i donacioneve përditësohet.¹⁰⁰⁷ Standardet etike respektohen duke zbatuar kodin e brendshëm të sjelljes. Avokati i Popullit pohon se në vitin 2021 ka pasur dy raste të shkeljes së Kodit të Sjelljes së Mirë Administrative. Në zgjedhje morën pjesë dy punonjës të personelit duke kundërshtuar dispozitat e Kodit dhe me udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në të dyja rastet, personeli mori një paralajmërim zyrtar.¹⁰⁰⁸

Në 2019, Avokati i Popullit miratoi një Strategji të re për Menaxhimin e Riskut me qëllim të ngulitjes së një kulture në dijeni të riskut në të gjithë organizatën. Strategjia siguron një qasje të strukturuar për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve dhe inkurajon rishikime dhe vlerësime të vazhdueshme për të nxitur zhvillimin.¹⁰⁰⁹ Personeli i Avokatit të Popullit u bë subjekt i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve me vëmendje ndaj rritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët.¹⁰¹⁰ Ky trajnim përfshinte tema për integritetin dhe etikën, siç u përmend në intervistë.¹⁰¹¹

TREGUESI 8.2.7 NDJESHMËRIA GJINORE

Deri në çfarë mase janë mekanizmat e Avokatit të Popullit të ndjeshëm ndaj gjinisë?



Protokollet dhe udhëzimet që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore janë kryesisht të pranishme në procesin e hartimit të buxhetit dhe ndonëse Avokati i Popullit mbledh të dhëna të ndara sipas gjinisë për

ankesat e pranuar, ata nuk kryejnë analiza dhe publikohen vetëm një pjesë e kufizuar statistikash të ndara sipas gjinisë.

Mekanizmat e ankesës dhe hetimit të Avokatit të Popullit nuk kanë protokolle dhe udhëzime të qarta që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore. Avokati i Popullit mbledh të dhëna për ankesat për shkelje të të drejtave, duke i ndarë ato sipas gjinisë dhe llojit të së drejtës.¹⁰¹² Mirëpo, ai nuk kryen analiza sipas gjinisë në bazën e të dhënave të tyre apo kohët e përpunimit sipas gjinisë.¹⁰¹³ Përveç kësaj, faqja e internetit e institucionit mundëson statistika të ndara sipas gjinisë për rekomandimet e tij.¹⁰¹⁴

Personeli u trajnuar mbi parimet e barazisë gjinore dhe buxhetimin gjinor.¹⁰¹⁵ Avokati i Popullit zhvilloi trajnime duke bashkëpunuar me institucionin kombëtar të statistikave (INSTAT) mbi përdorimin e treguesve gjinorë për monitorimin e të drejtave të njeriut.¹⁰¹⁶

Avokati i Popullit inkorporon parimet e buxhetimit gjinor në procesin e hartimit të buxhetit,¹⁰¹⁷ me vëmendje ndaj monitorimit dhe auditimit e politikave me bazë gjinore gjatë zbatimit të buxhetit.¹⁰¹⁸ Në mënyrë që të monitorojë dhe inkurajojë institucionet e tjera qendrore dhe vendore që të ndjekin parimet e buxhetimit gjinor, Avokati i Popullit po punon për hartimin e një raporti mbi buxhetimin për trajtimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Shqipëri.¹⁰¹⁹

ROLI

TREGUESI 8.3.1 HETIMI

Sa është Avokati i Popullit aktiv dhe efektiv në trajtimin e ankesave nga publiku?



Avokati i Popullit ka qëllim të trajtojë ankesat publike, të marrë përsipër çështjet në mënyrë të pavarur, të kryejë inspektime, të bashkëpunojë me grupe joformale, të bëjë sugjerime legjislative dhe të rrisë dukshmërinë e tij. Mirëpo, efektiviteti i tij vështirësohet

nga mossauesi i vazhdueshëm i administratës publike për të ndjekur rekomandimet e tij dhe mungesa e ndërgjegjësimit publik për rolin e tij.

Avokati i Popullit pranon ankesa nga individë ose OShC-të, merr përsipër çështjet me nismën e tij dhe kryen inspektime në institucionet publike. Ankesat nuk kërkojnë një format specifik¹⁰²⁰ dhe mund të dorëzohen në zyrën e recepsionit dhe shërbimeve në Tiranë dhe në shtatë zyrat rajonale.¹⁰²¹ Në mënyrë që të lehtësojë procedurën, Avokati i Popullit ka nxjerrë një manual¹⁰²² për mekanizmin e trajtimit të ankesave, i cili synon standardizimin e procedurave të brendshme.¹⁰²³ Në vitet 2020 dhe 2021, pandemia pengoi funksionimin normal të sistemit. Mirëpo, Avokati i Popullit raporton se pavarësisht ndërprerjes së pjesshme të shërbimit të drejtpërdrejtë për qytetarët, ankesat mund të dërgohen nëpërmjet postës së rregullt, email-it ose aplikacionit celular të institucionit.¹⁰²⁴ Në 2021, 9.6 për qind e ankesave janë dorëzuar nëpërmjet aplikacionit.¹⁰²⁵

Vazhdon duke u rritur kërkesa e qytetarëve për më shumë ndërhyrje nga Avokati i Popullit. Në 2021 janë dorëzuar gjithsej 5837 kërkesa, që shënon numrin më të madh të çështjeve në të gjitha kohët.¹⁰²⁶ Nga totali, 1170 kërkesa ishin në juridiksionin e Avokatit të Popullit, 460 çështje janë shqyrtuar për shkak të detyrës zyrtare në bazë të indikacioneve të mediave dhe 19 çështje jashtë juridiksionit të tij. Avokati i Popullit ofron këshilla dhe udhëzime për hapat e mëtejshëm ligjor për 4188 çështje të tjera.¹⁰²⁷ Hetimet administrative kanë përfunduar për 1933 çështje, edhe pse më shumë se gjysma ishin çështje të mbartura nga vitet e mëparshme.¹⁰²⁸

Avokati i Popullit mund të japë rekomandime legislative jo të detyrueshme dhe mund të ndikojë në politikën e qeverisë nëpërmjet rekomandimeve dhe publikimeve të tij. Në këtë aspekt, Avokati i Popullit mund të dorëzojë raporte të posaçme në Kuvend, por në zbatim ato rrallëherë diskutohen në seancat plenare (shih 8.2.4).¹⁰²⁹ Raportet e Komisionit Evropian në mënyrë të vazhdueshme theksojnë se administrata nuk arrin të zbatojë në mënyrë të rregullt rekomandimet e Avokatit të

Popullit. Shkalla e zbatimit është akoma e ulët dhe ka rënë në vitet e fundit, duke arritur në vetëm 50 për qind në vitin 2021.¹⁰³⁰ Kuvendi nuk arrin të promovojë shkallë më të lartë të zbatimit nga organi ekzekutiv, pavarësisht krijimit të një Platformë Ndërinstitucionale Online për të vëzhguar zbatimin nga administrata publike të rekomandimeve të institucioneve të pavarura mbikëqyrëse, përfshirë edhe Avokatin e Popullit.¹⁰³¹

Avokati i Popullit monitoron në mënyrë të vazhdueshme protestat dhe nxit masa mbrojtëse më të mëdha për lirinë e tubimit.¹⁰³² Gjatë viteve të fundit, ai ka ndërhyrë për t'u siguruar që autoritetet shtetërore të ruajnë proporcionalitetin dhe shpeshherë e ka kritikuar policinë e shtetit për përdorimin pa kriter të gazit lotsjellës dhe pengimin e gazetarëve për të mbuluar protestat.¹⁰³³

Përgjithësisht, Avokati i Popullit konsiderohet si një ndër organet e mbikëqyrjes më të besueshme dhe më efektive të organit ekzekutiv, që nuk ndikohet nga politika.¹⁰³⁴ Megjithatë, vlerësimet e organizatave të shoqërisë civile tregojnë se shfaqen shqetësime për paqartësi nga qytetarët për punën në institucion.¹⁰³⁵

Me anë të një projekti të financuar nga BE-ja, Avokati i Popullit ishte në gjendje të zhvillonte një strategji të komunikimit publik, por akoma nuk i ka vënë në zbatim veprimtaritë dhe programet e tij.¹⁰³⁶ Për më tepër, aplikacioni celular shërben si një mjet informues për veprimtarinë, funksionet dhe historitë e suksesshme të Avokatit të Popullit.¹⁰³⁷ Gjithashtu, shtatë zyrat rajonale e bëjnë më të lehtë kontaktin në rajon dhe promovojnë punën e Avokatit të Popullit.

TREGUESI 8.3.2 PROMOVIMI I PRAKTIKAVE TË MIRA

Deri në çfarë mase është Avokati i Popullit aktiv dhe efektiv në rritjen e ndërgjegjësimit brenda qeverisë dhe publikut për standardet e sjelljes etike?



Avokati i Popullit promovon vazhdimisht praktikat e mira dhe standardet etike në administratën publike dhe institucionet qeveritare, sidomos gjatë pandemisë së COVID-19. Megjithatë, ndikimi i tij kufizohet nga mandati i tij i kufizuar dhe miratim jo i shpeshtë i rekomandimeve të tij.

Avokati i Popullit angazhohet në mënyrë të vazhdueshme me administratën publike në promovimin e një kulturë demokratike për mbrojtjen e lirive të qytetarëve dhe të drejtave të njeriut. Shpeshherë, ai vepron kështu nëpërmjet projekteve të përbashkëta me OShC-të, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe palë të tjera të interesuara. Fushatat e ndërgjegjësimit të Avokatit të Popullit, sidomos lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe promovimin e diversitetit, tërheqin vëmendjen e gjerë të publikut dhe mbulimin mediatik.¹⁰³⁸

Në lidhje me mbikëqyrjen, mandati i Avokatit të Popullit mbulon sektorin publik, me përjashtim të zyrës së Presidentit, Kryeministrit dhe urdhrave ushtarakë me natyrë operuese. Ky përjashtim nuk bëhet sipas standardeve të parashikuara në dokumentet e Këshillit të Evropës dhe Komisionit të Venecias, ku përmendet se Avokati i Popullit duhet të mbulojë të gjitha organet e degës ekzekutive dhe të administratës publike në të gjitha nivelet.¹⁰³⁹ Përveç kësaj, mandati nuk përfshin veprime apo mosveprime të subjekteve private. Megjithatë, Avokati i Popullit e interpreton mandatin e tij duke përfshirë funksionet publike që zbatohen nga subjektet private. Ky interpretim gjithëpërfshirës mbështetet nga Nën-komiteti për Akreditim i Aleancës Globale të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (GANHRI), i cili pohon se mandati i Avokatit të Popullit duhet të zgjerohet në veprimet dhe mosveprimet e sektorit publik dhe privat.¹⁰⁴⁰

Në kohën e pandemisë COVID-19 në vitin 2021, Avokati i Popullit tregoi vendosmëri në mbështetjen e pjesëmarrjes demokratike, lirinë e lëvizjes dhe tubimit, si dhe kufizimet proporcionale dhe të arsyeshme për të drejtat.¹⁰⁴¹ Megjithatë, rekomandimi i Avokatit të Popullit për të lejuar

protestat gjatë pandemisë, sipas masave mbrojtëse shëndetësore, nuk u mor parasysh nga autoritetet publike.¹⁰⁴² Në këtë periudhë, Avokati i Popullit ka miratuar një qasje proaktive dhe ka trajtuar një numër të madh çështjesh sipas detyrës zyrtare për të mbrojtur të drejtat e grupeve të pambrojtura.¹⁰⁴³

Megjithëse ligji organik pranon të drejtën e Avokatit të Popullit për të paraqitur rekomandime legislative, raporti i Nën-komitetit për Akreditim të GANHRI-t vëren se ligji nuk e autorizon në mënyrë të qartë institucionin që të inkurajojë ratifikimin ose pranimin në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.¹⁰⁴⁴ Në fakt, Avokati i Popullit shpeshherë promovon legjislacionin sipas standardeve ndërkombëtare.

Në 2021, Avokati i Popullit lëshoi 267 rekomandime për organet e pushtetit qendror dhe vendor. Nga totali, 51 për qind e tyre u pranuan dhe u zbatuan në mënyrë të plotë ose të pjesshme, ndërsa 28 për qind e tyre nuk u zbatuan ose u refuzuan.¹⁰⁴⁵ Gati një e katërta e rekomandimeve nuk kanë marrë përgjigje. Avokati i Popullit ruan dhe përditëson një bazë të dhënash¹⁰⁴⁶ që lidhet me ecurinë e zbatimit, përveç përgatitjes së informacionit të përditësuar që përfshihet në raportet e vazhdueshme ose vjetore.¹⁰⁴⁷ Shpeshherë, puna e Avokatit të Popullit pengohet nga qëndrimet jobashkëpunuese të institucioneve, gjë që përkeqësohet edhe më shumë nga fakti se ai nuk gëzon autoritet për të zbatuar rekomandimet e tij. Për këtë arsye, roli i Kuvendit në monitorimin e nivelit të zbatimit është thelbësor.

NDËRVEPRIMET

Ndërveprimet kryesore të Avokatit të Popullit bëhen me Kuvendin, sektorin publik dhe shoqërinë civile.

Avokati i Popullit paraqet raporte vjetore në Kuvend dhe mund të sigurojë edhe raporte të posaçme sipas kërkesës, të cilat Kuvendi i përdor për të marrë vendime të duhura dhe për të vlerësuar punën e Avokatit të Popullit.¹⁰⁴⁸ Në përgjithësi, marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me Kuvendin janë pozitive, por mbështetja nga Kuvendi është shpeshherë e

pamjaftueshme në lidhje me kërkesat buxhetore dhe burimet e duhura njerëzore (seksioni 8.1.1).

Avokati i Popullit dhe sektori publik ndërveprojnë brenda kufijve të mandatit të Avokatit të Popullit për të hetuar dhe trajtuar ankesat kundrejt organeve të administratës publike. Megjithëse administrata publike detyrohet të bashkëpunojë me Avokatin e Popullit në hetimet e tyre dhe të ofrojë informacionin e duhur sipas kërkesës, qasja e Avokatit të Popullit në informacion është shpeshherë e kufizuar, pasi institucionet publike kryesisht nuk reagojnë ndaj kërkesave ose nuk respektojnë rekomandimet (seksioni 8.3.1).

Aspekte të caktuara të marrëdhënieve ndërmjet Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile rregullohen nga ligji organik.¹⁰⁴⁹ Në fakt, ata shpeshherë ndërveprojnë për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe që qeveria të mbajë përgjegjësi. OShC-të i paraqesin çështjet në vëmendje të Avokatit të Popullit dhe ky i fundit i përdor konstatimet dhe rekomandimet e tyre për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të bërë ndryshime. Për më tepër, Avokati i Popullit bashkëpunon me OShC-të për të rritur mbështetjen publike në nismat për të drejtat e njeriut.

REKOMANDIMET E ORGANIT

- + Kuvendi duhet të forcojë bashkëpunimin me Avokatin e Popullit për trajtimin e çështjeve të mosreagimit brenda administratës publike duke përmirësuar mekanizmin dhe metodologjinë ndërinstitucionale për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve dhe siguruar funksionimin e tij në kohë dhe të rregullt të tij. Përveç kësaj, duhet të marrë parasysh dhënien e statusit të detyrueshëm për rekomandimet.
- + Kuvendi duhet të shtojë burimet financiare dhe të punësojë më shumë staf për të avancuar aftësinë e Avokatit të Popullit në trajtimin e ankesave dhe në marrjen përsipër të veprimtarive për rritjen e ndërgjegjësimin.
- + Kuvendi duhet të shtojë ekspertizën e tij teknike për të vlerësuar raportet vjetore të Avokatit të Popullit dhe për të monitoruar zbatimin e

rekomandimeve, duke përfshirë konsultimin efektiv me organizatat përkatëse të shoqërisë civile dhe ekspertët e pavarur.

- + Avokati i Popullit duhet të përmirësojë ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të tij duke krijuar një platformë online të aksesueshme për përdoruesit që ofron përditësime të vazhdueshme, informacion të hollësishëm dhe raportim transparent për të rritur besimin e publikut. Veç kësaj, duke bashkëpunuar me palët e interesuara, ai duhet të krijojë mjete të posaçme për të vlerësuar ndikimin.
- + Avokati i Popullit duhet të krijojë një strategji komunikimi gjithëpërfshirëse dhe të synuar me tregues të qartë për të rritur dukshmërinë dhe për të promovuar rolin e tyre në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- + Avokati i Popullit duhet të hartojë protokolle dhe udhëzime që marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore për mekanizmat e ankesave dhe hetimit.

BIBLIOGRAFI

- ⁹²² Neni 60, Kushtetuta e Shqipërisë.
- ⁹²³ Neni 25, Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999 për "Avokatin e Popullit".
- ⁹²⁴ Neni 63, Kushtetuta e Shqipërisë.
- ⁹²⁵ Neni 61, Kushtetuta e Shqipërisë.
- ⁹²⁶ Neni 31, Ligji për Avokatin e Popullit.
- ⁹²⁷ Neni 32, Ligji për Avokatin e Popullit.
- ⁹²⁸ Neni 2, Ligji për Avokatin e Popullit.
- ⁹²⁹ Avokati i Popullit, Raport Vjetor i Veprimtarisë së Avokatit të Popullit 2021, f. 181.
- ⁹³⁰ Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë 2018, 2018, <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=SWD:2018:0151:FIN:EN:PDE>, f. 26.
- ⁹³¹ OECD, *Raport Monitorimi i Parimeve të Administratës Publike në Shqipëri, 2021*, f. 98.
- ⁹³² Aleanca Globale e Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut (GANHRI), Raporti dhe Rekomandimet e Sesionit Virtual të Nën-komitetit të Akreditimit (SCA), dhjetor 2020, f. 15.
- ⁹³³ Komisioni Evropian, *Raporti për Shqipërinë 2020*, 2020, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/albania_report_2020.pdf f.28.
- ⁹³⁴ GANHRI, Raporti i SCA-së, dhjetor 2020, f. 15.
- ⁹³⁵ Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Grupi i Punës për Rishikimin Periodik Universal, Raporti Kombëtar – Shqipëri, 2019, <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G19/048/74/PDF/G1904874.pdf?OpenElement>, f. 5.
- ⁹³⁶ Civil Rights Defenders (CRD), Çfarë fshihet pas dhe përtej mesatares - Efektiviteti i Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut, nëntor 2020, <https://crd.org/wp-content/uploads/2021/03/Effectiveness-of-NHRIs-in-the-WB-What-is-behind-and-beyond-the-average.pdf>, f. 60.
- ⁹³⁷ Avokati i Popullit, *Raport Vjetor i Veprimtarisë së Avokatit të Popullit 2021*, f. 181.
- ⁹³⁸ Avokati i Popullit, *Raport Vjetor i Veprimtarisë së Avokatit të Popullit 2022*, f. 189.
- ⁹³⁹ Avokati i Popullit, *Raport Vjetor i Veprimtarisë së Avokatit të Popullit 2022*, f. 188.
- ⁹⁴⁰ Ndër të tjera, USAID, Zyra e OKB-së në Shqipëri, SIDA, GIZ.
- ⁹⁴¹ Avokati i Popullit, *Raport Vjetor i Veprimtarisë së Avokatit të Popullit 2021*, f. 182.
- ⁹⁴² <https://gmr.lbg.ac.at/albanien-unterstuetzung-der-volksanwaltschaft-und-foerderung-der-menschenrechte/?lang=en>.
- ⁹⁴³ Neni 72, Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Zyrës së Avokatit të Popullit, <https://www.publeaks.al/wp-content/uploads/2016/12/RREGULLORE-AVP-1.1-7.1.pdf>.
- ⁹⁴⁴ Avokati i Popullit, *Plani Strategjik i Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë 2019-2022*, f. 31.
- ⁹⁴⁵ Neni 60, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- ⁹⁴⁶ Ligji nr. 8454, më 4.2.1999 për "Avokatin e Popullit".
- ⁹⁴⁷ Neni 60/2, Kushtetuta e Shqipërisë.
- ⁹⁴⁸ Neni 2, Ligji për Avokatin e Popullit.
- ⁹⁴⁹ Neni 61/1, Kushtetuta e Shqipërisë.
- ⁹⁵⁰ Neni 61/2, Kushtetuta e Shqipërisë. Ligji organik pasqyron të njëjtin standard, duke shtuar se kandidati për Avokatin e Popullit duhet të njihet për aftësitë e tij profesionale dhe figurën e pastër etike dhe morale.
- ⁹⁵¹ Neni 61/4, Kushtetuta e Shqipërisë.
- ⁹⁵² Neni 10, Ligji për Avokatin e Popullit.
- ⁹⁵³ Neni 33/1, Ligji për Avokatin e Popullit.
- ⁹⁵⁴ Neni 61/1, Kushtetuta e Shqipërisë.
- ⁹⁵⁵ Neni 6, Ligji për Avokatin e Popullit.
- ⁹⁵⁶ Neni 61/3, Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 6, Ligji për Avokatin e Popullit.
- ⁹⁵⁷ I dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata, i paaftë nga ana mendore ose fizike për të kryer funksionet e tij, kryen veprimtari të papërshtatshme ose nuk paraqitet në detyrë për më shumë se 3 muaj.
- ⁹⁵⁸ Neni 11, Ligji për Avokatin e Popullit.
- ⁹⁵⁹ OECD, *Raport Monitorimi për Parimet e Administratës Publike në Shqipëri, 2021*, f. 107.
- ⁹⁶⁰ CRD-ja, *Efektiviteti i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut*, F. 60.
- ⁹⁶¹ Neni 35/3, Ligji për Avokatin e Popullit.

⁹⁶² Plani Strategjik i Avokatit të Popullit për Republikën e Shqipërisë 2019-2022, f. 13.

⁹⁶³ Balkanweb, *Zbatimi i marrëveshjes PS-PD, Avokate e Popullit zgjidhet Erinda Ballanca*, 2017,

<https://www.balkanweb.com/ndryshimet-pas-marreveshjes-ps-pd-erinda-ballanca-zgjidhet-avokate-e-popullit/>.

⁹⁶⁴ Në 2017, partitë opozitare nuk u përfshinë në veprimtari parlamentare për tre muaj dhe shprehën synimin e tyre për t'u abstenuar nga zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme për shkak të shqetësimeve të abuzimit të pushtetit nga qeveria për përfitime elektorale. Përfundimisht u arrit një marrëveshje politike, duke përshkruar një sërë veprimesh që përfshijnë shkarkimin e gjashtë ministrave, zëvendëskryeministrit dhe drejtorëve të ndryshëm shtetërorë.

⁹⁶⁵ Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë 2018, 2018, <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=SWD:2018:0151:FIN:EN:PDE>, f. 26.

⁹⁶⁶ CRD-ja, *Efektiviteti i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut*, F. 57.

⁹⁶⁷ CRD-ja, *Efektiviteti i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut*, F. 60.

⁹⁶⁸ Ombudsperson's website, <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/about-us/about-us-details>.

⁹⁶⁹ Neni 28, Ligji për Avokatin e Popullit.

⁹⁷⁰ Vendimi i Parlamentit nr. 134/2018 "*Për miratimin e manualit vjetor dhe të vazhdueshëm të monitorimit të institucioneve të pavarura kushtetuese ose të themeluara me ligj*".

⁹⁷¹ Neni 7, Ligji nr. 119/2014 për "*Të Drejtën e Informimit*".

⁹⁷² Neni 2, Ligji për Avokatin e Popullit.

⁹⁷³ Neni 12, Ligji për Avokatin e Popullit.

⁹⁷⁴ Neni 30, Ligji për Avokatin e Popullit.

⁹⁷⁵ Neni 33/1, Ligji për Avokatin e Popullit.

⁹⁷⁶ Shih faqen zyrtare të internetit të Avokatit të Popullit: <https://www.avokatipopullit.gov.al/>.

⁹⁷⁷ Seksioni për statistikat në faqen e internetit së Avokatit të Popullit.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/statistics/statistics/2020>.

⁹⁷⁸ Intervista me znj. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit, 23 janar 2023.

⁹⁷⁹ CRD-ja, *Efektiviteti i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut*, F. 63.

⁹⁸⁰ Avokati i Popullit kërkoi rishikimin e një dispozite të Kodit Penal, duke e konsideruar atë të papërshtatshme me të drejtën për tubim, pasi ishte përdorur për të ndjekur penalisht protestuesit paqësorë.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Liria%20e%20tubimit%20dhe%20Vendimi%20i%20Gjykat%C3%ABs%20Kushtetuese.pdf>.

⁹⁸¹ Neni 36, Ligji për Avokatin e Popullit.

⁹⁸² Neni 26, Ligji për Avokatin e Popullit.

⁹⁸³ *Ibid.*

⁹⁸⁴ *Ibid.*

⁹⁸⁵ Neni 28, Ligji për Avokatin e Popullit.

⁹⁸⁶ Neni 27, Ligji për Avokatin e Popullit.

⁹⁸⁷ Neni 28, Ligji për Avokatin e Popullit.

⁹⁸⁸ *Ibid.*

⁹⁸⁹ Neni 1014, Ligji nr. 154/2014 për "*Organizimin dhe Funksonimin e Institucionit të Lartë të Auditimit*".

⁹⁹⁰ Neni 3, Ligji për Avokatin e Popullit.

⁹⁹¹ Ligji nr. 60/2016 për "*Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve*".

⁹⁹² Avokati i Popullit, *Raporti Vjetor i Veprimtarisë së Avokatit të Popullit 2022*,

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20vjetor%20i%20veprimtarise%20e%20institucionit%20te%20Avokati%20te%20Popullit%20per%20vitin%202022.pdf>.

⁹⁹³ Baza e të dhënave e mëparshme e raporteve të Parlamentit,

<https://staging.parlament.al/Kerkese?page=1&tipld=3>.

⁹⁹⁴ Baza e të dhënave aktuale e raporteve të Parlamentit,

<https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/17f53d7d-ee0d-415b-8457-96cf1007d263>.

⁹⁹⁵ CRD-ja, *Efektiviteti i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut*, F. 62.

⁹⁹⁶ IDM, Ruajtja e Rojtarëve, f. 18.

⁹⁹⁷ IDM, Ruajtja e Rojtarëve, f. 22.

⁹⁹⁸ *Ibid*, f. 7.

- ⁹⁹⁹ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Ruajtja e Rojtarëve: *Mbikëqyrja Parlamentare e Institucioneve të Pavarura në Shqipëri*, 2020, <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/parliamentary-oversight-English-final-1.pdf>, f. 11.
- ¹⁰⁰⁰ Neni 12, Ligji për Avokatin e Popullit.
- ¹⁰⁰¹ Avokati i Popullit, *Kodi i Sjelljes së Mirë Administrative*, <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/article/legislation>.
- ¹⁰⁰² Neni 37, Ligji për Avokatin e Popullit.
- ¹⁰⁰³ *Ibid.*
- ¹⁰⁰⁴ *Ibid.*
- ¹⁰⁰⁵ Neni 29, *Kodi i Sjelljes së Mirë Administrative* të Avokatit të Popullit.
- ¹⁰⁰⁶ Neni 18, *Kodi i Sjelljes së Mirë Administrative* të Avokatit të Popullit.
- ¹⁰⁰⁷ Intervista me znj. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit, 23 janar 2023.
- ¹⁰⁰⁸ *Ibid.*
- ¹⁰⁰⁹ Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2019, f. 164.
- ¹⁰¹⁰ Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2021, f. 13.
- ¹⁰¹¹ Intervista me znj. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit, 23 janar 2023.
- ¹⁰¹² Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2021, f. 15.
- ¹⁰¹³ OSBE, Ndikimi gjinor i korrupsionit në sektorët e kujdesit shëndetësor dhe universitetet shqiptare, 2021, https://www.osce.org/files/f/documents/5/4/513448_0.pdf, f. 22.
- ¹⁰¹⁴ Statistikat. Faqja në internet e Avokatit të Popullit, <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/statistics/statistics>.
- ¹⁰¹⁵ Intervista me znj. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit, 23 janar 2023.
- ¹⁰¹⁶ Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2021, f. 15.
- ¹⁰¹⁷ Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2019, f. 14
- ¹⁰¹⁸ *Ibid.*
- ¹⁰¹⁹ Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2019, f. 14
- ¹⁰²⁰ Neni 15, Ligji për Avokatin e Popullit
- ¹⁰²¹ Raporti Kombëtar i UPR-së për Shqipërinë, 2019, f. 11
- ¹⁰²² Urdhri i Avokatit të Popullit nr. 222, më 31.08.2019 për “Manualin mbi Mekanizmin e Trajtimit të Ankesave”
- ¹⁰²³ Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2021, f. 163
- ¹⁰²⁴ Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2020, f. 167
- ¹⁰²⁵ Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2021, f. 10
- ¹⁰²⁶ Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2021, f. 192
- ¹⁰²⁷ *Ibid*, f. 191
- ¹⁰²⁸ *Ibid*, f. 196
- ¹⁰²⁹ CRD-ja, *Efektiviteti i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut*, f. 62
- ¹⁰³⁰ Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2022, f. 16
- ¹⁰³¹ OECD, *Raport Monitorimi i Parimeve të Administratës Publike në Shqipëri*, 2021, f. 108.
- ¹⁰³² Avokati i Popullit vëzhgoi protestën e banorëve në zonën e Astirit kundër shkatërrimit të pronave të tyre për t'i lënë hapësirë ndërtimit të rrugëve dhe protestave kundër shembjes së godinës së Teatrit Kombëtar.
- ¹⁰³³ Komisioni Evropian Raporti për Shqipërinë 2020, f. 28.
- ¹⁰³⁴ OECD, *Raport Monitorimi i Parimeve të Administratës Publike në Shqipëri*, 2021, f. 98.
- ¹⁰³⁵ CRD-ja, *Efektiviteti i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut*, F. 65.
- ¹⁰³⁶ Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2020, f. 11.
- ¹⁰³⁷ Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2021, f. 10.
- ¹⁰³⁸ Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (NPEI) 2021/2023, https://integrimi-ne-be.puneteshqiptare.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOMB%C3%8BTAR-P%C3%8BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN_Final.pdf f. 293.
- ¹⁰³⁹ Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Rezoluta 1959 (2013): Forcimi i institucionit të Avokatit të Popullit në Evropë, 4 tetor 2013. Raporti; Komisioni Evropian për Demokraci Përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), Parimet për mbrojtjen dhe promovimin e institucioneve të Avokatit të Popullit (“Parimet e Venecias”), 1516 mars 2019, Opinioni nr. 897/2017.
- ¹⁰⁴⁰ Raporti i SCA-së për Avokatin e Popullit, f. 15.
- ¹⁰⁴¹ Komisioni Evropian Raporti për Shqipërinë 2022, f. 27; Rekomandimi i Avokatit të Popullit për Komisionin e Emergjencave Civile, Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Policisë së Shtetit, 2022,

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20marrjen%20e%20masave%20t%C3%AB%20nevojshme%20p%C3%ABr%20respektimin%20e%20liris%C3%AB%20kushtetuese%20t%C3%AB%20tubimit%20edhe%20gjat%C3%AB%20gjendjes%20s%C3%AB%20jasht%C3%ABzakonshme.%20.pdf>.

¹⁰⁴² Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2020, f. 118.

¹⁰⁴³ Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2020, f. 105.

¹⁰⁴⁴ Raporti i SCA-së për Avokatin e Popullit, f. 16.

¹⁰⁴⁵ Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2021, f. 168.

¹⁰⁴⁶ <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/article-ildp-layout/transparency>.

¹⁰⁴⁷ Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2021, f. 167.

¹⁰⁴⁸ Neni 26, 27, 28, Ligji për Avokatin e Popullit.

¹⁰⁴⁹ Neni 30, Ligji për Avokatin e Popullit.

INSTITUCIONI I LARTË I AUDITIMIT

PËRMBLEDHJE



Institucioni i Lartë i Auditimit të Shtetit të Shqipërisë (KLSH)¹⁰⁵¹ është institucioni i lartë i auditimit në Republikën e Shqipërisë. KLSH-ja është një institucion kushtetues i autorizuar për të audituar buxhetin e konsoliduar të shtetit dhe subjektet publike të qeverisjes qendrore dhe vendore, përfshirë fondet publike të siguruara nga Bashkimi Evropian ose organizatat e tjera ndërkombëtare, subjektet ligjore në të cilët shteti zotëron më shumë se gjysmën e aksioneve, ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti, veprimtaritë apo sektorët me kontrata koncesionare dhe partitë politike.

KLSH-ja ndahet në drejtori dhe departamente. Tetë drejtoritë dhe departamentet që kanë lidhje me veprimtarinë e auditimit, si departamenti i auditimit të institucioneve qendrore, departamenti i auditimit të njësisve vendore, departamenti i auditimit të buxhetit të shtetit, departamenti i auditimit të performancës, drejtoria e menaxhimit të cilësisë dhe standardeve etj. dhe kategorizohen në një Drejtori të Përgjithshme nën autoritetin e Kryetarit. Në mënyrë të drejtpërdrejtë nën autoritetin e Kryetarit janë edhe departamentet e auditimit të brendshëm dhe juridik të KLSH-së. Ndërsa, drejtoritë e posaçme për funksionimin administrativ të KLSH-së, si burimet njerëzore, komunikimi dhe shërbimet administrative, janë nën autoritetin e Sekretarit të Përgjithshëm të KLSH-së.

Kryetari i KLSH-së zgjidhet nga Kuvendi pasi caktohet nga Presidenti i Republikës. Ndërkohë që masat mbrojtëse legjislative për KLSH-në gjykohen të përshtatshme dhe sipas standardeve ndërkombëtare, ekzistojnë boshllëqe në lidhje me

zgjedhjen e Kryetarit vetëm nga shumica, kriteret të papërcaktuara lidhur me “përvojën e duhur financiare” dhe procese të paqarta në rastet kur Kryetari jep dorëheqjen para përfundimit të mandatit të tij.

Buxheti i KLSH-së dhe personeli i miratuar janë shtuar me kalimin e viteve. Megjithatë, boshllëqet e shumta të burimeve njerëzore në personelin e auditimit çojnë në një nivel të caktuar joefektiviteti në kryerjen e auditimeve të tij.

KLSH-së i mungon njëfarë transparence në vendimmarrje duke filluar nga raportet paraprake të auditimit deri në raportet përfundimtare dhe gjithashtu nuk përputhet plotësisht me ligjin për të drejtën e informimit, ku kërkon që informacioni i kërkuar me ligj të bëhet publik në një seksion të posaçëm të faqes së vet të internetit.

Ndonëse KLSH-ja duhet të raportojë dhe të mbajë përgjegjësi para Kuvendit, Kuvendi nuk ka arritur të diskutojë konstatimet e auditimit dhe të përzgjedhë audituesit e jashtëm për të audituar financat e KLSH-së. KLSH-ja është akoma joefektiv në përmirësimin e menaxhimit të financave publike për shkak të mosarritjes së Kuvendit për të mbajtur përgjegjës organin ekzekutiv dhe organet e tjera publike për zbatimin e rekomandimeve. Shumë nga gjetjet e KLSH-së në pesë vitet e fundit janë të përsëritura, gjë që sugjeron se efektiviteti i saj praktik në përmirësimin e menaxhimit financiar të qeverisë është mjaft i vogël. Në vitin 2018, Kuvendi njohu domosdoshmërinë e një nënkomisioni parlamentar për veprimtarinë e KLSH-së. Ndërsa KLSH-ja ka këmbëngulur në vullnetin e tij për këtë nënkomision parlamentar të dedikuar, në të cilin

gjetjet e tij do të debatoheshin nga të gjitha palët e interesuara dhe për rrjedhojë do të krijonin mbështetje më të madhe për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, ky nënkomision nuk është themeluar ende nga Kuvendi.

KAPACITETET

TREGUESI 9.1.1 BURIMET (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli institucioni i auditimit ka burime të përshtatshme për të arritur qëllimet e tij në praktikë?



Buxheti i KLSH-së dhe stafi i miratuar është rritur me kalimin e viteve. Megjithatë, boshllëqet e konsiderueshme të burimeve njerëzore çojnë në një shkallë të caktuar joefektiviteti në kryerjen e auditimeve të tij.

Ka pasur rritje të rregullta në buxhetin e KLSH-së, nga rreth 3.4 milionë euro në vitin 2020 në rreth 3.5 milionë euro në vitin 2021 dhe rreth 3.8 milionë euro në vitin 2022. Në vitin 2022, liria e KLSH-së për të menaxhuar buxhetin u kufizua nëpërmjet një akti normativ i cili rishpërndau fonde nga KLSH-ja për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë pa u konsultuar më parë me KLSH-në.¹⁰⁵² Megjithatë, KLSH-ja e konsideron buxhetin e tij të mjaftueshëm për kryerjen e veprimtarisë.¹⁰⁵³

Formimet akademike më të zakonshme për stafin e KLSH-së janë në fushat e ekonomisë, drejtësisë dhe inxhinierisë (152 nga 176 punonjës janë me diplomë universitare), që korrespondojnë me veprimtarinë e

KLSH-së.¹⁰⁵⁴ Ekipe të auditimit të KLSH-së kanë mundësi të përshtatshme trajnimi brenda vendit ose nëpërmjet ekspertizës ndërkombëtare me një total prej 25 ditësh trajnimi në vit për çdo auditues.¹⁰⁵⁵ Megjithatë, ndërkohë që numri i stafit total të miratuar të KLSH-së është rritur që nga viti 2017, kjo nuk është reflektuar në rritjen e numrit të personelit total ekzistues apo të stafit ekzistues të auditimit, i cili ka mbetur i qëndrueshëm që nga viti 2019 (Tabela 3).

Që nga viti 2020, ka pasur gjithashtu ritme të larta të qarkullimit të stafit (më shumë se 35 përqind e totalit të stafit) kryesisht për shkak të dorëheqjeve pas ndryshimit në drejtimin e KLSH-së (shih 9.1.3).¹⁰⁵⁷ Ky qarkullim i stafit të kualifikuar dhe me përvojë mund të rrezikojë aftësinë e KLSH-së për të kryer kontrolle financiare efektive (shih 9.3.1).¹⁰⁵⁸

TREGUESI 9.1.2 PAVARËSIA (LIGJI)

Deri në çfarë niveli ekziston pavarësia operationale zyrtare e institucionit të auditimit?



Masat mbrojtëse legjislative nëpërmjet Kushtetutës dhe Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH-së ("ligji i KLSH-së") për pavarësinë dhe mandatin e KLSH-së janë kryesisht të përshtatshme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.¹⁰⁵⁹ Megjithatë, ka boshllëqe për sa i përket zgjedhjes së Kryetarit vetëm me shumicë të thjeshtë, kriteret të papërcaktuara në lidhje me "përvojën e duhur financiare" dhe proceset e paqarta nëse Kryetari jep dorëheqjen para përfundimit të mandatit të tij.

Tabela 3, Struktura dhe numri i stafit të auditimit të miratuar nga KLSH-ja¹⁰⁵⁶

Stafi/viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Nr. total. i stafit të miratuar në strukturën e KLSH-së	181	191	196	203	218	233
Stafi total ekzistues	175	201	204	190	196	209
Nr. i stafit ekzistues të auditimit	130	144	149	146	148	145

KLSH-ja është themeluar me Kushtetutë,¹⁰⁶⁰ e cila përcakton parimet për mandatin, organizimin dhe funksionimin e tij, si dhe kufizon marrëdhëniet me legjislativin ndaj mekanizmave të nevojshëm të llogaridhënies (shih 9.2.3).¹⁰⁶¹ Ligji i KLSH-së siguron pavarësinë e tij në planifikimin dhe miratimin e politikave të veta, në kryerjen e auditimeve në përputhje me një program dhe metodë të vetë-përcaktuar dhe në vetëadministrimin e burimeve njerëzore.¹⁰⁶² KLSH-ja mund të marrë në konsideratë propozimet e bëra nga qeveria gjatë përcaktimit të planeve të auditimit, por nuk është i detyruar të veprojë sipas tyre.¹⁰⁶³ Megjithatë, është e detyrueshme me Ligj për financat e vetëqeverisjes lokale që të auditojë të gjitha njësitë vendore çdo vit, gjë që ndikon në planin e auditimit për një periudhë kalimtare.¹⁰⁶⁴

Kryetari duhet të jetë i paanshëm dhe nuk mund të jetë anëtar i asnjë organi të një partie politike apo organizate politike.¹⁰⁶⁵ Megjithatë, Kryetari i KLSH-së mund të zgjidhet dhe shkarkohet vetëm nga një shumicë e thjeshtë parlamentare, gjë që krijon rrezik për emërime politike.¹⁰⁶⁶ Për më tepër, kriteret profesionale për emërimin e Kryetarit janë të paqarta për sa i përket, për shembull, "përvojë e duhur financiare",¹⁰⁶⁷ duke i dhënë Kuvendit gjykim të gjerë. Në të njëjtën mënyrë, propozimi i Presidentit të Republikës për Kryetarin e KLSH-së nuk është garanci për të kufizuar gjykimin e Kuvendit¹⁰⁶⁸ meqenëse Kushtetuta e bën më të lehtë emërimin e një presidenti të politizuar me shumicë absolute (shih edhe 2.1.3).¹⁰⁶⁹

Pasi zgjidhet, Kryetari i KLSH-së ka një mandat shtatëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.¹⁰⁷⁰ Mandati quhet i zgjatur automatikisht derisa të emërohet pasardhësi.¹⁰⁷¹ Megjithatë, ligji i KLSH-së nuk përfshin dispozita për të siguruar vazhdimësinë institucionale nëse Kryetari jep dorëheqjen ose nuk dëshiron të qëndrojë në detyrë derisa të emërohet pasardhësi i tij/saj. Kjo ka krijuar pasiguri mbi legjitimitetin e vendimmarrjes në vitin 2018, kur ish-kryetari i KLSH-së deklaroi me vullnetin e tij për të mos kandiduar më si kandidat dhe delegoi kompetencat e tij për pesë muaj tek deputeti i tij, i cili nuk u zgjodh nga Kuvendi.¹⁰⁷² Për më tepër, në

dispozitat e ligjit të KLSH-së që mandati i kryetarit përfundon automatikisht në rast të "mungesës pa arsye në detyrë" i mungon specifikimi për kohëzgjatjen e një mungese të tillë dhe procedura e zbatimit të saj.¹⁰⁷³

TREGUESI 9.1.3 PAVARËSIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase institucioni i auditimit është i lirë nga ndërhyrjet e jashtme në realizimin e punës së tij në praktikë?



KLSH-ja operon kryesisht lirisht nga ndikimi i palëve të tjera të interesit dhe aktivitetet e saj janë jopartiake, ndërsa dispozitat e Ligjit për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, të cilat për një periudhë kalimtare e detyrojnë KLSH-në të auditojë të gjitha njësitë vendore çdo vit, në praktikë e kanë kufizuar vendosmërinë e KLSH-së për sa i përket planifikimit të auditimeve të saj bazuar në vlerësimin e riskut.

Aftësia e KLSH-së për të kryer punën e saj në mënyrë të pavarur është e kufizuar në praktikë si pasojë e boshllëqeve. Për shembull, edhe pse KLSH-ja vazhdon të ketë të njëjtën mesatare të auditimeve të kryera përgjatë një viti, në vitin 2022, auditimet për njësitë e vetëqeverisjes vendore përbënin pothuajse 40 për qind të planit të përgjithshëm të auditimit, duke ndikuar në aftësinë e saj për të kryer auditime financiare efektive (shihni 9.3.1).¹⁰⁷⁴

Nuk ka asnjë rast të shkarkimit të Kryetarit të KLSH-së para përfundimit të mandatit të tij ose të saj, dhe as raste rizgjedhjeje. Të gjithë ish-Kryetarët e KLSH-së vinin nga një karrierë politike e nivelit të lartë ose ndoqën një karrierë politike pas përfundimit të mandatit të tyre.¹⁰⁷⁵ Për shembull, ish kryetari i KLSH-së, Bujar Leskaj, u rikthye në karrierën e tij politike dhe tani është deputet i partisë kryesore opozitare, PD-së.¹⁰⁷⁶ Kryetari aktual i KLSH-së, i emëruar në korrik 2020, nuk ka formim politik, ndërsa Kuvendi shkualifikoi një kandidat të mëparshëm të propozuar nga Presidenti për shkak të anëtarësimit të tij në një parti politike.¹⁰⁷⁷

Zgjedhja e kryetarit aktual të KLSH-së u bazua në një kompromis midis mazhorancës qeverisëse dhe opozitës jashtëparlamentare dhe parlamentare, pasi nuk arritën të bien dakord për një kandidat për 18 muaj (shihni 1.3.1).¹⁰⁷⁸

QEVERISJA

TREGUESI 9.2.1 TRANSPARENCA (LIGJI)

Projektligji i vitit 2020 për regjistrimin e OJF-ve ndezi një debat të fortë, pasi legjislacioni kundërshtues kërkonte regjistrimin e të gjitha shoqatave informale dhe bazë, për të siguruar funksionimin e tyre.¹⁷⁵⁵ Për shkak të kundërshtimit të sektorit, kjo kërkesë nuk kaloi në draftin përfundimtar që u miratua nga parlamenti në vitin 2021.¹⁷⁵⁶

Nga ana tjetër, legjislacioni për lirinë e tubimit është prekur shumë, sidomos për shkak të rregulloreve të pandemisë. Para vitit 2021, neni 262 i Kodit Penal e kriminalizonte organizimin e protestave nëse nuk kishin leje nga Policia e Shtetit.¹⁷⁵⁷ Në vitin 2021, Gjykata Kushtetuese vendosi se neni ishte jokushtetues dhe kërkoi ndryshimin e tij.¹⁷⁵⁸

Megjithatë, vendimi i gjykatës nuk ishte plotësisht i plotë dhe parlamenti e zbatoi fjalë për fjalë. Për këtë arsye, Kodi Penal i ndryshuar, i cili u vlerësua gabimisht nga media dhe shoqëria civile¹⁷⁵⁹ aktualisht ka kriminalizuar plotësisht ushtrimin e

lirisë së tubimit në Shqipëri. Të gjitha llojet e protestave konsiderohen tashmë vepra penale, të sanksionuara me gjobë ose me burgim deri në një vit.¹⁷⁶⁰

Për sa i përket të drejtës së privatësisë, OJF-të pohojnë se falë përpjekjeve të tyre të advokimit, ligji i vitit 2021 për regjistrimin e OJF-ve ofron më shumë garanci për mbrojtjen e të dhënave personale të OJF-ve.¹⁷⁶¹ Ato lejohen të mbledhin dhe përpunojnë të dhëna të ndjeshme për aktivitetet e tyre. Megjithatë, nuk mund t'i ndajnë ato me palë të treta pa pëlqimin paraprak të qytetarëve privatë.¹⁷⁶²

TREGUESI 13.1.4 PAVARËSIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase shoqëria civile mund të ekzistojë dhe të funksionojë pa ndërhyrje të jashtme të panevojshme?



Qeveria, partitë politike dhe media ndërhyjnë në aktivitetet e OJF-ve duke ushtruar presion, frikësuar dhe ngacmuar aktivistët e shoqërisë civile. Ndalimet policore të aktivistëve u rritën gjatë pandemisë COVID-19, ndërsa gjobat nga autoritetet shtetërore u trefishuan në vitin 2022.

Civics Monitor pohon se hapësira qytetare në Shqipëri është kufizuar.¹⁷⁶³ Bazuar në gjetjet nga përmbledhja e vendit të Matricës së Monitorimit, gjobat për sektorin janë trefishuar në vitin 2022. Autoritetet tatimore vendosën 14 gjoba për OJF-të në vitin 2021¹⁷⁶⁴ dhe 48 në vitin 2022. Arsyt kryesore të gjobave në vitin 2022 ishin mungesa e informacionit nga OJF-të, mosdeklarimi i punonjësve dhe evazioni fiskal. 69 gjoba të tjera janë vendosur nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shkelje procedurale të regjistrimit të pronarëve përfitues, me kosto financiare prej 40,000 euro. OJF-të i konsiderojnë këto gjoba si të larta¹⁷⁶⁵ dhe joproporcionale.

Një sondazh i kryer nga MRB dhe Qendra e të Dhënave në vitin 2022 zbuloi se 76.2 përqind e qytetarëve të anketuar i perceptojnë OJF-të si

zgjerime të partive politike.¹⁷⁶⁶ Kjo nuk pasqyron vetëm perceptimin nga jashtë. Studimi vë në dukje ekzistencën e një shoqërie civile në hije, e cila përfshin disa OJF të lidhura me qeverinë, edhe pse asnjë shembull nuk bëhet publik. Këto OJF mbështesin agjendën e qeverisë dhe përfitojnë nga klientelizmi i saj.¹⁷⁶⁷ Nga ana tjetër, OJF-të e paanshme përjetojnë presione gjatë veprimtarisë së tyre, sidomos kur ato janë "kritike ndaj palëve politike, të biznesit dhe medias",¹⁷⁶⁸ gjë që vihet re në veçanti për OJF-të në nivel vendor.¹⁷⁶⁹

Frikësimet, ngacmimet dhe sulmet ndaj aktivistëve të shoqërisë civile kanë qenë të vazhdueshme gjatë viteve 2020-2022.¹⁷⁷⁰ OJF-të përjetojnë fushata shpifëse nga media, qeveria dhe partitë politike të cilat zhvlerësojnë punën e tyre.¹⁷⁷¹ Për shembull, studiuesit e grupit të ekspertëve, puna e të cilëve ishte kritike ndaj qeverisë përjetuan fushata nënçmuese nga qeveria dhe media pro-qeveritare.¹⁷⁷² Sa më të avancuara të jenë konstatimet, aq më e papëlqyeshme është fushata për të larguar vëmendjen nga konstatimet në sulmet *ad hominem*.¹⁷⁷³ Aktivistë lezbike, homoseksualë, biseksualë dhe transgjitorë (LGBT+) që mbronin zgjidhje ligjore për njohjen e prindërimit të çifteve homoseksuale, ishin objektiv i keqinformatave mediatike dhe gjuhës së urrejtjes.¹⁷⁷⁴ OJF-të që ofrojnë shërbime u përballën gjithashtu me kritika mediatike për mosprodhimin e rezultateve.¹⁷⁷⁵ Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dhënë disa vendime në favor të ankesave të OSHC-ve për komunitetet e cënueshme.¹⁷⁷⁶ Megjithatë, AMA nuk ka arritur të marrë masa ndaj stacioneve televizive që përdorin gjuhë nënçmuese kundër aktivistëve të komunitetit LGBT+,¹⁷⁷⁷ siç diskutohet në organin e medias (shih 12.2.4). Për më tepër, numri i aktivistëve të ndaluar nga policia u rrit veçanërisht gjatë dhe pas izolimit të COVID-19 duke përfshirë edhe gjatë vitit 2022,¹⁷⁷⁸ duke arritur kulmin me shembjen e Teatrit Kombëtar¹⁷⁷⁹ dhe protestat kundër vrasjes së një qytetari nga një oficer policie në 2020.¹⁷⁸⁰

QEVERISJA

TREGUESI 13.2.1 TRANSPARENCA (PRAKTIKË)

Deri në çfarë mase ka transparencë në OSHC-të?



Në përgjithësi, shumë OJF nuk e bëjnë publik informacionin përkatës mbi aktivitetet e tyre në faqet e tyre të internetit, në kanalet e tjera të komunikimit ose nëpërmjet aktiviteteve vjetore dhe raporteve financiare.

OJF-të e ngrenë zërin për transparencën e institucioneve publike, por shfaqin pak progres që ta tregojnë veten e tyre më transparente.¹⁷⁸¹ OJF-të përdorin media sociale, mjete digjitale dhe përfaqësime mediatike për të publikuar aktivitetet e tyre.¹⁷⁸² Megjithatë, ato nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur përditësimit të informacionit përkatës në lidhje me organizatën e tyre në faqet e tyre të internetit. Informacioni për stafin dhe organet e tyre qeverisëse është i pakënaqshëm si për OJF-të ashtu edhe për rrjetet.¹⁷⁸³

Mungojnë të dhënat e fundit, por një studim i vitit 2020 ka treguar se vetëm 39 përqind e OJF-ve i kanë publikuar raportet e tyre vjetore në internet, nga të cilat vetëm 25 përqind përfshinin informacion financiar,¹⁷⁸⁴ dhe vetëm në shifra shumë të gjera. Për më tepër, shumë pak OJF publikojnë raportet e tyre vjetore financiare të audituara veçmas.¹⁷⁸⁵ Mospërputhja midis fjalëve dhe veprave dobëson kauzën e OJF-ve dhe krijon arsye për të mosbesuar veprimtarinë e tyre.

TREGUESI 13.2.2 LLOGARIDHËNIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase janë OSHC-të përgjegjëse ndaj zonave të tyre zgjedhore?



Në përgjithësi, OJF-të nuk janë përgjegjëse ndaj strukturave të bordit dhe zonave të tyre zgjedhore dhe shpërfillin në masë të madhe kërkesën për të publikuar pasqyrat e tyre financiare vjetore.

Strukturat e bordit të OJF-ve ekzistojnë në letër dhe përfshijnë anëtarë që janë jashtë organizatës. Megjithatë, ato konsiderohen shumë formale dhe pa ndonjë kompetencë thelbësore mbikëqyrëse për operimin e OJF-ve, me përjashtime të pakta.¹⁷⁸⁶

Raporte të ndryshme¹⁷⁸⁷ tregojnë se organizatat e bazuara në anëtarësi kanë lidhje të dobëta me zonat e tyre elektorale, duke e bërë shumë të vështirë mbledhjen e tarifave të anëtarësimit,¹⁷⁸⁸ ndërsa lidhjet e OJF-ve vendore me përfituesit e tyre janë pak më të qëndrueshme dhe kohët e fundit janë lehtësuar nga mjetet e TI-së.¹⁷⁸⁹ Sipas sondazhit të vitit 2022 "Besimi në qeverisje", besimi në organizatat e shoqërisë civile ka qenë i qëndrueshëm gjatë viteve 2020-2022. Gjetjet e vitit 2022 tregojnë se 53.6 përqind e qytetarëve kanë besim të madh dhe në përgjithësi u besojnë OJF-ve, ndërsa 44 përqind nuk kanë aspak besim tek to.¹⁷⁹⁰ Bino dhe të tjerë pretendojnë se funksionimi i bazuar në projekte dhe ndërprerja e shërbimeve për shkak të qëndrueshmërisë së kufizuar financiare i pengon OJF-të të nxisin lidhje të qëndrueshme dhe besim me përfituesit e tyre.¹⁷⁹¹

Për të rritur llogaridhënien ndaj përfituesve dhe donatorëve të tyre, në vitin 20202, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit nxori Modelin e Raportit të Performancës së OJF-ve, i cili kërkon që OJF-të e mëdha me pasuri mbi 30 milionë lekë (260,870 euro) të publikojnë raportet e performancës së tyre, së bashku me pasqyrat financiare vjetore.¹⁷⁹² Në dijeninë e këtij raporti, OJF-të i kanë shpërfillur në masë të madhe këto kërkesa, por kanë përfshirë informacion shumë të gjerë të performancës në raportet e tyre vjetore.

TREGUESI 13.2.3 INTEGRITETI (ZBATIMI)

Deri në çfarë niveli sigurohet integriteti i OSHC-ve në praktikë?



Në përgjithësi, shumë OJF nuk janë aktive në sigurimin e integritetit të stafit dhe bordit të tyre. Megjithatë, shumë OJF po shtojnë përpjekjet për të zhvilluar Kodet e tyre të Sjelljes dhe po i bashkohen nismave vetërregulluese.

Duke kundërshtuar ndërhyrjen e shtetit për rregullimin e sektorit, OJF-të kanë intensifikuar nismat vetërregulluese për të rritur legjitimitetin dhe besueshmërinë e tyre, edhe pse rezultatet nuk janë ende të dukshme. Të dhënat tregojnë se 76 përqind e OJF-ve raportuan se kishin Kode Sjelljeje në vitin 2020,¹⁷⁹³ megjithatë zbatimi i tyre është mjaft i dobët.¹⁷⁹⁴ Me një lajm të mirë, pas dy vitesh punë ekipore ndërkombëtare, në vitin 2021, 16 OJF miratuan dhe u bënë pjesë e Kodit të Standardeve.¹⁷⁹⁵ Ky Kod është një mjet i brendshëm vetërregullues për zbatimin më të mirë të qeverisjes së mirë, burimeve njerëzore dhe menaxhimit financiar, transparencës dhe llogaridhënies brenda OJF-ve¹⁷⁹⁶ dhe ka strukturat e veta zbatuese. Anëtarësimi në Kod fitohet vullnetarisht duke plotësuar Kuadrin e Vetëvlerësimit të Kodit të Standardeve të OJF-ve.¹⁷⁹⁷ Komiteti i Kodit ka të drejtë të vlerësojë përmbushjen e detyrimeve dhe kërkesave bazë të Kodit për OJF-të që dëshirojnë t'i bashkohen atij, ose ato që duan të ruajnë anëtarësinë e tyre.¹⁷⁹⁸

Në të njëjtën kohë, që nga viti 2020, OJF-të filluan të punonin në një platformë të dedikuar online për anëtarët e Kodit për t'u mundësuar përfituesve dhe donatorëve të kontrollojnë aktivitetin e tyre.¹⁷⁹⁹ Platforma u publikua në vitin 2021.¹⁸⁰⁰ Anëtarësimi në Kod është rritur minimalisht në 24 anëtarë që nga viti 2021,¹⁸⁰¹ duke e bërë atë shumë të kufizuar në krahasim me numrin e OJF-ve aktive. Anëtarët gjithashtu nuk e kanë zbatuar plotësisht Kodin në praktikë, sidomos në lidhje me transparencën financiare. Për më tepër, në vitin 2021, OJF-të filluan

përgatitjen e Metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut të OJF-ve për financimin e terrorizmit si një përgjigje ndërkombëtare e shoqërisë civile për të shmangur mbi rregullimin e shtetit dhe për të forcuar hapësirën qytetare.¹⁸⁰² Metodologjia u publikua në vitin 2022 dhe e vlerësoi sektorin me "rrezik të ulët" për financimin e terrorizmit. OJF-të presin që autoritetet shtetërore të miratojnë metodologjinë dhe të heqin kategorizimin e sektorit të OJF-ve si "me rrezik të lartë" për pastrim parash.¹⁸⁰³ Në fund të vitit 2022, Rrjeti Ballkanik i Zhvillimit të Shoqërisë Civile (BCSDN) publikoi Komunitetin Rajonal të Llogaridhënies së Praktikës, i cili synon ndarjen e përvajave dhe rritjen e përbashkët të llogaridhënies së OJF-ve në Ballkanin Perëndimor.¹⁸⁰⁴

TREGUESI 13.2.4 GJINIA

Deri në çfarë niveli programet e OSHC-ve marrin parasysh ndjeshmërinë gjinore?



Programet e OJF-ve marrin parasysh konsideratat për sa i përket gjinisë, por jo në mënyrë të vazhdueshme, ndërsa mbledhja e të dhënave që ndahen sipas gjinisë mbështetet kryesisht nga donatorët.

Megjithëse nuk ekzistojnë të dhëna të ndara për sektorin e shoqërisë civile veçanërisht, sipas Institutit të Statistikave (INSTAT), sektori i shërbimeve publike, për komunitetin dhe shërbimeve sociale dominohet më shumë nga gratë.¹⁸⁰⁵ Asistenca Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi (TACSO) njofton se publiku e percepton shoqërinë civile veçanërisht si sektorin që ka parasysh ndjeshmërinë gjinore dhe si një përkrasë për më shumë veprimtari për integrimin gjinor.¹⁸⁰⁶ Sondazhi i kryer nga MRB-ja dhe Qendra e të Dhënave në vitin 2022 konstatoi se 47.9 përqind e të anketuarve e pranonin punën e shoqërisë civile për të drejtat e grave dhe fëmijëve në vend, që ishte shkalla më e lartë e pranimit, duke e krahasuar me kontributet e tyre në fusha të ndryshme që shtrihen nga llogaridhënia e institucioneve shtetërore për të

drejtat e njeriut.¹⁸⁰⁷ Megjithatë, kur dhuna ndaj grave tërheq vëmendjen e medias, publiku i gjerë fajëson OJF-të që punojnë me gratë për mungesën e efikasitetit të tyre.¹⁸⁰⁸

Sipas raportit të UN Women të vitit 2021, OJF-të ndërkombëtare në Shqipëri vazhdojnë të punojnë për forcimin e kapaciteteve programore dhe operuese të OJF-ve, duke përfshirë integrimin gjinor në fusha dhe programe të ndryshme tematike.¹⁸⁰⁹ OJF-të, pjesërisht të mbështetura nga donatorët, kanë tendencën të favorizojnë pjesëmarrjen e grave në vend të burrave në seminarët e tyre për zhvillimin e aftësive dhe përpiqen të sigurojnë pjesëmarrje të përzier gjinore në veprimtaritë e tyre.¹⁸¹⁰ Mbledhja e të dhënave që ndahen sipas gjinisë për shtrirjen dhe ndikimin e ngjarjeve dhe projekteve të OJF-ve mbështetet në pjesën më të madhe nga donatorët dhe të dhënat ruhen kryesisht për përdorim të brendshëm.¹⁸¹¹

ROLI

TREGUESI 13.3.1 PËRGJEGJËSIA E QEVERISË

Deri në çfarë pike shoqëria civile është aktive dhe e suksesshme që qeveria të mbajë përgjegjësi për veprimet e saj?



Megjithëse OJF-të janë deri diku aktive në kërkimin e llogaridhënies së qeverisë përmes hetimeve, monitorimit, kërkimit, padive dhe paraqitjes së kallëzimeve penale, efikasiteti i veprimeve të tyre kufizohet në histori të pakta që rezultojnë të suksesshme.

Sipas vlerësimit të Iniciativës Globale, ekzistojnë 49 OJF të përfshira në krimin e organizuar dhe kundër korrupsionit në Shqipëri në 2021,¹⁸¹² megjithëse të pakta janë ato që angazhohen vetëm në luftën kundër korrupsionit.¹⁸¹³ Roli mbikëqyrës publik i shoqërisë civile është rritur në cilësi dhe qëndrueshmëri, por ndikimi i tij që qeveria të mbajë përgjegjësi është akoma i kufizuar. Përveç kësaj, ato përjetojnë presionin e qeverisë dhe mbahet një

qëndrim shpërfillës ndaj rekomandimeve të politikave të tyre.

Veprimtaria e mbikëqyrësit kufizohet në disa OJF të konsoliduara dhe varet nga fondet e donatorëve. Veprimtaritë më me rëndësi të mbikëqyrësit përfshijnë hetimin, kërkimin dhe monitorimin. Vëmendja e OJF-ve ndaj medias ka qenë shumë e madhe në hetimin e një numri skandalesh të korrupsionit në nivele të larta. Me rëndësi të madhe ishte skandali i inceneratorëve për mbetjet,¹⁸¹⁴ ku BIRN-i u hodh në gjyq. BIRN-i e gjykoj padinë si një padë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP).¹⁸¹⁵ Hetime të tjera të rëndësishme përfshijnë procedurat e prokurimit publik (PPP), programin e rindërtimit pas tërmetit të vitit 2019 në Shqipëri, etj.¹⁸¹⁶ Ndër programet e pakta të monitorimit të vazhdueshëm, ResPublica është kthyer në një burim të besueshëm që monitoron zbatimin e legjislacionit për lirinë e informimit.¹⁸¹⁷ Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka monitoruar reformën në drejtësi.¹⁸¹⁸ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) monitoron zbatimin e reformës së administratës publike¹⁸¹⁹ dhe Open Data Albania ndjek shpenzimet e buxhetit publik, duke paralajmëruar për raste të dyshimta të korrupsionit.¹⁸²⁰ Cilësia e kërkimit ka vazhduar të përmirësohet, sidomos për shkak të rritjes së bashkëpunimit me grupet kërkimore ndërkombëtare. Publikimi më i rëndësishëm që zbatohet ishte raporti për zbërthimin e kapjes së shtetit në Shqipëri, i cili shqyrtonte rastet e korrupsionit të madh me anë të ligjeve të posaçme të zbatuara gjatë viteve 2008-2020.¹⁸²¹ Nisma e Lidërshiptit të Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet (SELDI) ka thëlluar kërkimin për kundër korrupsionin dhe kapjen e shtetit në nivel rajoni.¹⁸²²

Nga ana tjetër, OJF-të kanë arritur me sukses të përdorin lidhjet strategjike dhe të paraqesin kallëzimet penale kundër vendimeve të parregullta të qeverisë. Megjithatë, historitë që rezultojnë të suksesshme ndodhin rrallë. Për shembull, çështja gjyqësore e Eco Albania kundër kontratës koncesionare të nënshkruar nga shteti për ndërtimin e një hidrocentrali në lumin Vjosa vërtetoi paligjshmërinë e kontratës dhe konsultimet e

sajuara nga qytetarët në mbështetje të kontratës.¹⁸²³ Një arritje tjetër e shpërblyer ishte lufta ligjore e komunitetit të Zall-Gjoçajt, mbështetur nga Qendra Kujria dhe qendrat e ndihmës ligjore të Fondacionit të Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (OSFA) kundër vendimit për ndërtimin e hidrocentraleve në një zonë të mbrojtur kombëtare.¹⁸²⁴ ResPublica u themelua si një mbrojtëse e lirisë së informimit në procese të ndryshme gjyqësore¹⁸²⁵ si dhe në çështjet lidhur me programin e rindërtimit pas tërmetit të vitit 2019.¹⁸²⁶ Veç kësaj, në vitin 2019 dhe 2020, Nisma Thurje ka paraqitur kallëzime penale në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për hetimin e prokurimeve të spikatura publiko-private për sterilizimin e pajisjeve kirurgjikale dhe çështjen e inceneratorëve.¹⁸²⁷

TREGUESI 13.3.2 REFORMA E POLITIKAVE

Deri në çfarë pike shoqëria civile angazhohet në mënyrë aktive në nismat e reformës së politikave kundër korrupsionit?



Përgjithësisht, shoqëria civile është joaktive dhe e pasuksesshme për t'u angazhuar me qeverinë për politikat kundër korrupsionit.

OJF-të angazhohen në advokimin e politikë bërjes me qeverinë, përgjithësisht në ofrimin e ekspertizës së tyre gjatë konsultimeve publike dhe në ndërmarrjen e nismave ligjore ose politike. Në bazë të raportit të koalicionit të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC), nuk ka rregullore specifike që i dedikohet pjesëmarrjes së publikut në përpjekjet kundër korrupsionit. Këto nisma parashikohen në shtrirjen e gjerë të ligjit për konsultimet publike duke përfshirë konsultime për politika me interes të lartë për publikun.¹⁸²⁸ Në 2019, Kuvendi i Shqipërisë nxori një rezolutë duke njohur rolin e mbrojtësve për të drejtat e njeriut në luftën kundër korrupsionit, por rezoluta nuk është e detyrueshme nga ana ligjore dhe nuk është zbatuar deri më tani.¹⁸²⁹

Përgjithësisht, ndikimi i OJF-ve në konsultimet publike dhe në hartimin e politikave është i kufizuar.¹⁸³⁰ Konsultimet kufizohen nga ana ligjore vetëm në projektligje dhe ato njihen gjerësisht si “zbatime artificiale”.¹⁸³¹ Mungesa e transparencës nga ana e institucioneve publike, konsultimet kontradiktore dhe kufizimet për shkak të pandemisë së COVID-19 kanë përkeqësuar përpjekjet e OJF-ve për advokim.¹⁸³² Publiku dhe OJF-të i konsiderojnë mekanizmat e konsultimit si të paefektshme,¹⁸³³ kryesisht formale¹⁸³⁴ dhe pa ndikuar në legjislacion ose në hartimin e politikave.¹⁸³⁵

Pavarësisht sfidave, shoqëria civile ka dëshmuar kapacitetin e saj për të paraqitur prova në luftën kundër korrupsionit dhe për t'u përfshirë në ndërhyrjet kundër korrupsionit.¹⁸³⁶ Megjithatë, “hartimi i politikave që bazohen në prova ka qenë i vështirë për t'u arritur në praktikë në një mënyrë kuptimplote” për shkak të rezistencës së politikëbërësve dhe mosbesimit dhe hezitimit të grupit të ekspertëve për t'u angazhuar me autoritetet shtetërore.¹⁸³⁷ Pavarësisht nga numri i ulët, ka pasur raste kur përpjekjet e advokimit kanë rezultuar të suksesshme në njëfarë mase. Për shembull, reforma në drejtësi ishte një nismë kundër korrupsionit e financuar nga fondet e ndihmës, e cila konsiderohet si “maja e bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë”,¹⁸³⁸ megjithëse zbatimi i saj ka shkaktuar probleme nga OJF-të.¹⁸³⁹ Pavarësisht skandaleve të shumta të korrupsionit dhe kritikave ndaj PPP-ve, qeveria vazhdoi me politikën e saj,¹⁸⁴⁰ por kufizoi ligjërisht fushat për pranimin e propozimeve të pa kërkuara për prokurimet publike-private, duke ndjekur rekomandimet e Fondacionit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore.¹⁸⁴¹ Së fundmi, OJF-të përqendrohen në ndërhyrjet e synuara kundër korrupsionit për të rritur realizimin e projekteve të tyre. Për shembull, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë miratoi zbatimin e planit të integritetit të hartuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me ministrinë,¹⁸⁴² duke e zgjeruar praktikën në disa institucione publike vendore dhe qendrore.¹⁸⁴³

NDËRVEPRIMET

Në përgjithësi, shoqëria civile ndërvepron me median, organin ekzekutiv dhe organin gjyqësor. Ndërveprimi me organin ekzekutiv lehtësohet përmes mekanizmave të platformës së dialogut si Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian. Megjithatë, këto platforma nuk kanë arritur të plotësojnë nevojat e tyre për të rritur përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit në BE.¹⁸⁴⁴ Ato nuk kanë as bashkëpunim të avancuar dhe as dialog për zhvillimin e komunitetit në vend, pasi në vitin 2021 nuk janë mbajtur mbledhje të këshillit¹⁸⁴⁵ dhe në vitin 2022 janë mbajtur vetëm dy mbledhje.¹⁸⁴⁶ Siç u përmend edhe më parë, ndikimi i OJF-ve në konsultimet publike dhe në hartimin e politikave është i kufizuar¹⁸⁴⁷ për shkak të zvogëlimit të transparencës së procesit të vendimmarrjes së qeverisë¹⁸⁴⁸ dhe përdorimit të ulët të provave të paraqitura nga OJF-të në hartimin e politikave.¹⁸⁴⁹ Media shërben si një avokat për kauzat e shoqërisë civile, ashtu edhe si mjet denigrues duke nxitur sulme ndaj shoqërisë civile, në veçanti të dukshme në mediat që ndikohen nga qeveria.¹⁸⁵⁰ Ndërveprimi është rritur prej rritjes së rolit të mediave vizive dhe të mediave të tjera në veprimtarinë e OJF-ve, për zhvillimin e mediave të reja të OShC-ve dhe për rritjen e pranisë së ekspertizës së OJF-ve në studiot mediatike. Kohët e fundit, ndërveprimi i organit gjyqësor me OJF-të gjithashtu ka ardhur duke u rritur. OJF-të kanë ngritur padi në gjykatë dhe kanë dorëzuar dosje penale në zyrat e prokurorive, duke adresuar praktikën e mundshme korruptive të pushtetit qendror dhe vendor.

Marrëdhëniet ndërmjet OJF-ve dhe shërbimit civil duhet të transformohen drejt një bashkëpunimi të vazhdueshëm duke u bazuar në shkëmbimin e informacionit, përvojës dhe njohurive, pasi shoqëria civile dhe shërbimi civil përbëjnë komunitetin. Ndërveprimet me Kuvendin dhe pushtetin vendor duhet të forcohen më tej për të përmirësuar kontributin e sektorit në legjislacion dhe ofrimin e shërbimeve në nivel vendi.

REKOMANDIMET E ORGANIT

- + OJQ-të duhet të shtojnë përpjekjet e advokimit për zbatimin e veprimtarive të parashikuara në Udhërrëfyesin për një Mjedis më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023 dhe të angazhohen në mënyrë proaktive duke u konsultuar për një udhërrëfyes të mundshëm për 2024-2028.
- + Organizatat vetërregulluese duhet të rrisin nivelin e trajnimeve me OJQ-të në mënyrë që ato të mund të rrisin kapacitetet për të përdorur mundësitë alternative të financimit, duke përfshirë iniciativat për financimin bashkëpunues, thirrjet për prokurime publike, rimbursimet e TVSH-së, përjashtimin nga TVSH-ja, të ardhurat nga veprimtaritë sociale, etj.
- + Organizatat vetërregulluese duhet të rrisin anëtarësimin e OJQ-ve në Kodin e Sjelljes dhe të shtojnë përpjekjet për zbatimin e plotë të Kodit të Sjelljes nga anëtarët e OJQ-ve të tyre, në veçanti lidhur me transparencën financiare dhe llogaridhënien dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.
- + Kuvendi duhet të ndryshojë Kodin Penal, Neni 262 për organizimin dhe marrjen pjesë në tubime dhe manifestime të paligjshme, i cili penalizon të drejtën e tubimit paqësor me gjobë ose me burgim deri në një vit. I gjithë Neni duhet të rikonceptohet dhe mundësisht të hiqet pasi është ndërtuar mbi kërkesën jokushtetuese për marrjen e lejes nga Policia e Shtetit për organizimin e demonstratave.

BIBLIOGRAFI

- ¹⁶⁹¹ Ligji nr. 8788 Për Organizatat Jofitimprurëse, 03.04.2013, Neni 2, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2001/05/07/8788> [aksesuar më 4 shkurt 2023].
- ¹⁶⁹² Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, *Matrica e Monitorimit për Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti i Vendit Shqipëri 2022* (Tiranë: Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2023), f.9, <https://www.partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-csos-development-country-report-for-albania-2022/> [aksesuar më 20 korrik 2023].
- ¹⁶⁹³ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2023: 20.
- ¹⁶⁹⁴ Freedom House, Kombet në Transit 2022 Shqipëri, <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2022> [aksesuar më 22 korrik 2023].
- ¹⁶⁹⁵ Qëndrueshmëria e përgjithshme për vitin 2021 ishte 3.7, dhe qëndrueshmëria financiare ishte 4.5, ku 12 është qëndrueshmëria e rritur dhe 57 është qëndrueshmëri e penguar. Burimi: FHI360, *2021 Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazinë*, Publikimi i 25-të (USAID, ICNL dhe FHI360, 2023), f.10, <https://www.fhi360.org/sites/default/files/media/documents/csosi-europe-eurasia-2021-report.pdf> [aksesuar më 5 shkurt 2023].
- ¹⁶⁹⁶ Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Misioni dhe Objektivat e AMShC-së, <https://amshc.gov.al/en/mission-and-objectives-of-ascs/> [aksesuar më 12 shkurt 2023].
- ¹⁶⁹⁷ Qendra Kombëtare e Burimeve për Shoqërinë Civile në Shqipëri, <https://resourcecentre.al/> [aksesuar më 5 shkurt 2023].
- ¹⁶⁹⁸ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2023: 22.
- ¹⁶⁹⁹ Ligji për Organizatat Jofitimprurëse, Neni 41.
- ¹⁷⁰⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përditësuar më 10.02.2022, Neni 46, <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd> [aksesuar më 6 shkurt 2023].
- ¹⁷⁰¹ Shih ligjin nr. 8788 për Organizatat Jofitimprurëse; Ligji nr. 80/2021 për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse, 24.06.2021, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2021/06/24/80> [aksesuar më 6 shkurt 2023].
- ¹⁷⁰² Ligji për Organizatat Jofitimprurëse, Neni 3; BCSDN, Kuadri Ligjor – Ligji për Lirinë e Shoqatës (duke përfshirë Fondacionet) dhe Rregulloret e saj, <https://balkancsd.net/civil-dialogue/albania/legal-framework-law-on-freedom-of-association-incl-foundations-and-its-regulation/> [aksesuar më 8 shkurt 2023].
- ¹⁷⁰³ FHI360, *2020 Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazinë Publikimi i 24-të* (USAID, ICNL dhe FHI360, 2021), f.11, <https://www.fhi360.org/sites/default/files/media/documents/csosi-europe-eurasia-2020-report.pdf> [aksesuar më 6 shkurt 2023].
- ¹⁷⁰⁴ FHI360, *2019 Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazinë Publikimi i 23-të* (USAID, ICNL dhe FHI360, 2020), f.12, <https://www.fhi360.org/sites/default/files/media/documents/csosi-europe-eurasia-2019-report.pdf> [aksesuar më 6 shkurt 2023].
- ¹⁷⁰⁵ Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë 2023, f.12, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2021-10/Albania-Report-2021.pdf> [aksesuar më 6 shkurt 2023].
- ¹⁷⁰⁶ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2023: 21.
- ¹⁷⁰⁷ FHI360 2021: 10.
- ¹⁷⁰⁸ Asistenca Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi (TACSO), Raporti Përfundimtar Vlerësimi i Gjendjes së Mjedisit Mundësues dhe Kapaciteteve të Shoqërisë Civile Kundër Udhëzimeve 2014-2020 për Mbështetjen e BE-së për Shoqërinë Civile në Rajonin e Zgjerimit për vitin 2020 (Shkup: TACSO, 2021), f.44, <https://tacso.eu/wp-content/uploads/2022/05/Civil-Society-Assessment-Report-for-2020.pdf> [aksesuar më 6 shkurt 2023].
- ¹⁷⁰⁹ Partnerët Shqipëri, 2023: 9-10.
- ¹⁷¹⁰ Ligji 80/2021 për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse, Neni 51.
- ¹⁷¹¹ Ligji 80/2021 për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse, Neni 36.
- ¹⁷¹² FHI360, 2023: 11.
- ¹⁷¹³ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2021: 9.
- ¹⁷¹⁴ Ligji 80/2021 për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse, Neni 51, 53.
- ¹⁷¹⁵ Ligji 80/2021 për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse, Neni 51.

- ¹⁷¹⁶ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022, f. 10.
- ¹⁷¹⁷ Ligji 80/2021 për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse, Neni 33.
- ¹⁷¹⁸ FHI360 2021: 11.
- ¹⁷¹⁹ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Udhëzimi nr. 34, <https://www.cbc-mne-alb.org/tacka-custom/tacka-media/2019/12/INSTRUCTION-No.34-date.5.12.2019.pdf> [aksesuar më 7 shkurt 2023].
- ¹⁷²⁰ FHI360 2021: 11.
- ¹⁷²¹ Ligji 162/2020 për *Prokurimin Publik*, 23.12.2020, Neni 7, 103, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/12/23/162> [aksesuar më 7 shkurt 2023].
- ¹⁷²² FHI360 2021: 11.
- ¹⁷²³ Komisioni Evropian, 2021: 14.
- ¹⁷²⁴ Ligji 80/2020 për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse, Neni 51. Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022: 13.
- ¹⁷²⁵ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022: 11.
- ¹⁷²⁶ FHI360, 2021: 13.
- ¹⁷²⁷ FHI360, 2021: 13.
- ¹⁷²⁸ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022: 14-16.
- ¹⁷²⁹ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Rënia e demokracisë dhe Tkurra e shoqërisë civile: Si të ndryshojmë prirjet?, f.15, 37, https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Democracy-decline-and-shrinking-civic-space_ENG.pdf [aksesuar më 8 shkurt 2023].
- ¹⁷³⁰ Dokumenti i buxhetit vjetor i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile gjatë viteve 2015-2019 ishte 101,000,000 lekë (878,000 euro), në vitin 2020 ishte 61,000,000 lekë (530,000 euro), në 2021 ishte 90,000,000 ALL (783,000 euro) dhe në 2022 ishte 95,000,000 lekë (826,000 euro). Shih Raportet Vjetore të Veprimtarisë të AMShC-së në <https://amshc.gov.al/raporte-vjetore-te-veprimtarise/>
- ¹⁷³¹ Arlinda Ymeraj, *Hartëzimi i Shërbimeve Sociale në Shqipëri* (Tiranë: DPShCSH 2021), f. 5, <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Raporti-SSS-final-OK.pdf> [aksesuar më 8 shkurt 2023].
- ¹⁷³² Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2021, f. 32.
- ¹⁷³³ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022, f. 13.
- ¹⁷³⁴ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022, f. 13.
- ¹⁷³⁵ FHI360, 2023, f. 14.
- ¹⁷³⁶ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022: 13; *Euronews Albania*, Ekspertët Diskutojnë se Përse Shqiptarët S'kanë Besim te Shoqëria Civile, <https://euronews.al/pse-shqiptaret-s-kane-besim-te-shoqeria-civile-analistet-diskutojne-arsyet/> [aksesuar më 15 korrik 2023].
- ¹⁷³⁷ FHI360, 2021: 14.
- ¹⁷³⁸ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2021: 32.
- ¹⁷³⁹ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, *Filantropia* (Tiranë: Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022), f.18, http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2022/02/philanthropy.ed_3.pdf [aksesuar më 8 shkurt 2023].
- ¹⁷⁴⁰ TACSO, 2021: 46.
- ¹⁷⁴¹ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022: 20.
- ¹⁷⁴² FHI360, 2023: 13.
- ¹⁷⁴³ FHI360, 2021: 10.
- ¹⁷⁴⁴ FHI360, 2023: 13.
- ¹⁷⁴⁵ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, *Hartëzimi i Vlerësimit të Rrjeteve të Organizatave të Shoqërisë Civile në Shqipëri' Rrjetet në Shqipëri* (Tiranë: Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2019), f.8, <https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2019/12/Mapping-and-assessment-of-civil-society-organizations-networks-in-Albania.pdf> [aksesuar më 9 shkurt 2023].
- ¹⁷⁴⁶ FHI360, 2023: 13.
- ¹⁷⁴⁷ K. Kote, Shqiptarët me orët më të gjata të punës në javë në Evropë, <https://albaniandailynews.com/news/albanians-with-longest-working-hours-per-week-in-europe> [aksesuar më 16 shkurt 2023]; S. Danaj, Jeta dhe Puna në Shqipëri, <https://www.eurofound.europa.eu/country/albania> [aksesuar më 16 shkurt 2023]; Intervistat e zhvilluara në janar 2023 me dy aktivistë të shoqërisë civile që punojnë në OJF të ndryshme në Shqipëri, të cilët kërkuar të mbeshin anonimë.

- ¹⁷⁴⁸ B. Bino dhe të tjerë, Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimmarrje në Shqipëri (Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2020), f. 45, <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/CSO-Participation-in-Decision-Making-in-Albania.pdf> [aksesuar më 9 shkurt 2023].
- ¹⁷⁴⁹ Ligji nr. 8788 për Organizatat Jofitimprurëse, Neni 6, 7.
- ¹⁷⁵⁰ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2021: 11-12.
- ¹⁷⁵¹ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2021: 11-12.
- ¹⁷⁵² FHI360, 2021: 10.
- ¹⁷⁵³ FHI360, 2020: 12.
- ¹⁷⁵⁴ Lajmpress, Etilda Gjonaj: Pas 20 Vjetësh me Një Ligj për Regjistrimin e Organizatave të Shoqërisë Civile [Etilda Gjonaj: <https://lajmpress.org/etilda-gjonaj-pas-20-vjetesh-me-nje-ligj-per-regjistrimin-e-organizatave-te-shoqerise-civile/> [aksesuar më 9 shkurt 2023].
- ¹⁷⁵⁵ rupi i OJF-ve, Thirrje Publike kundër Miratimit të Projektligjit për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse, <http://partnersalbania.org/News/thirrje-publike-per-projektligjin-per-regjistrimin-e-organizatave-jofitimprurese/> [aksesuar më 17 shkurt 2023].
- ¹⁷⁵⁶ Qendra Kombëtare e Burimeve për Shoqërinë Civile në Shqipëri, Informacion Lidhur me Hyrjen në Fuqi të Ligjit Nr. 80/2021 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, <https://resourcecentre.al/sq/informacion-lidhur-me-hyrjen-ne-fuqi-te-ligjit-nr-80/2021-per-regjistrimin-e-organizatave-jofitimprurese/> [aksesuar më 9 shkurt 2023].
- ¹⁷⁵⁷ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2020: 17.
- ¹⁷⁵⁸ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Vendimi nr. 24, datë 4 maj 2021, https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php [aksesuar më 9 shkurt 2023].
- ¹⁷⁵⁹ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022: 7; BalkanWeb, Gjykata Kushtetuese Pranon Kërkesën, Shfuqizohet Neni 262 i Kodit Penal, S’ka Më Leje për Grumbullime e Manifestime, <https://www.balkanweb.com/gjykata-kushtetuese-pranon-kerkesen-shfuqizohet-neni-262-i-kodit-penal-ska-me-leje-per-grumbullime-e-manifestime/#gsc.tab=0> [9 shkurt 2023]; Avokati i popullit, Liria e tubimit dhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Liria%20e%20tubimit%20dhe%20Vendimi%20i%20Gjykat%C3%ABs%20Kushtetuese.pdf> [aksesuar më 18 shkurt 2023].
- ¹⁷⁶⁰ Ligji nr. 7895 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, 04.05.2021, Neni 262, <https://qbz.gov.al/preview/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d>.
- ¹⁷⁶¹ Qendra Kombëtare e Burimeve për Shoqërinë Civile në Shqipëri, Informacion Lidhur me Hyrjen në Fuqi të Ligjit Nr. 80/2021 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, <https://resourcecentre.al/sq/informacion-lidhur-me-hyrjen-ne-fuqi-te-ligjit-nr-80/2021-per-regjistrimin-e-organizatave-jofitimprurese/> [aksesuar më 9 shkurt 2023].
- ¹⁷⁶² Ligji nr. 9887 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Neni 7, Pika 1, e. <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2008/03/10/9887>
- ¹⁷⁶³ Civicus Monitor, Gjendja aktuale: E kufizuar, përditësimi i fundit më 30.6.2022 <https://monitor.civicus.org/country/albania/> [aksesuar më 10 shkurt 2023]; Shih FHI360 2021: 9; FHI360 2023: 10.
- ¹⁷⁶⁴ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022: 10.
- ¹⁷⁶⁵ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2023: 10-11.
- ¹⁷⁶⁶ *Euronews Albania*, Qytetarët Tregojnë Hapur Çfarë Opinioni Kanë për Shoqërinë Civile, <https://euronews.al/qytetaret-tregojne-hapur-çfare-opinioni-kane-per-shoqerine-civile/> [aksesuar më 15 korrik 2023].
- ¹⁷⁶⁷ B. Bino dhe të tjerë. 2020: 19.
- ¹⁷⁶⁸ Freedom House, Kombet në Transit 2022 Shqipëri, <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2022> [aksesuar më 22 korrik 2023].
- ¹⁷⁶⁹ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2019: 8.
- ¹⁷⁷⁰ FHI360 2021: 11; 15; FHI360 2023: 18.
- ¹⁷⁷¹ B. Bino dhe të tjerë. 2020: 18.
- ¹⁷⁷² Rasti më i spikatur erdhi nga publikimi i raportit “Zbërthimi i kapjes së shtetit në Shqipëri”, botuar në vitin 2021. Shih Freedom House, Kombet në Transit 2021 Albania, https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2022#footnote4_i9zdrpc [aksesuar më 11 shkurt 2023].

- ¹⁷⁷³ Shih Reporteri, Rama e Quan Raportin e Transparency International të Pavërtetë e Tendencioz, <https://reporteri.net/lajme/shqiperia/rama-e-quan-raportin-e-transparency-international-te-pavertete-e-tendencioz/> [aksesuar më 24 korrik 2023].
- ¹⁷⁷⁴ P. Pustina, Fushata Sensacionaliste e Dezinformimit “Prindi 1 dhe Prindi 2” i Fryu Flakëve të Homofobisë në Shqipëri, <https://faktoje.al/fushata-sensacionaliste-e-dezinformimit-prindi-1-dhe-prindi-2-i-fryu-flakeve-te-homofobise-ne-shqiperi/> [aksesuar më 3 gusht 2023].
- ¹⁷⁷⁵ B. Bino dhe të tjerë. 2020: 18.
- ¹⁷⁷⁶ FHI360 2023: 16.
- ¹⁷⁷⁷ Freedom House, Kombet në Transit 2021, https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2022#footnote4_i9zdrpc.
- ¹⁷⁷⁸ Civicus Monitor, Protestat kundrejt rritjes së çmimeve u bënë pre e dhunës dhe arrestimeve <https://monitor.civicus.org/updates/2022/04/13/protests-against-rising-prices-met-excessive-force-and-detentions/> [aksesuar më 14 shkurt 2023].
- ¹⁷⁷⁹ Avokati i Popullit, Avokati i Popullit Reagon mbi Përplasjet në Sheshin “Skënderbej”, <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-479/> [aksesuar më 11 shkurt 2023]; Policia e Shtetit, Raporti i Ngjarjeve për 72 Orët e Fundit, Policia e Shtetit, <https://www.asp.gov.al/raporti-i-ngjarjeve-per-72-oret-e-fundit-policia-e-shtetit-34/> [aksesuar më 12 dhjetor 2022]; Policia e Shtetit, Tiranë – Organizuan Protestë të Paligjshme, Procedohen Penalisht 9 Persona, <https://www.asp.gov.al/tirane-organizuan-proteste-te-paligjshme-procedohen-penalisht-9-persona/> [aksesuar më 12 dhjetor 2022].
- ¹⁷⁸⁰ Civicus Monitor, Brutaliteti dhe vrasja e policisë si pasojë e shkeljes së kufizimit të Covid-19 nxit protesta, <https://monitor.civicus.org/updates/2021/02/23/police-brutality-and-killing-response-covid-19-curfew-breach-sparks-protests/> [aksesuar më 12 shkurt 2023].
- ¹⁷⁸¹ B. Bino, 2020: 19.
- ¹⁷⁸² FHI360, 2022: 9-10.
- ¹⁷⁸³ TACSO, 2021: 33.
- ¹⁷⁸⁴ FHI360 2020: 10.
- ¹⁷⁸⁵ TACSO, 2021: 47.
- ¹⁷⁸⁶ FHI360, 2023: 13.
- ¹⁷⁸⁷ B. Bino dhe të tjerë., 2020: 21; FHI360, 2023: 12.
- ¹⁷⁸⁸ TACSO, 2021: 47.
- ¹⁷⁸⁹ FHI360, 2023: 12.
- ¹⁷⁹⁰ I. Semini dhe të tjerë., *Sondazhi 2022: Besimi në Qeverisje, Botimi i 10-të*(Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2023), f.27-28 <https://idmalbania.org/publication-of-the-10th-edition-of-trust-in-governance-annual-public-opinion-poll-in-albania/> [aksesuar më 25 korrik 2023].
- ¹⁷⁹¹ B. Bino, 2020: 21.
- ¹⁷⁹² TACSO, 2021: 45.
- ¹⁷⁹³ TACSO, 2021: 32.
- ¹⁷⁹⁴ FHI360, 2020: 10.
- ¹⁷⁹⁵ Qendra Kombëtare e Burimeve për Shoqërinë Civile në Shqipëri, Kodi i Standardeve për Organizatat Jofitimprurëse në Shqipëri: Një praktikë vetërregulatore për mirë qeverisje, transparencë dhe llogaridhënie të sektorit jofitimprurës, <https://resourcecentre.al/code-of-standards-for-non-profit-organizations-in-albania-a-self-regulatory-practice-for-good-governance-transparency-and-accountability-of-the-non-profit-sector/> [aksesuar më 12 shkurt 2023].
- ¹⁷⁹⁶ Qendra Kombëtare e Burimeve për Shoqërinë Civile në Shqipëri, Kodi i Standardeve për Organizatat Jofitimprurëse në Shqipëri (Tiranë: Partnerët për Ndryshim dhe Zhvillim, 2021), f.5, <https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2021/08/KODI-I-STANDARDEVE-PER-ORGANIZATAT-JOFITIMPRURESE-NE-SHQIPERI.pdf> [aksesuar më 12 shkurt 2023].
- ¹⁷⁹⁷ Qendra Kombëtare e Burimeve për Shoqërinë Civile në Shqipëri, 2021: 16.
- ¹⁷⁹⁸ Qendra Kombëtare e Burimeve për Shoqërinë Civile në Shqipëri, 2021: 19.
- ¹⁷⁹⁹ TACSO, 2021: 47.

- ¹⁸⁰⁰ Qendra Kombëtare e Burimeve për Shoqërinë Civile në Shqipëri, Njoftim për shprehje interesi për anëtarësim në Kodin e Standardeve për Organizatat Jofitimprurëse në Shqipëri, <https://standards4npo.al/post/24> [aksesuar më 14 shkurt 2023].
- ¹⁸⁰¹ Qendra Kombëtare e Burimeve për Shoqërinë Civile në Shqipëri, Anëtarët e Kodit të Standardeve, <https://standards4npo.al/member-listing> [aksesuar më 14 shkurt 2023].
- ¹⁸⁰² Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022: 10.
- ¹⁸⁰³ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2023: 11.
- ¹⁸⁰⁴ BCSDN, CfA: Thirrje për Anëtarët – Komuniteti Rajonal për Praktikën e Llogaridhënies (RACoP) të BCSDN-së, <https://balkanscd.net/cfa-a-call-for-members-bcsdns-regional-accountability-community-of-practice-racop-deadline-n-a-3/> [aksesuar më 18 shkurt 2023].
- ¹⁸⁰⁵ INSTAT, Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2021 (Tiranë: Instituti i Statistikave për Republikën e Shqipërisë, 2021), f. 79, <https://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/gender-equality/publication/2021/women-and-men-in-albania-2021/> [aksesuar më 18 shkurt 2023]; TACSO, 2021: 41.
- ¹⁸⁰⁶ TACSO, <https://tacso.eu/wp-content/uploads/2022/05/Civil-Society-Assessment-Report-for-2020.pdf> f. 41.
- ¹⁸⁰⁷ Euronews Albania, Qytetarët Tregojnë Hapur Çfarë Opinioni Kanë për Shoqërinë Civile, Minutazhi 1:31:30, <https://euronews.al/qytetaret-tregojne-hapur-çfare-opinioni-kane-per-shoqerine-civile/> [aksesuar më 15 korrik 2023].
- ¹⁸⁰⁸ B. Bino, 2020: 18.
- ¹⁸⁰⁹ UN Women, *Analizë e vlerësimit të vendit, Shqipëri, Raport i përgjithshëm*, (Tiranë: UN Women, 2021), f. 29, 37, 39, <https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-07/Albania%20CPE%20Synthesis%20Report.pdf> [aksesuar më 19 shkurt 2023].
- ¹⁸¹⁰ TACSO, 2021: 41.
- ¹⁸¹¹ Intervistat e bëra në janar 2023, me dy aktivistë të shoqërisë civile që punonin në OJF të ndryshme në Shqipëri, të cilët kërkuan të mbeten anonimë.
- ¹⁸¹² K. Amerhauser, W. Kemp, *Të bashkuar, më të fortë, Forcimi i qëndrueshmërisë ndërmjet shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor*, (Gjenevë: Iniciativa Globale, 2021) f. 5, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/03/WBalkans-CSOs-web.pdf> [aksesuar më 16 shkurt 2023].
- ¹⁸¹³ SELDI, *Shoqëria Civile Kundër Korrupsionit, Kundërshtimi i kapjes së OShC-ve*, (Shkup: SELDI, 2022), f. 5. <https://seldi.net/publications/seldi-policy-brief-16-civil-society-in-anti-corruption-counter-cso-capture/> [aksesuar më 12 shkurt 2023].
- ¹⁸¹⁴ A. Bogdani, B. Likmeta, Inceneratori: Si e ndërtoi perandorinë në rrënoja shqiptari i lidhur nga ana politike, <https://balkaninsight.com/2020/09/28/the-incinerator-how-a-politically-connected-albanian-built-an-empire-on-waste/> [aksesuar më 16 shkurt 2023].
- ¹⁸¹⁵ Gj. Erebara, Mirel Mërtiri, Padi Kundër BIRN Albania për Dëm “Moral dhe Ekzistencial”, <https://www.reporter.al/2020/12/01/mirel-mertiri-padi-kunder-birn-albania-per-dem-moral-dhe-ekzistencial/> [aksesuar më 17 shkurt 2023].
- ¹⁸¹⁶ Respublica, Si u shndërrua rindërtimi në një barrë për buxhetin e shtetit, <https://www.respublica.org.al/si-u-shnderrua-rindertimi-ne-nje-barre-per-buxhetin-e-shtetit/> [aksesuar më 19 shkurt 2023]; O. Mitre, PPP-të në Shëndetësi: Shqiptarët Paguajnë Miliona Euro për Shërbime të Pakryera, <https://www.reporter.al/2022/01/25/ppp-te-ne-shendetesi-shqiptaret-paguajne-miliona-euro-per-sherbime-te-pakryera/> [aksesuar më 19 shkurt 2023]; B. Likmeta, Kontraktori i linjës së furnizimit me energji në Shqipëri i pagoi miliona konsulencës së jashtme, <https://balkaninsight.com/2021/10/04/contractor-on-albania-power-line-paid-millions-to-offshore-consultancy/> [aksesuar më 19 shkurt 2023]; Gj. Erebara, Ministria e Financave Dështon të Publikojë Raportin e Performancës së Koncesioneve, <https://www.reporter.al/2022/08/19/ministria-e-financave-desh-ton-te-publikoje-raportin-e-performances-se-koncesioneve/> [aksesuar më 21 shkurt 2023].
- ¹⁸¹⁷ D. Matlija and I. Dule, *E Drejta e Informimit 2020*, (Tiranë: Res Publica, 2021), <https://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2021/04/Raporti-FOI-2020-Res-Publica.pdf> [aksesuar më 20 shkurt 2023].
- ¹⁸¹⁸ Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Reforma Në Drejtësi – Vetingu i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, <https://ahc.org.al/fushat-e-veprimtarise/reforma-ne-drejttesi-vettingu-i-gjyqtareve-dhe-prokuroreve/> [aksesuar më 20 shkurt 2023].
- ¹⁸¹⁹ WeBER, Monitorimi i Reformës në Administratën Publike, www.par-monitor.org [aksesuar më 20 shkurt 2023].
- ¹⁸²⁰ Open Data Albania, https://ndiqparate.al/?page_id=10789&lang=en [aksesuar më 20 shkurt 2023].

¹⁸²¹ Gj. Vurmo et al., *Zbërthimi i kapjes së shtetit në Shqipëri: Një shqyrtim i rasteve të korrupsionit të madh dhe ligjeve të posaçme që nga 2008 deri në 2020*, (Transparency International, 2021),

https://images.transparencycdn.org/images/2021_Report_DeconstructingStateCaptureAlbania_English.pdf

[aksesuar më 22 shkurt 2023];

Gj. Erebara, Sundimi me Ligje Speciale Është e Kundërta e Sundimit të Ligjit,

<https://www.reporter.al/2018/07/02/sundimi-me-ligje-speciale-eshte-e-kunderta-e-sundimit-te-ligjit/#https://www.reporter.al/sundimi-me-ligje-speciale-eshte-e-kunderta-e-sundimit-te-ligjit/>

[aksesuar më 22 shkurt 2023].

¹⁸²² SELDI, <https://seldi.net/> [aksesuar më 20 shkurt 2023].

¹⁸²³ Intervistë me përfaqësuesin e OJF-së Eco Albania, 17 shkurt 2023; Monitor.al, HEC-i i Poçemit mbi Vjosë, Sekretariati i Energjisë: Dy Muaj Kohë Shqipërisë që të "Mbrohët" <https://www.monitor.al/hec-i-i-pocemit-mbi-vjose-sekretariati-i-energjise-dy-muaj-kohe-shqiperise-qe-te-mbrohet/> [aksesuar më 2023].

¹⁸²⁴ FHI360 2023: 7.

¹⁸²⁵ D. Matlija dhe I. Dule, 2021.

¹⁸²⁶ Respublica, Rindërtimi – Zbardhet Vendimi i Gjykatës Administrative të Tiranës që Zbulon Abuzimin e Bashkisë Tiranë për Prishjen e Pallateve në Kombinat, <https://www.respublica.org.al/rindertimi-zbardhet-vendimi-i-gjykates-administrative-te-tiranes-qe-zbulon-abuzimin-e-bashkise-tirane-per-prishjen-e-pallateve-ne-kombinat/> [aksesuar më 21 shkurt 2023].

¹⁸²⁷ *Zëri i Amerikës*, Tiranë: SPAK merr kallëzimin e parë. Nisma "Thurje" Denoncon Koncesionin e Sterilizimit SPAK merr dosjen e parë. <https://www.zeriamerikes.com/a/5216615.html> [aksesuar më 21 shkurt 2023]; E. Kadriu, Nisma "Thurje" kallëzim penal në SPAK për inceneratorin e Fierit, <https://citizens-channel.com/2020/06/24/nisma-thurje-kallezim-penal-ne-spak-per-inceneratorin-e-fierit/> [aksesuar më 21 shkurt 2023].

¹⁸²⁸ A. Dafa, et al, *Raporti i shoqërisë civile për zbatimin e Kapitullit II (Parandalimi) dhe Kapitullit 5 (Rikuperimi i asetëve) të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit në Shqipëri*, (Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2023), f. 47, <https://uncaccoalition.org/albania-parallel-report-idm-july-2023-en/> [aksesuar më 27 korrik 2023].

¹⁸²⁹ A. Dafa dhe të tjerë, 2023: f. 49.

¹⁸³⁰ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022: 19.

¹⁸³¹ Komisioni Evropian, 2021: 13.

¹⁸³² FHI360, 2023: 14.

¹⁸³³ TACSO, 2021: 47;

¹⁸³⁴ I. Semini dhe të tjerë, 2023: 64.

¹⁸³⁵ B. Bino dhe të tjerë, 2020: 41.

¹⁸³⁶ S. Hroni, Roli i shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit, <https://idmalbania.org/albania-osce-chairmanship-speech/> [aksesuar më 23 shkurt 2023].

¹⁸³⁷ B. Bino, *Zhvillimi i politikave me probleme në Shqipëri – Trajtimi i mungesës së transparencës dhe hartimit të politikave të bazuara në prova*, (Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2022), f. 3, <https://www.par-monitor.org/flawed-policymaking-in-albania/> [aksesuar më 27 korrik 2023].

¹⁸³⁸ B. Bino dhe të tjerë, 2020: 38.

¹⁸³⁹ E. Hoxhaj, Akuzat për konflikt të interesit tejkalojnë reformën në drejtësi të Shqipërisë, <https://balkaninsight.com/2021/08/06/accusations-of-conflicts-of-interest-overshadow-albanias-justice-reform/> [aksesuar më 22 shkurt 2023]; Vladimir Karaj, Pyetjet mbi transparencën për përpjekjet shqiptare për të shpëtuar gjykatat nga korrupsioni, <https://balkaninsight.com/2020/01/24/transparency-questions-over-albanian-effort-to-rid-courts-of-corruption/> [aksesuar më 22 shkurt 2023]; Artur Malaj, Vetingu i gjyqtarit shqiptar nënvlehtësoi akuzat për korrupsion, <https://balkaninsight.com/2018/11/05/vetting-of-albanian-judge-disregarded-corruption-allegations-11-02-2018/> [aksesuar më 22 shkurt 2023].

¹⁸⁴⁰ A. Bogdani, Qeveria Injoron Kritikën dhe Firmos Koncesionin e Katërt në Shëndetësi, <https://www.reporter.al/2019/04/27/qeveria-injoron-kritikat-dhe-firmos-koncesionin-e-katert-ne-shendetesi/> [aksesuar më 23 shkurt 2023].

¹⁸⁴¹ Gj. Erebara, Qeveria Ndalon me Ligj Koncesionet që u Bënë Simbol i Saj, <https://www.reporter.al/2019/01/22/qeveria-ndalon-me-ligj-koncesionet-qe-u-bene-simbol-i-saj/> [aksesuar më 23 shkurt 2023].

¹⁸⁴² Ministria e Drejtësisë, Urdhër nr. 333, më 7.10.2020, për Miratimin e Planit të Integritetit për Ministrinë e Drejtësisë 2020-2023, https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/1.-Plani-i-Integritetit-p%C3%ABr-Ministrin%C3%AB-e-Drejt%C3%ABsis%C3%AB-2020-2023_AL.pdf [aksesuar më 23 shkurt 2023].

¹⁸⁴³ UNDP, STAR 3 – Mbështetja dhe avancimi i reformës së qeverisjes vendore <https://www.undp.org/albania/projects/star-3-sustaining-and-advancing-local-governance-reform> [aksesuar më 23 shkurt 2023].

¹⁸⁴⁴ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2023: 7.

¹⁸⁴⁵ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022: 18.

¹⁸⁴⁶ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022: 21.

¹⁸⁴⁷ Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022: 19.

¹⁸⁴⁸ A. Dafa dhe I. Shënplaku, PAR Monitor Albania 2021-2022, (Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2023), f. 41, <https://www.par-monitor.org/albania-par-monitor-2021-2022/> [aksesuar më 30 korrik 2023].

¹⁸⁴⁹ A. Dafa, I. Shënplaku, 2023: 44.

¹⁸⁵⁰ FHI360, 2023: 18.

BIZNESI

PËRMBLEDHJE



Sektori privat rregullohet kryesisht nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Ligji për Regjistrimin e Bizneseve dhe legjislacioni për kontabilitetin, auditimin ligjor, tatimet dhe doganat, si dhe Kodi i Procedurës Administrative.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë vendos politikën ekonomike, ndërsa Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është krijuar për të mbështetur dhe mbrojtur sipërmarrjen private, për të rritur bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të ndryshme në mënyrë që të përmirësohen shërbimet publike për bizneset dhe krijimin e një mjedisi miqësor dhe kushte të favorshme për sipërmarrjen që të lulëzojë.

Në 2022 ishin 125,222 shoqëri ekonomikisht aktive dhe po atë vit u regjistruan 15,700 shoqëri të reja.¹⁸⁵¹ Shumica e bizneseve veprojnë në sektorin e tregtisë, ndjekur nga shërbimet e akomodimit dhe ushqimit, si dhe sektori industrial. Pjesa më e madhe e bizneseve në Shqipëri janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme që ofrojnë shërbime apo tregti dhe prodhim. Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) është autoriteti kompetent që merret me regjistrimin dhe licencimin e bizneseve si dhe administrimin e regjistrimit të pronësisë përfituese. Ekzistojnë shumë dhoma të industrisë dhe tregtisë dhe dy këshilla shërbejnë si ndërmjetës ndërmjet institucioneve publike dhe jopublike.

Reforma rregullatore e ka bërë më të lehtë hapjen dhe mbylljen e bizneseve, por vështirësitë lidhur me procedurat e falimentimit, të drejtat e pronës, lejet e ndërtimit, autorizimet dhe aksesin në financa vazhdojnë të ekzistojnë. Autoriteteve të mbikëqyrjes iu nevojitet kapacitet dhe pavarësi më e madhe.

Mirëpo, ekzistojnë sfida në kategorizimin e ndërmarrjeve si të vogla, të mesme apo të mëdha në Shqipëri, meqenëse ligje të ndryshme përdorin përkufizime të ndryshme. Kjo mospërputhje jep shkas për boshllëqe ligjore dhe mbivendosje me ligjin tatimor, ligjin për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe ligjin për kontabilitetin që ofron klasifikime të dallueshme për bizneset e përmasave të ndryshme.

Dispozitat e transparencës janë gjithëpërmbljedhëse, me ligje për regjistrat e pronësisë përfituese dhe standardet e raportimit financiar. Megjithatë, pronësia e më pak se 25% të aksioneve për përfituesit nuk është e detyrueshme të zbulohet në regjistrin e pronësisë përfituese. Raportet financiare të audituara të shoqërive të mëdha i dorëzohen autoriteteve tatimore dhe bëhen të disponueshme për publikun nëpërmjet bazës së të dhënave online të QKB-së. Në rast të kundërt, bizneset e vogla dhe të mesme detyrohen vetëm të nënshkruajnë bilancet e tyre nga një kontabilist dhe publikimi nuk është i detyrueshëm për ta. Janë vënë re vonesa në publikimin e raporteve vjetore dhe raportime të pasakta. Disa shoqëri të mëdha nuk arrijnë të dorëzojnë pasqyrat financiare pas marrjes së kontratave shtetërore. Është rritur progresi në tregun e audituesve ligjorë, por sfidat vazhdojnë në sanksionimin e mospërputhjes.

Janë bërë përpjekje për të krijuar kode sjelljeje dhe masa kundër korrupsionit, me kode në sektorë si bankat. Zbatimi i Kodeve të Etikës dhe standardeve të integritetit është i kufizuar, me sfida për konfidencialitetin dhe mekanizmat e pavarur të

hetimit. Transparenca në ndëshkrimin e shoqërive për korrupsion është e kufizuar, me raporte që janë shpesh anonime dhe rrallëherë të përditësuara.

Pavarësisht faktit se përfaqësimi i grave në pozicionet për drejtimin e shoqërive të mëdha tejkalon paksa mesataren e BE-së, dallime të konsiderueshme gjinore vazhdojnë të ekzistojnë si në pushtetin politik ashtu edhe në atë ekonomik. Nismat si Plani Kombëtar i Veprimtimit për Gratë Sipërmarrëse kanë pasur ndikim të kufizuar.

Antikorrupsioni bën pjesë në agjendën e sektorit të biznesit, por nuk është një prioritet kryesor. Për më tepër, bashkëpunimi ndërmjet sektorit privat dhe shoqërisë civile është i pazhvilluar.

Mjedisi i biznesit në Shqipëri i nënshtrohet korrupsionit për shkak të sfidave si informaliteti, kapaciteti i ulët dhe mungesa e efektivitetit e administratës publike dhe mosbesimi në sistemin e drejtësisë. Niveli i korrupsionit në Shqipëri vlerësohet si një nga problematikat më të mëdha madje edhe nga Dhoma Amerikane e Tregtisë. Në Indeksën e Biznesit 2021-2022, ky element renditet në vendin e pestë ndër më shqetësuesit në klimën e biznesit mes 27 treguesve në total. "Nxitësit themelore të performancës në klimën e biznesit – praktikat e drejta, të barabarta dhe transparente – janë shumë larg pritshmërive të shoqërive dhe investitorëve. Në vitin 2021, perceptimi i të anketuarve ka anuar për "Monopolin dhe konkurrencën e pandershme" (-2,95 pikë), "Nivelin e korrupsionit" (-0,79 pikë), "Burokracinë e qeverisë" (-1,64 pikë) dhe "Zbatimin e ligjeve dhe rregullore" (-1.32 pikë)."¹⁸⁵²

Sistemi i regjistrimit online u përball me problematika të hershme, por kontribuoi në uljen e korrupsionit në nivelet më të ulëta të administrimit. Qeveria themeloi Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes për trajtimin e ankesave administrative.

Megjithatë, mungon një listë e zezë për të identifikuar sipërmarrjet e përfshira në akte korruptive dhe pastrimim e parave. E vetmja listë publike e disponueshme u përket individëve ose shoqërive që lidhen me financimin e terrorizmit,

sipas detyrimit ligjor. Shpeshherë, informacioni për shoqëritë që përfshihen në korrupsion zbulohet vetëm gjatë hetimeve të policisë ose në seancat gjyqësore. Mungesa e një baze të dhënash gjithë përmbledhëse pengon vlerësimin e progresit dhe zbatimin e standardeve kundër korrupsionit nga bizneset.

KAPACITETET

TREGUESI 14.1.1 BURIMET (LIGJI)

Në çfarë mase kuadri ligjor ofron një mjedis të favorshëm për formimin dhe funksionimin e bizneseve individuale?



Ligjet që lidhen me hapjen, operimin dhe mbylljen e bizneseve janë të qarta, të drejtpërdrejta dhe të lehta për t'u zbatuar dhe përfshijnë vetëm kërkesa të arsyeshme për aplikantët. Mirëpo, zbatimi i të drejtave të pronës vazhdon të jetë një shqetësim në mesin e komunitetit të biznesit.

Në mënyrë që të hapin një biznes, qytetarët duhet të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të marrin një numër unik identifikimi, të sigurojnë një emër unik, të përgatisin dokumentet e regjistrimit të biznesit, të regjistrohen për taksat, të marrin lejet e nevojshme dhe të regjistrohen për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) nëse tejkalojnë disa pragje.¹⁸⁵³ Në mënyrë praktike, për të regjistruar një biznes nëpërmjet sportelit elektronik të QKB-së, kërkuesi duhet të identifikohet në mënyrë elektronike me anë të portalit e-Albania, të zgjedhë llojin e dëshiruar të regjistrimit, të plotësojë formularin elektronik, të ngarkojë dokumentet e kërkuara, të konfirmojë në mënyrë elektronike aplikimin me një nënshkrim elektronik të njohur nga ana ligjore, të marrë konfirmimin automatik nga QKB-ja dhe t'i shqyrtohet aplikimi dhe dokumentet nga zyrtarët e autorizuar.¹⁸⁵⁴ Përgjithësisht, procesi është mjaft i thjeshtë, duke ndjekur një sistem "one-stop shop" dhe përfshin kosto të ulëta për qytetarët.

Zbatimi i një ligji të ri për falimentimin në vitin 2017 pati si synim thjeshtësimin e procedurave të daljes nga tregu, parandalimin e abuzimit, lehtësimin për rikuperimin e kolateralit dhe forcimin e regjimit për paaftësinë paguese.¹⁸⁵⁵

Në mënyrë të vazhdueshme, bizneset kanë shfaqur shqetësime për të drejtat e pasigurta të pronës, e cila mbetet një problematikë kryesore.¹⁸⁵⁶ Megjithatë, qeveria ka marrë përsipër nisma të ndryshme ligjore për të rregulluar situatën, përgjithësisht të nxitura nga agjenda e harmonizimit të BE-së. Këto përpjekje përfshijnë ndryshimin e Kodit Penal¹⁸⁵⁷ në 2017 për të adresuar më mirë shkeljet e të drejtave të autorit dhe ndryshimin e Ligjit për Pronësinë Industriale¹⁸⁵⁸ në 2017 për të krijuar një bazë të fortë në mbrojtjen e pronësisë intelektuale. Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022-2025 ka për qëllim të krijojë një treg të brendshëm operues duke vendosur një ekuilibër ndërmjet interesave të pronarëve dhe përdoruesve të të drejtave të pronësisë intelektuale duke forcuar sistemin e regjistrimit dhe mbrojtjes. Strategjia parashikon përmirësimet në kuadrin rregullator, rritjen e kapaciteteve administrative, rritjen e ndërgjegjësimit publik, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe lehtësimin e hedhjes në treg të objekteve të pronësisë intelektuale dhe transferimit të teknologjisë.¹⁸⁵⁹ ¹⁸⁶⁰ Shtrirja e ligjit për pronësinë industriale u zgjerua për të rregulluar sistemin e mbrojtjes së sekretit tregtar kundër blerjes, përdorimit dhe zbulimit të paligjshëm.¹⁸⁶¹

TREGUESI 14.1.2 BURIMET (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase janë në gjendje bizneset individuale në praktikë, të formohen dhe të funksionojnë në mënyrë efektive?



Përgjithësisht, hapja e një biznesi është shumë e thjeshtë dhe nuk përfshin investime të mëdha në kohë dhe para. Mirëpo, e kundërta ndodh për procedurat e falimentimit dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë

intelektuale që vështirësohet nga procedurat e ngadalta gjyqësore për shkak të procesit të ngadalhtë të vetting-ut të gjyqtarëve.

Prej shumë vitesh procesi i regjistrimit të biznesit ka qenë i shpejtë dhe dy vitet e fundit regjistrimi i një biznesi ka qenë falas.¹⁸⁶² Duke u bazuar në llojin e shoqërisë, regjistrimi i saj zgjat nga një deri në tre ditë (për ndërmarrjet me pronësi të huaj). Nevojiten vetëm disa¹⁸⁶³ dokumente (shih 14.1.1) dhe aplikimi i plotë bëhet në qendrën e integruar të QKB-së. Në vitin 2020 QKB-ja ofroi edhe mundësinë e regjistrimit online të shoqërive, ndërsa duke filluar që nga viti 2022 ky shërbim ofrohet vetëm online përmes portalit e-Albania.¹⁸⁶⁴ Sipas një administratori të Konfederatës së Përgjithshme të Industrisë, ky vendim ka sjellë probleme me vonesa në sistem¹⁸⁶⁵ dhe janë raportuar raste kur sistemi nuk funksionon siç duhet,¹⁸⁶⁶ por vendimi për të siguruar dokumente shtetërore vetëm online ka ndikuar në uljen e korrupsionit në nivelet më të ulëta të administrimit.¹⁸⁶⁷

Agjencia Kombëtare e Falimentimit veproi me kapacitet të plotë vetëm në vitin 2020.¹⁸⁶⁸ Për shkak të diskutimeve të vazhdueshme për rregulloren mbi procedurat e falimentimit (shih 14.1.1), zbatimi aktual mbetet ende i vështirë, duke marrë muaj të tërë dhe duke shkaktuar kosto financiare për bizneset. Bizneset ankohen në mënyrë të vazhdueshme se është e vështirë për të përfunduar një procedurë falimentimi¹⁸⁶⁹ dhe sipas administratorit të shoqatës së bizneseve Konfindustria, kjo ndodh për shkak se institucione të ndryshme tatimpaguese (p.sh. institucionet bashkiake, zyrat e tatimeve dhe doganat) ngelin prapa në lëshimin e detyrimeve dhe si pasojë komplikojnë procedurat për mbylljen formale të një biznesi.¹⁸⁷⁰

Apelimi i sistemit të biznesit, përveç apelimeve gjyqësore, trajtohet nëpërmjet krijimit të një strukture apelimi tatimor, e cila ka kaluar nga varësia e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve drejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ky objekt shërben si dhomë për zgjidhjen e ankesave administrative me bizneset para se të shkojnë në gjykatë.¹⁸⁷¹ Megjithatë, sipas ish-drejtorit të

Drejtorisë së Apelimit Tatimor, bizneset janë të mendimit se penaliteti i vendosur ndaj tyre duhet të lihet si garanci bankare dhe shpeshherë të bllokohet likuiditetin e tyre. Raporti i vendimeve të Drejtorisë së Apelimit Tatimor ka mbetur i pandryshuar gjatë viteve të fundit dhe vetëm pesë deri në gjashtë për qind e vendimeve janë në favor të biznesit dhe pjesa tjetër shkon në gjykatë.¹⁸⁷² Në kohët e fundit, procesi zgjat me vite për shkak të procesit të verifikimit (shih 3.2.6) dhe prej numrit të ulët të gjyqtarëve.¹⁸⁷³

Në lidhje me respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, ekziston një drejtori për pronësinë intelektuale që ruan regjistrimin bazë të markave tregtare dhe licencave. Procesi nuk aplikohet gjerësisht nga bizneset dhe ka vetëm 21,990 marka tregtare të regjistruara në total dhe 11,441 licenca.¹⁸⁷⁴ Kjo ndodh kryesisht për shkak të mungesës së informacionit të ofruar për komunitetin e biznesit lidhur me këtë shërbim dhe mungesës së shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve për të mbrojtur më së miri të drejtat e pronësisë intelektuale.¹⁸⁷⁵ Sipas shoqatave të biznesit, nuk do të lindte nevoja për të shkuar nëpër gjykata nëse Inspektorati i Mbrojtjes së Tregut dhe Drejtoria e Pronësisë Intelektuale do të bashkëpunonin së bashku.¹⁸⁷⁶

TREGUESI 14.1.3 PAVARËSIA (LIGJI)

Deri në çfarë mase ekzistojnë masa mbrojtëse ligjore për të parandaluar ndërhyrjet e jashtme të pajustificuara në aktivitetet e bizneseve private?



Ekzistojnë mbrojtje ligjore gjithëpërfshirëse për të parandaluar ndërhyrjet e jashtme të paarsyeshme në veprimtaritë e bizneseve. Mirëpo, ndryshimet e vazhdueshme rregullatore në regjistrimin e biznesit, licencimin, procedurat tatimore dhe prokurimet publike çojnë në raste të ndikimit të padrejtë në zbatim.

Kushtetuta njeh dhe mbron pavarësinë e bizneseve si një e drejtë themelore. Autoriteteve shtetërore u

ndalohet të kufizojnë ose ndërhyjnë në mënyrë arbitrare në zbatimin e kësaj të drejte, duke përjashtuar rastet kur ekziston një interes publik imponues që sanksionohet me ligj.¹⁸⁷⁷

Burokracia e qeverisë dhe zbatimi i paqëndrueshëm i ligjeve vazhdojnë të mbeten mjaft problematike në komunitetin e biznesit, të cilat pengojnë sigurinë ligjore duke prezantuar ndryshime të posaçme në masat rregullatore dhe tatimore.¹⁸⁷⁸ Ligji i licencimit është ndryshuar pesë herë që nga viti 2015, me dy rishikime në dy vitet e fundit. Ligji i regjistrimit ka pasur dy ndryshime që nga viti 2019 dhe ligji i prokurimit publik ka pësuar ndryshime çdo dy vjet që nga miratimi i tij. Ligji për procedurat tatimore është ndryshuar 22 herë që nga miratimi i tij në vitin 2018, duke përfshirë gjashtë ndryshime që nga viti 2019.

Duke pasur si synim sipërmarrjen e lirë private, qeveria themeloi Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, e cila mban përgjegjësi për trajtimin e ankesave administrative të bizneseve ndaj institucioneve dhe zyrtarëve publikë si dhe për të ndihmuar bizneset në mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore. Ministria ka kompetenca bashkëpunuese dhe mund të japë rekomandime. Në 2020, Ministria propozoi rishikimin e ligjit për inspektimin duke synuar vendosjen e inspektimit online në të gjitha fushat.¹⁸⁷⁹

Për më tepër, bizneset në Shqipëri kanë mundësi të tjera për të kërkuar dëmshpërblim nëse besojnë se janë subjekt i ndërhyrjeve të jashtme të paarsyeshme. Bizneset mund të paraqesin ankesë në QKB nëse ka pasur abuzime gjatë procesit të regjistrimit.¹⁸⁸⁰ Dhoma Kombëtare e Tregtisë siguron mbështetje për bizneset dhe mund të ndihmojë në ndërmjetësimin e mosmarrëveshjeve apo konflikteve që lindin ndërmjet bizneseve dhe qeverisë.¹⁸⁸¹ Përveç kësaj, bizneset mund të paraqesin ankesën pranë Autoritetit të Konkurrencës nëse mendojnë se janë subjekt i praktikave të padrejta ose kundër konkurrencës.¹⁸⁸² Së fundmi, sistemi gjyqësor ofron një mjet ligjor për bizneset që janë dëmtuar nga veprime të paligjshme ose të papërshtatshme.

TREGUESI 14.1.4 PAVARËSIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase është sektori i biznesit i lirë nga ndërhyrjet e jashtme të pajustificuara në punën e tij në praktikë?



Përdorimi i bizneseve nga zyrtarët për të marrë favore është i përhapur në të dy nivelet: në abuzimin e fondeve të tyre për interesa politike dhe në korrupsionin për përfitime personale monetare. Megjithatë, shumë biznese shqetësohen më shumë për kufizimin e lirive ekonomike përmes ligjeve të posaçme sesa për korrupsionin e përhapur në nivelet e ulëta të administrimit.

Akuzat e organeve të drejtësisë,¹⁸⁸³ sondazhet e bizneseve dhe raportimet për perceptimin e korrupsionit në Shqipëri¹⁸⁸⁴ tregojnë se abuzimi në këtë fushë shtrihet në të gjitha nivelet e administrimit, duke filluar nga punonjësit dhe specialistët e thjeshtë deri te niveli drejtues, duke përfshirë deputetë dhe ish-ministra.

Duke u bazuar në raportin e tranzicionit për vitet 2022-23 të publikuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Shqipëria ka pësuar rënie për sa i përket mirë qeverisjes, duke shënuar 4.62 pikë, nga 5.26 në 2016 dhe 4.71 në 2020. Shqipëria lë pas vetëm Bosnjën dhe Hercegovinën në grupin e vendeve të Evropës Juglindore për sa kohë që niveli i ulët i mirë qeverisjes mbetet shqetësues. Rezultatet e qeverisjes kanë rënë ndjeshëm në disa ekonomi të caktuara gjatë gjashtë viteve të fundit, duke reflektuar kryesisht rritjen e perceptimit të informalitetit dhe korrupsionit (siç shihet, për shembull, në Shqipëri dhe Bosnjë dhe Hercegovinë) dhe një rënie në ndikimin e perceptuar të gjykatave.¹⁸⁸⁵

Rastet e zyrtarëve publikë që paguhen nga sektori privat janë të përhapura, ndonëse janë ndërmarrë nisma për të shmangur kontaktet ndërmjet bizneseve dhe zyrtarëve publikë. Në maj 2022, qeveria vendosi që të gjitha dokumentet e administratës publike të lëshohen online për të shmangur kontaktet e qytetarëve me punonjësit e

administratës. Të gjitha kërkesat e dokumenteve bëhen online dhe administrata detyrohet t'i lëshojë brenda afatit. Gjithashtu janë ndërmarrë nisma të mëparshme për krijimin e disa portaleve qeveritare për të denoncuar veprimet korruptive apo për të zgjidhur problemet e bizneseve dhe qytetarëve në platformën "shqiperiaqeduam.al". Më 11 prill 2023, pesë dhoma mjaft të rëndësishme, Konfindustria Amerikane, Gjermane, Franceze, Italiane dhe Konfindustria Shqiptare kërkuan në një deklaratë të përbashkët që qeveria dhe Kuvendi të zbatojnë një legjislacion në luftën kundër korrupsionit dhe të zvogëlojnë ryshfetin duke vendosur standardet e OECD-së.¹⁸⁸⁶

Megjithëse ndër vite janë ndërmarrë nisma dhe fushata ligjore në këtë fushë, niveli i korrupsionit në administratën tatimore dhe dogana është i përhapur. Mediat investigative raportojnë se bizneset paguajnë punonjësit e këtyre agjencive.¹⁸⁸⁷ Një fushë tjetër që ka një nivel të lartë korrupsioni dhe shantazhi ndërmjet bizneseve është edhe prokurimi publik.¹⁸⁸⁸ Shpeshherë, proceset e prokurimit nuk merren përsipër në bazë të standardeve të të dhënave të disponueshme të kontraktimit, transparencës dhe shmangies së konflikteve të interesit jo vetëm për administratën, por edhe për shoqëritë dhe mungon krijimi i një sistemi zbatimi për kontraktorët.¹⁸⁸⁹ Aktualisht, disa lloje të financimit publik shmangin plotësisht proceset standarde të prokurimit publik për shkak të gjykimit të gabuar nga zyrtarët publikë, të cilët shfrytëzojnë privilegjin që lidhet me "interesen thelbësor shtetëror" sipas ligjit.¹⁸⁹⁰

Niveli i korrupsionit ndërmjet qeverisë dhe bizneseve ka qenë i dukshëm që nga fillimi i punës së Prokurorisë së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në vitin 2019. Skemat e mëdha korruptive si rasti i "inceneratorëve"¹⁸⁹¹ ose në fushën e prokurimeve publike, në 2021, drejtori i agjencisë më të madhe u vu në pranga dhe u dënua "për shkelje të barazisë në tenderët publikë", propozojnë përhapjen e korrupsionit edhe në nivele të larta.¹⁸⁹²

Konkretisht, Gjergj Buxhuku nga Konfindustria përmend ligjin e posaçëm që ofron statusin e

“investitorit strategjik”, ku dhurohet toka shtetërore dhe përjashtimet nga taksat. Kjo krijon shtrembërime të konkurrencës në treg.¹⁸⁹³ Raste të ngjashme janë kontratat koncesionare dhe PPP-të e miratuara me ligj të posaçëm në Kuvend, të cilat shmangin procesin e prokurimit publik duke u dhënë shoqërive miliona euro nga buxheti apo shërbime ekskluzive që krijojnë monopole në treg dhe shkatërrojnë konkurrencën.¹⁸⁹⁴ Në tetë vitet e fundit, qeveria ka dhënë pesë kontrata koncesioni për rrugët, katër në fushën e shëndetësisë, tre në fushën e mbetjeve urbane (inceneratorët) dhe disa të tjera në kontrollin e karburanteve, si shënjimi apo matja e sasisë së karburanteve dhe ka miratuar një ligj të posaçëm për dhënien e tokës së portit më të madh në vend (Porti i Durrësit)¹⁸⁹⁵ dhe është në proces në dhënien e monopolit të një shoqërie në fushën e lëshimit të certifikatave elektronike për biznesin. Në shumë prej këtyre kontratave PPP, si inceneratorët apo sterilizimi i seteve kirurgjikale, prokuroria ka hapur hetime dhe janë arrestuar zyrtarë të lartë, një ish-ministër dhe një deputet i Kuvendit të Shqipërisë në vitin 2021 dhe 2022.¹⁸⁹⁶

Në 2021, bashkëshortja e ministrit të Jashtëm fitoi statusin e “investitorit strategjik” për ndërtimin e një hoteli në bregdetin jugor të Shqipërisë dhe iu dha e drejta ekskluzive e përdorimit të vijës bregdetare për 30 vite. Deputeti i opozitës, Agron Shehaj, i cili denoncoi këtë çështje, është përballur më pas me bllokimin e ambienteve të biznesit të tij nga Policia e Shtetit.¹⁸⁹⁷ Përballë valës së protestave që filloi pas krizës së inflacionit, në mars të vitit 2022, qeveria vendosi të ngrrejë dy borde për të vendosur çmimin e ushqimeve dhe karburanteve.¹⁸⁹⁸ Shoqatat e biznesit kanë qenë kundër këtij vendimi dhe kanë numëruar raste të falimentimit të ndërmarrjeve të vogla, ndërkohë që ul pavarësinë ekonomike.

QEVERISJA

TREGUESI 14.2.1 TRANSPARENCA (LIGJI)

Deri në çfarë mase ekzistojnë dispozita për të garantuar transparencë në aktivitetet e sektorit të biznesit?



Dispozitat e transparencës janë të përshtatshme dhe janë miratuar disa ligje për të përmirësuar transparencën. Megjithatë, pronësia e më pak se 25% e aksioneve nuk është e detyrueshme të përfshihet në regjistrin e pronësisë përfituese dhe penalitetet e ulëta për mosparaqitjen e raporteve financiare vjetore çojnë në mospërputhje.

Në vitin 2020 u miratua Ligji për Regjistrin e Pronarëve Përfitues, ku bizneset dhe OJQ-të sigurojnë të dhënat për të plotësuar regjistrin. Subjektet që zotërojnë 25% ose më shumë të aksioneve në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në një shoqëri identifikohen si Pronarë Fundorë Përfitues (UBO).¹⁸⁹⁹ Qendra Kombëtare e Biznesit mban regjistrin e UBO-ve dhe bizneset që nuk regjistrojnë UBO-të e tyre mund të përballen me gjoba në formë monetare.¹⁹⁰⁰ Ndryshimet në ligjin e UBO-ve u miratuan në janar 2022, duke shtyrë afatin e regjistrimit dhe duke rritur penalitetet për mospërputhje.¹⁹⁰¹ Informacioni i disponueshëm për publikun në regjister përfshin emrin e pronarit përfitues, shtetësinë, detajet e hollësishme të lindjes dhe llojin dhe përqindjen e pronësisë. Autoritetet e autorizuara shtetërore kanë akses elektronik të pakufizuar për përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore, ndërsa të dhënat jopublike mund të merren nga individë që shfaqin një interes të ligjshëm duke paraqitur një kërkesë.¹⁹⁰²

Shoqëritë duhet të përgatisin pasqyrat financiare vjetore,¹⁹⁰³ dhe ato që tejkalojnë disa pragje duhet t'i auditojnë pasqyrat e tyre nga një auditues i jashtëm. Kriteret bazohen në totalin e pasurive, të ardhurat totale dhe numrin mesatar të të punësuarve në vit.¹⁹⁰⁴ Pasqyrat financiare të

audituar duhet t'i dorëzohen autoriteteve tatimore dhe janë të disponueshme për publikun nëpërmjet bazës së të dhënave online të QKB-së.¹⁹⁰⁵ Bizneset e mëdha duhet të publikojnë pasqyrat financiare vjetore, raportet e progresit për veprimtaritë dhe raportet e konsoliduara të progresit bashkë me raportin e auditimit në faqet e tyre zyrtare brenda 7 muajve që nga data e raportimit.¹⁹⁰⁶

Bizneset e vogla dhe të mesme kanë për detyrë që bilancet t'i nënshkruajnë nga një kontabilist, por publikimi i tyre nuk është i detyrueshëm.¹⁹⁰⁷ Shfaqen probleme në mënyrën sesi ligje të ndryshme i kategorizojnë ndërmarrjet në të vogla, të mesme dhe të mëdha. Ligje të ndryshme i kategorizojnë në mënyra të ndryshme, duke krijuar një boshllëk ose mbivendosje ligjore.¹⁹⁰⁸ Ligji tatimor e kategorizon biznesin e madh si një lloj tjetër biznesi, ligji për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ka një përkufizim tjetër dhe ligji për kontabilitetin ka një tjetër.¹⁹⁰⁹

Përgjithësisht, edhe pse afati i fundit për dorëzimin e bilanceve vjetore është data 31 korrik e vitit pasues, sipas Kryetarit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, dorëzimi i pasqyrave financiare vonohet dhe finalizohet në gjysmën e dytë të vitit. Penaliteti i vendosur në rastin e paraqitjes me vonesë të pasqyrës financiare është 15,000 lekë (afërsisht 145 euro), kështu që shoqëritë e mëdha dhe të rëndësishme e shmangin këtë detyrim duke zgjedhur të paguajnë penalitetin. Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) zbatohen nga subjekte me interes publik që përmbushin kriteret specifike dhe rregullohen nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) zbatohen nga të gjitha bizneset e tjera.¹⁹¹⁰ Ata kanë mundësinë të miratojnë në mënyrë vullnetare SNRF-të edhe pse SKK-të e rishikuara në përgjithësi janë të modeluara sipas SNRF-ve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.¹⁹¹¹

Banka e Shqipërisë mban përgjegjësi për mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave dhe institucioneve të tjera financiare.¹⁹¹² Kryen inspektime të rregullta dhe të posaçme në vend. Inspektimet e rregullta kryhen çdo vit dhe mbulojnë

një sërë fushash, duke përfshirë menaxhimin e riskut, qeverisjen e korporatave, raportimin financiar dhe përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret,¹⁹¹³ ndërsa inspektimet e posaçme kryhen për shkak të shqetësimeve apo rreziqeve specifike të identifikuar nga Banka e Shqipërisë.¹⁹¹⁴

Pavarësisht problemeve në fushën e transparencës së biznesit, vitet e fundit janë bërë përmirësime, si detyrimi i shoqërive që kanë lidhur kontratë me institucionet publike për të paraqitur listën e pagesave që kanë marrë nga fondet shtetërore.¹⁹¹⁵

TREGUESI 14.2.2 TRANSPARENCA (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase ka transparencë në sektorin e biznesit në praktikë?



Struktura e pronësisë së shoqërive është publike dhe kohët e fundit, bizneset detyrohen të paraqesin strukturën e pronësisë përfituese si dhe të publikojnë pasqyrat financiare vjetore dhe pagesat nga kontratat shtetërore, por jo të gjitha ndërmarrjet e përmbushin këtë detyrim.

Portali i Qendrës Kombëtare të Biznesit ofron informacion të hollësishëm për shoqëritë, pronësinë dhe bilancet e tyre të kontabilitetit.¹⁹¹⁶

Një pjesë e madhe e shoqërive të mëdha detyrohen të publikojnë një raport vjetor duke përfshirë pasqyrat financiare (shih 14.2.1). Shfaqen vonesa në publikimin e raporteve vjetore dhe vihet re se ato nuk janë aq të sakta sa në publikimin e ndryshimit të aksionerëve.¹⁹¹⁷

Ekzistojnë raste të shumta kur firmat që kanë kontratë të lidhur me shtetin për vlera të konsiderueshme i paraqesin me vonesë bilancet e tyre, apo raste të tjera kur pas lidhjes së kontratës nuk dorëzojnë më pasqyra financiare. Një problematikë tjetër mes këtyre shoqërive është nënshkrimi i pasqyrave financiare vetëm nga administratori dhe jo nga financuesi apo një auditues i jashtëm që shërben si palë e tretë. Ligji detyron shoqëritë e klasifikuara si biznese të mëdha

të zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe të auditojnë bilancet e tyre nga një analist financiar i certifikuar, por kjo nuk ndodh në të gjitha rastet.¹⁹¹⁸

Ekzistojnë rreth 3100 biznese që përmbushin kriteret për të pasur auditues të jashtëm.¹⁹¹⁹

Në vitet e fundit ka pasur një përmirësim në tregun e audituesve ligjorë (i barasvlershëm me një kontabilist të certifikuar), pasi deri në vitin 2018 nuk ka pasur asnjë kontroll të zbatimit të standardeve nga ana e tyre. Sipas Kryetarit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, standardet nuk janë zbatuar siç duhet nga një pjesë e madhe e audituesve. Ekzistojnë shumë çështje të tilla që Bordi i Mbikëqyrjes përballet me probleme për të sanksionuar kontabilistët, por ata kanë bërë shumë rekomandime dhe kanë dhënë paralajmërime.¹⁹²⁰ Sipas Kryetarit të Bordit të Mbikëqyrjes, tregu ka pasur probleme në zbatimin e standardeve ndërkombëtare, por gjendja është duke u përmirësuar në kohët e fundit, pasi ata (audituesit ligjorë) e dinë se janë nën mbikëqyrje më të rreptë. Për më tepër, Bordi i Mbikëqyrjes po punon me Zyrën e Tatimeve dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit në mënyrë që sistemi të pranojë vetëm kontrollin financiar dhe asnjë pasqyrë tjetër financiare të paraqitur nga bizneset e mëdha.¹⁹²¹

Struktura e aksionarëve të biznesit duhet të publikohet në regjistrin e QKB-së dhe në vitin 2021 u krijua regjistri zyrtar i pronarëve përfitues i cili është publik. Që nga dhjetori i vitit 2023, rreth 77 për qind e bizneseve kanë paraqitur përfituesit e tyre fundorë bashkë me strukturën aksionare sipas detyrimeve ligjore.¹⁹²²

Vetëm një numër i kufizuar i ndërmarrjeve të mëdha raportojnë për përgjegjësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre korporative. Shoqëritë që raportojnë për këto standarde bëjnë pjesë në sektorin financiar dhe industrial. Përgjithësisht, klima e biznesit dhe konkurrencës në Shqipëri nuk ka në qendër të vëmendjes përgjegjësinë sociale dhe zbatimin e këtij koncepti nuk është i përhapur.¹⁹²³ Korrupsioni brenda shoqërive private është më pak i përhapur sesa në ndërmarrjet shtetërore; ekzistojnë këto

raste, por nuk ka raporte të sakta me të dhëna konkrete për këtë çështje.¹⁹²⁴

Mungesa e tregut të bursës në Shqipëri¹⁹²⁵ nuk i ka ndihmuar shoqëritë të konkurrojnë në nivelin e transparencës, përgjegjësisë sociale, largpamësisë dhe qëndrueshmërisë së veprimtarisë së tyre.

TREGUESI 14.2.3 LLOGARIDHËNIA (LIGJI)

Deri në çfarë mase ekzistojnë rregulla dhe ligje që rregullojnë mbikëqyrjen e sektorit të biznesit dhe qeverisjen e kompanive individuale?



Dispozitat e ligjit për qeverisjen e sipërmarrjeve janë relativisht të përshtatshme. Megjithatë, rregullimi i raportimit jofinanciar dhe raportimit të qëndrueshmërisë së korporatës është i pamjaftueshëm.

Vendi ka miratuar disa ligje dhe rregullore për përmirësimin e llogaridhënies dhe të drejtave të aksionarëve në qeverisjen e korporatës.

Asambleja e përgjithshme e shoqërisë mban përgjegjësi për marrjen e vendimeve të rëndësishme për sa i përket politikave tregtare të shoqërisë, ndryshimeve në statut, emërimit dhe shkarkimit të administratorëve dhe likuiduesve, si dhe përcaktimin e kompensimit të tyre.¹⁹²⁶ Asambleja e përgjithshme duhet të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të raportuara nga administratorët¹⁹²⁷ si dhe të miratojë pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e progresit të veprimtarisë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) është rregullatori kryesor që mban përgjegjësi për mbikëqyrjen dhe rregullimin e sektorit financiar në Shqipëri, duke përfshirë shoqëritë e sigurimit dhe firmat e titujve.¹⁹²⁸ AMF-ja është një organ i pavarur shtetëror që financohet nga burimet e veta, investimet dhe gjobat e vendosura dhe përbëhet nga një staf profesionistësh të specializuar në financë, drejtësi dhe ekonomi.¹⁹²⁹ Përveç kësaj, Banka e Shqipërisë luan një rol edhe në rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit financiar, duke i

kushtuar vëmendje garantimit të sigurisë dhe funksionimit normal të sistemit bankar.¹⁹³⁰

AMF-ja është autoriteti i licencuar dhe mbikëqyr bursën në Shqipëri.¹⁹³¹

Ndryshimet e fundit në ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, të cilat e përafrian atë pjesërisht me Direktivën e Kontabilitetit të BE-së, kërkojnë raporte të menaxhimit të veprimtarisë për bizneset e mesme dhe përjashtojnë njësitë e vogla nga zbulimet e hollësishme.¹⁹³² Për më tepër, ndryshimet autorizojnë Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit për të monitoruar zbatimin e standardeve të raportimit financiar dhe të kontabilitetit. Megjithatë, kapaciteti i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit është akoma i kufizuar.¹⁹³³

Në qershor të vitit 2020, u bënë publike udhëzimet për raportimin jofinanciar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.¹⁹³⁴ Pavarësisht nga kjo, kuadri ligjor në këtë fushë vazhdon të mbetet i papërshtatshëm dhe rregulloret për raportimin e qëndrueshmërisë së korporatave mungojnë akoma.¹⁹³⁵

TREGUESI 14.2.4 LLOGARIDHËNIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase ka qeverisje efektive të kompanive në praktikë?



Përgjithësisht, stafi drejtues i korporatës rrallëherë duhet t'i japë llogari bordit dhe aksionarëve për vendimet e tij dhe shoqëri të shumta nuk zbatojnë standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të raportimit financiar.

Nuk jepen të dhëna dhe statistika të sakta se sa firma zbatojnë standarde të mirë qeverisjes, por vitet e fundit disa ndërmarrje të mëdha kanë filluar t'i miratojnë ato.

Sektori bankar, shoqëritë e sigurimeve dhe telekomunikacioni janë industritë që janë në krye të listës në zbatimin e standardeve të qeverisjes së korporatave, ndjekur nga shërbimet e konsulencës,

sektori i energjisë dhe tregtia, sipas një indeksi të publikuar në vitin 2021 nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, e cila mori në shqyrtim 50 biznese nga lista e korporatave më të mëdha në vend.¹⁹³⁶

54 për qind e korporatave të mëdha zbatojnë standardet e përgjegjësisë sociale, por buxheti për këtë standard është më pak se një për qind e shpenzimeve të tyre vjetore për 70 për qind të shoqërive¹⁹³⁷. Gjysma e firmave nuk kanë një dokument të politikave mjedisore të miratuar nga drejtuesit, megjithëse pretendojnë se zbatojnë parimet sociale dhe mjedisore.¹⁹³⁸

Struktura e ndërmarrjeve në Shqipëri sugjeron një ekonomi që zotërohet nga bizneset e vogla dhe të mesme, ndërsa përafërsisht 1% janë shoqëri me më shumë se 50 punonjës.¹⁹³⁹ Bordet e drejtorëve që kanë kompetencën për të monitoruar veprimtarinë e ndërmarrjeve janë më të përhapur në industri ku ky funksion vjen si detyrim ligjor, si bankat, shoqëritë e sigurimit dhe institucionet financiare.¹⁹⁴⁰ Vendimi i bordeve është i detyrueshëm për stafin drejtues të këtyre shoqërive, të cilat kanë edhe njësi të auditimit të brendshëm. Në korporatat e tjera, vihet re se stafi drejtues shpërfill bordin dhe fuqia në çështjet financiare dhe të prokurimit është e përqendruar në duart e administratorit ose pronarit.¹⁹⁴¹ 78 për qind e firmave të mëdha kanë në strukturën e tyre një bord drejtues, ku 75 për qind tregojnë se është operues dhe me kompetenca të plota.¹⁹⁴²

Në agjendën e qeverisë nuk ka buxhet për të ndihmuar shoqëritë apo për t'i nxitur ato për të luftuar korrupsionin. Pavarësisht nga kjo, ndër vite janë zhvilluar takime dhe programe me synim luftën kundër korrupsionit, por deri më sot nuk ka rezultate për arritje konkrete. Komuniteti i biznesit të huaj ka kërkuar hartimin e një legjislacioni me zbatimin e disa pikave në këtë fushë duke përdorur si model standardet e OECD-së.¹⁹⁴³

TREGUESI 14.2.5 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (LIGJI)

Deri në çfarë mase ekzistojnë mekanizma për të garantuar integritetin e të gjithë atyre që veprojnë në sektorin e biznesit?



Shoqatat e sektorit të biznesit kanë bërë përpjekje për të krijuar kode sjelljeje, por ka mungesë të kodeve të posaçme të detyrueshme kundër korrupsionit.

Ekzistojnë vetëm disa kode sjelljeje në të gjithë sektorin në Shqipëri për industri të caktuara, si bankat dhe sigurimet. Në përgjithësi, këto kode sjelljeje hartohen nga shoqatat e industrisë dhe miratohen nga organet rregullatore. Për shembull, Shoqata Shqiptare e Bankave ka hartuar një Kod Sjelljeje për anëtarët e saj, i cili përcakton parimet për sjelljen etike, transparencën dhe mbrojtjen e konsumatorit.¹⁹⁴⁴ Mirëpo, nuk ka kode të posaçme të detyrueshme kundër korrupsionit për bizneset. Ndonëse vazhdon të ekzistojë një kod vullnetar i qeverisjes së korporatës, ai në përgjithësi nuk zbatohet.¹⁹⁴⁵ Në bazë të indeksit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, 60 për qind e korporatave kanë pretenduar se kanë një Kod Etike dhe 38 për qind e tyre thonë se punonjësit duhet të bëjnë një deklaratë vjetore sipas këtij Kodi.¹⁹⁴⁶

Ligji shqiptar për ryshfetin dhe korrupsionin nuk zbatohet jashtë territorit.¹⁹⁴⁷ Megjithatë, Shqipëria ka nënshkruar në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, e cila u kërkon shteteve anëtare të penalizojnë ryshfetin e zyrtarëve publikë të huaj në transaksionet e biznesit ndërkombëtar.¹⁹⁴⁸ Referencat kryesore ligjore të përdorura nga shoqëritë për politikën kundër korrupsionit dhe politikën e sinjalizimit janë Ligji i Kodit Penal nr. 9049, më 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, detyrimeve financiare të zyrtarëve të zgjedhur dhe disa nëpunësve publikë" dhe Ligjit nr. 60, datë 02. 06. 2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".¹⁹⁴⁹

Që nga viti 2016, ekziston një ligj i posaçëm për raportimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve të

veprimeve korruptive. Ligji mbron sinjalizuesit e praktikave korruptive brenda organizatës ose shoqërisë dhe ruan anonimitetin. Ligji që bazohet në praktikën e BE-së ishte një tjetër përpjekje jo vetëm për të rritur monitorimin e formave të kryerjes së biznesit me integritet, por edhe për të zhvilluar rolin e stafit në denoncimin e rasteve të korrupsionit dhe abuzimit. Ky ligj duket se është pritur mirë nga bizneset.¹⁹⁵⁰

Ligji mbulon përgjegjësinë personale dhe atë të korporatës.¹⁹⁵¹ Bizneset mbajnë përgjegjësi për çdo vepër penale të kryer nga përfaqësuesit ose organet e tyre, si dhe për çdo vepër penale të kryer në emër ose për përfitimin e saj për shkak të mungesës së kontrollit dhe mbikëqyrjes së mjaftueshme nga ata që menaxhojnë dhe drejtojnë subjektin.¹⁹⁵² Nëse merr dënimin, biznesit mund t'i ndalohet angazhimi në transaksionet me fonde publike, mund t'i hiqen licencat ose mund t'i ndalohet të reklamojë veprimtaritë e tij.¹⁹⁵³ Gjykata mund të urdhërojë publikimin e vendimit gjyqësor.¹⁹⁵⁴

Një ofertues mund të mos pranohet nga Agjencia e Prokurimit Publik në rast se ka konflikt interesi ose nëse ofertuesi tenton të korruptojë një zyrtar.¹⁹⁵⁵ Për më tepër, agjencia mund të përjashtojë ofertuesit që janë dënuar për krime të caktuara, si korrupsioni ose mashtrimi, dhe të shkualifikojë ata që paraqesin të dhëna ose dokumente të rreme.¹⁹⁵⁶

Në përgjithësi, mbetet e paqartë nëse korporatat e mëdha në Shqipëri kanë drejtues profesionistë për përputhshmërinë.

TREGUESI 14.2.6 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase sigurohet në praktikë integriteti i atyre që punojnë në sektorin e biznesit?



Shumë pak shoqëri zbatojnë kodet e etikës dhe standardet e integritetit dhe nuk ka të dhëna zyrtare për zbatimin e tyre. Mbizotërimi i bizneseve të vogla në ekonomi nuk ka ndihmuar në ngritjen e këtyre

standardeve; mirëpo, në vitet e fundit, hyrja e korporatave shumëkombëshe në treg ka ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit në këtë aspekt.

Më pak se gjysma e korporatave të mëdha kryejnë trajnime me punonjësit për kundër korrupsionin dhe sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.¹⁹⁵⁷

Më shumë se gjysma e korporatave kanë miratuar një politikë sinjalizimi, por ekzistojnë raporte që në disa raste mekanizmi nuk siguron konfidencialitetin e sinjalizuesit ose nuk kryen hetime të pavarura për rastet e raportuara.¹⁹⁵⁸

Ka mungesë statistikash për rastet e korrupsionit të zbuluara nga denoncimet në sektorin e biznesit dhe niveli i korrupsionit në këtë fushë matet nëpërmjet studimeve dhe sondazheve të kryera nga qendrat apo shoqatat e biznesit.¹⁹⁵⁹ Ka mungesë të dhënash të grumbulluara edhe në organet e drejtësisë për rastet e korrupsionit në shoqëri, ndërkohë që publikimi i këtyre të dhënave konsiderohet i dëmshëm për imazhin e korporatës. Sipas Indeksit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, strukturat që mbikëqyrin zbatimin e politikave kundër korrupsionit në disa ndërmarrje të mëdha janë ngritur, por ato nuk kanë një linjë telefonike për të raportuar shkeljet që lidhen me korrupsionin dhe konfliktin e interesit.¹⁹⁶⁰

Nuk ka listë të zezë të firmave që janë përfshirë në sistemin e korrupsionit dhe pastrimit të parave. E vetmja listë publike e personave apo shoqërive është ajo e OKB-së për financimin e terrorizmit, publikimi i së cilës është detyrim ligjor.¹⁹⁶¹

Në pjesën më të madhe të rasteve, emrat e shoqërive të përfshira në praktika korruptive mësohen gjatë hetimeve të policisë apo seancave gjyqësore. Mungesa e bazës së të dhënave kufizon analizën e progresit dhe zbatimin e standardeve kundër korrupsionit nga ndërmarrjet. Rastet e ndëshkimit të shoqërive në fushën e pastrimit të parave shpallen në mënyrë anonime, ndërsa informacioni nuk përditësohet dhe të dhënat bëhen të ditura vetëm një herë në vit nëpërmjet raportit vjetor.

TREGUESI 14.2.7 PËRFAQËSIMI GJINOR

Deri në çfarë mase gratë kanë një pjesë të udhëheqjes së sektorit të biznesit?



Edhe pse shkon më tej se mesatarja e BE-së, vazhdon të ketë një mungesë ekuilibri të konsiderueshme midis pranisë së grave dhe burrave në udhëheqjen e sektorit të biznesit dhe në mbajtjen e pushtetit ekonomik.

Në Shqipëri, përfaqësimi i grave në pozicionet drejtuese të shoqërive më të mëdha të kuotuar është pak më i lartë se mesatarja e BE-së, me 26.4 për qind krahasuar me 25.0 për qind.¹⁹⁶² Përveç kësaj, përfaqësimi i grave në bordin e Bankës Qendrore është dukshëm më i lartë, me 48.1 për qind krahasuar me 20.3 për qind në BE.¹⁹⁶³ Edhe pse statistikat tregojnë njëfarë progresi drejt barazisë gjinore në pushtetin ekonomik, ka ende boshllëqe të rëndësishme gjinore që kërkojnë vëmendje dhe veprim të mëtejshëm pasi burrat vazhdojnë të mbajnë shumicën e pozicioneve si në pushtetin politik ashtu edhe në atë ekonomik.

Pavarësisht se Plani Kombëtar i Veprimit për Gratë Sipërmarrëse 2014-2020 kishte si synim krijimin e më shumë mundësive sipërmarrëse për gratë, ndikimi i tij nuk binte në sy. Një sondazh i kryer nga Deloitte Albania tregon se qytetarët mbështesin nismat legjislative për kuotat në biznes.¹⁹⁶⁴

Në 2019, gratë zotëronin plotësisht kapitalin (100 për qind) në 12.31 për qind të bizneseve të regjistruara dhe burrat zotëronin plotësisht 70.4 për qind të shoqërive të regjistruara.¹⁹⁶⁵ I njëjti model zbatohet për pronësinë e një aksioni kontrollues në kapital (më shumë se 50 për qind). Nga 3291 shoqëri të themeluara në vitin 2019, 18.38 për qind prej tyre drejtoheshin nga gratë.

Autoriteti i Prokurimit Publik ka bërë ndryshime në formularët e tij standard të ofertave për të përkrahur barazinë gjinore.¹⁹⁶⁶ Në bazë të kërkesave të reja, të gjithë ofertuesit duhet të nënshkruajnë menjëherë një deklaratë për mosdiskriminimin në punësim dhe të bien dakord në ofrimin e pagesës së

barabartë për punë të barabartë. Ofertuesve që konstatohet se shkelin këtë deklaratë mund të ndalohen të marrin pjesë në proceset e ardhshme të tenderimit.

ROLI

TREGUESI 14.3.1 ANGAZHIMI I POLITIKAVE KUNDËR KORRUPSIONIT

Në çfarë mase është sektori i biznesit aktiv në angazhimin e qeverisë në luftën kundër korrupsionit?



Megjithëse antikorrupsioni është pjesë e agjendës së angazhimit të sektorit të biznesit me qeverinë, nuk është prioritet. Rrallëherë bëhen deklaratat publike nga sipërmarrës të lartë që i bëjnë thirrje qeverisë të bëjë më shumë përpjekje për të luftuar korrupsionin.

Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, mban përgjegjësi përmes Drejtorisë së Përgjithshme Kundër Korrupsionit për marrjen e raporteve dhe hetimin e rasteve të ndërmarra ose të përcjella nga koordinatoret kundër korrupsionit.¹⁹⁶⁷ Shoqatat e biznesit përfshijnë në agjendën e tyre politikën kundër korrupsionit dhe reduktimin e informalitetit, pasi i quajnë të dëmshme këto tema në klimën e të bërit biznes. Janë bërë takime dhe konferenca të përbashkëta ku është kërkuar adresimi i këtyre praktikave dhe shoqatat e biznesit kanë bërë mbledhje të organizuar në vitin 2023 për të ndërmarrë nisma konkrete në luftën kundër korrupsionit.¹⁹⁶⁸

Dhoma Amerikane e Tregtisë ka filluar diskutimet me Ministrinë e Drejtësisë për krijimin e një programi në luftën kundër korrupsionit duke marrë parasysh edhe rekomandimet e përfshira në Agjendën e Investimeve.¹⁹⁶⁹

Rastet e shoqatave të biznesit që i bëjnë thirrje qeverisë për të luftuar korrupsionin janë të vazhdueshme në Shqipëri, por shoqatat e huaja të


biznesit shfaqin më shumë interes për këto apeline sesa organizatat vendase. Fenomeni i korrupsionit është një problematikë që shpeshherë paraqitet në mbledhjet në nivel qeveritar dhe është me prioritet, por çështja vazhdon të ngelet pezull sepse nuk ndërmerren veprime konkrete.¹⁹⁷⁰

Shoqatat e biznesit kanë denoncuar edhe raste konkrete të abuzimeve të bizneseve nga zyrtarët dhe rastet kur kërkohet vëmendja e qeverisë në luftën kundër korrupsionit janë të zakonshme,¹⁹⁷¹ ndërkohë që korrupsioni llogaritet si një ndër problematikat kryesore në klimën e biznesit në raportet e tyre vjetore.

Në Shqipëri, vetëm një shoqëri, Banka Intesa San Paolo, ka nënshkruar Kompaktin Global të OKB-së në vitin 2007, si dhe një shoqatë biznesi, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, e cila e ka nënshkruar atë në vitin 2020. Tre shoqëri të tjera, Bacogas, Pro Credit Bank, Pespa Alumin dhe Shoqata e Grave në Biznes, duket se kanë nënshkruar paktin, por u përjashtuan për shkak të mosarritjes për të bërë të ditur progresin.¹⁹⁷²

TREGUESI 14.3.2 MBËSHTETJA PËR/ANGAZHIMI ME SHOQËRINË CIVILE

Deri në çfarë mase sektori i biznesit angazhohet/i ofron mbështetje shoqërisë civile në detyrën e saj për të luftuar korrupsionin?



Bashkëpunimi ndërmjet sektorit privat dhe shoqërisë civile vazhdon të mbetet i pazhvilluar.

Një ndër arsytet për moszhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat dhe shoqërisë civile është mungesa e informacionit për veprimtaritë e OShC-ve, gjë që e bën të vështirë për shoqatat e biznesit të identifikojnë mundësitë për bashkëpunim dhe investim.¹⁹⁷³

Mirëpo, ka një tendencë në rritje në sektorin privat drejt njohjes së rolit që luajnë OShC-të në avancimin e çështjeve të ndryshme ndërsektoriale, duke përfshirë por pa u kufizuar në promovimin e

si përmarrjes sociale, filantropisë dhe kundër pastrimit të parave. Sektori privat është bërë i vetëdijshëm për përfitimet e angazhimit me OshC-të, duke përfshirë ekspertizën e tyre unike, rrjetet dhe përvojën në terren.¹⁹⁷⁴ Për ta përmbledhur, ka disa fusha ku shoqatat e biznesit dhe organizatat e shoqërisë civile po punojnë bashkërisht. Përpjekjet e përbashkëta të një grupi ekspertësh vendorë dhe shoqatave që përfaqësojnë sektorët e pasurive të paluajtshme dhe të këmbimit valutor shërbejnë si një shembull i rëndësishëm bashkëpunimi në promovimin e politikave kundër pastrimit të parave.¹⁹⁷⁵ Nismat e tyre bashkëpunuese synojnë përmirësimin e aftësive të aktorëve joshitetorë dhe ndërgjegjësimin për kuadrin ligjor lidhur me politikën kundër pastrimit të parave.

NDËRVEPRIMET

Ndërveprimet kryesore të bizneseve bëhen me sektorin publik, organin gjyqësor dhe organin ekzekutiv.

Sektori publik harton kuadrin ligjor, rregullator dhe për politikën në të cilin bizneset veprojnë dhe luan një rol kyç në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve që lidhen me korrupsionin dhe duke garantuar që bizneset t'i respektojnë ato. Për më tepër, ky ndërveprim mund të çojë në konflikt interes, korrupsion dhe kapje nga organet rregullatore (shih 14.1.4). Megjithatë, sektori i biznesit beson se përpjekjet e fundit për të përmirësuar digjitalizimin në ofrimin e shërbimeve publike kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zvogëlimin e ngarkesës administrative për bizneset dhe në lehtësimin e praktikave korruptive.¹⁹⁷⁶

Bizneset kërkojnë mjete ligjore nëpërmjet sistemit gjyqësor për të mbrojtur interesat e tyre, si zbatimi i kontratave ose kërkimi i kompensimit për dëmet. Sektori i biznesit varet nga organi gjyqësor për të trajtuar sjelljet e pahijshme të administratës publike ndaj biznesit, megjithatë gjykatat administrative, në veçanti Gjykata Administrative e Apelit, janë të ngarkuara me një ngarkesë të madhe çështjesh dhe kapaciteti i tyre i kufizuar njerëzor është një sfidë. Çështjet që lidhen me biznesin përbëjnë vetëm

gjysmën e ngarkesës, ku më të përhapurat janë çështjet e administratës tatimore, të ndjekura nga inspektoratet shtetërore, administratat doganore dhe institucionet e prokurimit publik.¹⁹⁷⁷ Megjithatë, marrëdhënia ndërmjet bizneseve dhe organit gjyqësor shpeshherë është e diskutueshme, pasi bizneset kërkojnë të ndikojnë në rezultatin e procedurave ligjore me anë të mënyrave të ndryshme, si ryshfeti, korrupsioni ose ushtrimi i presionit politik.

Ndërveprimi kryesor ndërmjet bizneseve dhe organit ekzekutiv përfshin zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve që ndikojnë në operimin e bizneseve dhe mekanizmat e konsultimeve dhe reagimeve për të kuptuar ndikimin e politikave dhe rregulloreve në sektorin privat. Mirëpo, efikasiteti i procesit të konsultimit publik dhe ndikimi i tij në proceset e vendimmarrjes vazhdon të mbetet i kufizuar.¹⁹⁷⁸ Përveç kësaj, organi ekzekutiv mund të përdorë pushtetin e tij për të dhënë favore ose trajtim të privilegjuar për biznese të caktuara në këmbim të ryshfetit ose formave të tjera të përfitimeve të paligjshme.¹⁹⁷⁹ Në të njëjtën mënyrë, bizneset mund të përfshihen në ryshfet ose forma të tjera korrupsioni për të siguruar kontrata qeveritare.

REKOMANDIMET E ORGANIT

- + Qeveria duhet:
 - + të nxisë miratimin e kodeve kundër korrupsionit nga bizneset duke i bërë ato të detyrueshme në proceset e prokurimit publik;
 - + të ketë një agjendë dhe metodologji konkrete për të luftuar korrupsionin në sektorin privat dhe të konsiderojë rezultatet e kësaj agjende në baza vjetore në bashkëpunim me shoqatat e biznesit;
 - + të përjashtojë praktikën e dhënies së kontratave në fushën e prokurimit publik pa konkurrencë dhe të mos shtyhet afati i ligjit "Për Investimet Strategjike", duke i lejuar bizneset e këtyre sektorëve të konkurrojnë lirisht;

- + të zhvillojë programe për të ndihmuar bizneset në luftën kundër korrupsionit duke ofruar mbështetje financiare për nismat kundër korrupsionit, nxitës për bizneset që miratojnë praktikat e qeverisjes së korporatës dhe financimin e projekteve të përgjegjësive sociale.
- + Sektori privat dhe shoqëria civile duhet të nxisin një bashkëpunim më të madh për të trajtuar në mënyrë efikase korrupsionin dhe për të promovuar transparencë dhe llogaridhënie më të madhe. Kjo mund të përfshijë zbatimin e nismave të përbashkëta ose krijimin e forumeve me shumë palë të interesuara për konsultim në mënyrë që të harmonizojnë agjendat e tyre.
- + Qeveria dhe Kuvendi duhet të harmonizojnë ligjet tatimore dhe të kontabilitetit për të trajtuar madhësinë dhe llojin e biznesit duke u bazuar në të njëjtat standarde.
- + Qendra Kombëtare e Biznesit duhet të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për të publikuar në mënyrë automatike bilancet vjetore të shoqërive kur ato paraqiten në zyrat e administratës tatimore për të shmangur vonesat.
- + Njësia Kundër Korrupsionit, Njësia e Inteligjencës Financiare dhe Banka e Shqipërisë duhet të publikojnë dhe përditësojnë çdo muaj një listë të bizneseve të përfshira në praktika korruptive dhe pastrim parash, të ndara në lista të bizneseve nën hetim, të dënuara në Shkallën e parë dhe të dënuara me vendim të formës së prerë.
- + Qeveria dhe Kuvendi duhet të ndryshojnë Ligjin për Pronësinë Përfituese, duke zvogëluar pragun për pronarët që duhet të deklarojnë pronësinë deri në 1 për qind të aksioneve dhe jo në 25 për qind siç është aktualisht.

BIBLIOGRAFI

- ¹⁸⁵¹ Regjistrat e Biznesit 2022, INSTAT, <https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/regjistrat-e-biznesit/publikimet/2023/regjistrat-e-biznesit-2022/>.
- ¹⁸⁵² Dhoma Amerikane e Tregtisë për Biznesin, "Indeksi i klimës së biznesit 2021-2022", 14 dhjetor 2022, <https://amcham.com.al/amcham-business-index-2021-2022/>, f. 5, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁵³ Ligji nr. 9723 për "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III.
- ¹⁸⁵⁴ Neni 24-32, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 3.5.2017 për "përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit".
- ¹⁸⁵⁵ Ligji nr. 110/2016 për "Falimentimin".
- ¹⁸⁵⁶ Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë, 2018, f. 47.
- ¹⁸⁵⁷ Ligji nr. 36/2017 për "Shtesat dhe ndryshimet në Ligjin nr. 7895 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë".
- ¹⁸⁵⁸ Ligji nr. 17/2017 për "Shtesat dhe ndryshimet në Ligjin nr. 9947 për Pronësinë Industriale".
- ¹⁸⁵⁹ Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022-2025, miratuar më 26/05/2022.
- ¹⁸⁶⁰ Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë, 2022, f. 78, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>.
- ¹⁸⁶¹ Neni 7, Ligji nr. 96/2021 për "Disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9947 për Pronësinë Industriale".
- ¹⁸⁶² E-Albania, "Aplikimi për regjistrimin fillestar", https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15310, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁶³ Dokumentet e kërkuara janë Akti i Themelimit, Statuti i Shoqërisë, kapitali i nënshkruar dhe pagesa e tij, dhënia e nënshkrimeve (modelet e nënshkrimit të administratorit) dhe formulari i aplikimit. Shih Administratën Tatimore, "Regjistrimi i Tatimpaguesve", <https://www.tatime.gov.al/d/8/222/437/1099/regjistrimi-i-tatimpaguesit>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁶⁴ E-Albania, Portali zyrtar i shërbimeve qeveritare në Shqipëri, <https://e-albania.al/>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁶⁵ Intervista me Gjergj Buxhuku, administrator i "Konfindustria", 3 mars 2023.
- ¹⁸⁶⁶ Revista Monitor, "Mosfunksionimi i E-Albania, bllokohet veprimtaria e bizneseve", 20 korrik 2022, <https://www.monitor.al/mosfunksionimi-i-e-albania-bllokohet-aktiviteti-i-bizneseve-kaos-dhe-kosto-per-sipermarrjet/>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁶⁷ Tv Klan, "Rama: Shërbimet online ulën korrupsionin", 19 mars 2021, <https://tvklan.al/rama-sherbimet-online-ulen-korrupsionin/>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁶⁸ Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë, 2021, f. 54
- ¹⁸⁶⁹ Intervista me Neritan Mullaj, Drejtor Ekzekutiv i Dhomës Amerikane të Tregtisë, 16 shkurt 2023.
- ¹⁸⁷⁰ Intervista me Gjergj Buxhuku, administrator i "Konfindustria", 3 mars 2023.
- ¹⁸⁷¹ Administrata Tatimore, Deklarata Zyrtare, <https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/165/njoftim-mbi-drejtorine-e-apelimit-tatimor>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁷² Intervista me Artur Papajani, ish-drejtor i Drejtorisë së Apelit Tatimor, 16 Mars 2023.
- ¹⁸⁷³ BIRN Albania, "Këshilli i Lartë Gjyqësor këmbëngul se sistemi i ri për gjykatat është një projekt vizionar", 11 mars 2022, <https://www.reporter.al/2022/03/11/klgj-insiston-se-shkurtimi-i-gjykatave-eshte-projekt-vizionar/>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁷⁴ Regjistri Kombëtar i Pronësisë Intelektuale: <http://registriobjektevepi.dppi.gov.al/epublish-search/public/home?jsessionid=B50235A50393A891E8902D4F3AEB6C3F?0>.
- ¹⁸⁷⁵ Intervista me Neritan Mullaj, Drejtor Ekzekutiv i Dhomës Amerikane të Tregtisë, 16 shkurt 2023.
- ¹⁸⁷⁶ Intervista me Neritan Mullaj, Drejtor Ekzekutiv i Dhomës Amerikane të Tregtisë, 16 shkurt 2023.
- ¹⁸⁷⁷ Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 11.
- ¹⁸⁷⁸ AMCHAM Indeksi i biznesit 2022-2023, Dhoma Amerikane e Tregtisë, <https://amcham.com.al/wp-content/uploads/2023/12/ABI-2023-Ok-Nentor-2023.pdf>; Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë, 2022, f. 55.
- ¹⁸⁷⁹ Propozimi II i Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes <https://sipermarrja.gov.al/strategjia-per-nderveprim-mes-sipermarrjes-dhe-institucioneve-publike-2/>.
- ¹⁸⁸⁰ Neni 72, Ligji nr. 9723 për "Regjistrimin e Biznesit".
- ¹⁸⁸¹ Neni 4, Statuti i Dhomës së Tregtisë, <https://www.cci.al/wp-content/uploads/2023/03/Statuti-DHTIT.pdf>.
- ¹⁸⁸² Neni 29/1, për "Mbrojtjen e Konkurrencës", https://caa.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/Ligji_Per_mbrojtjen_e_konkurrences_i_Perditesuar.pdf.

- ¹⁸⁸³ Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar “Raporti Vjetor 2022”: <http://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/e688d169-74cf-46b2-a22f-240b153ee952>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023]. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar “Deklarata Zyrtare për arrestimin e Lefter Koka”, <https://spak.gov.al/njoftim-62/>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁸⁴ Dhoma Amerikane e Tregtisë për Biznesin, “Indeksi i klimës së biznesit 2021-2022”, 14 dhjetor 2022, <https://amcham.com.al/amcham-business-index-2021-2022/>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁸⁵ Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, “Raporti i Tranzicionit 2022-2023”, 22 nëntor 2022, <https://www.ebrd.com/transition-report-2022-23>, f. 103, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁸⁶ *Zëri i Amerikës*, “Korrupsioni dhe klima e biznesit, pesë Dhoma Tregtie kërkojnë reformim”, 11 prill 2023, <https://www.zeriamerikes.com/a/7045035.html>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁸⁷ News 24 TV, “Doganierët në Durrës marrin ryshfet. Del në skemë dhe vëllai i këshilltarit të kryeministrit”, 13 dhjetor 2022, <https://www.balkanweb.com/investigimi-pa-merak-ta-mbyllim-direkt-super-skandali-i-korrupsionit-doganieret-e-portit-te-durresit-filmohen-duke-marre-ryshfet-ne-skeme-dhe-vellai-i-keshilltarit-te-rames/>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁸⁸ *Euronews Albania*, “Të vrasim djalin. Si u kërcënua pronari i shoqërisë që të tërhiqej nga tenderi”, 10 prill 2023, <https://euronews.al/te-vrasim-djalin-si-u-kercenua-me-arme-ne-koke-administratori-per-tenderin-1-mln-e/>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁸⁹ Intervista me Neritan Mullaj, Drejtor Ekzekutiv i Dhomës Amerikane të Tregtisë, 16 shkurt 2023.
- ¹⁸⁹⁰ Intervista me Neritan Mullaj, Drejtor Ekzekutiv i Dhomës Amerikane të Tregtisë, 16 shkurt 2023.
- ¹⁸⁹¹ Në 2020, Prokuroria e Posaçme nisi një hetim për dhënien me koncesion të inceneratorëve në Elbasan, Fier dhe Tiranë. Sipas këtyre hetimeve janë arrestuar dhe dënuar zyrtarë të lartë si ish-ministri i Mjedisit Lefter Koka, ish-deputeti Alqi Bllako dhe është shpallur një urdhër arresti për ish-zëvendëskryeministrin Arben Ahmetaj.
- ¹⁸⁹² BIRN Albania, “Zyrtarët e Ministrisë së Brendshme shpallen fajtorë për tenderin e Uniformës së policisë”, 30 dhjetor 2021, <https://www.reporter.al/2021/12/30/zyrtaret-e-ministrise-se-brendshme-shpallen-fajto-re-per-tenderin-e-uniformave/>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁹³ Intervista me Gjergj Buxhuku, administrator i “Konfindustria”, 3 mars 2023.
- ¹⁸⁹⁴ Ligji nr. 55 për “Investimet Strategjike” 2015, <https://aida.gov.al/images/PDF/baza-ligjore/LIGJI-MBI-INVESTIMET-STRATEGJIKE.pdf>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁹⁵ Ligji nr. 79 “Për miratimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development Company dhe NSHMI Development LLC për projektin e investimit strategjik “Marina dhe Jahtet e Durrësit” 2022, <http://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/ca45e21e-1c8f-4fd0-81c9-73da98c0bef5>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁹⁶ BIRN Albania, “Alqi Bllako u arrestua”, 1 prill 2022, <https://www.reporter.al/2022/04/01/policia-alqi-bllako-ne-arrest-u-vetedorezua/>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁹⁷ *Zëri i Shqiptarëve*, “Shehaj: Policia zaptoi biznesin tim për të më mbyllur gojën”, 20 tetor 2022, <https://www.voal.ch/denoncova-xhacken-dhe-gjiknurin-shehaj-rama-dergoi-policine-ne-biznesin-tim-per-te-me-mbyllur-gojen-politike/shqiperi/>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁹⁸ Ligji nr. 7, “Për transparencën e produkteve ushqimore dhe produkteve të tjera që lidhen me to” 2022, <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/Akt-Normativ-nr.-7-dat%C3%AB-18.3.2022-1.pdf>, [aksesuar më: 6 nëntor 2023].
- ¹⁸⁹⁹ Ligji nr. 112/2020, për “Regjistrin e Pronarëve Përfitues”, Neni 3.
- ¹⁹⁰⁰ Ligji për “Regjistrin e Pronarëve Përfitues”, Neni 4/1 dhe Neni 13.
- ¹⁹⁰¹ Ligji nr. 6/2022, për “disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 112/2020 për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”.
- ¹⁹⁰² Ligji për “Regjistrin e Pronarëve Përfitues”, Neni 7.
- ¹⁹⁰³ Ligji nr. 25/2018, për “Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Neni 12/1
- ¹⁹⁰⁴ Ligji nr. 25/2018, për “Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Neni 4.
- ¹⁹⁰⁵ Ligji nr. 25/2018, për “Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Neni 22/1
- ¹⁹⁰⁶ Ligji nr. 25/2018, për “Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Neni 22/2
- ¹⁹⁰⁷ Intervista me Dritan Fino, Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, 15 shkurt 2023.
- ¹⁹⁰⁸ Intervista me Dritan Fino, Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, 15 shkurt 2023.
- ¹⁹⁰⁹ Intervista me Dritan Fino, Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, 15 shkurt 2023.
- ¹⁹¹⁰ Ligji për “Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Neni 5.
- ¹⁹¹¹ *Ibid.*

- ¹⁹¹² Ligji nr. 8269, për “Bankën e Shqipërisë”, Neni 3/1, pika b).
- ¹⁹¹³ Vendimi nr. 30 i Bankës së Shqipërisë për “Dokumentin e Politikës Operative të Mbikëqyrjes”, f. 20.
- ¹⁹¹⁴ *Ibid.*
- ¹⁹¹⁵ Ligji nr. 25 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” 2018, <https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/ligj-nr.-25-dt.-10.5.2018.pdf>, [aksesuar më 7 nëntor 2023].
- ¹⁹¹⁶ Intervista me Neritan Mullaj, Drejtor Ekzekutiv i Dhomës Amerikane të Tregtisë, 16 shkurt 2023.
- ¹⁹¹⁷ Klan Tv, “Inspektimet për kontabilistët e autorizuar”, 24 tetor 2020, <https://tvklan.al/kontrolle-per-kontabilistet-dhe-audituesit-ligjore/>, [aksesuar më 7 nëntor 2023].
- ¹⁹¹⁸ Intervista me Dritan Fino, Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, 15 shkurt 2023.
- ¹⁹¹⁹ Intervista me Dritan Fino, Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, 15 shkurt 2023.
- ¹⁹²⁰ Intervista me Dritan Fino, Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, 15 shkurt 2023.
- ¹⁹²¹ Intervista me Dritan Fino, Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, 15 shkurt 2023.
- ¹⁹²² Qendra Kombëtare e Biznesit, “Raporti Vjetor 2022”, <https://qkb.gov.al/media/38381/raport-vjetor-per-regjistrin-tregtar-regjistrin-e-leje-licencave-dhe-autorizimeve-dhe-regjistrin-e-prionarit-perfitues-2022.pdf>, f. 13, [aksesuar më 7 nëntor 2023].
- ¹⁹²³
- ¹⁹²⁴
- ¹⁹²⁵ Revista Monitor, “Mbyllet Bursa e Tiranës”, 1 prill 2022, <https://www.monitor.al/bursa-e-tiranes-cregjistrohet-perfundimisht-mbyllet-historia-e-burses-se-pare-shqiptare1/>, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹²⁶ Ligji nr. 9901, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Neni 81
- ¹⁹²⁷ Ligji për “Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Neni 95
- ¹⁹²⁸ Ligji nr. 9572, për “Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, Neni 2
- ¹⁹²⁹ Ligji për “Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, Neni 3, 5 dhe 26
- ¹⁹³⁰ Ligji nr. 8269, për “Bankën e Shqipërisë”, Neni 3.
- ¹⁹³¹ Rregullorja nr. 120 e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për “Licencimin dhe Mbikëqyrjen e Bursës”.
- ¹⁹³² Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë, 2019, f. 61.
- ¹⁹³³ Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë, 2018, f. 60.
- ¹⁹³⁴ Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Udhëzuesi për përgatitjen e raportimit jofinanciar, 2020, https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/Udhzuesi%20i%20raportimit%20jofinanciar_publicuar.pdf.
- ¹⁹³⁵ Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë, 2023, f. 84.
- ¹⁹³⁶ Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, “Indeksi i Qeverisjes së Korporatës”, dhjetor 2022: <https://icc-albania.org.al/14627-2/>, f. 15, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹³⁷ “Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, “Indeksi i Qeverisjes së Korporatës”, dhjetor 2022: <https://icc-albania.org.al/14627-2/>, f. 27, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹³⁸ “Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, “Indeksi i Qeverisjes së Korporatës”, dhjetor 2022: <https://icc-albania.org.al/14627-2/>, f. 28, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹³⁹ Instituti i Statistikave në Shqipëri, “Regjistrat e Biznesit 2022”, <https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%20C3%ABrbimet/regjistrat-e-biznesit/publikimet/2022/regjistrat-e-biznesit-2021/>, f. 9, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹⁴⁰ Ligji nr. 9662/2006 “Për bankat në Shqipëri”, https://www.bankofalbania.org/Rreth_Bankes/Legislacioni/Ligj_9662_2006_Per_bankat_ne_Republiken_e_Shqiper_ise_version_i_integruar.html, Neni 30, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹⁴¹ “Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, “Indeksi i Qeverisjes së Korporatës”, dhjetor 2022: <https://icc-albania.org.al/14627-2/>, f. 32, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹⁴² Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, “Indeksi i Qeverisjes së Korporatës”, dhjetor 2022: <https://icc-albania.org.al/14627-2/>, f. 30, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹⁴³ *Zëri i Amerikës*, “Korrupsioni dhe klima e biznesit, pesë Dhoma Tregtie kërkojnë reformim”, 11 prill 2023, <https://www.zeriamerikes.com/a/7045035.html>, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹⁴⁴ Shoqata Shqiptare e Bankave, “Kodi i Sjelljes”, <https://aab.al/rreth-nesh/aab/kodi-i-etikes/>.
- ¹⁹⁴⁵ inistria e Financave dhe Ekonomisë, Kodi i Qeverisjes së Korporatës për Shoqëritë Aksionare të Përrjashtuara në Shqipëri, https://www.ecgi.global/sites/default/files/codes/documents/cg_code_unlisted_companies_albania_14apr2008_en.pdf

- ¹⁹⁴⁶ "Indeksi i Qeverisjes së Korporatës", Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, dhjetor 2022: <https://icc-albania.org.al/14627-2/>.
- ¹⁹⁴⁷ Deloitte Albania, *Të merresh me biznes në Shqipëri – Një udhëzues krahasues*, 2022, f. 9, <https://www2.deloitte.com/content/dam/Deloitte/global/Documents/Legal/dttl-legal-doing-business-in-albania.pdf>.
- ¹⁹⁴⁸ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Neni 16, https://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50026_E.pdf.
- ¹⁹⁴⁹ Ligji nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", <https://qbz.gov.al/eli/ligji/2016/06/02/60-2016>; Ligji nr. 9049/2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, detyrimeve financiare të zyrtarëve të zgjedhur dhe disa nëpunësve publikë", <https://www.ildkpkj.al/legjislacioni/>.
- ¹⁹⁵⁰ Intervista me Neritan Mullaj, Drejtor Ekzekutiv i Dhomës Amerikane të Tregtisë, 16 shkurt 2023.
- ¹⁹⁵¹ Ligji nr. 9754, "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë".
- ¹⁹⁵² Ligji për "Përgjegjësinë penale të personave juridikë", Neni 3.
- ¹⁹⁵³ Ligji për "Përgjegjësinë penale të personave juridikë", Neni 15, 16 dhe 17.
- ¹⁹⁵⁴ Ligji për "Përgjegjësinë penale të personave juridikë", Neni 19.
- ¹⁹⁵⁵ Ligji nr. 9643, për "Prokurimin Publik", Neni 26/1.
- ¹⁹⁵⁶ Ligji nr. 9643, për "Prokurimin Publik", Neni 45, 47.
- ¹⁹⁵⁷ "Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, "Indeksi i Qeverisjes së Korporatës", dhjetor 2022: <https://icc-albania.org.al/14627-2/>, f. 32, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹⁵⁸ Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, "Indeksi i Qeverisjes së Korporatës", dhjetor 2022: <https://icc-albania.org.al/14627-2/>, f. 33, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹⁵⁹ Revista Monitor, "Shqipëria me kapjet më të mëdha nga shteti për veprimtaritë tregtare në rajon", 7 dhjetor 2022, <https://www.monitor.al/shqiperia-ka-kapjen-me-te-larte-te-shtetit-nga-bizneset-dhe-mbetet-me-e-korruptuara-ne-rajon/>, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹⁶⁰ Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, "Indeksi i Qeverisjes së Korporatës", dhjetor 2022: <https://icc-albania.org.al/14627-2/>, f. 33, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹⁶¹ Njësia e Inteligjencës Financiare Shqiptare dhe Deklarata e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 9 nëntor 2021, <https://fiu.gov.al/njoftimi-i-keshillit-te-sigurimit-te-kombeve-te-bashkuara-09-10-2021-sc-14695-9-november-2021/>, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹⁶² INSTAT, *Indeksi i Barazisë Gjimore për Republikën e Shqipërisë 2020*, f. 21, https://www.instat.gov.al/media/6661/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020.pdf.
- ¹⁹⁶³ *Ibid.*
- ¹⁹⁶⁴ Sondazhi i Deloitte Albania, <https://www2.deloitte.com/al/en/pages/audit/articles/shexo-survey.html>.
- ¹⁹⁶⁵ Open Data Albania, *Pronësia e shoqërive të biznesit të regjistruara gjatë vitit 2019 sipas Përfaqësimit gjinor*, <https://ndiqparate.al/?p=10883&lang=en>.
- ¹⁹⁶⁶ Banka Botërore, *Drejt Barazisë Gjimore në Shqipëri: Ndryshimi i mendësive përmes reformës institucionale*, 2020, <https://www.worldbank.org/en/results/2020/06/19/toward-gender-equality-in-albania-shifting-mindsets-through-institutional-reform>.
- ¹⁹⁶⁷ Ministria e Drejtësisë, Agjencia Kundër Korrupsionit, <https://www.drejtesia.gov.al/rrjeti-i-koordinatoreve-anti-korrupsion/>, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹⁶⁸ *Zëri i Amerikës*, "Korrupsioni dhe klima e biznesit, pesë Dhoma Tregtie kërkojnë reformim", 11 prill 2023, <https://www.zeriamerikes.com/a/7045035.html>, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹⁶⁹ Intervista me Neritan Mullaj, Drejtor Ekzekutiv i Dhomës Amerikane të Tregtisë, 16 shkurt 2023.
- ¹⁹⁷⁰ Intervista me Gjergj Buxhuku, administrator i "Konfindustria", 3 mars 2023.
- ¹⁹⁷¹ Birn Albania, "Lufta për 'Duty Free' kthehet në një sfidë për klimën e biznesit në Shqipëri", 6 maj 2020, <https://www.reporter.al/2020/05/06/lufta-per-duty-free-u-kthye-ne-test-lakmues-per-klimen-e-investimeve-te-huaja/>, [aksesuar më: 7 nëntor].
- ¹⁹⁷² Kombet e Bashkuara, "Lista e Kompaktit Global", https://unglobalcompact.org/search?document_type=Headline&keywords=albania&page=1&search%5Bdocument_type%5D=Participant, [aksesuar më: 7 nëntor 2023].
- ¹⁹⁷³ USAID, Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile për Shqipërinë 2021, 2022, f. 9, <https://idmalbania.org/2021-civil-society-organizations-sustainability-index/>.
- ¹⁹⁷⁴ *Ibid.*, f.10.

¹⁹⁷⁵ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Forumi me shumë palë të interesuara kundër pastrimit të parave në Shqipëri, 2022, <https://idmalbania.org/event-summary-multi-stakeholder-forum-on-anti-money-laundering-in-albania/>.

¹⁹⁷⁶ Sondazhi: Cilësia e Shërbimeve Publike Digjitale sipas Këndvështrimit të Biznesit, Këshilli i Investimeve, 2023, <https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2023/11/Keshilli-Investimeve-Anketa-mbi-Cilesine-e-Sherbimeve-Publike-Digjitale-sipas-Kendveshtrimit-te-Biznesit.pdf>.

¹⁹⁷⁷ Për përmirësimin e mjedisit të biznesit 2015-2021, Këshilli i Investimeve f. 101,

https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2022/05/Keshilli-Investimeve_Mbi-Klimen-e-Investimeve-2015-2021.pdf.

¹⁹⁷⁸ Konsultimi publik si një mjet efektiv për përmirësimin e vendimmarrjes dhe dialogut ndërmjet bizneseve dhe institucioneve, Këshilli i Investimeve, 2022, f. 24, https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2023/01/AL_Konsultimi-Publik-si-nje-mjet-efektiv-per-permiresimin-e-dialogut-publik-privat.pdf.

¹⁹⁷⁹ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe Transparency International, Zbërthimi i kapjes së shtetit në Shqipëri: Një shqyrtim i rasteve të korrupsionit të madh dhe ligjeve të posaçme që nga 2008 deri në 2020, 2021, <https://idmalbania.org/deconstructing-state-capture-in-albania/>.

NDËRMARRJET SHITËRORE

PËRMBLEDHJE

REZULTATI I PËRGJITHSHËM I ORGANIT :
REZULTATI I KAPACITETIT:
REZULTATI I QEVERISJES:



Ndërmarrjet shtetërore (NSH) janë subjekt i rregullimit nga tre ligje themelore, përkatësisht Ligji për Ndërmarrjet Shtetërore, Ligji për Transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare dhe Ligji për Sipërmarrësit dhe Shoqëritë Tregtare. Nuk ekziston një regjistër publik të NSH-ve që kontribuon në mungesën e transparencës.

Pjesa më e madhe e NSH-ve mbikëqyren nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ndërsa pjesa tjetër mbikëqyret nga ministritë e posaçme të ndryshme sektoriale ose bashkitë. Megjithëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë mban përgjegjësi nga ana ligjore për të drejtat e pronësisë shtetërore në të gjitha NSH-të, ajo delegon administrimin e NSH-ve drejt ministrive të posaçme. Mirëpo, disa vendime për pronësinë, si emërimet e bordit, kërkojnë koordinim ndërministror.

Struktura qeverisëse e NSH-ve përfshin një bord të mbikëqyrjes dhe një drejtor, ku bordi i mbikëqyrjes përbëhet nga anëtarë të emëruar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe ministria e posaçme për pronësinë ose njësi e qeverisjes vendore që mban përgjegjësi për emërimin e stafit drejtues të NSH-ve.

Pozicionet në bordin dhe stafin drejtues të NSH-ve shpesh perceptohen që të plotësohen në bazë të lidhjeve personale dhe politike sesa kualifikimeve profesionale, duke çuar në problematika për ndikimin politik dhe duke theksuar boshllëqet në kuadrin e caktimit të anëtarëve të bordit. Shpeshherë, anëtarëve të bordit u mungon pavarësia dhe autoriteti për vendimmarrjen, pasi shumë vendime paracaktohen nga qeveria. Për më tepër, shumë prej këtyre subjekteve shihen si të paqëndrueshme nga ana financiare. Rrjedhimisht,

shpesh lindin debate rreth NSH-ve dhe marrëdhënieve të tyre me qeverinë.

Janë vendosur kufizime për dhurimet për partitë politike dhe disa dënime penale skualifikojnë individët nga pozitave drejtuese të NSH-ve. Deklaratat e pasurisë nevojiten për anëtarët e bordit dhe drejtorët e NSH-ve.

Ligji i trajton NSH-të dhe shoqëritë private në mënyrë të barabartë për sa i përket konkurrencës në treg, por disa shtrembërime konkurruese vazhdojnë të përsëriten, në veçanti në sektorë si energjia, aeroportet dhe portet, ku partneriteti publik-privat dhe rregullat e paqarta të qeverisjes pengojnë konkurrencën e drejtë.

KAPACITETET

TREGUESI 15.1.1 PAVARËSIA (LIGJI)

Deri në çfarë mase kuadri ligjor dhe rregullator për NSH-ve mbron funksionimin e pavarur të NSH-ve dhe siguron një fushë loje të barabartë ndërmjet NSH-ve dhe kompanive të sektorit privat?



Megjithëse ekzistojnë dispozita të caktuara, ato nuk garantojnë operimin autonom të NSH-ve. Përveç kësaj, konkurrenca e drejtë ndërmjet NSH-ve dhe shoqërive të sektorit privat cenohet pre përjashtimeve nga procedurat e rregullta të prokurimit dhe subvencionet shtetërore.

Në radhë të parë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë mban përgjegjësi për zbatimin e të drejtave për pronën e shtetit në NSH, ndërsa

ministrive të posaçme u jepen role administrative.¹⁹⁸⁰ Mirëpo, ligji nuk i përcakton mjaftueshëm dallimet ndërmjet roleve pronësore dhe administrative.¹⁹⁸¹ Aktualisht, përgjegjësitë e pronësisë shtetërore shpërndahen në shumë ministri dhe organe qeveritare. Qeverisja korporative e NSH-ve ka mangësi¹⁹⁸² dhe nuk ekziston asnjë organ koordinues për të harmonizuar praktikat e pronësisë shtetërore dhe për të përhapur konsistencën në të gjitha ministrinë e pronësisë. Mirëpo, ministrinë e pronësisë kanë njësi të veçanta monitorimi nga njësitë e tyre sektoriale të hartimit të politikave, duke siguruar kështu një ndarje më të qartë institucionale të funksioneve.¹⁹⁸³

Është krijuar një kuadër për emërimin e bordit, por ekziston rreziku i ndikimit politik në caktimin e anëtarëve të bordit për shkak të mungesës së kriterëve transparente dhe të bazuara në merita.¹⁹⁸⁴

Ligji për NSH-të nuk bën dallime ndërmjet shoqërive publike dhe private dhe kërkon që NSH-të të veprojnë në të njëjtat kushte të konkurrencës së lirë lidhur me pjesën e tregut, produktet dhe shërbimet.¹⁹⁸⁵ Përgjithësisht, shteti nuk mbulon humbjet e NSH-ve¹⁹⁸⁶ dhe nuk mban përgjegjësi për detyrimet e NSH-ve ndaj palëve të treta.¹⁹⁸⁷ Mirëpo, akoma vazhdojnë të ekzistojnë disa shtrembërimë konkurruese. Kohët e fundit u themelua Korporata Shqiptare e Investimeve për të drejtuar projekte investimi me interes publik.¹⁹⁸⁸ Mirëpo, rregullat e qeverisjes dhe mbikëqyrjes së saj janë të paqarta dhe numri i madh i PPP-ve dhe përjashtimi i pjesshëm i rregullave të zakonshme të prokurimit për PPP-të në sektorin e energjisë, aeroporteve dhe porteve pengojnë konkurrencën e ndershme në ato tregje.¹⁹⁸⁹ NSH-të e mëdha, krahas aksesit të tyre në financimin e borxhit tregtar si firmat private, përfitojnë nga subvencionet shtetërore, gjë që krijon një avantazh të padrejtë ndaj shoqërive private për sa i përket avantazheve të financimit operacional.¹⁹⁹⁰

Qeveria nuk përgatit një raport të rregullt për performancën e NSH-ve për sa i përket veprimtarive të tyre me interes për publikun.¹⁹⁹¹

INDICATOR 15.1.2 INDEPENDENCE (PRACTICE)

Deri në çfarë mase kryhen në praktikë operacionet e përditshme të NSH-ve pavarësisht nga ndërhyrja e shtetit?



Megjithëse shteti nuk ndërhyr në operimin e përditshëm të NSH-ve, kontrolli dhe direktivat e tyre kryesore vijnë prej qeverisë ose bashkisë që zotëron shoqërinë.

NSH-të më të rëndësishme janë pjesë e një tregu të kontrolluar për shkak të pozicionit të tyre monopol në treg për produktin ose shërbimin që ato ofrojnë. Prandaj, çmimi për produktin ose shërbimin e tyre, si dhe raporti financiar dhe plani i investimit rishikohen dhe miratohen nga një subjekt i pavarur. Kjo strukturë është krijuar për të mbrojtur konsumatorët nga abuzimet e mundshme me pozicionin mbizotërues në treg. Mirëpo, vendimet e këtyre subjekteve në raste të caktuara kanë qenë të diskutueshme.¹⁹⁹² Në shumicën e rasteve, subjektet e pavarura kanë treguar se disa nga vendimet e tyre për mbrojtjen e çmimeve dhe konsumatorit drejtohen nga qeveria dhe jo nga një shqyrtim i qartë i programeve ekonomike, konkurrencës dhe progresit të sektorit.¹⁹⁹³ Megjithëse autoriteti përgjegjës për çmimin e energjisë për konsumatorët është Enti Rregullator i Energjisë (ERE), gjatë vjeshtës së vitit 2022, rritja e çmimit të energjisë është njoftuar më herët nga ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë. Në vitet e fundit, ERE-ja ka ndjekur politikën e qeverisë për të mos ulur çmimet e energjisë në kohën që shoqëritë e këtij sektori kishin fitime të larta.¹⁹⁹⁴

Sipas një të intervistuarit, anëtarët e bordit të NSH-së nuk ushtrojnë funksionet e tyre të plota, të cilat janë analizimi, monitorimi dhe marrja e në vendimi në mënyrë profesionale, duke marrë parasysh se pothuajse të gjitha vendimet merren në mënyrë paraprake nga ministria ose qeveria dhe anëtarët e bordit shërbejnë më shumë si sekretarë të tyre sesa si hartues politikash.¹⁹⁹⁵ Ndërmarrjet më me rëndësi në Shqipëri janë ato në fushën e energjisë dhe

furnizimit me ujë dhe në të dyja rastet çmimi i shitjes vendoset nga subjektet e pavarura.¹⁹⁹⁶ Gati 100 për qind¹⁹⁹⁷ e energjisë në Shqipëri furnizohet nga ndërmarrjet publike, ndërsa prodhimi privat u shitet NSH-ve ose eksportohet jashtë vendit.¹⁹⁹⁸ Ekzistojnë vetëm disa shoqëri që e prodhojnë dhe e konsumojnë vetë energjinë. Edhe në rastin e çmimit të ujit, tarifat miratohen nga Enti Rregullator i Ujit duke u bazuar në aplikacionet dhe programet ekonomike të shoqërive. Në Shqipëri gjenden 57 shoqëri të furnizimit me ujë në pronësi të bashkive të ndryshme.¹⁹⁹⁹

Pavarësia e marrjes së vendimeve nga organet drejtuese të NSH-ve është në pikëpyetje, pasi shumë vendime njoftohen nga një ministër apo kryeministri para se të miratohen në mbledhjen e bordit.²⁰⁰⁰ Drejtorët ose menaxherët e shoqërive kanë më shumë pushtet se bordet në zbatim dhe në shumicën e rasteve, Drejtorët e Përgjithshëm janë shpesh në një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me ministrin e posaçëm, gjë që provon se ata kanë më shumë pushtet se bordi.²⁰⁰¹ Në shumicën e rasteve, emërimi i administratorit të shoqërisë bëhet nga ministri i posaçëm dhe ka edhe raste kur miratimi jepet nga Zyra e Kryeministrit.²⁰⁰² Në disa ndërmarrje ka administratorë të kualifikuar me një profil që lidhet me veprimtarinë e shoqërisë, por ka edhe raste kur Drejtori i Përgjithshëm nuk ka fare përvojë në këtë fushë, ose ka konflikt interesi pasi ai ose ajo ka punuar më parë në pozicione kyçe në sektorin privat po në të njëjtën fushë.²⁰⁰³ Pavarësisht aftësive drejtuese, pjesa më e madhe e administratorëve kanë profil politik dhe marrin pjesë në mënyrë aktive në fushatat elektorale të partisë që i ka emëruar.²⁰⁰⁴ Sipas ish-drejtorit të Përgjithshëm të Auditimit në KLSH, këto pika ngrenë dyshime nëse punësimi, emërimet dhe vendimet e tyre varen plotësisht në interesat më parësore të shoqërisë.²⁰⁰⁵

Në pjesën më të madhe të rasteve, postet e bordit në shoqëritë publike shihen si një mënyrë shpërblimi për të siguruar pagesën për mbledhjet dhe për të rritur pagën e një nëpunësi publik. Në pjesën më të madhe të shoqërive, anëtarët e bordit janë drejtorë, këshilltarë ose persona të afërt me

ministrat dhe shkarkohen nga detyra kur ndërrohet ministri ose ka alternim të partisë politike në pushtet.²⁰⁰⁶ Në bordet e NSH-ve vihet re mungesa e ekspertëve, aktorëve të shoqërisë civile dhe akademikëve. Në raste të caktuara, anëtarët e bordit e kanë të vështirë të sigurojnë informacionin e nevojshëm për shoqërinë dhe kur kanë kundërshtuar vendimmarrjen, ka pasur raste kur janë shkarkuar.²⁰⁰⁷ Ish-drejtori i Përgjithshëm i Auditimit deklaroi se nuk ka asnjë pritshmëri nga ky proces pasi nuk ka administratë jopolitike apo bord jopolitik sepse shumica prej tyre haptazi janë pjesë e fushatave dhe janë anëtarë partish. NSH-të duhet të drejtohen nga ekspertë dhe Drejtorë të Përgjithshëm me përvojë të duhur për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve dhe pasurive kombëtare dhe jo nga zyrtarë aktivë shtetërorë që e përdorin administratën si një mënyrë për të mbledhur vota dhe për të gjetur vende pune partiake. Ata menaxhojnë një shumë tepër të madhe parash dhe një numër shumë i madh i të punësuarve në NSH-të që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zgjedhje.²⁰⁰⁸

Pjesa më e madhe e shoqërive publike ofrojnë shërbime ekskluzive në sektorin e tyre, duke përfshirë shoqëritë në sektorët e energjisë, ujit, hekurudhave, navigacionit ajror apo grumbullimit të mbetjeve në territore të caktuara. Është e pamundur të krahasohet nëse ato kanë akses të padrejtë në tregjet private. I vetmi aspekt që mund të vihet re në mënyrën se si ato përdorin privilegjin e tyre është të kontrollohet nëse ka ndonjë abuzim të pozicionit të tyre dominues në treg për sa i përket çmimit dhe cilësisë. Autoriteti i Konkurrencës në Shqipëri ka konstatuar abuzime në disa raste ose NSH-të për sa i përket çmimit të vendosur nga bordet e tyre ose subjektet e pavarura.²⁰⁰⁹

Shoqëritë të cilat përballen me konkurrencën në treg janë Posta Shqiptare dhe Albpetrol. Posta Shqiptare siguron shërbime postare dhe pagesash dhe ofron çmime më të ulëta se operatorët e tjerë, gjë që lidhet me volumin më të madh të punës dhe klientëve të saj, pasi është e përhapur në të gjithë territorin. Pavarësisht kësaj, tregu i saj në vitet e fundit ka pësuar rënie, duke u zëvendësuar më

shumë nga operatorët privatë konkurrues në treg. Albpetrol është një shoqëri që prodhon dhe shet naftë dhe zotëron shumicën e puseve në tokë në Shqipëri. Prodhimi i saj shitet në tregun privat, por nuk është vendimtar për çmimin e naftës pasi formula lidhet me bursën.²⁰¹⁰ Edhe pse prodhuesi më i madh i naftës është një shoqëri private Bankers Petroleum,²⁰¹¹ pjesa më e madhe e prodhimit të saj eksportohet jashtë vendit dhe kërkesa për naftë bruto në tregun vendas ka rënë që me mbylljen e rafinerisë së naftës, Rafineria e përpunimit dhe tregimit të naftës në Shqipëri (ARMO). Menjëherë pas falimentimit të ARMO-s, Autoriteti i Konkurrencës në Shqipëri konstatoi se Bankers Petroleum kishte abuzuar me pozicionin e saj në tregun e naftës dhe vendosi një gjobë ndaj shoqërisë.²⁰¹²

QEVERISJA

TREGUESI 15.2.1 TRANSPARENCA (LIGJI)

Deri në çfarë mase ekzistojnë dispozita për të siguruar transparencë në aktivitetet e NSH-ve?



Për ndërmarrjet shtetërore ekzistojnë dispozita të përshtatshme ligjore lidhur me zbulimin e informacionit, në veçanti lidhur me llogaritë financiare dhe kuadrin e menaxhimit. Megjithatë, ligji për NSH-të nuk jep afate specifike për dorëzimin e llogarive vjetore dhe nuk u kërkohet të raportojnë për programin e tyre kundër korrupsionit.

Transparenca e NSH-ve drejtohet nga kuadri ligjor për ndërmarrjet tregtare²⁰¹³ dhe sektorin publik.²⁰¹⁴ NSH-ve u kërkohet të ruajnë, të përgatisin dhe të paraqesin llogaritë vjetore dhe të raportojnë në mënyrë të vazhdueshme treguesit dhe të dhënat statistikore.²⁰¹⁵ Drejtori duhet të dorëzojë në fund të çdo viti një raport për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjes, i cili më pas miratohet nga bordi i mbikëqyrjes dhe i dërgohet organit të pronësisë, bashkë me llogaritë vjetore të vërtetuara.²⁰¹⁶ Raporti vjetor duhet t'u njoftohet

edhe punonjësve nëpërmjet përfaqësuesve të sindikatave.²⁰¹⁷ Pasqyrat financiare i dorëzohen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, e cila i nxjerr ato në faqen zyrtare të internetit.²⁰¹⁸ Kushdo mund të kërkojë lirisht në bazën e të dhënave elektronike për çdo të dhënë të regjistruar.²⁰¹⁹

Për sa i përket ndërmarrjeve private, NSH-të duhet të dorëzojnë dhe të bëjnë publike statutet e tyre, strukturat e pronësisë dhe informacionin për identitetin e anëtarëve të bordit të mbikëqyrjes, pasqyrat financiare vjetore, raportet e progresit të veprimtarive dhe raportet e auditimit.²⁰²⁰ Ndërmarrjet tregtare me shumicën e aksioneve shtetërore ose ato që kryejnë funksione publike janë subjekt i dispozitave të Ligjit për të Drejtën e Informimit që autorizon Programet e Transparencës dhe publikimin e informacionit proaktiv dhe sipas kërkesës.²⁰²¹ Për më tepër, prokurimi në ndërmarrjet shtetërore ku qeveria zotëron shumicën e aksioneve kërkohet t'u përmbahet dispozitave të transparencës të parashikuara nga Ligji për Prokurimin, duke përfshirë informacionin online dhe procedurat e apelimit.²⁰²²

Për më tepër, NSH-ve nuk u kërkohet të raportojnë për programet e tyre kundër korrupsionit.

TREGUESI 15.2.2 TRANSPARENCA (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase ka transparencë të NSH-ve në praktikë?



Ndonëse NSH-të zbulojnë disa informacione të rëndësishme për shërbimet që ofrojnë, pjesa më e madhe e tyre nuk e kanë zbatuar siç duhet "Programin e Transparencës". Ka mungesë të të dhënave të përditësuara financiare dhe regjistri i prokurimeve publike dhe asnjë nga shoqëritë nuk i shpall vendimet e bordit.

Pjesa më e madhe e NSH-ve kanë një faqe interneti që ofron informacione për shërbimin e tyre publik dhe një pjesë e mirë kanë zyra shërbimi për qytetarët që të informohen dhe të adresojnë

problemet që lidhen me shërbimin, por mungesa e të dhënave të grumbulluara për NSH-të është ende problematike. Nuk ka regjistër publik të NSH-ve²⁰²³ që zotërohet nga shteti dhe raportet e tyre financiare nuk publikohen më në Drejtorinë Shtetërore të Pasurive dhe Pronës Publike që nga viti 2016.²⁰²⁴ I vetmi informacion i disponueshëm mund të gjendet në Regjistrin Kombëtar të Biznesit, por bilancet dhe raportet financiare publikohen me vonesë dhe disa NSH të rëndësishme (Operatori Shqiptar i Furnizimit me Energji [OSHEE], Korporata Elektroenergetike Shqiptare [KESH], Albcontrol dhe Posta Shqiptare) nuk kanë dorëzuar raport financiar gjatë dy viteve të fundit.²⁰²⁵

Sipas një analisti politikash dhe ish-drejtor i Euronews Albania, niveli i pagave të drejtuesve të bordeve dhe administratorëve në NSH-të ka qenë gjithmonë një problematikë dhe shpeshherë është ngritur si shqetësim nga KLSH-ja. Në shumicën e NSH-ve, administratori paguhet dy ose tre herë më shumë se kryeministri ose ministri që mbikëqyr dhe përfaqëson pronësinë e ndërmarrjes.²⁰²⁶

Nuk ekziston një marrëdhënie transparente ndërmjet ndihmës së dhënë nga qeveria për këto ndërmarrje dhe në veçanti për ato në pronësi të pushtetit vendor. Investimet buxhetore bëhen publike vetëm kur bëhen ndryshime në buxhetin e shtetit. Në raste specifike, garancitë për linjat e kreditit nga institucionet shtetërore për NSH-të mund të gjenden vetëm në regjistrin e borxhit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë²⁰²⁷ dhe ka një gjuhë tepër teknike për t'u kuptuar nga publiku.²⁰²⁸ Në raste të shumta, pagesat nga buxheti i shtetit për kreditë e NSH-ve nuk kanë qenë transparente, por janë zbuluar nga KLSH-ja.²⁰²⁹ Janë bërë shumë investime për shoqëritë e furnizimit me ujë, shoqëritë e energjisë dhe disa korporata të reja si Korporata e Investimeve²⁰³⁰ dhe Illyrian Guard.²⁰³¹ Ndërmarrjet e furnizimit me ujë, në të shumtën e rasteve, kanë borxhin më të madh për pagesat e faturave të energjisë ndaj OSHEE-së, gjë e cila ka shkaktuar një krizë borxhi ku OSHEE-ja duhet të paguajë borxhin për energjinë që ka blerë nga KESH-i dhe Operatori Shqiptar i Transmetimit (OST).²⁰³²

Në vitin e kaluar, Shqipëria krijoi një regjistër të pronësisë përfituese²⁰³³ pas dy vitesh shtyrjeje,²⁰³⁴ por gjysma e ndërmarrjeve nuk e kanë dorëzuar formularin e deklaratës së pronarit përfitues, ndërsa disa e kanë plotësuar gabim.²⁰³⁵ Një problem tjetër me shoqëritë private apo shtetërore me sipërmarrje të përbashkët është kufizimi i deklaratimit të pronësisë deri në 25 për qind të aksioneve, gjë që e bën të pamundur zbulimin e pronarëve të tjerë që kanë aksione më të ulëta pronësie.²⁰³⁶

TREGUESI 15.2.3 LLOGARIDHËNIA (LIGJI)

Deri në çfarë mase ekzistojnë rregulla dhe ligje që rregullojnë mbikëqyrjen e NSH-ve?



Janë ndërmarrë masa gjithëpërfshirëse për të siguruar mbikëqyrjen e përshtatshme të NSH-ve nëpërmjet strukturave të qeverisjes së brendshme, mbikëqyrjes shtetërore dhe shkallëve të ndryshme të auditimit. Megjithatë, nuk ka një njësi qendrore koordinuese dhe përpjekjet për të krijuar një të tillë kanë rezultuar të pasuksesshme.

Strukturat e qeverisjes së NSH-ve përbëhen nga bordi i mbikëqyrjes dhe një drejtor (d.m.th. administrator).²⁰³⁷ Bordi i mbikëqyrjes përbëhet nga tre deri në nëntë anëtarë, dy të tretat e të cilëve emërohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe një e treta nga ministria e posaçme për pronësinë ose njësi e qeverisjes vendore.²⁰³⁸ Bordi i mbikëqyrjes është autoriteti më i lartë për vendimmarrjen dhe mban përgjegjësi për përcaktimin e objektivave dhe për emërimin e stafit drejtues të NSH-ve me dy të tretat e votave.

Në 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë propozoi krijimin e një agjencie që do të vepronte si njësi qendrore për koordinimin, por për shkak të mosarritjes së një marrëveshjeje në qeveri, Agjencia për Administrimin e Pronës Publike nuk u themelua.²⁰³⁹ Megjithatë, Drejtoria për Administrimin e Pronës Shtetërore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë mban përgjegjësi për

menaxhimin e NSH-ve dhe analizimin e bilanceve të shoqërive aksionare, por ajo nuk raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë në parlament.²⁰⁴⁰

Autoritetet nuk mbledhin të dhëna të përgjithshme të performancës financiare për NSH-të, gjë që e bën të vështirë nxjerrjen e përfundimeve të përgjithshme për efikasitetin e tyre dhe paraqet rreziqe fiskale, me detyrime të mundshme të vlerësuara nga FMN-ja në rreth 18 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) në 2018.²⁰⁴¹

NSH-të i nënshtrohen llojeve të ndryshme të auditimeve në katër nivele, duke përfshirë auditimet e brendshme, auditimet ministrore, auditimet nga KLSH-ja dhe auditimet e pavarura nga audituesit e jashtëm të certifikuar për pasqyrat e tyre financiare. Programet e auditimit, përzgjedhja dhe koordinimi i NSH-ve vendosen në mënyrë të pavarur nga KLSH-ja, i cili në radhë të parë fokusohet në sigurimin që NSH-të operojnë sipas ligjeve përkatëse,²⁰⁴² ndërsa audituesit e jashtëm përqendrohen në verifikimin që pasqyrat financiare janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. NSH-të me shumicën e aksioneve shtetërore duhet të jenë subjekt i auditimeve të jashtme të pasqyrave të tyre financiare, ndërsa për NSH-të ku shteti është aksionar i pakicës, auditimet e jashtme autorizohen vetëm nëse tejkalojnë një numër të caktuar të punonjësve dhe vlerën e pasurive.²⁰⁴³ Shteti mban përgjegjësi për emërimin e audituesve të jashtëm. Legjislacioni kërkon që të gjitha NSH-të të themelojnë një komitet auditimi, por aktet nënligjore të NSH-ve nuk ofrojnë një përkufizim të qartë për një komitet auditimi.²⁰⁴⁴

NSH-të janë subjekt i të njëjtave norma dhe procedura tatimore dhe të njëjtave standarde të brendshme të kontabilitetit dhe raportimit financiar ndërkombëtar si shoqëritë e tjera tregtare.²⁰⁴⁵ Autoriteti i Konkurrencës mbikëqyr politikat e ndihmës shtetërore, duke përfshirë ato ndaj NSH-ve.²⁰⁴⁶

TREGUESI 15.2.4 LLOGARIDHËNIA (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase ekziston në praktikë mbikëqyrja efektive e NSH-ve?



Përgjithësisht, bordet dhe njësia koordinuese janë vetëm pjesërisht të efektshme në ofrimin e mbikëqyrjes së vendimeve të NSH-ve dhe në zbatim fuqia e tyre është e dobët, e dominuar kryesisht nga Drejtori i Përgjithshëm.

Bordet kanë autoritetin ligjor për të marrë vendime dhe për të monitoruar stafin drejtues, por në zbatim fuqia e tyre mbi vendimmarrjen dhe monitorimin vendoset në shumicën e rasteve nga drejtori ekzekutiv ose administratori. Dobësia e bordeve, fuqia e tyre dhe varësia e emërimeve prej personave të lidhur nga ana e politikës (ministra ose kryetarë bashkie) shpeshherë ka çuar në shkarkimin e anëtarëve që nuk votojnë për planin e sjellë nga administratori ose që kishin kërkuar ngritjen e një grupi monitorimi të shoqërisë.²⁰⁴⁷ Sipas një ish-Drejtori të Përgjithshëm të Auditimit të KLSH-së, pjesa më e madhe e mbledhjeve të këshillit drejtues të NSH-ve zhvillohen për të vepruar sipas ligjit dhe procedurës.²⁰⁴⁸ Në raste të shumta, anëtarët e bordit ndikohen nga interesat politike në ushtrimin e funksioneve të tyre, duke zvogëluar paanshmërinë në vendimmarrje (shih 15.1.2).

Asnjë nga NSH-të nuk ka udhëzues për vlerësimin e performancës për anëtarët e bordit apo stafin drejtues. Disa nga shoqëritë (Albpetrol, Posta Shqiptare, Hekurudha Shqiptare) deklaruan se nuk ka asnjë vlerësim të performancës së punës së bordit drejtues dhe se në pjesën më të madhe të rasteve puna e tyre vlerësohet nga pronari, që është ministria e posaçme përkatëse.²⁰⁴⁹ KESH-i pohoi se ka një proces të vetëvlerësimit të punës së auditimit të brendshëm, por raporti nuk është bërë publik në faqen zyrtare. KLSH-ja ka konstatuar se në procedura të caktuara, auditimi i brendshëm i KESH-it nuk ka arritur të konstatojë shkelje që kanë shkaktuar dëme në ekonomi.²⁰⁵⁰ Sipas një ish-drejtori të përgjithshëm të auditimit të KLSH-së,

NSH-të nuk dorëzojnë raporte financiare edhe pse kanë detyrim ligjor.²⁰⁵¹

KLSH-ja auditon në mënyrë të vazhdueshme NSH-të duke u bazuar në programin vjetor dhe publikon raportin përfundimtar. Disa nga auditimet e KLSH-së nuk janë publike, ndërsa strukturat e auditimit të brendshëm të NSH-ve nuk publikojnë asnjë raport.²⁰⁵²

TREGUESI 15.2.5 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (LIGJI)

Deri në çfarë mase ekzistojnë mekanizma për të siguruar integritetin e NSH-ve?



Megjithëse ekzistojnë dispozita që adresojnë donacionet, deklaratat e pasurisë dhe konfliktet e interesit, kuadri rregullator aktual nuk përfshin të gjithë elementët e integritetit të NSH-ve, siç janë masat kundër korrupsionit ose masat mbrojtëse kundër pastrimit të parave.

Nuk ka Kod të Qeverisjes së Korporatës për NSH-të. Në vitin 2011, Ministria e Financave dhe Ekonomisë publikoi një kod të qeverisjes së korporatës për shoqëritë aksionare të përjashtuara me asistencën e Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Financës, i cili thekson shkurtimisht se shoqëritë duhet të hartojnë politikat dhe procedurat të posaçme, ndër të tjera, me masat kundër korrupsionit, masat kundër pastrimit të parave, konfliktet e interesit dhe dhuratat ose trajtimin e privilegjuar.²⁰⁵³ Megjithatë, Kodi nuk është i detyrueshëm dhe nuk ka qenë i dukshëm ose i përditësuar që nga publikimi i tij në 2011.


Kufizimet për donacionet për partitë politike vlejné për NSH-të. Ligji për partitë politike thotë se ndihma financiare dhe materiale nga subjektet publike vendase ose klientët e kapitalit shtetëror është e ndaluar.²⁰⁵⁴ Në përpjekje për të garantuar integritetin e personave që ushtrojnë funksione publike, individëve që janë dënuar për disa vepra penale u ndalohet të emërohen në çdo pozicion

drejtues të shoqërive që janë në pronësi të plotë ose shumicë ose të administruara nga shteti.²⁰⁵⁵

Për sa i përket deklaratave të pasurisë, anëtarët e organeve rregullatore, zyrtarët e emëruar nga ministrat (p.sh. anëtarët e bordit të NSH-ve) dhe administratorët e NSH-ve ku qeveria zotëron shumicën e aksioneve dhe që numërojnë më shumë se 50 punonjës janë të detyruar të dorëzojnë deklaratat të pasurisë të cilat më vonë vlerësohen dhe auditohen nga ILDKPKI.²⁰⁵⁶ Ligji kërkon që deklaratat të publikohen online, megjithëse baza e të dhënave online nuk është ende funksionale. Ato mund të aksesohen përmes kërkesave për lirinë e informacionit. NSH-të dhe shoqëritë tregtare në të cilat shteti ose pushteti vendor zotëron shumicën e aksioneve i nënshtrohen Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili synon të rregullojë rastet e konfliktit ndërmjet interesave publike dhe private të zyrtarëve në ushtrimin e funksioneve të tyre.²⁰⁵⁷

TREGUESI 15.2.6 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (ZBATIMI)

Deri në çfarë mase sigurohet integriteti i NSH-ve në praktikë?



Në përgjithësi, ka mungesë të veprimeve që synojnë të sigurojnë integritetin e NSH-ve, dhe sjellja e parregullt është kryesisht e ndaluar.

Shqipërisë i mungon një njësi koordinuese për monitorimin e NSH-ve. Nuk ka regjistër zyrtar të ndërmarrjeve shtetërore dhe monitorimi i tyre bëhet drejtpërdrejt nga pronari, i cili është institucion i ndryshëm në varësi të llojit dhe modelit të ndërmarrjes. Zbatimi i kodit të qeverisjes së korporatës mungon në shumicën e shoqërive publike.

Disa NSH deklarojnë se nuk e konsiderojnë veten si korporata dhe disa të tjera thanë se rregulloret e miratuara nga bordet e tyre nuk kërkojnë aplikimin e këtyre standardeve.²⁰⁵⁸ Dy NSH (KESH dhe Hekurudhat Shqiptare) pranuan se nuk zbatojnë

kodin e qeverisjes së korporatave. NSH-të e tjera të kërkuara nuk u përgjigjën. Shumica e parimeve të qeverisjes së mirë të korporatës dhe integritetit të NSH-ve mbështeten në kodet e tyre të etikës, por nuk ka të dhëna publike për efektivitetin e tyre.²⁰⁵⁹

Konflikti i interesit të anëtarëve të bordit është i dukshëm jo vetëm për shkak të lidhjeve të tyre politike. Shumica e vendeve të bordit janë të zëna nga anëtarë të kabinetit të ministrisë dhe nuk ka përfaqësim nga punëtorët e kompanisë apo shoqëria civile.²⁰⁶⁰ Sipas një të intervistuar, ka raste kur anëtarë apo Drejtorë të përgjithshëm të këtyre ndërmarrjeve emërohen, por kanë punuar në kompani të rëndësishme apo kanë mbajtur poste politike nga të cilat janë shkarkuar për mungesë integriteti.²⁰⁶¹ Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë më të madhe publike OSHEE, Ardian Çela, ka qenë drejtues i fushatës në qarkun e Durrësit gjatë zgjedhjeve të vitit 2021²⁰⁶² dhe drejtori i Postës Shqiptare, Laert Duraj, kandidoi si deputet i partisë që e emëroi në këtë detyrë në zgjedhjet e fundit zgjedhore.²⁰⁶³ Gjatë auditimeve të KLSH-së, sipas ish-drejtorit të përgjithshëm të Auditimit të KLSH-së, disa NSH nuk kishin dosje të personelit dhe në rastet kur kishte dosje pune, ato kanë gjetur rekomandime punësimi nga partia.²⁰⁶⁴

Kompanitë publike përdoren gjerësisht për interesat e stafit të ministrisë, duke u siguruar atyre staf mbështetës që nuk mund t'i punësojnë për shkak të strukturës së miratuar të administratës.²⁰⁶⁵ Kompanitë publike përdoren gjithashtu për të lidhur kontrata për interesa politike dhe ekonomike që caktohen nga qeveria të cilat në disa raste dëmtojnë interesat e tyre të biznesit.²⁰⁶⁶ Ryshfeti është i përhapur në sektorin e prokurimit të këtyre kompanive, dhe korrupsioni i nivelit të ulët është më i zakonshëm te shoqëritë e shpërndarjes së energjisë dhe ujësjellësit,²⁰⁶⁷ që kanë të bëjnë me lidhjet ose faturimin e paligjshëm të energjisë ose rrjetit të ujit.²⁰⁶⁸ Rastet e këtyre abuzimeve publikohen shpesh nga policia dhe mediat, por në pesë vitet e fundit ato kanë pësuar rënie. Megjithatë, korrupsioni dhe favorizimi janë përhapur në ndërmarrjet shtetërore si shoqëria kryesore e shërbimeve elektrike.²⁰⁶⁹ Në raportet e

KLSH-së janë konstatuar shkelje në procedurat e tenderimit dhe buxhetit,²⁰⁷⁰ ndërkohë disa punonjës të OSHEE-së dhe OST-së dhe punonjës të tjerë të NSH-së u arrestuan për përfitime përmes procedurave të paligjshme dhe për dëmtim të interesave të kompanisë. Sipas një analisti për politikën dhe një gazetari me përvojë në raportimin e NSH-ve, disa nga ndërmarrjet shtetërore i kanë shërbyer interesave të sipërmarrësve pranë qeverisë me synim për të realizuar fitime marramendëse dhe nuk i kanë shërbyer interesit publik.²⁰⁷¹

Ka shumë pak raste të sinjalizimit nga punonjës të NSH-ve që denoncojnë praktika të paligjshme,²⁰⁷² pavarësisht se disa NSH kanë zbatuar struktura të sinjalizimit.²⁰⁷³

NDËRVEPRIMET

Ndërveprimet kryesore të NSH-ve lidhen me organin ekzekutiv, KLSH-në dhe biznesin.

NSH-të ndërveprojnë ngushtë me degën ekzekutive të qeverisë. Organi ekzekutiv ka fuqinë të propozojë dhe/ose të emërojë anëtarët e bordeve mbikëqyrëse dhe administratorët e NSH-ve, të ndikojë në vendimmarrjen dhe planifikimin e tyre strategjik dhe të mbikëqyrë dhe monitorojë operacionet e tyre. Në disa raste, ndërhyrja politike në menaxhimin e NSH-ve ka çuar në performancë të dobët, korrupsion dhe humbje financiare (shih treguesin 15.1.1).

Ndërveprimi midis NSH-ve dhe KLSH-së është thelbësor për sigurimin e menaxhimit të duhur të pasurive publike, llogaridhënies dhe transparencës në funksionimin e NSH-ve. NSH-të i nënshtrohen auditimit nga KLSH, i cili kryen auditime financiare dhe të performancës (shih 15.2.3). Auditimet mbulojnë çështjet e përputhshmërinë rregullatore, menaxhimit financiar dhe qeverisjes së brendshme. Rekomandimet e dhëna nga KLSH-ja luajnë një rol thelbësor për të siguruar funksionimin efikas të NSH-ve. KLSH-ja mban përgjegjësi për zbulimin e çdo sjelljeje të pahijshme dhe raportimin e çdo konstatimi të tillë në Kuvend.

Në mënyrë të drejtpërdrejtë, NSH-të konkurrojnë me bizneset private në të njëjtat tregje dhe janë subjekt i kuadrit të njëjtë ligjor (shih 15.1.1.). Në aspekte të caktuara, NSH-të gëzojnë një avantazh konkurrues për shkak të pronësisë së tyre qeveritare dhe aksesit në financimin shtetëror. Kjo shpie në konkurrencë të pandershme dhe shtrembërim të tregut duke shkaktuar dëme në sektorin privat (shih 15.1.2). Në lidhje me përpjekjet kundër korrupsionit, NSH-të mund të përfitojnë nga zbatimi i kodeve të sjelljes, politikave kundër rryshfetit ose mekanizmave të sinjalizuesit që kanë origjinën në sektorin privat.

REKOMANDIMET E ORGANIT

- + Qeveria duhet të krijojë një agjenci koordinimi për standardizimin e praktikave të pronësisë së NSH-ve. Agjencia duhet të mbajë përgjegjësi përpara Kuvendit dhe të raportojë të dhënat e performancës së NSH-ve.
- + Kuvendi duhet të ndryshojë Ligjin për Ndërmarrjet Shtetërore për të përcaktuar emërimin e anëtarëve të bordeve dhe menaxherëve të ndërmarrjeve shtetërore. Parimet duhet të pasqyrojnë kritere të unifikuar për profesionalizmin, edukimin, përvojën dhe etikën dhe duhet të përcaktohet se anëtarët e bordit nuk duhet të punësohen si staf politik apo të kryejnë veprimtari politike. Edhe shkarkimi i tyre nga detyra duhet të jetë pjesë e kësaj rregulloreje dhe të bazohet në kritere lidhur me performancën, efikasitetin, integritetin dhe vendimmarrjen e tyre në shoqëri. Për më tepër, ligji duhet të pasqyrojë të drejtën e punëtorëve të shoqërisë dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile për të pasur një pozicion në bordin e shoqërisë.
- + Pagesat e kryera nga ndërmarrjet shtetërore duhet të bëhen publike dhe Kuvendi duhet të ndryshojë ligjin për të integruar shpenzimet e tyre në sistemin e Thesarit të Shtetit në mënyrë që publiku të aksesojë këto të dhëna.
- + Ndërmarrjet shtetërore duhet të publikojnë vendimet e tyre të bordit në faqen e internetit dhe mbledhjet e bordit duhet të bëhen të ditura në rastet kur nuk përfshihen çështje konfidenciale në agjendë.
- + Kuvendi duhet të ndryshojë ligjet për ndërmarrjet shtetërore dhe prokurimet publike duke përfshirë të gjitha llojet e procedurave të blerjes në rregulloret e prokurimit publik të shoqërive shtetërore, duke përfshirë shpalljen e fituesit të të gjithë tenderëve dhe mbarëvajtjen e gjithë procedurës.
- + Procedurat e punësimit duhet të kryhen sipas Kodit të Punës dhe mënyra e rekrutimit duhet të jetë transparente nëpërmjet një konkurrimi të hapur me qëllim përzgjedhjen e punonjësit më të aftë për pozicionin që ofrohet.

BIBLIOGRAFI

- ¹⁹⁸⁰ Neni 4 i Ligjit nr. 7926 për “Transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”
- ¹⁹⁸¹ OECD, Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore 2021, <https://www.oecd.org/development/competitiveness-in-south-east-europe-2021-dcbc2ea9-en.htm>, f. 683
- ¹⁹⁸² Komisioni Evropian Raporti për Shqipërinë 2019, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2019-07/20190529-albania-report.pdf>, f. 48
- ¹⁹⁸³ OECD, Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore 2021, f. 683
- ¹⁹⁸⁴ *Ibid.*
- ¹⁹⁸⁵ Neni 5, Ligji për “Ndërmarrjet Shtetërore”
- ¹⁹⁸⁶ Duke përjashtuar rastet e veçanta kur bëhet fjalë për subvencionimin e çmimeve të kontrolluara sipas miratimit të Këshillit të Ministrave; Neni 14, Ligji për Ndërmarrjet Shtetërore.
- ¹⁹⁸⁷ Neni 15, Ligji nr. 7582 për “Ndërmarrjet Shtetërore”
- ¹⁹⁸⁸ Ligji nr. 71 “Për Korporatën Shqiptare të Investimeve”, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2019/10/17/71/cb906b7e-dca0-4bd1-a653-a7f2dc5d27c6>
- ¹⁹⁸⁹ Komisioni Evropian Raporti për Shqipërinë 2019, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/albania_report_2020.pdf, f. 55
- ¹⁹⁹⁰ OECD, Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore 2021, f. 685
- ¹⁹⁹¹ *Ibid.*, f. 684
- ¹⁹⁹² BIRN Albania, “Llogaritjet e pandershme për koston e energjisë i shpien konsumatorët drejt humbjes”, 26 qershor 2018, <https://www.reporter.al/2018/06/26/llogarite-e-pandershme-mbi-kostot-e-energji-se-nxjerrin-konsumator-te-humbur/> [aksesuar më: 5 tetor 2023].
- ¹⁹⁹³ Intervista me Neritan Sejhami, analist i politikave dhe ish-drejtor i *Euronews Albania*, 8 janar 2023 dhe Azmi Stringa, ish-drejtor i Përgjithshëm i Auditimit në Institucionin e Lartë të Auditimit, 26 janar 2023.
- ¹⁹⁹⁴ Tv Klan, “Rikthehet faturimi i energjisë me dy nivele”, 23 gusht 2022, <https://tvklan.al/rikthehet-faturimi-i-energji-se-me-dy-fasha/> [aksesuar më: 5 tetor 2023]. ; Tv Klan, “Balluku: Nuk do të ketë rritje në çmimin e energjisë”, 25 tetor 2022, <https://tvklan.al/balluku-nuk-do-te-kete-rritje-te-cmimit-te-energji-se-elektrike-as-kufizime/> [aksesuar më: 5 tetor 2023].
- ¹⁹⁹⁵ Intervista me Neritan Sejhami, analist i politikave dhe ish-drejtor i *Euronews Albania*, 8 janar 2023.
- ¹⁹⁹⁶ ERE-ja në tregun e energjisë dhe Enti Rregullator i Ujit në furnizimin me ujë.
- ¹⁹⁹⁷ Enti Rregullator i Energjisë, “Raporti Vjetor 2021”, <https://ere.gov.al/images/2022/04/Raporti%20Vjetor%202021%20perfundimtare.pdf>, f.14. [aksesuar më: 5 tetor 2023].
- ¹⁹⁹⁸ Çmimi i energjisë për hidrocentralet private përcaktohet nga Enti Rregullator i Energjisë nëpërmjet një formule që llogarit kostot e prodhimit dhe Bursën hungareze të energjisë (HUPEX).
- ¹⁹⁹⁹ Enti Rregullator i Ujit, “Raporti Vjetor 2022”, https://erru.al/wp-content/uploads/2023/08/Raporti_Vjetor_2022-FINAL.pdf, f. 64. [aksesuar më: 5 tetor 2023].
- ²⁰⁰⁰ Tv Klan, “Rikthehet faturimi i energjisë me dy nivele”, 23 gusht 2022, <https://tvklan.al/rikthehet-faturimi-i-energji-se-me-dy-fasha/> [aksesuar më: 5 tetor 2023]; Tv Klan, “Balluku: Nuk do të ketë rritje në çmimin e energjisë”, 25 tetor 2022, <https://tvklan.al/balluku-nuk-do-te-kete-rritje-te-cmimit-te-energji-se-elektrike-as-kufizime/> [aksesuar më: 5 tetor 2023].
- ²⁰⁰¹ Intervista me Neritan Sejhami, analist i politikave dhe ish-drejtor i *Euronews Albania*, 8 janar 2023.
- ²⁰⁰² Argjiro Lajm, “Kryeministri shkarkon njeriun e Koço Kokëdhima”, 27 janar 2018, <https://argjirolajm.net/rama-shkarkon-njeriun-e-koco-kokedhimes/> [aksesuar më: 5 tetor 2023]. Gazeta *Panorama*, “Ristani: Kryeministri Rama emëron drejtor të OSHEE-së një person nën hetim”, 4 dhjetor 2014, <http://www.panorama.com.al/pd-ristani-rama-emeron-ne-krje-te-oshee-person-nen-hetim-sjell-vetem-erresire/> [aksesuar më: 5 tetor 2023].
- ²⁰⁰³ Boldnews, “Ish-drejtori i Bankers Petroleum emërohet administrator i ri i Albpetrol”, 14 maj 2022, <https://boldnews.al/2022/05/14/drejtori-i-bankers-emerohet-nga-balluku-si-administrator-i-albpetrol/> [aksesuar më: 5 tetor 2023].
- ²⁰⁰⁴ Tirana Post, “Drejtori i Përgjithshëm i Operatorit të Furnizimit me Energji Ardian Çela drejton fushatën në Durrës”, 10 shtator 2020, <https://tiranapost.al/aktualitet/kreu-i-oshee-adrian-ela-merr-drejtimin-e-fushates-ne-durres-704> [aksesuar më: 5 tetor 2023]; *Euronews Albania*, “Ish-deputeti Ervin Bushati u emërua në krye të Postës

Shqiptare”, 28 shtator 2021, <https://euronews.al/ish-deputeti-ervin-bushati-emerohet-ne-krye-te-postes-shqiptare/> [aksesuar më: 5 tetor 2023].

²⁰⁰⁵ Intervista me Azmi Stringa, ish-Drejtor i Përgjithshëm i Auditimit në Institucionin e Lartë të Auditimit, 26 janar 2023.

²⁰⁰⁶ Open Data Albania, “Sekretarët e qeverisë së Ramës zaptojnë bordet publike”, 13 shkurt 2018,, <https://ndiqparate.al/?p=8002> [aksesuar më: 5 tetor 2023].

²⁰⁰⁷ Balkanweb, “Shkarkohet nga detyra Drejtori i Përgjithshëm i Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare”, 28 janar 2019, <https://www.balkanweb.com/lajm-i-fundit-shkarkohet-drejtori-i-kesh-ja-kush-e-zevendeson/> [aksesuar më: 5 tetor 2023]; *Top Channel*, “Malaj: Shkarkimi im nga Bordi i Bankës Qendrore, një hakmarrje politike.”, 17 korrik 2019, <https://top-channel.tv/2019/07/17/malaj-shkarkimi-im-nga-bordi-i-bsh-hakmarrje-politike-argumentet-joprofesionale/> [aksesuar më: 5 tetor 2023].

²⁰⁰⁸ Intervista me Azmi Stringa, ish-Drejtor i Përgjithshëm i Auditimit në Institucionin e Lartë të Auditimit, 26 janar 2023.

²⁰⁰⁹ Autoriteti i Konkurrencës “Buletini 2022”, <http://www.caa.gov.al/uploads/publications/RVPE-2021.pdf>, f. 60, f. 76. [aksesuar më: 5 tetor 2023]

²⁰¹⁰ Albpetrol, “Njoftimi i ankandit”, 30 qershor 2023, <https://www.albpetrol.al/ankand-per-shitjen-e-naftes-brutnga-shoqeria-albpetrol-sh-a-11/>, [aksesuar më: 6 tetor 2023].

²⁰¹¹ Bankers Petroleum ka lidhur një kontratë koncesioni me Albpetrol për shumicën e burimeve të naftës në Shqipëri. Albpetrol, “Marrëveshjet për Hidrokarburet”, <https://www.albpetrol.al/kompanite-marreveshjet-hidrokarbure/>, [aksesuar më: 6 tetor 2023].

²⁰¹² Autoriteti i Konkurrencës “Buletini 2022”, <http://www.caa.gov.al/uploads/publications/RVPE-2021.pdf>, f. 49. [aksesuar më: 6 tetor 2023].

²⁰¹³ Ligji nr. 9901 për “Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”

²⁰¹⁴ Ligji nr. 119 për “*Të Drejtën e Informimit*”

²⁰¹⁵ Neni 8, Ligji për “*Ndërmarrjet Shtetërore*”

²⁰¹⁶ Neni 10, Ligji për “*Ndërmarrjet Shtetërore*”

²⁰¹⁷ *Ibid.*

²⁰¹⁸ Neni 61, Ligji nr. 9723 për “*Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*”

²⁰¹⁹ *Ibid*, Neni 66

²⁰²⁰ *Ibid.* Neni 32, 36 dhe 43

²⁰²¹ Neni 2/1, pika b), Ligji për “*Të Drejtën e Informimit*”

²⁰²² Neni 4/b, pika iii), Ligji nr. 162 “*Për prokurimin publik*”

²⁰²³ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Pronës Publike, <https://financa.gov.al/drejtoria-e-pergjithshme-e-prones-publike/> [aksesuar më: 6 tetor 2023].

²⁰²⁴ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Raportet e Ndërmarrjeve Shtetërore, <https://financa.gov.al/raportime-te-nderrmajeve-shteteore/> [aksesuar më: 6 tetor 2023].

²⁰²⁵ Qendra Kombëtare e Biznesit, “Ekstrakti historik i OSHEE”, 6 tetor 2023, f. 94. [aksesuar më: 6 tetor 2023] ;

Qendra Kombëtare e Biznesit, “Ekstrakti historik i KESH”, 6 tetor 2023, f. 54. [aksesuar më: 6 tetor 2023] ;

Qendra Kombëtare e Biznesit, “Ekstrakti historik i Albcontrol”, 6 tetor 2023, f. 33. [aksesuar më: 6 tetor 2023];

Qendra Kombëtare e Biznesit, “Ekstrakti historik i Postës Shqiptare”, 6 tetor 2023, f. 48. . [aksesuar më: 6 tetor 2023]

²⁰²⁶ Intervista me Neritan Sejmani, analist i politikave dhe ish-drejtor i *Euronews Albania*, 8 janar 2023.

²⁰²⁷ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, “Regjistri i borxhit”, <https://financa.gov.al/regjistri-i-borxhit/>, [aksesuar më: 6 tetor 2023]

²⁰²⁸ Intervista me Neritan Sejmani, analist i politikave dhe ish-drejtor i *Euronews Albania*, 8 janar 2023.

²⁰²⁹ Institucioni i Lartë i Auditimit, “Auditimi i Buxhetit të Shtetit 2021”, f. 123:

<https://panel.klsh.org.al/storage/phpxDvtk0.pdf> [aksesuar më: 5 tetor 2023]

²⁰³⁰ Revista Monitor, “Qeveria shpërndan dy miliardë lekë (20 milionë USD) për Korporatën e Investimeve”, 27 dhjetor 2021, <https://www.monitor.al/qeveria-con-dy-miliarde-leke-per-shtese-kapitali-te-korporates-se-investimeve/> [aksesuar më: 5 tetor 2023].

²⁰³¹ Illyrian Guard, “Akti i themelimit”, <https://illyrianguard.al/rreth-nesh/historia-dhe-filozofia/> [aksesuar më: 5 tetor 2023].

²⁰³² Enti Rregullator i Energjisë, “Konsultimet Publike”, <https://ere.gov.al/sq/publikime/konsultime> [aksesuar më: 5 tetor 2023].

- ²⁰³³ Qendra Kombëtare e Biznesit, Njoftim për Regjistrimin e Pronarëve Përfitues, <https://qkb.gov.al/newsroom/njoftime/njoftim-per-regjistrin-e-pronareve-perfitues-per-subjektet-tregtare/> [aksesuar më: 6 tetor 2023]
- ²⁰³⁴ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Njoftimet, <https://financa.gov.al/denaj-shtyrja-e-regjistrimit-te-pronarit-perfitues-me-30-qershor-lehtesi-per-biznesin/> [aksesuar më: 6 tetor 2023]
- ²⁰³⁵ Scan Tv, "Pse ndërmarrjet e mëdha shtetërore nuk i bëjnë publike të dhënat vjetore?", 7 tetor 2022, <https://scantv.al/pse-kompanite-e-medha-shqiptare-nuk-publikojne-te-dhenat-vjetore-nga-30-kompani-vetem-1-subjekt-me-aksionere-shqiptare-i-ben-publike-rregullisht/> [aksesuar më 7 tetor 2023]
- ²⁰³⁶ Ligji nr. 112 për "Regjistrin e Pronarëve Përfitues" 2020, Neni 3.2, <https://qzb.gov.al/eli/ligj/2020/07/29/112/db2c0285-316f-43ab-bef6-c3f50e28d1ac;q=pronaret%20perfitues> [aksesuar më: 5 tetor 2023].
- ²⁰³⁷ Neni 8, Ligji për "Transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare",
- ²⁰³⁸ *Ibid*
- ²⁰³⁹ OECD, Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore 2021, f. 685
- ²⁰⁴⁰ Struktura e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, <https://financa.gov.al/drejtorene-e-administrimit-te-prones-shtetore/>
- ²⁰⁴¹ Komisioni Evropian Raporti për Shqipërinë 2020, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/albania_report_2020.pdf, f. 56
- ²⁰⁴² Neni 10, pika e), Ligji nr. 154/2014 për "Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"
- ²⁰⁴³ Neni 41, Ligji nr. 10091 për "Auditimin Ligjor dhe Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar"; OECD, Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore 2021, f. 684
- ²⁰⁴⁴ Banka Botërore, *Qeverisja korporative e ndërmarrjeve shtetërore në Evropë dhe Azinë Qendrore*, 2020, f. 31, <https://openknowledge.worldbank.org/server/api/core/bitstreams/4365f932-a93d-5479-96e4-46b2e5e83795/content>
- ²⁰⁴⁵ Neni 27, Ligji nr. 29/2023 për "Tatimin mbi të Ardhurat"
- ²⁰⁴⁶ Neni 2, Ligji nr. 9121 për "Mbrojtjen e konkurrencës"
- ²⁰⁴⁷ Tv Klan, "Shkarkimet dhe dorëheqjet në bashkinë e Tiranës", 27 korrik 2017, <https://tvklan.al/shkarkime-dhe-doreheqje-ne-bashkine-e-tiranes/> [7 tetor 2023]
- Ora News, "Pas administratorit të OST-së, largohet edhe drejtori i Drejtorisë së rrugëve", 22 janar 2019: <https://www.oranews.tv/article/pas-drejtorene-te-ost-iken-edhe-afirim-qendro-i-arrsh-se> [7 tetor 2023]
- ²⁰⁴⁸ Intervista me Azmi Stringa, ish-Drejtor i Përgjithshëm i Auditimit në Institucionin e Lartë të Auditimit, 26 janar 2023.
- ²⁰⁴⁹ Përgjigja zyrtare nga një kërkesë për informim, sipas Neneve 1 dhe 2 për "Të Drejtën e Informimit, Ligji nr. 119, 2014".
- ²⁰⁵⁰ Institucioni i Kontrollit Shtetëror, "Auditimi i Shoqërive për Performancën në Sektorin e Energjisë", janar 2023, f. 40 <https://panel.klsh.org.al/storage/phpXHwktB.pdf> [7 tetor 2023]
- ²⁰⁵¹ Intervista me Neritan Sejmani, analist i politikave dhe ish-drejtor i *Euronews Albania*, 8 janar 2023.
- ²⁰⁵² "Scan Tv, "Pse ndërmarrjet e mëdha shtetërore nuk i bëjnë publike të dhënat vjetore?", 7 tetor 2022, <https://scantv.al/pse-kompanite-e-medha-shqiptare-nuk-publikojne-te-dhenat-vjetore-nga-30-kompani-vetem-1-subjekt-me-aksionere-shqiptare-i-ben-publike-rregullisht/> [aksesuar më: 7 tetor 2023]
- ²⁰⁵³ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kodi i Qeverisjes së Korporatës për Shoqëritë Aksionare të Përrjashtuara në Shqipëri, https://www.ecgi.global/sites/default/files/codes/documents/cg_code_unlisted_companies_albania_14apr2008_en.pdf
- ²⁰⁵⁴ Neni 21, Ligji nr. 8580 për "Partitë Politike"
- ²⁰⁵⁵ Neni 3/1, pika g), Ligji Nr. 138 për "Garantimin e Integritetit të Personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
- ²⁰⁵⁶ Neni 3, pikat e, gj, dhe j, Ligji Nr.9049 për "Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë"
- ²⁰⁵⁷ Neni 4/1, pika d), Ligji nr. 9367 për "Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike"
- ²⁰⁵⁸ Përgjigja e pyetjes së informacionit të Postës Shqiptare, KESH, Hekurudhave të Shqipërisë, Ujësjellësit Tiranë, Albpetrol, Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSHEE dhe OST nuk dhanë përgjigje. Ligji për të Drejtën e Informimit, nr. 119, 2014".

- ²⁰⁵⁹ Përgjigja e pyetjes së informacionit të Postës Shqiptare, KESH, Hekurudhave të Shqipërisë, Ujësjetës Tiranë, Albpetrol, Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSHEE dhe OST nuk dhanë përgjigje. Ligji për të Drejtën e Informimit, nr. 119, 2014”.
- ²⁰⁶⁰ *Reporter.al*, “Për vota dhe favore: Ndërmarrjet publike vuajnë nga humbjet dhe emërimet politike”, 28 shtator 2023, <https://www.reporter.al/2023/09/28/per-vota-dhe-qoka-ndermarrjet-publike-vuajne-nga-humbjet-dhe-emerimet-politike/> [7 tetor 2023]
- ²⁰⁶¹ Intervista me Neritan Sejmini, analist i politikave dhe ish-drejtor i *Euronews Albania*, 8 janar 2023.
- ²⁰⁶² *Top Channel*, “Ardian Çela zbulon objektivin e paarritur në zgjedhjet e 25 prillit”, 29 prill 2021, <https://top-channel.tv/2021/04/29/ardian-cela-zbulon-objektivin-e-paarritur-te-ps-ne-zgjedhjet-e-25-prillit/> [7 tetor 2023]
- ²⁰⁶³ *Gazeta Sot*, “Laert Duraj: Kandidimi për deputet, përgjegjësi dhe vlerësim”, 12 mars 2021, <https://sot.com.al/politike/laert-duraj-kandidimi-per-deputet-pergjegjesi-dhe-vleresimi-ne-25-prill-i428941> [7 tetor 2023]
- ²⁰⁶⁴ Intervista me Azmi Stringa, ish-Drejtor i Përgjithshëm i Auditimit në Institucionin e Lartë të Auditimit, 26 janar 2023.
- ²⁰⁶⁵ *Dritare.net*, “Bieta Sulo dhe Mira Kazhani punonjëse në UKT”, 2 maj 2020, <https://dritare.net/ngjarjet-e-dites/bieta-sulo-dhe-mira-kazhani-punonjese-ne-ukt-reagon-veliaj-104> [7 tetor 2023]
- ²⁰⁶⁶ *Lapsi.al* “KESH firmos kontratë ‘të bardhë’ për dy anijet e energjisë në Vlorë”, 12 janar 2023, <https://lapsi.al/2023/01/12/kesh-firmos-kontrate-te-bardhe-per-dy-anijet-e-energji-se-ne-vlore/> [7 tetor 2023]
- ²⁰⁶⁷ *Gazeta Telegraf*, “Arrestohet faturisti i Ujësjetës të Fierit”, 17 tetor 2018, <https://telegraf.al/kronike/arrestohet-faturisti-i-ujesjellesit-te-fierit-i-fuste-ne-xhep-pagesat-e-njerezve/> [7 tetor 2023]
- ²⁰⁶⁸ *Euronews Albania*, “Zbulohet ‘shtëpia e barit’ në Shkodër, arrestohen 5 punonjës të OSHEE”, 15 janar 2022, <https://euronews.al/zbulohet-shtepia-e-barit-ne-shkoder-arrestohen-5-punonjes-te-oshee/> [7 tetor 2023]
- ²⁰⁶⁹ *Dosja.al*, “Arrestohet ish-drejtori i prokurimeve në OSHEE, shpallet në kërkim ish-shefja e kabinetit”, 20 tetor 2020, <https://dosja.al/lajm-i-fundit-arrestohet-ish-drejtori-i-prokurorimeve-te-oshee-erlis-bushati-shpallet-ne-kerkim-ish-shefja-e-kabinetit-emrat> [7 tetor 2023]
- ²⁰⁷⁰ Institucioni i Kontrollit Shtetëror, “Raport për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit 2021”, f. 98, <https://panel.klsh.org.al/storage/phpxDvtk0.pdf> [7 tetor 2023]
- ²⁰⁷¹ Intervista me Neritan Sejmini, analist i politikave dhe ish-drejtor i *Euronews Albania*, 8 janar 2023.
- ²⁰⁷² Komiteti Shqiptar i Helsinkit, “Sinjalizuesit – një instrument ligjor i pashfrytëzuar”, 29 tetor 2020, <https://ahc.org.al/sinjalizuesit-apo-bilbilfryresit-instrumenti-ligjor-i-pashfrytezuar/> [7 tetor 2023]
- ²⁰⁷³ Përgjigja e pyetjes së informacionit të Postës Shqiptare, KESH, Hekurudhave të Shqipërisë, Ujësjetës Tiranë, Albpetrol, Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSHEE dhe OST nuk dhanë përgjigje. Ligji për të Drejtën e Informimit, nr. 119, 2014.

REKOMANDIMET

Pas shqyrtimit falë vlerësimit të NIS-it për Shqipërinë, rekomandimet pasuese pasqyrojnë gjetjet dhe njohuritë thelbësore të gjeneruara nga çdo organ specifik. Ky seksion është bërë për të ofruar një udhërrëfyes strategjik për trajtimin e sfidave të identifikuar dhe promovimin e përmirësimeve në secilën fushë. Lista në vijim është organizuar në bazë të institucioneve të cilave u drejtohen rekomandimet.

NDRYSHIMET E LEGJISLACIONIT:

- + Të rishikojë ligjet lidhur me “sekretin shtetëror” për të përcaktuar qartë se çfarë përbën sekret shtetëror dhe të krijojë një proces transparent shqyrtimi për informacionin e klasifikuar.
- + Të ndryshojë ligjin për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë për të shfuqizuar kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor për anonimizimin e informacionit lidhur me emërimin, transferimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve.
- + Të ndryshojë kuadrin ligjor për mbrojtjen nga sinjalizuesit për të përcaktuar qartë se çfarë përbën zbulim të mbrojtur, të krijojë kanale raportimi të sigurta dhe konfidenciale dhe të ndalojë në mënyrë të qartë shpagimin.
- + Të rishikojë legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit në sektorin publik për të siguruar qartësi dhe zbatim më të mirë.
- + Të miratojë mbrojtje më të forta ligjore për punonjësit me kontratë të përkohshme të rregulluar nga Kodi i Punës.
- + Të rishikojë kuadrin ligjor të prokurimit publik për të siguruar që nuk ka ofertë fiktive duke siguruar integritimin me Regjistrin Kombëtar të Bizneseve për kontrollet e vazhdueshme, duke përfshirë monitorimin e treguesve të rreziqeve, publikimin e rregullt në një format të disponueshëm të të gjitha kontratave dhe koncesioneve dhe sigurimin e publikimit të raporteve të kontrolleve të verifikuara.
- + Të ndryshojë Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Partitë Politike për të përfshirë rregulloret për financimin e fushatave politike nga palët e treta që nuk janë subjekte zgjedhore.
- + Të ndryshojë Ligjin për KLSH-në duke përfshirë dispozitat për zgjedhjen dhe shkarkimin e Kryetarit të KLSH-së nga një shumicë e kualifikuar.
- + Të ndryshojë Kodin Zgjedhor duke përjashtuar plotësisht kohën e transmetimit të reklamave zgjedhore dhe kohën e transmetimit të lajmeve nga donacionet në vlerë jo monetare dhe duke rregulluar fushatën online të zbatuar nga partitë/subjektet politike që marrin pjesë në zgjedhje. Duhet të rriten tarifat e sanksioneve administrative për shpërdorimin e burimeve shtetërore gjatë fushatës zgjedhore.

- + Të ndryshojë Ligjin për Prokurimin Publik dhe Ligjin për Investimet Strategjike kështu që pronarët e mediave që zotërojnë biznese në sektorë të tjerë të ekonomisë si ndërtimi, turizmi etj., të mos lejohen të marrin fonde publike ose të marrin statusin e investitorit strategjik, si një përpjekje për të reduktuar ndërhyrjen e shtetit dhe për të forcuar pavarësinë e medias.
- + Të rishikojë Kodin Penal për të hequr nenin që penalizon të drejtën e tubimit paqësor me gjobë ose me burgim deri në një vit.
- + Të ndryshojë Ligjin për Ndërmarrjet Shtetërore për të përcaktuar emërimin e anëtarëve të bordeve dhe menaxherëve të ndërmarrjeve shtetërore.

KUVENDI:

- + Të zhvillojë sipas standardeve ndërkombëtare dhe të konsultojë me ekspertë dhe organizata të shoqërisë civile një metodologji për vlerësimin e hapësirave të mundshme për korrupsionin në projektligje dhe zbatimin e saj për propozimet ligjore nga Këshilli i Ministrave, deputetët apo qytetarët.
- + Të zbatohet në praktikë kontrolli legjislativ pasues në kuadrin e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit duke kontrolluar zbatimin praktik të ligjit dhe politikave kryesore.
- + Të vlerësojë gjashtë muaj përpara përfundimit të legjislaturës standardet e integritetit të parashikuara në Kodin e Sjelljes së deputetëve dhe të monitorojë efektet e tyre zbatuese në veprimtarinë e deputetëve.
- + Të sanksionojë shkeljet e integritetit dhe sjelljet e pahijshme etike nga deputetët pavarësisht se cilës parti politike i përkasin.
- + Të regjistrojë, trajtojë dhe bëjë të qartë vendimin dhe ndjekjen e tij për peticionet e dorëzuara në Kuvend nga qytetarët.
- + Të punësojë staf të mjaftueshëm politik dhe administrativ për të mbështetur dhe mundësuar veprimtarinë e gjerë të komisioneve parlamentare dhe të Kuvendit drejt standardeve më të larta.
- + Të sigurojë që përdorimi i akteve normative të minimizohet duke forcuar mekanizmat e tij

mbikëqyrës dhe duke përmirësuar procedurën e tij legislative si dhe duke kërkuar raportim të vazhdueshëm dhe të rregullt për aktet normative nga organi ekzekutiv.

- + Të shfrytëzojë maksimalisht mandatin e tij kushtetues për të kontrolluar në mënyrë efektive organin ekzekutiv. Kjo përfshin pranimin dhe veprimin sipas hetimeve parlamentare, mbajtjen e interpelancave më të shpeshta për t'i kërkuar llogari organit ekzekutiv, të kërkojë nga ministrat dhe zyrtarët e lartë që të raportojnë në komisionet përkatëse parlamentare dhe të ftojë shoqërinë civile, median dhe palët e tjera të interesit në këto takime.
- + Të forcojë bashkëpunimin me Avokatin e Popullit duke përmirësuar mekanizmin dhe metodologjinë ndërinstitucionale për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve dhe siguruar funksionimin në kohë dhe sistematik të tij.
- + Të rrisë pavarësinë e ILDKPKI-së duke miratuar një ligj organik specifik për funksionimin dhe organizimin e ILDKPKI-së.

PUSHTETI EKZEKUTIV:

- + Ti japë përparësi luftës kundër korrupsionit duke bërë përpjekje më të qëndrueshme, të vazhdueshme dhe të koordinuara siç duhet dhe me burime të përshtatshme, duke synuar si korrupsionin e vogël ashtu edhe atë institucional.
- + Të krijojë dhe t'u përmbahet proceseve rigoroze të rekrutimit të bazuar në merita për të siguruar që pozitat e shërbimit civil, sidomos postet e larta, të plotësohen në bazë të ekspertizës dhe kompetencave të lidhura me politikën dhe jo në bazë të emërimeve politike.
- + Të finalizojë reformën gjithëpërfshirëse të pagave, ta bëjë sistemin më të drejtëpërdrejtë dhe t'i komunikojë hapur ndryshimet shërbimit civil.
- + Të publikojë vazhdimisht dokumente dhe raporte kyçe që janë me interes publik, duke përfshirë raportet e mbledhjeve të kabinetit dhe rezultatet e Programit të Transparencës. Për më tepër, duhet të sigurojë që kërkesave për

informim t'u kthehet përgjigje e menjëhershme. Të publikojë raportet e auditimit online në kohën të përshtatshme dhe të përfshijë në Propozimin e Buxhetit të Organit ekzekutiv të dhëna për gjendjen financiare të qeverisë dhe parashikimin makroekonomik.

- + Të rishikojë kodet në fuqi për integritetin dhe etikën që do të përditësohen në mënyrë që të adresojë skenarët e "rotacioneve të shpeshta" dhe të sigurojë që ka rregulla të qarta dhe të zbatueshme lidhur me pas-punësimin dhe sjelljen në zyrë.
- + Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të propozojnë ndryshime kushtetuese që garantojnë buxhetin e prokurorisë, duke shtuar një dispozitë që parashikon që prokurorisë t'i caktohet një përqindje e caktuar e buxhetit të përgjithshëm.
- + Të nxisë miratimin e kodeve kundër korrupsionit nga bizneset duke e bërë atë të detyrueshëm në proceset e prokurimit publik dhe të vendosë një agjendë dhe metodologji konkrete për të luftuar korrupsionin në sektorin privat dhe të konsultojë rezultatet në baza vjetore duke bashkëpunuar me shoqatat e biznesit.
- + Të krijojë një agjenci koordinimi për standardizimin e praktikave të pronësisë së NSH-ve. Agjencia duhet të mbajë përgjegjësi përpara Parlamentit dhe të raportojë të dhënat e performancës së NSH-ve.
- + Shkolla Shqiptare e Administratës Publike duhet të ketë burime të përshtatshme për të ofruar trajnime me cilësi të lartë. Programet e zhvillimit profesional duhet të monitorohen nga afër dhe të vlerësohen kundrejt treguesve të qartë të përafuar me qëllimet strategjike të organit ekzekutiv.
- + Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje duhet të fillojë menjëherë publikimin e rregullt të raporteve të hollësishme në lidhje me ankesat e qytetarëve. Këto raporte duhet të përfshijnë statistika për numrin e ankesave të marra, klasifikimin e çështjeve, veprimet e ndërmarra në këtë aspekt dhe rezultatet përfundimtare.

INSTITUCIONET E PAVARURA:

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

- + Të rishikojë strukturën e brendshme dhe proceset që lidhen me rolin e tij në monitorimin dhe hetimin e financimit të partive politike.
- + Të rekomandojë reforma specifike për të adresuar anshmërinë politike në proceset e emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV) dhe Qendrave të Numërimit të Votave.
- + Të marrë një rol më aktiv dhe bindës në sanksionimin e shkeljeve të Kodit Zgjedhor nga partitë politike, një qasje që do të nxiste partitë politike të përafrojnë politikatat e tyre të brendshme me dispozitat e Kodit.
- + Të publikojë raportet e auditimit të brendshëm dhe të sigurojë raportim gjithë përmbledhës për çështjet kryesore që lidhen me organizimin e zgjedhjeve, si dhe veprimet e tij për të garantuar integritetin e procesit zgjedhor dhe zbatimin efektiv të dispozitave që drejtojnë zgjedhjet dhe financimin e partive politike.
- + Zbatimi i mekanizmave më efektivë për pjesëmarrjen e grave në procesin zgjedhor.

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT

- + Të intensifikojë shqyrtimin e deklaratave të pasurisë në sektorin publik duke zbatuar një qasje më të fortë dhe sistematike për verifikimin e saktësisë dhe plotësinë e këtyre deklarimeve.
- + Të rrisë transparencën e vendimmarrjes së tij dhe të sigurojë të dhëna statistikore të qarta për vendimmarrjen e tij për parandalimin e korrupsionit përmes ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, numrin e referimeve në prokurori për shkelje të ligjit të deklaratave të pasurisë dhe ndjekjen e tyre, si dhe për rezultatet e vendimmarrjes së tij në kuadër të ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

- + Të vlerësojë në mënyrë gjithëpërfshirëse nëse burimet e tij njerëzore janë të përshtatshme për të plotësuar nga ana sasiore dhe cilësore kërkesat e ligjit për veprimtaritë e tij parandaluese, edukative dhe hetimore.

AVOKATI I POPULLIT

- + Të përmirësojë ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të tij duke krijuar një platformë online të aksesueshme për përdoruesit që ofron përditësime të vazhdueshme, informacion të hollësishëm dhe raportim transparent për të rritur besimin e publikut.
- + Të krijojë një strategji komunikimi gjithëpërfshirëse dhe të synuar me tregues të qartë për të rritur dukshmërinë dhe për të promovuar rolin e tyre në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- + Të zhvillojë protokolle dhe udhëzime që kanë parasysh ndjeshmërinë gjinore për mekanizmat e ankesave dhe hetimit, duke përfshirë gratë.

INSTITUCIONI I LARTË I AUDITIMIT

- + Të krijojë mekanizma të stimulimit financiar duke u bazuar në performancën për të ulur shkallën e qarkullimit të stafit auditues me përvojë.
- + Të rishikojë strukturën e tij për rritjen e numrit të stafit produktiv me funksione auditimi. Të ofrojë trajnime për audituesit e tij se si të bëjnë rekomandime më gjithëpërfshirëse, me baza të arsyeshme dhe aktuale.
- + Të pasqyrojë në mënyrë të plotë në raportet përfundimtare të auditimit komentet dhe vëzhgimet e subjekteve të audituara dhe vendimet e audituesve për to.
- + Të monitorojë të gjitha rekomandimet e lëshuara në një vit dhe të bëjë transparente në raportet e performancës edhe shkallën e veprimeve dhe sanksioneve të zbatuara në praktikë siç rekomandohet nga KLSH-ja.
- + Të sigurojë të dhëna statistikore në raportet e tij vjetore për rezultatet e referimeve penale në prokurori.

INSTITUCIONET NË SISTEMIN E DREJTËSISË:

- + Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të themelojë Këshillin e Marrëdhënieve ndërmjet organit gjyqësor dhe medias, me përfaqësues nga të dyja palët.
- + Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë duhet të ndryshojnë përkatësisht Kodin e Etikës Gjyqësore dhe Standardet dhe Rregullat, për të ndaluar gjykatësit të marrin rimbursime, kompensime dhe honorare lidhur me udhëtimet e sponsorizuara në mënyrë private.
- + Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të miratojë një akt për përfshirjen e numrit të çështjeve kundër organit ekzekutiv dhe rezultatit të tyre, si dhe të dhënave të ndara sipas gjinisë, në statistikat e organit gjyqësor;
- + Shkolla e Magjistraturës duhet të përfshijë në programin e trajnimit të vazhdueshëm tema për zbatimin e mekanizmave që kanë parasysh ndjeshmërinë gjinore.
- + Këshilli i Lartë i Prokurorisë duhet të miratojë rregulla të hollësishme lidhur me transferimet e përkohshme për plotësimin e vendeve vakante në prokurori dhe të kryejë menjëherë vlerësimet e performancës së prokurorëve. Ngritja në detyrë e prokurorëve duhet të bazohet në këto vlerësime të performancës.
- + Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokuroria e Përgjithshme duhet të kryejnë një vlerësim për të përcaktuar ngarkesën e punës që një prokuror mund dhe duhet të përballojë brenda orarit të punës, çka nënkupton përcaktimin e një standardi maksimal.

AGJENCITË LIGJBATUESE:

- + ASP-ja duhet të rishikojë kriteret e saj për emërimin dhe ecjen përpara në karrierë. Duhet të krijohet një sistem i ri që përfshin kriteret e qarta profesionale për ecjen përpara në karrierë, një kufi maksimal për periudhën e promovimit dhe një strukturë dhe organizim të planifikuar

mirë ku arritja e rangut më të lartë nuk kushtëzohet me një vend vakant.

- + Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe Përfaqësuesi duhet të miratohen me urdhër të presidentit. Kjo procedurë është e ngjashme me atë që përdoret për miratimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura shqiptare dhe komandantëve të ushtrisë, flotës ushtarake detare dhe forcave ajrore. Kjo nuk e ndalon politizimin, por shton një kontroll të pavarur mbi fuqinë e organit ekzekutiv për të caktuar këta dy zyrtarë.
- + Duhet të hiqet dispozita e kthimit, e cila lejon që ish-anëtarët e ASP-it të kthehen në detyrë. Siç është hartuar aktualisht, dispozita në radhë të parë nuk ka kufizime në rang ose pozicion që mund të zënë të kthyerit në detyrë, përfshirë atë të DPP-së, ndërkohë që nevoja dhe vlera e saj për ASP-në nuk është hartuar në asnjë dokument zyrtar të politikës.
- + AMP-ja duhet të publikojë deklaratat e pasurisë së punonjësve të policisë, kurse ASP-ja duhet të publikojë të dhënat për donacionet e marra në faqet e tyre të internetit. Kjo rrit transparencën dhe fuqizon integritetin e policisë.

SEKTORI PUBLIK:

- + Inspektorati Shtetëror i Punës duhet të përgatisë të dhëna të caktuar për inspektimet e inspektoratit në media dhe rezultatet e tyre për të garantimin e zbatimit të Kodit të Punës për të mbrojtur të drejtat e punës së gazetarëve.
- + Të dhënat e monitorimit të AMA-s (monitorimi i rregullt dhe monitorimi zgjedhor) duhet të publikohen në formate të dhënash të disponueshme për t'u mundësuar studiuesve dhe gazetarëve të përdorin të dhënat dhe të qëndrojnë të informuar për mjedisin mediatik në vend.
- + Qendra Kombëtare e Biznesit duhet të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për të publikuar në mënyrë automatike bilancet vjetore të shoqërive kur ato paraqiten në zyrat e administratës tatimore për të shmangur vonesat.

AKTORËT JOSHTETËRORË:

- + Mekanizmat vetërregullatorë dhe institucionet e mbikëqyrjes së medias duhet të angazhohen në një diskutim të hollësishëm për hartimin e rekomandimeve për legjislacionin dhe zbatimin e mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies së organeve mediatike, në veçanti lidhur me raportimin nga ana cilësore dhe transparencën e financimit.
- + OJQ-të duhet të shtojnë përpjekjet e advokimit për zbatimin e Udhërrëfyesit për një Mjedis më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023 dhe të angazhohen duke u konsultuar për një udhërrëfyes të ardhshëm për 2024-2028.
- + Organizatat vetërregullatore duhet të rrisin numrin e trajnimeve me OJQ-të, në mënyrë që ato të mund të rrisin kapacitetet për të përdorur mundësitë alternative të financimit, duke përfshirë nismat për financimin bashkëpunues, thirrjet për prokurime publike, rimbursimet e TVSH-së, përjashtimin nga TVSH-ja, të ardhurat nga veprimtaritë sociale, etj.
- + Organizatat vetërregullatore duhet të rrisin anëtarësimin e OJQ-ve në Kodin e Sjelljes dhe të shtojnë përpjekjet për zbatimin e plotë të Kodit të Sjelljes nga anëtarët e OJQ-ve të tyre, në veçanti lidhur me transparencën financiare dhe llogaridhënien dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.

NDËRMARRJET SHETËRORË:

- + Procedurat e punësimit duhet të kryhen sipas Kodit të Punës dhe mënyra e rekrutimit duhet të jetë transparente nëpërmjet një konkurrimi të hapur me qëllim përzgjedhjen e punonjësit më të aftë për pozicionin që ofrohet.
- + Ndërmarrjet shtetërore duhet të publikojnë vendimet e tyre të bordit në faqen e internetit dhe mbledhjet e bordit duhet të bëhen të ditura në rastet kur nuk përfshihen çështje konfidenciale në agjendë.

Institute for Democracy and Mediation
Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1,
1017 Tirana, Albania

Tel: +355 - 4 - 240 0241

info@idmalbania.org
www.idmalbania.org

Facebook: /IDMAlbania
Twitter: @IDM_Albania

Transparency International
International Secretariat
Alt-Moabit 96, 10559 Berlin, Germany

Phone: +49 30 34 38 200
Fax: +49 30 34 70 39 12

ti@transparency.org
www.transparency.org

Blog: transparency.org/en/blog
Facebook: /transparencyinternational
Twitter: @anticorruption